

Teodor KEKO

BIBLIOTEKA

B5H-32

K 43

Dymbëdhjetë shenjtorë  
një profet  
dhe disa njerëz

Tregime e novela

1890

## GJENOVEFA

Atëherë unë punoja kamerier në Lokalin e Morrit, ku të mbyste ty mi i bërxiollave e duhanit dhe duhet të kishe bërryla prej lojtari regbije, që të arrije ta çaje gjithë atë turmë larashe hamejsh. shoferësh, marinarësh, kontrabandistësh e policësh, për t'ua çuar në tavolinat e pista krrikllat e birrës klientëve. Por unë ua kisha marrë dorën klientëve të mi. Herë me bërryla e herë me shkëlma, gjithmonë rruga ime hapej. Kisha përfunduar fare kot në atë lokal aq të njohur e primitiv, thjesht se më përjashtuan vitin e fundit nga gjimnazi, kur u gris një fotografi e Enver Hoxhës në stendën e shkollës. Grisësin nuk e gjetën kurrë, por faji më ngeli mua, meqë një vëllai im ishte arratisur nja tre vjet më parë. Kështu që dyshimin e bënë fakt të kryer, por më ndihmuan që të filloja një punë, deri sa të rikthehesha vitin e ardhshëm në shkollë. Çuditërisht, atë vit te Morri do të riedukoheshin edhe dy kolegë të tjerë të mij, Xhimi, që kishte pështyrë mësuesen e marksizmit në shkollën e tij, një shterpë e shëmtuar që trembte edhe sorat në pemë, siç e përkufizonte ai, dhe Gjenovesën, një vajzë e urtë, që e kishin kapur me kryq në qafë, një kryq të dhuruar nga gjyshja e saj që kur kishte mbushur pesë vjeç. Unë me Xhimin punonim kamarierë në turne të kundërt, Gjenosevën e lanë të lante pjatat e të ndihmonte banakieren plakë, që duhej të ishte njeriu më gojëndyrë në rruzull. Me ne kamarierët sillej dhembshurisht. Na quante thjesht "hajdutë" dhe "plehra", por këto dy fjalë në vokabolarin e saj pervers tingëllonin si deklarata dashurije. Gjithmonë do të na qeraste çdo mëngjes me nga një dopio konjak e kafe të fortë, pastaj, ashtu, bullafiqe, me cicat stërtëmëdha mbi banak, rrinte e na pyeste se e kishim kaluar natën e shkuar.

- Bëni, qejf, vagabonda!- psherëtinte në fund, duke iu përveshur punës me një energji të habitshme.

Asaj i pati vdekur burri herët dhe, siç pretendonte ajo vetë, nga ajo ditë e poshtë nuk kishte kundruar më mashkull me syrin e dreqit. Unë nuk e besoj, për vete, por Xhimi ishte i bindur se tjetra nuk gënjente në këtë pikë...

E kush shkon me atë, o Gon, më thoshte, ka rob të gjallë t'ia hapë në krevat palat e dhjavit kësaj lope, për t'ia gjetur veglën! Le po të ra, larg qoftë sipër, pastaj! Qaji nja dhjetë brinjë!...

Më marrsh të ligat, kanosej ajo, me atë gjoksin që i bëhej mal nga inati, unë nuk kam dashur vetë, se kurvarë të qelbur zorraxhinj edhe sot më vinë nga mbrapa...E di, ia kthente Xhimi, vetëm, kur të urinosh, mate mirë në vrimë të banjës, se edhe një përmbytje i duhet Shqipërisë së shkretë...

Ata kapeshin si Tomi me Xherrin njëri me tjetrin, kurse Gjenovefa dëgjonte lëkurëkuq në fytyrë, duke qeshur mbytur. Ajo ishte një bukuri e turpshme. E hajthme, zeshkane, truphedhur, me flokë pis të zeza, deri në brez e ca buzë mishore, të bënte menjëherë për vete. Por nuk ia vlente t'ia afroheshe. Sapo i hidhje një fjalë me dy kuptime, kthente shpinën e qante. Po të ndodhej aty rrotull Mira banakierja në kësi rastesh, duhej t'ia mbathje vrapit, se mund të ta lëshonte kokës ndonjë nga ato krikllat e mëdha plot me birrë, që vinin nja dy kile të mira.

Mua po më pëlqente puna. Ndonjë lek dilte, dhe, po të flasim për atë kohë, i binte ta kisha gjithmonë xhepin plot. Me klientët bëhej store e madhe, kur dëgjoje ato historitë e tyre të pabesueshme. Më shumë liri kisha, kështu që jo rrallë, darkave vonë, i shtrirë në shtrat, uroja të panjohurin, ose të panjohurën, që e kishte grisur atë fotografinë sa një çarçaf dhe ngrija lloj-lloj planesh me mendjen time të rafinuar që mos kthehesha më në shkollë. Tani gjimnazistët më ngjanin me ca kalamaj të përkëdhelur e pa kripë. Ndoshta unë isha rritur shumë shpejt te Morri. Nuk bisedoja më për këngëtarë e për eskursione, për nota apo për vështrime adolishentësh...Tani bisedoja për gjëra serioze, për pak kontrabandë e për njerëz që vuanin burgjeve dhe, po të më tekej ta bëja atë punë, mjafton të hidhesha një vrap deri te pallati i Kacelve ngjitur, kur kthehej turni i dytë nga Kombinati i Autotraktorëve. Gjeje plot vajza të bukura, që përtonin të shkonin në shtëpitë e tyre e që i thoshin të nesërmen babit e mamit se patën punuar dy turne bashkë...

Mua më pëlqente veçmas një grua e re e divorcuar, me një vajzë të vogël, që tani është bërë balerinë e njohur dhe atë nuk kisha nevojë ta prisja, se kthehej drejt e te Morri me të zbritur nga autobusi. Hante një bërxollë të ngrohtë, sa pastroja unë lokalin dhe, si hypte në zgarën e biçikletës sime, ia mbathnim të dy në shtëpinë e saj.

Gjenovefa i shihte dhe i kuptonte të gjitha. Vetëm unë e kuptova me vonesë se sjellja e saj ndaj meje ndryshoi. Tani ishte më serioze. Nuk afrohej shumë dhe nuk i vinte më era naivitet fjalëve të saj.

Një janari, fill pas Vitit të Ri, ne kishim ngelur vetëm në lokal. Prisnim të

ngrihej një klient i sapo futur, një shofer arbani, dhe bisedonim të dy të mbështetur nga të dy skajet e kundërt për gjëra kotë. Atje unë mora vesh për herë të parë se ajo ishte një katolike besimtare.

- Mos!- m'u lut, kur unë ia ktheva se punët e Zotit ishin ca përralla të sajuara nga hajdutët dhe, po të bëhesha hajdut profesionist, si Loni me gishtin e madh të dorës së djathtë, që e kishte prerë vetë, meqë e tradhëtonte, kur iu fuste gishtat në xhep të tjerëve, kualifikimin përfundimtar do të kërkoja ta bëja si prift!

- Feja të mbush me shpresë,- tha urtë e butë ajo,- edhe kur ti mendon se të janë mbyllur të gjitha rrugët, ajo ndriçon befaz një shteg shpëtimi për ty...

- Ama shteg si ky që të hapi ty, nga gjimnazi "Sami Frashëri" te pijanecët e Morrit? Nga këto lloj shtigjesh hap nga dhjetë në ditë unë!...

- Nuk është më keq këtu,- tha ajo,- ja, ti je i mirë, nuk je spiun, si ata të klasës sime...Mira është e mirë...Xhimi...

- E ku e di, ti, se ç'hale jam unë!- ia ktheva, duke e urdhëruar të më mbushte një konjak.

Ma mbushi gotën pa fjalë.

- Po të qeras unë,- më tha duke u skuqur,- sot kam ditën e emrit. Ne kristianët zakonisht kështu i vemë emrat, në bazë të kalendarit kishtar...

Mua m'u qesh.

- Ta gëzosh!- e urova duke ngritur gotën.- Po pi edhe, ti, diçka,- shtova.

- Mirë,- pranoi ajo e skuqur,- megjithëse unë nuk pi...

Ajo mbushi një gotë vermut dhe ne i përplasëm gotat. Shoferi i urbanit mori edhe një gotë tjetër. Dukej atij nuk i shkohej në shtëpi. Po as ne nuk e kishim me ngut. Sikur po na ecte muhabeti, me ato historitë respektive të gjimnazit, për djem e vajza që na pëlqenin apo vice versa dhe, si kishim kthyer edhe gotat e dyta, unë vdiqa gazit, kur ajo më tregoi për një idiot, që i kishte shkuar në shtëpi për t'i kërkuar dorën.

- Të betohem, ishte tamam idiot!- më siguronte mes të qeshurave të papërmbajtura ajo.- I kishte sytë një në Kombinatin e tjetrit në Laprakë, apo nuk i dilte edhe shkurpë nga goja!

- Më qafsh, kishte emocione?- e ngacmoja unë.

- Kishte, thua? Ai nuk fliste dot...Mëk-mëk, mëk-mëk...më gjeti mua atëherë...

Ne po thanim edhe gotat e treta.

- E mbushim edhe nga një,- i thashë,- se po kënaqem...

Ajo ishte bërë lulëkuq në fytyrë dhe tani qeshte papushim për çdo gjë. Pranoi dhe, kur ne po i rrokullisnim, shoferi u ngrit e iku dhe unë i vura çelësin lokal, që mos na ngecte ndonjë klient tjetër, që i binte të ngrihej në mëngjes pastaj nga tavolina. Ishin ca të poshtër, që s'gjenin hotel. Me ata të pillte belaja...

Gjenovefës i kishte rënë në hije magjepëse. I ndrinte si hënë fytyra e floku në atë dritë të dobët. Ishte vërtet femër e bukur.

- E di që je bërë si yll?- e pyeta befas.

Ajo u skuq.

- Mos u tall tani!- tha me një ton lutës.- Le që kështu të dukem ty, ngaqë ti je mësuar me ato plakat e Kombinatit të Autotraktorëve...

- Je shumë seksi vërtet,- këmbëngula kot. Po seksi ishte.

Çuditërisht ajo nuk ma preu shkurt, si gjithmonë.

- Ti ia fut kot!- tha duke u përkëdhelur.- Shiko sa jam shëndoshur! Lashë nam, duhet të ha më pak...

- Nuk shikoj gjë që këtu,- ia ktheva.

- Si nuk shikon?- pyeti ajo duke bërë një rreth në banak.

Unë kapërceva banakun dhe e vendosa ta provoj një herë ta prek. Nami nuk do të bëhej. Tek e fundit, vetë po debatonte për punë shëndeti. Ia vura duart në bel, shpinëkthyer nga unë, siç e kapa, i mërmërita që këtu s'ka dhjamë, pastaj u ngjita pak më lart, deri sa arrita te gjinjtë e mrekullueshëm, të fortë e të plotë, që m'i prenë gjunjët.

- Mos!- belbëzoi ajo.- Të lutem...

Po unë nuk dëgjoja më, me kokën futur mes flokëve të saj të mrekullueshëm, që fëfërinin e lëshonin xixa, dhe me buzët të ngjitura në qafën e saj, sipër një nishani të vockël. As ajo nuk kishte shumë dëshirë të më largonte, megjithë ato mos-et pa fund që lëshonte. E mështeta më në fund në skutën e futur të banakut dhe duart e mija tani lëviznin lërisht më trupin e saj, që nuk kundërshonte më e që shfaqej gjithmonë e më i lakuriqtë para syve të mi. Tani buzët e saj puthiteshin gjithmonë e më shpesh me buzët e mija dhe, kur ia futa kokën mes gjinjve të lëshuar në liri, e ndjeva që ajo ishte vesuar e tëra. Klithmat e saj të mbytura përplaseshin pas shisheve, gotave e vozave të birrës dhe, kur ne mbaruam atë punë të bërë qenërisht, ishim shpërfytyruar të dy.

- Po mua, ç'm'u desh?- dënosi ajo.

Asnjëherë nuk kisha ndjerë keqardhje për njerëzit, për të mos thënë që isha komplet injorant në aktin e ngushëllimit. Kurse Gjenovefa më preku.

- Mos qaj!- i thashë butësisht.- Unë të dua!

- Mos gënje, se do të të vrasë Zoti!- më tha...

Të nesërmen nuk erdhi më në punë. Unë e kërkova, e kërkova shumë, por ajo nuk më doli për një kohë të gjatë përpara. Atëherë unë e desha vërtet dhe vonë, kur ne qemë "ribërë njerëz", u takuam në një aktivitet që zhvillohej mes dy gjimnazeve tona. U përqaftuam si miq të vjetër, por ajo nuk donte të bisedonte më për atë që pati ndodhur krejt rastësisht një natë në lokalin e pisët. Tani është bërë grua, një grua e bukur, serioze, me dy binjakë të vegjël, që nuk ka perëndi, veç saj,

t'i dallojë. Qëllon të takohemi në rrugë dhe gjithmonë përqaftimi i saj më jep një ndjenjë trishtimi. Kryqin, që e flaku një vit nga shkolla, e ka gjithmonë në qafën e bukur, kurse unë nuk u bëra kurrë prift, o sepse dëgjova lutjen e saj, o meqë nuk i hyra karrierës së hajdutit...

**FRANCË, KORRIK 1996**

## VARRIMI NËN SHI

Korteu i zgjatur qëndroi më në fund në një malore të lehtë, që hapej menjëherë mbas brezit të lisave në një lëndinë të bukur. E ulën arkivolin buzë një grope me dhe të freskët anash buzëve të saj, pastaj shumica filluan të pastrohen nëpër pellgjet e rrugës së porsahapur. Gjithë ata njerëz me emër, me celularë e radio nëpër xhepat e tyre apo të bodiguardëve, qenë bërë baltë e gjallë. Ç'përbaltën këpucët, ashtu, shkel e shko, fërkuan pantallonat, për të hequr të paktën baltën e tharrë, dhe u mblodhën sërisht rreth arkivolit. Kishte filluar lutjet e tij hoxha. Për drej, atë çast ia nisi edhe një shi i ri, i imët tashmë, por që të futej drejt e në eshtra. Nestori uroi Zotin, që i dha aq mend, sa ta merrte në mëngjes çadrën me vete. E ndjente kokën e rëndë. Kishte pirë një natë më parë deri pranë mëngjesit dhe, duket, nuk qe çliruar akoma nga gjithë ai alkool i futur në trup. I strukur nën çadër, nuk mendonte për asgjë. Vetëm shihte pemët e bukura e stër- të- mëdha. Dhjetë vjet më parë kishte bërë zborin tremujor fill pas mbarimit të studimeve universitare në repartin ushtarak bri varrezave. Atëherë nuk kishte qenë as gjysma e këtij territori e pushtuar nga varret. O kanë vdekur me shumicë këto dhjetë vjet, ose të vdekurve ka filluar t'iu pëlqejë klima malore, tha me vete ai. Ndryshe nuk mund të shpjegohej gjithë ky zgjerim...Pastaj i zuri syri bri tij një vajzë që po bëhej qull në atë shi pikëvogël. Flokët e zinj me ca onde të lehta po shtroheshin gradualisht, si një fëmijë i vogël, që, mbas shumë përpëlitjesh, nis e i dorëzohet gjumit. E kundroi qetësisht tjetrën nga pas, të zhytur në një pallto të madhe të zezë, që nuk të jepte të kuptoje asgjë, nëse kishe të bëje me një femër të kolme, apo me ndonjë karakatinë këmbështrembër nga ato që ua çuan mendjen konstruktorëve primitivë të shpiknin urat. Nga pas dukej një trup i drejtë, me shpatulla të bukura, por, sikur ajo t'i



përdorte suporet, i binte të ishte në thelb një dordolec fushe...Atëherë vajza ktheu kokën, kush e di pse, dhe ai dalloj i habitur një portret të bukur, të skuqur nga thëllimi, me një hundë nazike, mes mollëzave paksa ovale, që zbrisnin në një mjekër të hollë dhe një goje mesatare, me buzë mishtore, që ajo i lëpinte mekanikisht herë pas here. Nestorit i bënë përshtypje sytë e saj. Ato ishin të mëdhej dhe të errët, ca sy edhe pa shprehje, edhe misteriozë, me qerpikë të gjatë e paksa vëngëroshë, o nga natyra, o nga përhumbja.

- Po të duash, mund të hysh në çadër,- e ftoi Nestori tjetrën.- Edhe inglizi e ka bërë për dy njerëz,- shtoi ai, si për t'i treguar tjetrës që i kishte bërë një ftesë formale, më shumë të shtyrë nga dëshira e konstruktorit të këtij shimbajtësi anglez.

adra ishte vërtet e madhe. Tjetra e pranoi ftesën. U afrua bri tij. Kur supi i saj e preku, Nestori e kuptoi se ajo po dridhej...Kjo, që ka kaq ftohtë, duhet të ketë ca pika gjak jevgu, mendoj ai, duke kujtuar pastaj fluturimthi ata pak ciganë që i kishte rastisur të takonte në jetën e tij. Më intersanti kishte qenë Renatua, me gjithë ato vëllezër e motra, shumica e të cilëve mbanin emra të anëtarëve të familjeve mbretërore...Elisabeta, Huani, Karli, Andrea, Gresi...Nisi të nuhaste mekanikisht se mos vajza difuzote atë aromën karakteristike të romëve, por s'nuhati gjë.

-...Ju jeni njeri i familjes?- po pyeste vajza.

- Jo,- ia ktheu Nestori,- unë kam qenë shok bange për dymbëdhjetë vjet me vëllain e vogël të tij...

- Mendova mos ishit i familjes,- përsëriti tjetra.

- Jo,- përsëriti ai,- mua më kanë vdekur me kohë njerëzit e mi. Unë jam jetim,- saktësoi,- tridhjet e dy vjet më parë, si sot, më gjetën në derën e një kishe në Elbasan. Më quajnë Nestor. Ma ka vënë emrin prifti. Është emër shenjtori katolik, por unë nuk kam ndonjë lidhje me shenjtorët...

- Më vjen keq,- tha vajza e prerë,- nuk e dija...

- Nuk ka problem,- tha Nestori,- unë jam mësuar tashmë. Nganjëherë mendoj se kam patur fat, që më braktisën. Vetmia më pëlqen dhe vdekjet brenda fisit nuk i kapërdij dot. Kur të vdes vetë, akoma nuk ka rënë miu në pjatë?...Tek e fundit, ndjehem i lumtur që nuk i kam njohur as për fytyrë prindërit e mi. Mund të qëllonin ndonjë xhins diktatori...

Tjetra qeshi mbytur. Iu prish disi ekuilibri dhe ai ia ndjeu gjirin e fortë në sup. Tani të ikurin po e ulnin ngadalë në gropë, mes ca të qarave, që u ngjasonin ulurimave të derrave të egër në pyll. Ajo e pa portretin e ngrirë të tjetrit, atë moskokëçarje kriminale dhe u bë vërtet kurioze.

- Gjynah!- tha ajo.

- Po,- ia ktheu ai.- Ato lulet artificiale po ia hedhin shumë vandalisht mbi kokë. Rrezik, i është ngritur ndonjë xhungë tani. Po u çua, gjëja e parë që do të

kërkojë, do të jetë ndonjë dhjetë leksh hekuri...

Tjetra kukurisi përsëri.

- Lash nam,- tha pastaj,- isha më mirë në shi. Edhe nuk qeshja, edhe dukej sikur po qaja...

- Shiu nuk i bën mirë vetëm bujqësisë,- proverboi Nestori me një vështrim që i bridhte në një hapësirë të pafundme varresh.- Thua është edhe ndonjë nga formuesit e mi në këtë pellg kufomambajtës?- pyeti papritur.

- Nuk besoj,- tha ajo.- Prindi nuk vdes, pa e parë edhe një herë sëmijën e tij...Më shumë ka mundësitë të jetë ndonjë fytyrë e pikëlluar pjesëmarrëse në funeralin tonë,- kukurisi ajo.

Qeshi lehtë edhe Nestori. I pëlqeu eleganca e mendimeve të tjetrës. Pastaj, tek flakëriheshin baltovinë e lule mbi varr, ata nisën hipotezat rreth prindërformuesve të mundshëm të Nestorit, duke ndaluar te ca burra e gra në moshë, deri sa ngelën me një bindje gati absolute te një flokëkashitë, që Nestori e përcaktoi si njeri të fekonduar përmes shartimit me një kokërr luidhër dhe s'kishte më kuptim të vazhdonin qëndrimin në ceremoniën funebër. Ajo nuk e mbante dot të qeshurën. Ia mbathën të dy drejt makinës së Nestorit, me një ecje tejet të pikëlluar e me një të qeshur të mbytur, që nga pas dukej ngashërimë klasike, dhe pesë minuta më pas, duke qeshur më në fund lirisht, ndodheshin të ulur te klubi KENEDI. Kundronin shiun që varej nëpër xhamet e mëdhej e fushën e trishtuar rrethuar nga një gri mortore.

- Po, ti, ç'deshe në varrim?- e pyeti Nestori.

- Jemi komshinj,- tha tjetra.- Kur u martua, ai erdhi në një apartament ngjitur me shtëpinë time...

Nestori u kujtua pastaj për më kryesoren: nuk i dinte akoma emrin. Por ajo nuk ia tregoi.

- E pse duhet ta rëndosh kujtesën kot,- tha, duke fërkuar vathët në veshë, pa ia ndarë vështrimin.- Më thirr si të duash! Është më demokratike, apo jo?

Atë po e tërhiqte kjo vajzë, por ende nuk kuptonte se si mund t'i afrohej më shumë, pa e frikësuar e pa e detyruar t'ia fuste vrapit shpëtimtar në mes të shiut. Një zë i pëshpëriste nga brenda të bënte kujdes. Kjo vajzë nuk dukej se i pëlqente intimitetet e tepëruara.

- Pat,- tha ai.- Unë po të thërras Pat. Ky emër më ka pëlqyer gjithmonë...Ti mund të më thërrasësh shkurt Tori...

- Pat,- përsëriti ajo.- Pat...Emër i bukur, por njerëzit që janë quajtur kështu nuk kanë pasur fat të mirë...

Tori e ndërpreu.

- Pat Holmani vërtet vdiq, por, për të vdekur, të gjithë vdesin. Këtu nuk ka punë fati. Ajo ishte vajzë me fat, përderisa nuk i rrëshqiti këmba në dashuri...Nuk

e zgjedha kot emrin Pat!

- E ku e di, ti, a kam patur fat dhe a do të kem fat në dashuri unë?- pyeti me cinizëm ajo.

Tori mori një shprehje prej njeriu të mërzhitur e bezdisur njëherësh. Jashtë shkrepëtiu një rrufe e fortë, a thua tështiu nga goja apo nga pas ndonjë shenjtor i shëndetshëm.

- Se si e ke patur fatin, këtë vërtet nuk e di dhe, tek e fundit, as më intereson hiç, përderisa është një gjë e pandryshueshme tashmë. Kurse që do të kesh fat të mrekullueshëm në dashuri, duke nisur nga dita e sotme, për këtë garantoj me kokën time! Se këtë gjë, deri në një masë të caktuar, e kam në dorë edhe vetë...

Asaj iu shpif një e qeshur prej budallai. Si i kishte lidhur fjalët e mendimet ky njeri, që nuk ta mbushte mendjen për një tru aq diabolik në pronësi! Sa bukur ia kishte hedhur në tavolinë gjithë ç'mendonte!

- Ti je fantastik!- i tha duke fshirë lotët.- Por harroje atë muhabet! Tani këto lloj marrëdhëniesh nuk më interesojnë absolutisht fare!...Më shumë jam e interesuar të fus ndonjë kapital më fajde. Janë rritur shumë përqindjet...

- Unë jam demokrat,- tha Nestori krejt seriozisht,- dhe kam një respekt të shenjtë për opinionet e të tjerëve lidhur me personin e tyre, fjala vjen, por kjo nuk do të thotë se nuk kam respekt edhe për mendimin tim, sado idiot qoftë. Është problemi jot, nëse do të bëhesh murgeshë, apo pëlqen rrugën e asketizmit. Unë kam për detyrim personal të deklaroj atë që po ndjej për ty këto çaste: që je shumë interesante, që më pëlqen aq shumë, sa më vjen të të puth tani, në tavolinë!...Ti mos e respekto, po nuk pate dëshirë, këtë ndjesi që vjen jashtë personit tënd!

Pat i ndjeu se kjo bisedë po rrëshqiste në ca ujëra si të turbullta, mirëpo edhe i vinte për të qeshur, edhe po e kuptonte qartë se logjika e këtij njeriu lidhej në një mijë forma në një vend dhe nuk ishte e lehtë t'ia ndryshoje mendjen.

- Po e tepëron,- e këshilloi ajo, më shumë për ta larguar, duke veshur një tis prej të fyere në fytyrë, mirëpo atëherë, krejt pa pritur, ai u zgjat drejt saj në tryezë dhe i këputi një të puthur të gjatë në qafë, që ia bëri sakaq mishin kokërr.

- U ngopa!- psherëtiu i kënaqur ai.- Tani më iku uria. Nuk më hahet më!

- Paskë qenë fare budalla!- tha e skuqur dhe zëulur ajo.

Nestori bëri një lëvizje me dorë.

- Idiot!- tha ai.- 'pret,- shtoi pastaj,- nga një njeri i rritur në shtëpinë e fëmijës.

Asaj iu shpif përsëri e qeshura, por befas seç ndjeu një keqardhje të thellë dhe, si u zgjat edhe ajo në tryezë, e puthi krejt pa kuptuar tjetrin në faqe.

- As mua nuk më hahet tani,- tha edhe ajo gjithë purpur në fytyrë.

Jashtë kullonin ujëra. Ajo ishte njëzet e një vjeç, puthte për herë të parë një njeri, as që pati guxuar ta çonte nëpër mend se këtë ndërmarrje historike do ta kryente në mes të një lokali, faqe kamarierëve e banakierëve dhe, aq më tepër, me

një njeri krejt të panjohur, pa nënë e babë, me një trung gjeanalogjik të kalbur e që, nga të gjitha gjasat, i binte të ishte më shumë xhins kunadhesh. Ndjente një marrje mendsh. Gjithë kjo ngatërresë e habitshme iu bë lëmsh fare, kur e plotësoi tablonë e marrë edhe me atë tjetrën, që e kishte njohur Nestorin gjysmë ore më parë në një funeral.

- Si ndodhi kështu?- pyeti ajo përhumbshëm.

Nestori e dëgjonte me vështrimin përtej xhamave të mëdha.

- Ka një logjikë,- ia nisi pastaj,- unë sot kam ditëlindjen. Jam shenjtor. Vërtet shenjtor rrjepacak, pa nënë e pa baba, por Zoti nuk mund të më harronte dhe, për të mos më lënë vetëm fare, më këshilloi të merrja çadrën në mëngjes e të vija në funeral. Duket, ai e dinte se atje do të ndodheshe ti...Për mua, kjo punë shkoi mirë. Gjithmonë sipas meje, kanë shumë më tepër vlerë, nga sa mendon ti, njerëzit që më qëndrojnë afër...

- Dakort,- tha ajo,- por unë e kisha fjalën se këto marrëdhënie kanë një vijim logjik, duhet të lidhen me një ideal, dreqi ta marrë. Pikë respekti nuk kemi as për idealet e as për fatet tona...

✕ Ideali është monument në atë vend ku shoqëria ka respekt për të gjitha idealet,- tha ai pa i hequr sytë nga peizazhi i qulltë përtej.- Kurse këtu ka vetëm një ideal të shumërespektueshëm: O Mete, për vete!...Pesë vjet më parë më pëlqente një vajzë. Vendosa të martohem me të, por nuk më lejuan. Pse? Sepse nuk isha i pasur dhe nuk kisha nënë e babë, megjithëse dorëzova në familjen e saj edhe analizat e gjakut komplet! Harxhova kot një litër gjak! Dashurija dhe respekti nuk u konsideruan pasuri...

- Ku ndodhet tani ajo vajza?- pyeti Pati.

- Nuk e di,- tha ai,- nuk u interesova më. Ndoshta punon shitëse në ndonjë dyqan mode. Kishte trup të bukur dhe një sensualizëm tepër të lexueshëm...

- Po, ti, ku punon?- e pyeti ajo, duke menduar me vete se edhe ky jetimi nuk ishte për t'u nënvleftësuar në të parë.

- Unë jam avokat i tre kompanive të huaja,- tha ai,- jam specializuar në Nju Jork për të drejtën ndërkombëtare, plot dy vjet...Më pajton ndonjëherë edhe shteti, kur ka konflikte të thella me investitorë të huaj...

- Qenke xham,- bëri tjetra.

Nestori tundi kokën mohueshëm.

- Leku është gjithçka, sa nuk e ke,- shtoi pastaj me zë. I ra kraharorit nga ana e zemrës me grusht dhe tha: Po nuk këndo i kjo, leku është kallp!...Ikim tani?- pyeti befas dhe sakaq ndodhej në këmbë. Ishte e qartë. Kush e di ç'i qe kujtuar, që i iku humori tërësisht.

Ai e puthi edhe një herë te dera tjetrën, këtë herë tamam m'u në qendër të buzëve, gjithë pa i marrë leje, pastaj e shoqëroi pa folur deri pranë shtëpisë ku

banonte, i përkëdheli lehtë flokët e bukur në ndarje me një dorë tejet prindërore dhe i tha ngadalë:

- Qofsh mirë, Pat! Ishte vërtet një kënaqësi njohja me ty...

- Po të duash, më bëj ndonjë telefon,- tha tjetra,- nuk më shqetëson fare...Ca gjëra nuk më pëlqyen, por edhe unë jam përgjithësisht e kënaqur...

- Do shihemi me siguri në ndonjë vdekje,- tha shpërfillshëm ai.- Këtu vetëm vdekjet janë me shumicë...

Ajo e pa tek i dha gaz makinës, duke u zhdukur sakaq. I dukej vetja sikur sapo qe zgjuar nga një ëndërr e çuditshme. Ndjente ende në fytyrë buzët e ngrohta të tjetrit dhe iu mbushën sytë me lot. Kishte qenë aq i mirë, aq rebel, aq moskokëçarës e aq i sjellshëm, kurse ajo as emrin nuk denjoi t'ia tregonte. Pse, pyeti veten, duke u kthyer për në shtëpi. Pse? Ishte trill, apo frikë? Në shkallë kishte shumë hyrje-dalje. Dëgjohej turbull një e qarë e ngatërruar, pa fillim e pa fund, por asaj delikatese, që nuk dëgjonte dot as edhe një mace të mjaulliste, iu duk normale që njerëzit të qanin. Ishte koha për këtë punë, ja, edhe jashtë binte shi...

1996

*Nestori ka qenë grek dhe ka jetuar në kohën e perandorit Dioklician, që e përbuzte fenë e re të Krishtit. Nestori ishte ihtar i kësaj feje. Nestori del në skenë gjatë zhvillimit të garave në stadiumin e Selanikut, ku ndodhej edhe perandori. Në këto gara ishte absolut një atlet trupmadh, me të cilin nuk guxonte të ndeshje askush. Kasneci provokoi të krishterët, duke thënë se, nëse ata kishin një perëndi, le t'i ndihmonte ajo për ta mundur atletin e pamposhtur pagan. Nestori, i fyer, shkoi në burg dhe i mori leje mësuesit të tij shpirtëror, shën Dhimitrit, i cili qe burgosur nga Diokliciani po për shkak të përhapjes së fesë së krishterë, që të ndeshje me atletin pagan. Shën Dhimitri ia dha lejen dhe u fal për të. Nestori hyri në arenë dhe, për-habinë e të gjithëve, e goditi për vdekje atletin pagan. Paganët shkelën çdo rregull etik dhe kërkuan vdekjen e Nestorit, udhëheqësit të rinisë së krishterë të Selanikut. Perandori hezitonte ta firmoste këtë turp, por presioni pagan u zgjerua shumë. Ai lejoi më në fund t'i pritët koka Nestorit, por ky qe një ekzekutim më shumë se i turpshëm. Menjëherë shën Dhimitri, i cili e mori vesh në burg të vërtetën, shkoi para xhelatëve dhe kërkoi të egzekutohej, duke thënë: "...viktimat do t'i mposhtin vrasësit e tyre!" Ky është shpjegimi që jep Kisha Ortodokse, e cila e feston shën Nestorin jo në shkurt, si Kisha Katolike, por më 27 tetor.*

## MË PESË MARS

Në orën tetë të darkës, Matilda ishte gati. E veshur me minifundin e zi, e lyer me kujdes, ajo kundroi me kujdes gjoksin e bukur, që shpalosej nën delkotenë e gjerë. Nuk i dhimbte më mesi. Ndoshta, sepse edhe ajo dhembje e vazhdueshme e kishte fare të qartë se tani po trokiste ora e punës, e cila do të përfundonte, kur në xhep të qenë mbledhur një milion lireta. Matilda korigjoi edhe diçka në lyerjen e lehtë të buzëve, pastaj thirri nga dhoma e saj. Ishte gati. Landi, pronari i saj, po e kundronte duarfutur në xhepa nga dera e hapur paksa. I bënte përshtypje kjo femër e pafjalë, kjo vajzë e parritur ende, që kishte ngrënë aq dru, për të pranuar të dilte në rrugë, dhe që ishte ushqyer nja dy javë të mira vetëm me bukë e ujë, deri sa e uli kokën e u bë qingj. Ishte e freskët, e paprishur ende nga prostitucioni, kundërmonte vërtet aromë vajze, po t'i qëndroje pranë, dhe, ta shihje në butikë, kur dilte të blinte ndonjë veshje, mendoje se duhej të ishte një studente që rridhte nga ndonjë familje e mirë. Ia kishte blerë Matildën një beratas të krimbur në borxhe për pak gjë. Ai e pati mashtruar Matildën me ca plaçka të shtrenjta e sende floriri, duke i premtuar martesë e parajsë, dhe, si e solli në Itali me një skaf kontrabandistësh, e hoqi qafe për pesë milion lireta te Landi. Beratas dukej i trembej ndonjë hakmarrjeje të çmendur të Matildës, sepse rathët e syve i kishte sterrë. Me siguri nuk pati vënë gjumë në sy prej ditësh. Landi ia numuroi loretat në dorë tjetrit, me ta parë njomëzaken dhe, që natën e parë, filloi ta përdhunojë rregullisht një javë me rradhë, pa pushim, me të gjitha stilet e kafshëritë që afronin revistat pornografike... Tani kjo kokëfortë e dikurshme, që e kishte bërë kokën gjithë gunga, duke i rënë si e marrë mureve me kokë, ishte shndërruar në një minierë floriri. Brenda katër muajve kishte ngritur një klientelë të lakmueshme edhe nga prostitutat e kualifikuara dhe rrallë e për mall i binte fati të qëndronte duke u dridhur në rrugën e ftohtë pranë katedrales në pritje të klientëve. Landi e dinte se tani do të

shkonin të pinin një kafe te Fontana. Në tetë e gjysmë do hynte në lokal Xhixhi, sardenjasi i thinjur, që nuk dinte ku ta prishte pensionin prej ish-diplomati. Ai kishte punuar gjatë andej nga Amerika Latine dhe vdiste për këto bukuroshe të pashartuara, siç i quante. Do paguante kafetë, pastaj do ta merrte Matildën një orë në shtëpinë e tij. Ishte e enjte dhe çdo të enjte, në tetë e gjysmë, Matilda ishte e Xhixhit. Ajo do të kthehej në orën dhjetë, do porosiste një limonatë, duke i zgjatur lekët Landit, dhe do të ulej me Patricion, që ia kishte paguar kaparin pronarit të saj dhe po e priste prej çerek ore. Patricio ishte kasap, siçilian i butë. Ai punonte në Milano dhe kthehej një herë në vit pranë familjes. Ai do ta sillte në orën dymbëdhjetë. Mbas mesnate qëllonte që pronari i Fontanës t'i bënte një shenjë Matildës, për të hyrë mbas banakut. Ai ishte një zeshkan nja dyzet vjeç dhe Landi e dinte se Matildës sikur i binte pika, kur ia shkelte syrin me një tundje koke pronari. Ishte hamshor që donte shërbim të mirë!...Pastaj vinte e premtja, pastaj e shtuna, gjithë natën me doktorin e syve, që kishte një mal me para, pastaj e diela...Më pa Zoti me këtë femër, psherëtiu Landi, duke kujtuar Shqipërinë. E kishte xhepin të ngrohtë tani dhe asgjë nuk i mungonte. Kishte edhe për vete, edhe për Matildën, edhe për ata të shtëpisë, edhe për fëmijët që do të lindte, po të martohej ndonjëherë...

Pesë minuta më pas ndodheshin të ulur te Fontana. Porositën kafe dhe ia nisën ca bisedave kot, që shkonin nga shkonin e ngeleshin te Shqipëria. Matilda shihte përhumbshëm nga porta, andej nga do të shfaqej Xhixhi i parfumuar, me mendjen larg, te familja e saj e vogël, që rronte me pensionin e babait dhe asistencën e nënës. Hamendësonte se ç'po bënin atë kohë. A kishin drita, të paktën? Sikur e shihte të gjallë nënën, duke gatuar në furnelën e vajgurit makaronat me vaj, babain duke lexuar gazetën e dhuruar në kafe, vëllain që bridhte rrugëve...Shihte përhumbshëm pikturat e saj të vendosura stivë mbi dollap. Kujtonte Liceun dhe pastaj ditën që shkoi si idiote mbas atij mashtruesit të fëlliqur. Mesnatën në Orikum, tek hypnin rresht, pa folur në skafin e madh, duke paguar me rradhë lekët e udhëtimit, që nuk i dihej fundi, mëngjesin në stacionin e boshatisur të Barit dhe përzierjen e saj me një grup studentësh, me t'u shfaqur policia në stacion...lu mblodhën lotët në fyt, kur kujtoi se me ç'fytirë do të kthehej përsëri në Tiranë. Landi i kishte premtuar se mbas dy vjetësh do ta lëshonte, por një Zot e dinte nëse do ta mbante fjalën, megjithëse tridhjetë përqind të fitimit deri tani ia çonte rregullisht në bankë me llogarinë e hapur në emrin e saj. Fshiu një lot me kujdes, që mos t'i prishej tualeti, dhe pyetjes së tjetrit iu përgjigj se sonte sikur nuk ndihej mirë për punë.

Landi u err. Egërsohej në çast dhe bëhej kafshë, në të tilla ato fjalë për t'i kërkuar pushim. Zanati i saj s'varej nga zemra. Vetëm deshte t'i tregonte se sonte ndihej e mërzitur...

- M'u kujtuan ata të shtëpisë,- tha,- kush e di ç'po bëjnë tani...

- Dëgjo,- tha tjetri,- ti, edhe për ata po punon këtu. Mbas një viti e gjysmë do jemi të gjithë të pasur. Po të ngeli mendja andej, do vdesësh si qen në mes të Milanos. Ka edhe këtu njerëz që jetojnë pa bukë, pa ujë e pa drita...

Por e ndërpre në bisedën. Krisi zilja e derës dhe, ja, tek u shfaq Xhixhi. U ul gjithë xhentesë në tavolinë, porositi edhe ai një kafe, pastaj pa orën. Dy minuta më pas ata dolën, duke e lënë Landin në tryezë. Matilda ecte dy hapa pas Xhixhit, e mbështjellë me pallton e gjatë, duke vështruar vitrinat përmbri. Apartamenti i Xhixhit ndodhej fare pranë. Mbas Tratorisë së atyre napolitanëve llafazanë, porta e hekurit, kati i dytë...Dera kuiste pak, duhej lyer me vaj. Pallto duhej rrëzuar nga supet që në prag, këpucët duhej të fluturonin shpërfillshëm në koridorin e gjatë, te maska e asaj shëmtirës inkase duhej varur bluza, kurse minifundi me gjithë çorapet hiqej para syve të ndezur të Xhixhit, që e shihte duke u dridhur nga cepi i shtratit...Pastaj...Po ajo pije, po ajo muzikë dhe po ai stil, me po atë fjali në fund "Sot ishe e mrekullueshme!"...

- Sot ishe e mrekullueshme!- rënkoi Xhixhi fiks në orën dhjetë të natës.

Matilda kishte ndër një keqardhje për këtë mashkull, që po e vinte jeta poshtë tashmë, dhe qe përkujdesur seriozisht në shtrat për Xhixhin. I qe parë aq i rrëgjuar në rrugë, megjithë përkujdesjet e tij të pafundme për t'u paraqitur sa më i ri e elegant, sa që i ngjau me babain e saj!...Kështu do të bëhem edhe unë, trishtoi me vete, tek vishej ngadalë, gjithë para syve të Xhixhit, për t'i dhënë edhe një kënaqësi të fundit.

- Dëshiron ndonjë kafe?- e pyeti befas Xhixhi.

Ai nuk ishte tip sentimental. Nuk i kishte në natyrën e tij këto përkujdesje ndaj kategorisë së Matildës. Ajo pa orën thjesht për ta menduar shpejt përgjigjen. Mjeshtëria e re e kishte shndërruar në mosbesuese. E dinte shumë mirë se mes këtyre ashikëve gjendeshin plot pisanjosë, siç e dinte se çdo natë koleget e saj mashtroheshin, rriheshin apo bëheshin copa-copa. Megjithatë, pranoi. Një mendje i thoshte se Xhixhi sonte ndihej keq.

- Rri,- i tha ajo,- se kafetë i bëj unë...

Vuri ekspresin në guzhinë, nxori pak qumësht nga frigoriferi, mori ca biskota në raftet mbi kokë, i vendosi të gjitha në tabaka dhe u kthye në dhomë. Xhixhi ishte veshur tashmë. Ai qëndronte në skrivani, duke kërkuar diçka në një kuti, që ajo po e shihte për herë të parë. Nxori nga andej një unazë të mrekullueshme dhe ia zgjati Matildës.

- Është dhuratë për ty,- i tha.- Ka qenë e nënës sime, por unë nuk kam ndërmend të martohem ndonjëherë. Ti sot ke ditëlindjen...

- Nuk e kam sot ditëlindjen,- belbëzoi sinqerisht Matilda, megjithëse unaza i pëlqeu.



- Sot ke ditën e emrit,- e sqaroi Xhixhi.- Sot është dita e santa Matildës. Ka qenë një shenjtoare me histori të gjatë, por një herë tjetër do ta tregoj jetën e saj...

Ai ia vendosi unazën në gishtin e parafundit të dorës së majtë, kundroi atë dorë të brishtë, ia puthi lehtë, pastaj i zgjati loretat. Matildës i erdhi zor t'i numuronte dhe i futi sakaq në gjirin e hapur. E puthi tjetrin dhembshurisht në faqe, vështroi edhe një herë e lumtur unazën që shkëlqente në dritën e zbehtë, mërmëriti një "faleminderit" dhe kërkoi leje të ikte. Lekët i numuroi në shkallë. Ishin shumë, gjysmë milioni lireta, ishin gjithsej gjysmë milioni lireta dhe tepricën ajo e futi në një të çarë sekrete të palltos nën jakë. Nga brryli i rrugës pa dritat e kafes, ku po e priste Landi me Patricion, pastaj kujtoi përsëri Xhixhin. I erdhi keq që e la vetëm. Sepse iu duk tmerrësisht i trishtuar. Po ç'të bënte? Patricio po e priste vërtet. Ajo ia loretat e Xhixhit Landit, pastaj doli me tjetrin. Ky do ta çonte në një shtëpi të vogël katër rrugë më tej. Dera e tij nuk kërciste. Atje do të xhvishej në dhomë, pa u nxituar, si tjetri, do t'i palosnin rrobat të dy po aq me kujdes, pastaj do të futeshin në shtratin e pastër. që, sidoqoftë, vinte pak era mish, dhe ai do t'i lutej përsëri që ajo ta pranonte pa kontraktivë. Pastaj do t'i hypte sipër Patricios, do ta guduliste pak dhe, kur të fillonte ajo punë, duhej t'u përgjigjej pyetjeve të tij provokuese. Në fund, ai mund t'i falte njëzet mijë lireta, duke e porositur një qind herë se këto nuk ishin për Landin, por për Matildën...

Tani ndihej vërtet e mërzitur. Një ditë emri pa të papritura! Ngjiti shkallët që të çonin në shtëpinë e Patricios, priti sa të hapte derën tjetrin, dera nuk kërciti, u xhveshën të dy ngadalë në dhomë, palosën plaçkat gjithë kujdes, hynë në shtrat dhe ajo dëgjoi zërin e tij të qurravitur:

- Do ta bëjmë pa prezarvativ sonte?

Nuk kishte patur asnjë të papritur nata e sotme.

- Mirë!- pranoi çuditërisht ajo, duke fshehur një përlojtje të befte.

Kishte ditën e emrit dhe shenjtoret një ditë në vit duhet të jenë sjellë historikisht mirë...Nuk dinte asgjë, as për santa Matildën e as për shenjtët në përgjithësi, por në këtë pikë sepse ndihej fare e sigurt.

1996

## MARKO EVANGJELISTI

Klubi thujse po boshatisej nga klientët e tymi i duhanrave, kur aty nga ora njëmbëdhjetë e darkës u duk në derë si i bukuri shejtan Marko evangjelisti. Në fakt, Marko ishte çoban, një arumun i degjeneruar, siç e quanin me përkëdheli në gazetë, por mbiemri evangjelisti i pat mbetur që nga vite të shkuara, pa ndonjë arsye serioze, që ia vlente ta mbaje mend, përderisa edhe Marko ngrinte supet, sa herë e pyesje. Ai i rrotulloi një herë nëpër lokal ato sytë e tij të flohtë, që nuk u shpëtonte asgjë, vëzhgoi kush shërbente në banak, pastaj shkoi e u ul në tavolinë me grekun, pronarin e klubit, që po pinte birrë me një gazetar.

- Si jemi sot me të drejtat e njeriut?- pyeti Marko.- Sikur nuk dalloj shumë optimizëm. Ka ndonjë shkelje këtej nga minoriteti grek? Mua ma fshiu një ditë pune nga rroga ai nordiku im,- shtoi gjithë qejf, duke porositur konjak.

Sytë nuk i ndante nga banaku. Tani po priste rastin t'i pyeste punonjësit e lokalit, nëse iu kishte prerë ndonjë ditë pune, si zakonisht, pronari, ky grek si skuth që i qëndronte përbri dhe i donte të gjitha të drejtat e njeriut për shpirtin e vet të panginjur.

Kishte pirë dhe veçanërisht në këto momente vdiste të ngacmohej me grekun. I shkaktonte një lloj alergjije me krruajtje ky pronar pordhac, që kush e di ç'mik të fortë i kishte futur Zotit, derisa i Plotfuqishmi bënte sikur nuk shikonte dhe e linte këtë kërmë gjallë akoma.

- Ah, po, ti, nuk je për punë, o bir,- psherëtiu greku.- Le që, ti, nuk je për asgjë! Si kallëp, të merr në qafë, po nga brenda je i krimbur i gjithi!...Të lesh ndonjë çupkë me barrë, rrezik lind një hardhuckë të vogël, e shkreta! Të gjithëve u bëhet gjaku ujë, ty të është bërë sperma ujë i distiluar!...

Marko tundi kokën e tij simpatike në shenjë miratimi. Ishte vërtet goxha maskull, që të merrte në qafë me vështrimin pjerrtas mbushur me cinizëm e ironi dhe trupin e thatë e muskuloz. I futi një të kthyer konjakut me fund, pastaj kërkoi edhe një tjetër.

- Futi edhe pak limon, - i tha banakieres.- Ta pi edhe unë si greku, mbase më kap edhe mua në ndonjë cep për gryke fati i këtij mortjes...Ta hap edhe ndonjë klub, si puna e këtij, që më është bërë si ato ushqimore e katundeve në kohën e Enverit, ku gjeje edhe bukë, edhe kripë, edhe gozhda...Edhe këtu, çfarë nuk gjen, nga ca njerëz si puna ime, deri kurdë e grekë!...Po ç' merrem edhe unë me një njeri që e ka mbiemrin më të gjatë nga trupi!- e mbylli ligjëratën ai, duke kujtuar mbiemrin e stërgjatë të grekut shtatshkurtër.

Banakierja, një bionde e freskët me gjoks të bukur e një portret interesant, qëndronte si mbi gjemba. I trembej për vdekje grekut. Ai ishte xheloz. Nuk të falte as po të nuhaste se po shihje ndonjë klient, jo më të shkoje me të, apo të ishte e pranishme, kur e tallte ndokush. Të qërronte nga puna për hiç gjë ky kriminel xheloz. Kurse ajo mbaronte me gjithë lecka, po ta humbte këtë vend pune. Pastaj, në rrugë, nxirr gishtin e madh përpara dhe, hë, autostop!...

- Do gjendet ndonjë patë edhe për ty,- u tregua zemërgjerë greku,- se me ato zogat e mija, më vjen keq, por nuk afroresh dot...Ti, e kupton vetë, po ta ngulnin surratin tënd te dollari amerikanët, nuk do të kishte burrë në botë ta fallcifikonte më! Ti, veç si aspirinë për kambistët vlen...

Ai pa gjithë nënkuptim andej nga banaku, me një zgërdhirje që sa vinte e zaptonte terren në fytyrën e tij plloçake.

Në këtë pikë nuk gënjente. Ishte një përdhunues manjak i kamariereve e banakierëve dhe ato ndërroheshin në çast, me të kërkuar punë ndonjë vajzë që e kishte gjoksin një milimetër më të madh. Kolegu i Markos u shkri. Ai e dinte se s'kishte gjë më të lezetshme, se sa ta ngacmoje Markon, kur ishte i pirë. Atëherë ai kurdisej e lëshonte xhevahire. Mirëpo Marko nuk po lëshohej. Vetëm se ia nisi një histori të thekur me një maskull, që e kishte gruan të ndershme. Seç ngatërroi me betime besnikërije, sinqeritet, vdekje, shën Pjetër e ventilator dhe më në fund e nxori gruan superkurvë e burrin superbudalla. Kolegu i Markos nisi të zgërdhihej. Merrej vesh që Marko e kishte me grekun. Banakieres sikur po i merreshin mendtë. I vinte dhe si për të përzier. Ajo i bëri një shenjë përgjëruese Markos ta linte atë muhabet dhe Marko tha "mbarova", po greku nuk e la të qetë. Ai e mbante kunjin dhe kishte një qetësi që të luante mendsh. Olimpikë, që ta mbushte mendjen top, se nuk kishte qenë rastësi, që Olimpiadat nisën jetë në Greqi.

- Kjo historia jote më kujton atë përrallën e dhelprës me rrushtë,- tha greku, që edhe ato pak njohuri të mbetura në kujtesën e tij të çalë i kishte nga eposi grek.

- Nuk është tamam ashtu,- iu përgjigj sfidës Marko,- sepse dhelpra nuk e ha

rrushin...Mos i beso për gjithëka Ezopit! Ai ishte skllav, si këto punëtorët e tua. dhe pronari nuk ecën me trutë e skllavit!...Po shkove në kopshtin zoologjik të Athinës, hap sytë se mos i hedh rrush ndonjë dhelpre! Edhe sikur të jetë stafidhe, mos ia hidh! Do të të zhdukim me shkelma, se iu ngordhin dhelptrat!...Është njësoj sikur të them unë tani që greku ha mut! Nuk mund ta them, se nuk është e vërtetë!...Populli i lashtë grek nuk ka ngrënë kurrë mut!...

Gazetari, me një fytyrë të hequr, porositi duke qeshur konjak për të tre. Ai kishte përfunduar studimet për histori dhe vdiste nga qejfi, kur dëgjonte argumente të tilla të stërholluara, që mund të futnin në panik edhe vetë baballarët e historisë.

- E kam thënë unë,- bëri ai,- Markon e ka kapur plaka me ndonjë dhelpër. Nuk ka më kompetent se ky për punë dhelprash e pulash!

- Fjalë ka,- ia nguli kunjin greku,- në terren është i mbaruar! Shikoje kur shkon me shërbim hotele! Shpëtojnë sportelistët, po të jetë ndonjë femër kliente, që nuk fle dot vetëm. E fusin në dhomën e Markos. Si motra i trajton, vëllai!...

Banakerja e pa Markon që po mendohej. Ajo ia njihte huqin e moshapjes rrugë dhe u bë e bardhë në fytyrë. Kush e di çfarë tmerresh do të nxirrte tani nga goja. Edhe kamarierja po mallkonte këtë gojëhelm, që u kujtua të vinte në klub atë çast tek po bëheshin gati ta mbyllnin. Tani do ta çmendte grekun dhe ato s'puthnin më nesër në punë. Por Marko ishte çuditërisht tjetër njeri. I hodhi një vështrim të gjatë grekut, pa orën pastaj, që tregonte se kishte kaluar mesnata, dhe tha gjithë qejf:

- Sot kam ditën e emrit! Me demek, sot duhet të sillem mirë, sepse jam shenjtor!

Porositën prapë konjak dhe ia nisën qyfyreve të lehta, me ca gej e gazetare të reja, që ta kthenin konjakun në çast në djersë, nga të qeshurat e shfrenuara. Markon e kishin veçanërisht për zemër gejtë, që kur botoi një speciale emancipuese për ta...

- Rrezik më kanë zgjedhur kryetar,- qeshte,- për ditë më dërgojnë nga një zarf, ku më informojnë për aktivitetet e tyre. 'e kapa një post më në fund!- psherëtiu duke fshirë sytë.

Aty nga ora një e natës ata u kujtuan se duhet të iknin. Më në fund në lokal ra heshtja. Kamarierja ia nisi sistemimit të karrigeve e tavolinave, banakerja lau gotat e fundit, pastaj tha me zë:

- Ama, i lezetshëm ky Markua! Të shkrin fare!

- Fantastik!- pohoi kamarierja.- Si nuk i mbaron një herë ai humor!

- Është edhe djalë zotni!- shtoi banakerja.

Asaj iu kujtua ajo mbrëmja verën e shkuar, kur kishte pirë një konjak me Markon dhe ai e kishte ftuar qetësisht, a thua po i afronte një konjak të dytë, ta kalonin natën bashkë. Ia pati bërë kërkesën shkurt, se greku sillej vërdallë, me veshët ngritur e sytë katër, dhe ajo pati pranuar me kënaqësi. Ndjente një simpati

të fortë për Markon, që nuk e kishte për gjë t'ua nxirrte bojën në gazetë edhe politikanëve më të njohur. Tjetri kishte lënë orën e vendin e takimit dhe qe çuar. Gjithë natën e Perëndisë ajo qe shkrire në krahët e Markos, që, edhe kur e bënte atë punë, lëshonte xhevahire nga goja. Pastaj nuk qenë takuar më. Ajo e kishte kënaqur atë natë, por, duket, Marko i trembej martesës dhe nuk ia kishte qejfi të shkonte dy herë në një vend. Ama, sherr nuk bënë kurrë e mbetën miq. Ja, edhe sonte ai e qepi gojën. Kishte bërë gjestin më heroik, përpara pordhacërisë së grekut inpotent, që vinte era qen e ta bënte atë punë si qen!

Edhe kamarierja mendonte të njëjtën gjë. Ajo qe lidhur me Markon një mbrëmje vere, tek kthehej në shtëpi. Pati mbaruar punë në lokal dhe, sapo kishte marrë për në shtëpi, dalloi Markon në timon. Ia kishte bërë me dorë dhe tjetri qe treguar xhentil. Ishin nisur drejt shtëpisë së saj, por patën përfunduar në Durrës, në një motel luksoz, ku Markon e njihnin dhe e donin. Atje, pa e zgjatur shumë, ajo iu dorëzua tjetrit, duke ia futur gjinjtë e fortë e të mëdhenj në gojë, që Markua ia kishte lavdëruar, duke ia krahasuar me pjeprat bullgarë...

- Djalë i rrallë!- iu vuri kapak mendimeve të saj ajo, atyre mendimeve që lindnin nga disa kujtime vërtet të bukura, me seks të shfrenuar e kunjat brilante, e që nuk të ngjallnin kurrëfarë pendese.

Kur ato dolën në rrugë, frynte një erë e ftohtë. Por të dyja kishin ardhur papritur në qejf. Kamarierja këndonte një këngë të njohur ciganësh me zërin e saj të ngrohtë, kurse banakierja e shoqëronte herë pas here. Nuk kishin ndonjë arsye klasike për të qenë në qejf në fund të orarit të stërgjatur të punës, përveç faktit se në këtë dynja kishte akoma ca njerëz të mrekullueshëm, si Markua...

1996



## E HUAJ

Emë qëndron e ulur në karrigen e saj lëvizëse pranë dritares me vështrimin e hedhur tej në rrugë. Prej gati katër orësh qëndron pa lëvizur në atë pozicion, që në orën tetë të mëngjesit, kur shtëpia është boshatisur nga njerëzit. Ajo vëzhgon e përhumbur makinat e policisë dhe ambulancat, që e çajnë rrugën e rrëmujshme me zhurmë, numuron njerëzit që bien në gropën e mbushur me ujë, sepse nuk e dinë që atje është fshehur një grackë nën pellg e mbetur dhuratë nga dimri i acartë, sheh njerëzit që ngrihen të përbaltur duke mallkuar, numuron karrocet rrangalla të tërhequra nga ca kuaj të telekosur e të pa ushqyer, pastaj e le përgjysmë numurimin e qenve pa zot, ata e lodhin, se janë pa fund, dhe i duket sikur nuk mendon asgjë. Nga dritarja bota i duket një gjë pa kuptim, e përbërë nga sonambulë, apo nga formalistë të stërlodhur, të cilët sillen përditë rreth një boshti. Ajo nuk ka dëshirë të dalë jashtë, ka një vit pa kapërcyer pragun e shtëpisë dhe nuk pranon të komunikojë me të tjerët. U vizitua vetëm një herë dhe nga dita kur mjekët thanë se ajo ka një lodhje të madhe nervore, pa e vrarë mendjen se ç'arsye fshiheshin pas gjithë këtij stërmundimi nervor, as pranon të vizitohet më e as kurohet me ilaçe. Asaj nuk i dhemb asgjë. Është e sigurt që mjekët ia fusin kot. Të vetmit njeri që pranon t'ia kthejë përshëndetjen me një tundje dore nga dritarja, apo të pranojë t'i hapë derën e të bisedojë është gazetari. Por me atë shihet rrallë. Ai del rëndom nga garsonieri i tij përballë apatamentit të saj nga ora tre mbasdite dhe kthehet gjithmonë mbasmesnate. Është një djalë fytyrë mprehtë, me sy të kaltër e flokë të zinj, i gjatë mbi mesataren, që dikur luante shkëlqyeshëm futboll. Ai u nda nga futbollit herët, atëherë kur theu këmbën poshtë gjurit në një ndeshje në Vlorë. Tani shkruante artikuj interesantë në gazetën më të madhe të vendit për kulturën, por kurrë për

sportin. Ishte nga ata tipa që, kur heqin dorë nga diçka, e varrosin përfundimisht ëndrën e vjetër. Ai është i vetmi me të cilin Emë ka folur gjerë e gjatë. Emë ka mbaruar studimet e larta për filozofi dy vjet më parë, por nuk ka punuar asnjë ditë. Nuk gjeti dot një punë për të qenë në zanatin e saj. Një vit e gjysmë më parë ajo filloi punë si shitëse mobiljesh në një firmë private, por e la mjeshtërinë e re shumë shpejt dhe nga ajo ditë nuk e kapërceu më pragun e shtëpisë. Asaj i vodhën nga arka treqind dollarë dhe pronari e akuzoi për hajdute. Emë iu betua me lot në sy se nuk kishte vënë dorë kurrë në mallin e të tjerëve, por ai i kërkoi paratë. Bëri gati edhe denoncimin e tmerrshëm për ta dorëzuar në polici. Atëherë Emë i kërkoi një javë kohë dhe ia mbathi në Durrës, te tezza e saj. U mendua dy ditë dhe në fund gjeti zgjidhjen më të thjeshtë. Një mbrëmje, tek po kthehej nga marketi në shtëpinë e tezes, dikush i pëshpëriti paturpësisht se do t'i falte gjithçka, po të pranonte për të fjetur një natë me të. Emë përgjithësisht nuk i mendonte gjatë gjërat, kurse atë natë nuk e vrau mendjen hiç... Nuk dukesh aq i pasur, ia ktheu shpërfillshëm tjetrit... Sa do, e pyeti mashkulli për bri. Dukej një surrat i lyrosur, i rruajtur mirë e i larë, por, sidoqoftë, lyrë kishte e, në thelb, një tip i neveritshëm rrumaduci me pak bark ishte... Mua më duhen treqind dollarë, ia preu ajo. Më jep treqind dollarë dhe unë vij kur të duash... Tjetri i dha katërqind dollarë shpërfillshëm dhe e mori Emën në një hotel të vogël buzë pishave të Golemit. Doli që ishte një idiot i lindur, i shartuar me manjakun seksual. Ai e lau me pështymë e me shampanjë Emën dhe i punoi gjithë ato perversitete për 24 orë, sa nganjëherë nuk të dukej njeri, por makinë poshtërsish. Veç të tjerave, të bënte copë e të vinte edhe të rënkoje me zor, a thua po vdisje nga qejfi. Rrezik do kishte fshehur ndonjë regjistruer cepave të dhomës... Ai siklet nuk paguhej as me katër mijë dollarë, por ajo duroi, se ndodhej në kurth, me një damkë të turpshme si hajdute mbi shpinë. Kur ia ktheu lekët pronarit, nuk njihej. Gjithë ajo freski e bukuri sikur ishte vyshkur hap e mbyll sytë, në çast... Urdhëro lekët, i tha pronarit, dhe, po më dëgjove mua, kërkoje hajdutin, se e ke nëpër këmbë. Unë nuk do shkel më këtu... Dhe nga ajo ditë Emë zuri vend pranë dritares. Ushqehet shumë pak dhe nuk merret vesh me çfarë e mban shpirtin gjallë. Është dobësuar shumë, ndoshta ka rënë nja dhjetë kile dhe, merret vesh ç'pamje ka marrë, po të kesh parasysh se dikur nuk ka qenë e shëndoshë. Nuk e tundon asgjë, vetëm tund kokën mohueshëm, pa t'i hedhur sytë. Asaj i duket vetja e humbur në këtë vend. Shpesh mendon se ka ardhur kot në këtë jetë të zymtë, ku njeriu nuk ka ç'bën dhe ku i punojnë lloj-lloj poshtërsish. Në këto momente asfalti atje poshtë dritares sikur mbushet me lule e nganjëherë i duket vetja se është zog fluturues e, po të hidhet nga dritarja, do të fluturojë në qiell. Gjithë ky formalizëm monotonije asaj ia lidh këmbët dhe ia lodh vështrimin. Tani Emës i është mbushur mendja top se njeriu është thjesht një produkt i formalizmit. Lind nga një akt formal seksual, jeton formalisht, punon, ushqehet, vishet, rritet e vdes formalisht,

i rrethuar nga një hiç i madh. Nga një hiç kolosal. Duke vështruar në rrugë, në atë rrugë të mbushur me farë-farë karakteresh e fatësh të çuditshëm njerëzorë, ajo dëgjon trokitje në derë. Nuk ka ndërmend ta hapë derën, mirëpo trokitjet janë këmbëngulëse. Pastaj dëgjon zërin e gazetarit që po e thërret nga koridori në emër. Ngrihet dhe e hap derën. I prin rrugë tjetrit pa folur. Ze vend prapë në dritare, me vështrimin nga rruga dhe pyetjes së tjetrit, që e ka pas shpine se ç'po bën i përgjigjet me një "hiç".

- Tani po vrisja mendjen,- shton pastaj,- se si mund të ketë ndryshuar rruga jonë...Megjithëse, nuk pres ndonjë çudi të madhe!

- Te sheshi është hapur një bankë private,- i thotë gazetari,- Sheshit i kanë ngjitur një emër hoxhe. Ajo kafja e vogël me makina elektronike, ku kemi ngrënë një akullorë bashkë, është bërë restorant luksoz peshku. Ngjitur është hapur edhe një minimarket i mirë, i shtrenjtë, por ushqimet i ka italiane. Janë hapur në rrugë, atje ku shiteshin librat për tokë, edhe dy dyqane me veshje grass...

- Çfarë mode janë?- pyet ajo.

- Moda e fundit,- i shpjegon tjetri.- Veçse çmimet janë në qiell. Unë kam shpëtuar, që nuk jam fejuar akoma...Atje, në vend që të blesh brekë, të heqin edhe brekët e trupit!...

Ajo qesh. Ai është i ri akoma, dy vjet më i madh se ajo dhe nuk duhet t'ia kalojë keq, edhe sikur vetëm çereku i vajzave të reja, që ajo sheh të hyjnë në shkallë, të shkojnë tek ai. Le që të gjitha mikeshat e tij duhet të jenë. Nuk ka djalë tjetër të ri në këtë shkallë...

- Ehu, ti i ke punët në terezit!- i thotë ajo mikut të saj.- Punë të mirë ke, qejf bën, njeri nëpër këmbë nuk ke, këshilla nuk dëgjon...Pastaj këtu të mërzhitet edhe vetja jote, jo më të kesh të tjerë nëpër këmbë. Ç'e do? Që të të kërkojë llogari ku ishe e kë takove? Këtu të gjitha mirëkuptimet vendosen mbi bazën e plotësimit deri më një të kuriozitetit idiot!...

- Ashtu të duket ty,- i thotë gazetari,- por pse nuk më pyet mua? Mos harro se duhet të laj e pastroj vetë, po, nganjëherë edhe vetmia të vret...Supë ka pesë vjet që nuk ha, lugën nuk e njoh më...Ti ke filozofinë tënde, por nuk egziston filozofi, kur nuk ka analiza të atyre që ndodhin rëndom...

- Qenke bërë evropian!- tallet Ema.

Flasin të dy me vështrim nga rruga. Ai qëndron në këmbë, me duar të futura në xhepa, ajo e ulur në karrige.

- Do kafe?- e pyet Ema befas.

Kjo ftesë është vërtet e çuditshme. Duket, i ka pëlqyer ai fakti, që fqinji i saj ka hequr dorë nga luga. Gazetari e pranon me qejf ftesën. Ajo ngrihet dhe vendos në furnelën me gaz ekspresin. Mbas dy minutash ata pinë kafe të ulur në kolltukët e rehatshëm dhe gazetarit i mbeten sytë te kofshët paksa të zbuluara të Emës.



Duken më shumë ca kërcinj të bardhë, si prej sapuni apo allçije. Diçka e përafërt.

- Ç'po shikon?- e pyet ajo, duke rregulluar fundin.

- Këmbët e tua,- ia kthen ai,- që të janë bërë si krruajtëse dhëmbësh. Ke qenë gjithë ajo femër, seks i gjallë,- shton ai,- kot e ke lëshuar veten!

Merr si përgjigje një ngërdheshje buzësh. Vetëm buzët dhe sytë i kanë mbetur të pandryshuar kësaj femre.

- E ç'rëndësi ka bukuria?- pyet Ema në hapësirë.- Unë nuk jetoj për njeri. E kisha dikur dhe nuk më hyri në punë, përkundrazi...Me këta njerëz nuk dua as të ble e as të shes! Këtu, sa më e bukur të jesh, aq më shumë fëlliqësira takon!

Gazetari rrufit kafën ngadalë. Ai mendohet para se ta hapë gojën, atë gojë plot dhëmbë të bukur e të shëndetshëm. Lëpin edhe një herë buzët, pastaj thotë:

- Unë erdha të të ftoj për drekë,- merr kurajon e ia nis,- ti sot ke ditën e emrit. E dëgjova në radio, kur po rruhesha...Festojë, për hatër tim!- i lutet.

- Më ler rehat!- ia pret Ema shkurt.- Që kur paska mbirë civilizimi mes jush?! Deri para një viti ishit të gjithë zero në njohjen e kalendarin kishtar...

Në të vërtetë, gazetari është jo zero, por totalisht injorant në punë feje dhe akoma nuk dallon dot kishën nga xhamija. Punën e ditës së emrit të Emës ia ka thënë nëna e Emës, duke ditur se vajza e saj vetëm me gazetarin mund të bisedojë. Edhe ai, idioti, vajti e prishi kot gjumin e mëngjesit!...

Mirëpo ai nuk i ndahet. Tani i vjen realisht keq për Emën dhe jeton me dramën e saj. E kupton, ajo nuk ka asnjë faj, që nuk ushqen më asnjë iluzion te jeta. Nuk e lanë as të ngrihet në këmbë. Por po rreh ujë në havan. Ema është ulur përsëri pranë dritares, pa prituri që tjetri ta mbarojë kafënë. Edhe filxhani i saj ka mbetur përgjysmë mbi tavolinë. Vështrimin e ka larg në rrugë dhe psherëtin, kur shikon një viktimë tjetër të bjerë në grackën brenda pellgut me ujë. Të gjithë kanë rënë atje, veç kryetarit të Bashkisë. Dhe askush nuk kujtohet ta mbyllë! Kush e di ku po i fluturonte mendja, të shkretit, mendon ajo për të porsarënin e fundit. Do ketë, me siguri, ndonjë lek borxh...E ka harruar gazetarin. Sytë e dhembshur të saj të japin të kuptosh se duhet të jetë duke vazhduar t'ia qajë hallin atij fatkeqit që ra në gropë. Gazetari e kap lehtë për supesh. Nis edhe ia fërkon supet e qafën lehtë, ka tamam dorë masazhieri dhe asaj sikur i vjen mirë. I shpihen kockat dhe ndjen një si paqe të madhe në trup.

- Të lutem!- i thotë ai me një zë të përvuajtur.- Bëje për mua! Kthehu dhe mos dil më!...Dakort, ti u zhgënjeve para një viti, por, mos harro: e shkuara nuk jeton, e sotmja ekziston!...

- Ik!- ia kthen Ema.- Mos e harxho frymën kot! Dhe, sa për atë sentencën që më recitove, po të them se gjuha shqipe e ka shumë aktive kohën e shkuar, bile e ka me plot variacione...Rroftë mbreti, poshtë mbreti ka kuptim aty ku mbretit ia këpusin kokën! Mbreti i djeshëm sot nuk është vetëm mbret! Është edhe Parlament,

edhe Qeveri, edhe shoqëri, edhe Shqipëri!...E sotmja ekziston brenda asaj gropës, tregon me gisht grackën Ema, ku sapo ka rënë keqas një polic. Kapelja e tij po noton tani si varkë në pellg, kurse revolja e përbaltur mesiguri nuk do shkrepë më...

Gazetari sheh skenën tragji-komike, kthehet dhe del. Ajo e sheh tek niset për të kapërcyer rrugën. Ema nuk e ndjek me kuriozitet çapitjen e tjetrit. Këtë copëz ruge, të cilën përfshin syri i saj, atij nuk do t'i ndodhi asnjë e papritur. Ai e njuh këtë fragment përmendësh, me gropa të fshehura, hekura që zgjaten rrezikshëm drejt xhakëtës, pllaka trotuari që lëvizin dhe të spërkatën me baltë...Është gjithë ai djalë. Ka edhe zemër të mirë. Por është idealist. Mendon, se po njohu një copë rrugë, ka kuptuar gjithçka. Është një idealist individualist, që ka harruar se loja luhet në skuadër e që, gjithashtu, ka lindur nga një veprim kolektiv. Atë e gënjen mendja se kjo botë mund të rregullohet me solidaritet, jeton me subjekte. Kurse në këtë botë çelësat e parajsës apo të ferrit i kanë kriminelët dhe solidariteti me ta, në rastin më të mirë, kur e mbyll gojën e sytë bashkë, nuk të çon më larg se buka me djathë. Po qe puna për djathë, edhe frigoriferi i Emës është plot me djathë, bile vetëm djathë ka brenda, kurse ajo kërkoi nga kjo botë diçka tjetër, pak dinjitet kërkoi. Tani dinjiteti ka rënë te ajo gropa e maskuar, tinzare, që të bën palaço në sy të të gjithëve, kur t'i kalon me mendjen larg, te lumturia, e ajo të shndërron në baltëri e llucëri të gjallë...Emës i mblidhen lotët në fyt. Te gropa ka rënë një fëmijë i vogël, që po kthehet nga shkolla. I hapen librat e fletoret e detyrave nëpër pellg dhe ai fillon qan. Njerëzit shohin të hutuar ç'po ndodh. Ca qeshin, ca mallkojnë, por askush nuk kujtohet të verë diçka mbi gropë, për ta parandaluar të keqen. Kurse gazetari i lutet asaj të venë në restorant për të festuar ditën e emrit. Që ta thyejnë edhe ata qafën në ndonjë gropë!...Në një vend me gropa kokëthyesë gjithandej, emri ka vlerë vetëm për arkiv. Në atë arkiv makabër, që u heq të drejtën e votës ca njerëzve. Dhe as është parë e as është dëgjuar, qoftë edhe nga mendjet më të sofistikuar, që i vdekuri të festojë ditëlindjen e tij...

Tani Emës ka nisur t'i turbullohet vështrimi. Pamja ka marrë ca ngjyra të zbardhëlljyera, ku mbizotëron e bardha me grinë. Është e lodhur. Por ka ardhur ora që edhe ajo duhet ta lëshojë këtë vend pranë dritares. Do kthehen njerëzit në shtëpi dhe ajo do të mbyllet në dhomën e saj. Më mirë kështu, se sa në gropë. Nga gjithë lodhja e saj buron një keqardhje e lehtë për njerëzit çapitës në rrugë. Vetëm keqardhje. Asgjë më shumë. Sepse ajo është e huaj. As ka e as dëshiron të ketë lidhje me këta njerëz, që vetëm hapin gropa e thyejnë kokën për ditë brenda tyre. Ema e braktis dritaren dhe shkon e shtrihet. Si zakonisht, e ze gjumi menjëherë. Si zakonisht, shikon një ëndërr të çuditshme. Ndodhet rastësisht spektatore në një teatër ku ndodhin çudira. Ajo ndjek gjithçka me shumë kuriozitet dhe nuk kupton

asgjë nga loja absurde. Është e huaj. Edhe nesër do të jetë pikërisht kështu, në dritare, një botë duke vështruar diçka absurde, që pretendon se është botë.

**GUSHT, 1996**

## \* E QARA

Është një mesdrekë e bukur me një qiell të kaltër kaltërsisht, po Dianës në retinë i përthyer gjithçka gri. Ajo ka gjysmë ore që merret me përgatitjen e tryezës, megjithëse është ende shumë herët për t'u ulur në tavolinë. Vajza do vijë, të paktën, pas tre orësh, po qe se nuk ka pastrim klase, apo ndonjë ditëlindje të shokëve a shoqeve. Diana kërkon ta mbarojë këtë punë të bezdisur, sepse e ka vendosur të shtrihet, derisa të kthehet në shtëpi. Seç ndjen një këputje të pëgjithshme në gjunjë e më lart. Torta ndodhet në qendër të tryezës, një tortë e madhe dhe e bukur e përgatitur nga një dorë mjeshtri të vërtetë, e mbushur me arra e lajthi e me një urim të vizatuar pak pjerrtas përsipër. Emri i saj i lyer me krem të bardhë ka hyrë në një kaush letre, fillimisht si qull, për t'u kthyer pastaj në një Dianë të ëmbël. Sallatat e ftohta janë gjithashtu tepër estetike dhe ajo tundohet e fut një copë bukë të lyer me gjalpë e paksa havjar të zi, që ia ka dhuruar djali i ambasadorit iranian, një fëmijë i zeshkët e i zgjuar, gjithë zjarr e me një mençuri të habitshme. që të habit se sa mirë e ka mësuar shqipen për dy vjet. Përtypet mekanikisht, e ndjen se po kapërdin diçka të mirë, por nuk i shijon asgjë. Dhe shkon e shtrihet në shtrat pa u xhveshur. Pastaj kujtohet që telefoni është në prizë. Tingëllima e ziles së tij e tremb, i shkakton një si ankth në zemër. Ngrihet, e shurdhon edhe atë aparat, që sot i duket më i bezdisur se kurrë, dhe shtrihet sërish. Te koka ka një telegram urimi pa pika e presje. Një dashuri, apo një pasion kursimtar...Një pikë, një presje 10 lek...Nise në mënyrë surrealistë!...Edhe ditëlindja e saj, tridhjetë e pesë vjetori i saj, i duket tepër surrealist, si ky telegram...Të uroj ditëlindjen Jetë të gjatë e të lumtur Gëzuar Andi...

Megjithëse nuk arrin dot në këtë konkluzion, Diana nuk është e lumtur. Ajo

është diçka në mes, ama, në një mes me të nxehtë përvëlues. Ndodhet në ekuator. As e lumtur, as e mërzitur, as e varfër, as e pasur... Tamam-tamam, është e trishtuar. Nuk bie shi!

Kuptohet, mendja i rrotullohet larg e afër te ky Andi i telegramit. Kur ajo filloi punën si mësuese kimije, ata ishin kolegë. Asaj i pëlqeu që në fillim karakteri i tij i hapur, së bashku me të folurën e ngadaltë rrallë e për mall. Atëherë ai iu rrotullua shumë, por ajo gjithmonë e mbajti larg, megjithëse në ëndërr e shihte shpesh nëpër ca skena erotike... Kështu i ishte larguar gjithmonë zjarrit kjo Dianë e bukur, me ca flokë ujëvarë e një lëkurë të bardhë edhe para, edhe pas martesës së saj të çuditshme me Gonin kozmik, njeriun më të ngatërruar të botës, njeriun më aventurier e më me fat të globit, bohemini dhe imoraliin e pandreqshëm, që të detyronte të trokisje gjithë frikë në derën tënde, kur ktheheshe në shtëpi... Por ai kishte qenë edhe pendimtari e kavalieri më i madh njëherësh, pa harruar që, sa fat kishte, kur luante bixhoz apo bënte ndonjë biznes, aq pa fat qëlloi në kontaktet me vdekjen. Duket edhe vdekja e dashuroi atë njeri të lindur së prapthi! Ai vdiq fare kot pesë vjet më parë, nga një gjemb kaktusi, që iu ngul në gisht, iku. Tetanozi qëlloi i pamëshirshëm, si edhe varrimi i atij njeriu, ku një në dhjetë pjesëmarrës që dënesnin e kapërdinin lotët në varrim, një ishte ish-e dashura e tij. Nuk pati guxuar t'i ngrinte sytë nga gropa e varrit atë mbasdite të tmerrshme. I vinte turp. Kishte gjithashtu frikë të shihte Andin përballë, atë And që e kundronte gjithë trishtim, duke menduar se ajo do të gjente një fat shumë më të mirë, po mos e kishte shkëlmuar ashtu barbarshe ndjenjën e tij varfanjake...

Gjithë këto kujtime të trishtuara, kurse ajo sot kishte ditën e emrit dhe ditën e lindjes. Të rronte Goni, kush e di ku do të ndodhej tani. Në ndonjë restorant luksoz, e veshur e gjitha me tesha të reja. E kush ia zbulonte trillet e çastit atij njeriu, që gjithmonë ikte kundër logjikës?... Por bënte vaki të ishte duke e pritur në dritare si idiote, ndërkohë që ai, i harruar e neglizhent, pis e pa shpirt, si vetja, po zhgërryhej plazheve me ndonjë nga ato miket e veta të pafundme, që një Zot i madh e dinte si ua prishte mendjen me atë të parën e tij vëngroshe. Pastaj surrati i qarravitur... Harrova, më fall!...

Botë pa fat, mërmëriti Diana, duke fshirë një lot. Tani i rrotullohej mendja te Andi. Dhe jo vetëm tek ai! Sa njerëz i qenë lutur si shën Mërisë, kurse ajo...

Kafshë, hesapi, shau Diana veten. I hypën nervat, sepse iu kujtua Maksi, mësuesi i fiskulturës në Plazhin e Divjakës, kur qenë në eskursion me fëmijët e shkollës. Atje ata hëngrën bashkë në një nga barakat buzë detit të qetë, hëngrën nën pisha një peshk barbun të mrekullueshëm dhe e tepruan me verën e bardhë, duke ndjekur me sy fëmijët që mblidhnin larg guacka buzë detit. Maksi e kishte prekur si pa dashje në kofshë, për t'i tërhequr vëmendjen, pra, pastaj, kur ajo nuk reagoi, i qe afruar dhe i kishte këputur një të puthur të gjatë pranë buzëve.

Pavarësisht se ishte dredhur e gjitha nga ky mister, Diana e pat shtyrë egërsisht dhe ia kishte mbathur drejt fëmijëve. Kështu u mbyll ajo histori pa kuptim, që zhvillohej në një sfond të trishtuar, pikërisht kur ajo e kapi Gonin në shtrat me një shoqen e saj dhe kur iu betua se do t'ia lante tradhëtinë me tradhëti...

Pse nuk e mbajta betimin, pyeti veten ajo qetësisht, duke kujtuar se si i pati kënduar Maksi heroikisht, sa herë i kalonte përbri, gjithmonë të njëjtën këngë të vjetër me një varg të vetëm: "Buzët me sheqer..."

Për një kohë të gjatë ajo luajti atëherë rolin e shurdhm-memeces. Më në fund, e mërzitur nga ai refren dhe ajo kërkesë sysh monotone, i qe kthyer një ditë:

"Në fakt, buzët ishin me peshk!"

"Mua m'u dukën me sheqer", ia pat pritur Maksi.

"Ti nuk njeh as sheqerin, o i metë!", qe tallur ajo.

Dhe ai hekraxhiu, që thyente gjithë ditën paralele e shtanga, i pati thënë më të fortën:

"Në një vend ku balta është më e ëmbël se mjalta, pse mos jetë edhe peshku, të paktën, i ëmbël si sheqeri?!"

Diana kishte qeshur me të madhe.

"Nuk e dija se je kaq i hollë! Po të ma kishe thënë këtë gjë në Divjakë, do kisha rënë në shtrat me ty, por tani, sinqerisht, je i vonuar. Sidoqoftë, që sot unë kam mendim ultra pozitiv për ty!..."

"Tani më kënaqe!", i qe përgjigjur ai. "Kjo ishte e vetmja gjë që më mungonte!..."

Kështu qenë ndarë, nëpër ca ironira e duke qeshur, dhe, më pas, Maksi i pati treguar një herë për mes përbetimeve, se, duke ndjekur këshillën e saj, ua pati prishur mendjen nja dy zonjushave interesante...

Kohë e shkuar, trishti ajo, duke kujtuar vizitën e Maksit për ngushëllim pas vdekjes së Gonit. Ai pati ardhur për të dyzetat, i trishtuar dhe i veshur bukur. Gjithë kohën mbajti në prehër vajzën e vogël jetime, i tregoi përralla që i shpikte aty për aty, se përrallë nuk duhej të kishte lexuar në jetën e tij, e bëri të qeshë dhe, kur ajo po e përcillte, e uthi shoqërisht e i mërmëriti me një zë të lagur:

- Më vjen shumë keq, Diana! Po t'u desh ndonjëherë ndihma ime, mos më kurse!

Nga ajo ditë nuk u panë më. Ajo nuk ndjente nevojën as për ndihmë e as për konsulta. Ishte si puna e ilaçeve, mendoi turbull ajo, që piheshin kuturu, ç'ilaç të të ndodhej në shtëpi, sepse shqiptaët e dinë që ilaçet, cili lloj qofshin, iu bëjnë mirë, sepse janë të sigurt që janë të prekur nga të gjitha sëmundjet!...

Kurse Andi...Ai gjithmonë do të shfaqej, me forma të ndryshme dhe fytyrë të njëjtë: lutëse. Në çdo ditëlindje ajo do të merrte një telegram surrealist nga Andi, do ta haste shpesh si rastësisht në rrugë, por kurrë nuk do t'i pranonte ofertat

monotone, pavarësisht se të stërholluara të tij, për t'u afruar më shumë. Me Andin nuk do të kishte ndonjë pendesë të madhe, po të lidhej, por ajo i kishte mbushur mendjen vetes se kjo lidhje intime do të ngelej një zhgënjim i madh, kur bashkimi i tyre kafshëror në shtrat të krahasohej me dashurinë magjike ëndrrave të çmendura...

Duke pritur vajzën, Diana kujton jetën e saj. Gjithmonë, edhe vajzë, edhe grua, kishte qenë në qendër të vëmendjes së meshkujve. Dhe përherë pati dyllosur veshët si grekët e lashtë e qe maskuar në fytyrë si indianët në vaktit. I trembej këtyre lidhjeve, apo...

Dy vjet më parë një shoku i Gonit u interesua që Diana të fillonte punë në një ministri. Vendi i punës i pëlqeu dhe ajo pranoi. E nisi me dëshirë atë punë të re me një liri e hapësirë të madhe, por shumë shpejt Diana dha dorëheqjen. Askush nuk e kuptoi se pse e braktisi atë vend pëllumbash ajo e pse i flaku përgjithmonë rrobat e errëta. Po Diana vetë e dinte mirë të vërtetën, atë të vërtetë pa ngjyrë e me erë, që rrotullohej mbi njerëzimin nga lindja e hershme. Një mbasdite ministri e thirri në zyrë. Atë ditë binte shi. Ishte një kohë e trishtuar, nga ato që Goni i shkretë i cilësonte si ditë të prera o për të bërë dashuri në një shtrat të ngrohtë, o për të pirë vënçe. Duket edhe ministri mendonte një lloj me Gonin e saj, të dekompozuar tashmë. Ai nxori një shishe MARTINI mbi tryezë, dy gota, dy kanoçe me coca-cola dhe e ftoi tjetrën të ulej.

“ Unë nuk pi alkool...Nuk kam pirë kurrë!...”

Ministri nënqeshi. Ai ishte diçka më i madh se ajo, ndihej i fortë, si çdo provincial taze dhe, duke u rrekur për të kryer punën më të vështirë për të, hapjen e kanoçeve, bëri një gjest shpërfillës me dorë.

“ Sa për dijení, unë nuk kam asnjë paragjykim në vlerësimin e vartësve nëse pijnë, apo jo...”

“ Po ulem, por unë nuk pi!”

Ajo u ul, duke mbledhur fundin e ngritur paksa rreth kofshëve të gjata. Nuk deshte të prishte qejf, por as siguri e ministrit nuk po i pëlqente. E vështroi dorën e tjetrit si i mbushi gotat, si e trokiti gotën e tij pastaj me të sajën dhe si shqiptoi ngadalë:

“ Unë kam mendim të mirë për ty! Javën që vjen je futur në listën e delegacionit, që do ta kryesoj unë, në Londër...”

“ Faleminderit”, tha Diana, pa ia ndarë sytë gotës. Londra i ngjallte një kuriozitet të çuditshëm, që nga leximet e Dikensit e të Gollsuorthit.

“ Provoje!”, e cyti tjetri të pijë, “ Në Londër do të ketë shumë dreka-darka dhe, po nuk pive, atje bën figurë të keqe...”

Dianën e bëri kurioz ky njeri. Dukej një provincial trim! Ishte aq trim, sa kishte guxuar të vinte edhe kravatë! Gjergj Elez Ali ishte!...

Diana e mori vesh mirë se ç' donte ministri. Ajo kanapeja përballë po e priste me padurim trupin e saj. Ishte si album ajo kanape...E sata duhet të jem?, pyeti veten përhumbshëm Diana.

“Unë kisha menduar se ju ruanit një mendim më të mirë për vejushat”, ndërroi befaz temën e bisedës ajo.

Tonin e kishte të butë, sytë i mbante poshtë dhe duhej të ndiheshë profet, që ta kuptoje ku i rrihte çekani.

“Unë, më duket, se kam menduar mirë për ty”, ia ktheu zëulët ministri.

Dianën e nervozoi njëjësi i tjetrit. E ç'kishte më shumë ky njeri nga ajo, përveç servilizmit të qelbur dhe imoralitetit vulgar?

“Ti nuk mendon mirë për mua!” tha ajo, duke u ngritur.

Eci drejt derës para syve të tjetrit, duke u tundur lehtë koketërisht, si për t'i treguar ministrit se nuk i kishte rrëshqitur nga dora një femër çfardo.

Nuk u paraqit më në punë dhe nuk veshi më robe të errëta. I dukej sikur të gjithë mendonin se ajo po vdiste për seks, sikur po e priste mbarë racën mashkullore, pa dasi fetare, krahinore e estetike këmbëhapur...

Kështu kishte ndodhur, kurse ajo sot, në ditën e emrit të saj rri e mendohet se pse nuk iu dorëzua asnjëherë tundimit, atij tundimi që i ngjallej me zjarr brenda vetes dhe e detyronte të ndiqte gjithë afsh ëndrra me erotizmin më të skajshëm. Jo, i pat thënë Andit dhe jo shumë kohë më pas buzët e saj qenë endur nëpër një shtrat të stërmadh në trupin e bardhë të tjetrit, që rënkonte symbyllur përmes një zhargoni të pakuptueshëm. Jo brutale i shqiptoi edhe Maksit, por në darkëvonë Diana ishte shtrirë në tapetin e palestrës, duke pritur gjithë ankth shfaqjen e tjetrit, që urdhëronte nga kush e di ç'skutë “një-dy, një-dy...”, urdhëra që ajo i zbatonte përmes një striptizmi të çuditshëm ushtarak, apo fiskulturor, duke i fluturuar teshat e bardha si zogj nëpër unazat, shkallët suedeze e hekurat e paraleleve. Pastaj, e kryqëzuar në shkallën paralele, ajo kishte pritur me gjoksin e ngritur lart tjetrin dhe kishte rënkuar rëndë. E pat shtyrë me përbuzje dymbëdhjetë orë më parë Maksin dhe pastaj qe zgjuar si dosë e zhgërryer në orgazëm...Kështu ndodhi edhe me ministrin, kështu edhe me...

Çudi, pse duhet të ndodhë kështu, pyeti veten ajo. Nuk i frikësohej askujt, as atëherë e as sot. Kishte kundërshtuar formalisht një gjë që e ëndërronte përjetësisht, diçka që qëndronte gjithmonë e zgjuar brenda saj, pa mbyllur sy kurrë, ditë e natë, që e ndillte dhe i jepte një dhembje koke të vazhdueshme, që ia bënte gjumin të dashur...

Ndoshta unë jam një krijesë arkaike, filozofoi ajo, një mekanizëm muzeal, që respektonte ende pa vetëdije Kanunin e Lek Dukagjinit në një botë që po ia harronte edhe inicialet ligjvënësit të famshëm. Kështu duhej të ishte! Një fëmijëri tipike pa rritje, një fëmijë që shqiptonte për diçka “JO” dhe nuk tëhiqej, edhe



sikur ta varje.

Nga kjo JO absurde unë kam humbur shumë, mendoj ajo, duke bërë një llogari të shpejtë nëpër mend. I dilte që të kishte humbur dëshirat dhe kënaqësitë, punën dhe miqtë. Asgjë nuk fitoi nga vetëpërmbajtja kokëfortë! Ishte e sigurt që as vajzës nuk do t'i linte një emër të mirë. Në këtë botë të komanduar nga çelësi i paragjyqimeve ajo, vejusha, i binte të ishte një femër imorale. Sepse edhe bota ka mbetur në fëmijërinë e saj në disa drejtime, konkludoi ajo, duke kujtuar vejushat imorale të Homerit e të latinëve, të Dekameronit e të...Edhe haremi i parë i Muhametit me vejusha u ngrit, trishtoi ajo...

Çudi pse bota nuk ka nxjerrë për ne vejushat proverbin: "Femëra e ve, kishë, xhami, teqe!"?, u habit vërtet Diana.

Por ndihej shumë e lodhur nga gjithë kjo filozofi idiote dhe, kur pa që vajza vinte pas një ore nga shkolla, vendosi të bënte një dush. Të hiqte, të paktën, erën e gjellës nga trupi.

U xhvesh dhe, tek hynte në banjë, syri i zuri shkarazi lakuriqësinë e saj. Ishte ende një trup i bukur, një send i lakmueshëm, një makinë luksoze. Asgjë nuk ishte vjetëruar e ndryshkur nga ato linja harmonike, përkundrazi, tani gjinjtë ishin më të plotë e ijet më tunduese...

Hyri me shpejtësi në dush. I trembej atij shembëllimi në pasqyrë. Duke u fërkuar ngadalë, duke endur sfungjerin në skutat e fshehta të trupit të saj, ajo e ndjeu se mishi i saj ishte ende i fortë. Gjinjtë, këto provokatore të përjetshme të botës mashkullore, e mbanin kokën ende lart, ndoshta të forcuara nga kujtimet. Gjithë duke u fërkuar ngadalë, ajo u pushtua nga një kënaqësi e thellë, gati-gati e harruar idiotërisht, që i ringjalli fytyra të pastra meshkujsh në atë hapësirë të ngushtë, fytyra që e puthnin, e përkëdhelnin mjeshtërisht, hynin brenda saj plot mirëkuptim, pa thyer asgjë e pa shkaktuar asnjë dhembje...

Unë jam idiote, shau veten ajo, duke u fshirë. Ndohej akoma nën pushtetin e kënaqësisë prehëse të provuar pak çaste më parë. Vërtet jam katolike, po në ndonjë urdhër murgeshash nuk bëj pjesë. Pse mos ta jetoj edhe unë, siç më pëlqen dhe pa i shkelur kujt në kallo, këtë dreq jete? Boll, uluriu përbrenda Diana, boll! Nuk duroj dot më!...

Kur doli në koridor, ishte e përskuqur e gjitha nga afshi i brendshëm i vendimit të marrë. Ndihej e lumtur, e lirë më në fund nga ato zinxhirë mesjetarë që i kërcisnin brenda vetes. Boll me ëndrra! Do të gjente edhe ajo një njeri të pranueshëm dhe asnjë krim nuk do të kryente! Nuk do të përdhunonte kënd e askujt nuk do t'ia hiqte kafshatën nga goja! Gjithë kjo botë ishte materiale. Dukeshë vërtet një kafshë prehistorike e veshur me velin ideal...

Dianës i zuri syri telefonin. Ky telefon, lidhja e saj e parë me botën, duhej të tringëllinte gëzueshëm paskëtaj!...

Zgjati dorën ta rihapte, me shpresën se, mos Andi, apo dikush që ajo e pati shtrënguar në krahët e saj në ëndërrat e pafundme, do të telefononte. Por dora çuditërisht nuk iu bind. Mblodhi të gjitha energjitë e saj për ta kryer atë veprim aq të thjeshtë e që kërkonte aq pak forcë. Nuk mundi. Atëherë ajo e ndjeu se ishte trimëruar sërisht në ëndërr. E zgjuar nga kjo botë e mrekullueshme, e pafuqishme për ta bërë ëndrrën realitet, ajo ra përmbys në shtrat dhe nuk i përmbajti dot lotët...

Qau gjatë, rëndë, me histeri...

Mendoj vetëvrasjen dhjetëra herë, por qindra herë një zë monoton i përsëriste në vesh:

“ Unë veten nuk e vrava, por mblodha ëndrrat dhe qava!”

Në fakt, atje qanin të gjithë.

**TETOR, 1996**

## KAFE "EVROPA"

Është orë e vdekur, njëmbëdhjetë e mëngjesit. Vapë e madhe dhe në kafe në këtë orë nuk gjen thuajse asnjë nga klientët e përhershëm. Avokatët me prokurorët tani ndodhen nëpër gjyqe apo burgje, punonjësit e bankës i kanë pirë kafetë, shumica tjetër ndodhen me pushimet verore. Nja dy të papunë pijnë birrë në cep, kurse kamarieri është mbështetur në banak. Ai po pi kafënë e dytë dhe i lutet banakierit të fusë në magnetofon kasetën e Pavarotit. Ky ka kryer nja dy vjet kanto në Lice Artistik këtu e 15 vjet të shkuara dhe nuk është çliruar akoma nga virusi i ariëve operistike.

- Na çmende,- psherëtin banakieri, duke llogaritur xhiron e bërë deri atë kohë.

- Po të jap kulturë falas, o budalla,- i thotë kamarieri,- nesër, me gjithë këtë pasuri që po merr sot, mund të martohesh kollaj fare me ndonjë nga ato studentet e bukura të kantos...

Ndërkohë, në lokal hyjnë dy vajza të kolme, me fustane të shkurtëra, që ua nxjerrin mirë në pah këmbët e bukura. Ato ulen pranë banakut dhe kërkojnë akullore.

- Me ato studentet e kantos ngatërrohu vetë po deshe,- vazhdon bisedën banakieri, duke përmbushur porosinë e fundit.- Tani kanë ardhur ditë të vështira, për ato nuk ka më punë. Iku koha jote, kur njerëzit kishin qejf të shëlleheshin në diell dhe të këndonin... Duhet t'i mbash me bukë gjithë jetën dhe të durosh ulurimat e tyre hysterike. Zot na ruaj!- përfundon.- Nuk mund të jem në gjithmonë i shënuar nga fati i keq! Apo jo, vajza?- iu drejtohet papritur vajzave të porsaulura pranë, që po qeshin nën buzë.

- Ke të drejtë!- e mbështetin ato me një gojë.- Llapësi që bën zhurmë është i patolerueshëm,- e çon më tej solidaritetin vajza bionde, që ka një hundë me majë,

buzë të plota, sy gri me bisht e ca flokë të shtrirë deri në bel.

Banakieri, një tridhjetëvjeçar muskuloz e tip i pa dhjamë në trup. kënaqet nga afiniteti i afruar prej vajzave. Ai nuk e mban dorën, kur iu hedh akulloret në gotat e kristalta dhe, duke grirë ca fruta sipër akulloreve, vazhdon bisedën rreth fatit tragjik:

- Mirë të gjitha,- thotë,- po a durohet fëmija e këngëtares? Zakonisht këto krijesa kanë një zë brisk, që të çpon timpanin e veshit. Se kanë dhe pak damar artisti, pra! Këta qelbacë nuk qajnë nga halli, si kalamajtë e botës, por nga qejfi!...Kemi pasur ne fëmijën e një sopranoje ruse në lagje, që unë e di ç'kemi hequr! Mendo, akoma ndihem i pangopur me gjumë! Pesë vjet s'vuri njeri gjumë në sy në lagje, kur lindi ai muzhiku i degjeneruar...

Vajzat filluan të qeshin, kurse kamarieri u shtri si lopë në banak.

- Po, ti, karagjoz ngele, o i shkretë!- tha ai mes të qeshurave.- Pres kokën, po nuk të ka zënë jot ëmë në skenën e estradës, mbasi mbaronte provat yt atë me ato grupet amatore!...Mbush edhe dy gota ujë...Si i doni?- pyeti vajzat.- Natyral, apo mineral?

- Natyral!- thanë ato.

- Pini çfarë uji të doni,- tha banakieri,- por, po hëngrët pula hungareze e iu ze salmonela, mos ia vini fajin ujit tonë. Se gati për të sharë qeverinë jeni, ua shoh që këtu syçkën!

- Lere ujin,- tha biondja,- mua po më ze barku pa e çuar gotën në gojë. Na tmerrove fare!

- Po ece me mendë e këtij njeriu, vdes për bukë!- tha kamarieri.- Ky është mjeshtër, për të përhapur panik...

- Unë vetëm paralajmëroj,- u mbrojt banakieri.- bile, mund të quhem paralajmërues demokrat, sepse asnjëherë nuk diktohem. Vetëm sugjeroj!

Biondja nuk po ia ndante sytë. Sepse i vinte shumë për të qeshur, sa herë hapte gojën ky tip i çuditshëm. Tani po mendonte rreth prejardhjes së tjetrit. Me siguri duhet të ishte lauruar në ndonjë fakultet. Nuk dukej fare gdhë.

- Që je demokrat, kjo merret vesh,- pohoi biondja me një fytyrë krejt të pafajshme.- Ti je patologjikisht demokrat, ose, siç thuhet ndryshe, demokrat bruto!...

- E shikon?- iu kthye banakieri kamarierit.- Njeriu që të do e të vlerëson të njeh menjëherë. Ja, kjo vajza më kuptoi në çast, ma bëri me një herë grafinë me ato syçkat e saj, që lëshojnë rreze ultraviolet. Jo si, ty, syshpëlarë, që prish ekologjinë, ku hedh vështrimin tënd të kalbur, a thua nuk del nga zgavrata e syve, po nga ndonjë depo ilaçesh të skaduara me kohë e vakt!...

Biondja u shkri fare.

- Qenke fantastik!- tha.- Me siguri, duhet të kesh punuar ca kohë magazinier

andej nga profarma...

- Fantastike je, ti,- bëri të habiturin banakieri,- që më njohe kaq shpejt pa as më të voglën firo. Mos studion gjë për psikologji?

- Jo,- qeshi biondja,- por edhe psikologjia njerëzore më intereson, për profesionin që kam...

- Thashë unë,- u kënaq tjetri,- nuk ka mundësi të të njohë kaq mirë një hu! Duket tipi i përpunuar. Shkolla jonë ka qenë historikisht e fortë. Hyn dru e del njeri! Ja, shiheni këtë kamarierin! Tetë klasë ka, i ziu! Ky vetëm këmbët e palara i kupton, se ka nuhatje të fortë. Për gjë tjetër, s' e ke...

Vajzat dhe kamarieri ranë përmbys. Pavaroti po i jepte fund atyre "vinçero"-ve të tija magjike dhe, kur ai e mbylli kreshendon, banakieri iu afroi diçka për të pirë vajzave. Ato pranuan. Biondja mori një amaro, tjetra, një zeshkane plot sensualizëm, kërkoi lëng domateje.

Banakieri doli nga banaku dhe ua serviri vetë porosinë vajzave.

- Këtë punë e bëj shumë rrallë,- tha,- por ju më pëlqyet. Ia vlen të shërbesh, kur gjen partneritet! E ndjej se do kalojmë mirë bashkë...

- Je shumë xhentil,- ia ktheu biondja,- më vjen keq, që u shpenzove...

Banakieri bëri një lëvizje shpërfillëse me dorë.

- Mua më quajnë Adrian,- shpjegoi pastaj,- sot kam ditën e emrit në kalendarin kristian, megjithëse për vete jam mysliman 24 karatsh. Adrian Hoxha,- paraqiti vetveten, duke saktësuar gjithçka.

- Mua më quajnë Vera,- tha biondja.- Unë e kam ditën e emrit ca ditë më mbrapa, më 20 korrik. Unë jam e përzier, tip turlije,- shtoi ajo.- Babain e kam ortodoks, nënën myslimane, emrin katolik...

Adriani psherëtiu.

- Paskemi lindur tamam për njëri-tjetrin!- tha pastaj pa i ndarë sytë biondes.

Po i pëlqente vërtet kjo vajza dhe se pse po i mbushej mendja që edhe ai sikur po ia zgjonte interesin tjetrës.

Biondja qeshi.

- Vetëm një gjë e vockël na ndan,- tha duke parë gjithë djallëzi andej nga kamarieri.- Unë studioj për kanto!

- Mos!- briti banakieri, ndëkohë që kamarieri ra sërish përmbys mbi banak.- Edhe një herë që u tundua virgjëria e gjallë, s'pati fat!- psherëtiu pastaj.

- Jetë mizore!- i mbajti krahun biondja, duke kukurisur.

- Ç' e pyet,- shtoi zeshkania,- një herë nuk patëm fat! Të vjen për të vënë ulurimën...

- Po, ti,- iu kthye zeshkanes banakieri me një dritë shprese në sy. Nuk ishte e keqe, paçka se fliste rrallë...

Mori si përgjigje një tundje koke.

- Edhe, ti?- belbëzoi.

- Edhe unë,- pohoi gjithë turp zeshkania,- mexosoprano!

Kamarieri nuk çohej më nga banaku. Atë e mbyti fare e qeshura. kur pa banakierin të ngrihej nga tavolina e vajzave me një pamje tejet tragjike në fytyrë.

- Më mirë mos ta kisha ditën e emrit sot,- tha duke hyrë në banak,- gjithë ky tersllëk, sikur kam prishur kisha e xhamija!

Vajzat u ngritën.

Biondja ia bëri edhe një herë me dorë banakierit, pastaj ato dolën nga kafja duke qeshur. Adriani shihte këmbët e tyre të bukura nga pas dhe psherëtinte. Nuk i punohej më. Mbushi dy kriklla birrë, ia zgjati njërën kamarierit dhe tha gjithë trishtim.

- Ishin të mira! Dhe, si çdo gjë e mirë, në këtë vend i përket të shkuarës. Na ishte një herë...

- Përrallë,- i mbajti krahun kamarieri.

Ata i kthyen gotat dhe vendosën t'i mbushin përsëri. Në një farë feje, dita e emrit duhej festuar.

1996

## BETIMI

Herën e fundit ata hëngrën darkë në Monza, përballë katedrales të ndriçuar bukur nga projektorët e fshehur mjeshtërisht. Linci këmbënguli të darkonin në Monza, megjithëse ishte sigurt se në Milano nuk do t'i shqetësonte askush. Ajo natë pati kaluar sipas skemës së lashtë të fiksuar mes tyre tashmë: ajo qau sa u ngop dhe përsëriti dhjetëra herë, se, po të zhdukej prapë me muaj, siç e kishte zakon, Linci do bënte mirë t'ia harronte emrin, kurse Linci pinte për qejf të vet dhe ia merrte herë pas here ndonjë motiv sentimental të atyre këngëve italiane të viteve '70, ku i kishte ngecur ora, që kur e ngritën familjarisht dhe e degdisën në internim baltrave të Roskovecit, pastaj burgjeve kalvar, nga të cilët shpëtoi në 1991-in.

Ata ishin lidhur bashkë nja katër vjet të shkuara, kur qenë takuar rastësisht në Peruxhia: Monika duke kërkuar më kot vajzën e tezes e Linci duke hyrë, si zakonisht, në një klub për të hedhur ndonjë gotë. Linci e pati parë, tek po parkonte makinën, Monikën, që shihte e hutuar majtas-djathtas dhe i dha dum në çast që kjo bukuroshe e trembur do që ndonjë shqiptare e mashtruar keq. Siç e kishte zakon, nuk e mendoi gjatë hipotezën që iu vërtit në kokën e tij të qethur shkurt. Iu drejtua shqip tjetrës "si mund t'iu ndihmoj?" dhe Monika, megjithë porositë e marra për të mos e shfaqur identitetin e saj te të panjohurit, iu përgjigj krejt pa vetëdije shqip. Ata hynë në bar së bashku, ai bëri çmos që ta ndihmonte tjetrën, se, sa për kavalier zor t'i dilte njeri përballë, dhe arriti ta marrë vesh se vajza e tezes së Monikës që zhvendosur ca ditë më parë në Milano. Duke pirë e duke vërshëllyer në qejf të tij, Linci i tha Monikës se atë natë mund ta kalonte në dhomën e tij të

hotelit. Ai kishte ca punë në darkë vonë dhe mund të mos kthehej fare në hotel. Monika pranoi. Nuk kishte çfarë të bënte. Linci u kthye nga ora dy e natës në dhomë. E gjeti tjetrën duke qarë në dritare. Me 100 mijë lireta në xhep, tjetra ishte e mbaruar. Ai e ngushëlloi moskokëçarës dhe pastaj i tha tjetrës shqeto:

- Ç' e vret mendjen? Nesër është nesër! Ditë e re, nafakë e re! Ia fusin pordhës ata që merren me parashikime! E ardhmja as shihet e as ndërtohet! Ajo ose të le, ose të merr! Sonte qenka natë për dashuri! Hajde, zemra...

- Po unë nuk të njoh,- belbëzoi e kapur në kurth ajo.

- Këtu qëndron bukurija,- tha Linci,- gjërat që të mbeten në kujtesë nuk kanë vlerë! Kështu, të panjohur, edhe bëjmë qejf, edhe harrojmë gjithçka që nesër...A ka gjë më hyjnore se sa harresa?

Për filozofi ai mbetej unikal. Ata fjetën atë natë bashkë, të nesërmen Linci e shoqëroi Monikën në Milano, ktheu gjithë Milanon përmbys, deri sa e zbuloi ku ishte futur vajza e saj e tezes, pastaj, si i këputi tjetrës një "Çao!" fodulle, ia mbathi. U zhduk ca kohë dhe, pas nja gjashtë muajsh, i ngelur vetëm në Milano, u kujtua për Monikën. Kështu u takuan përsëri. Ajo tani punonte si infermiere në një azil pleqsh dhe e kishte kapur diçka veten, megjithëse e urrente punën që bënte, një punë ku laheshe me çif e kak bashkë, sipas saj.

- Duhet të jetë punë e vështirë,- e mbështeti Linci në shtrat, duke nuhatur drejt trupit të saj.

Pas kësaj here Linci nuk kalonte kurrë në Milano, pa u kthyer te Monika. Ai ishte mirë ekonomikisht. Mund të quhej nga padronët mariuanës shqiptare dhe nuk kishte rënë kurrë në kthetrat e policisë, sepse nuk mund të gjeje një njeri në dynja të parashikonte se si do vepronte Linci pas një minute, e jo më pas disa ditëve. Sa herë godiste, ai i këpuste nja një muaj pushim. Pushimet i kalonte si xhentëlmen në Milano me Monikën përkrahu. Dhe erdhi një kohë që ata u lidhën shumë njëri me tjetrin.

Monika qante gjithmonë e më shpesh. Ajo e dinte se Linci tani kishte lek sa të hanin edhe qentë e Italisë dhe këmbëngulte që ai ta linte punën. E ç'i duheshin fitimet e tjera, kur ai nuk do t'i prishte dot deri sa të vdiste lekët që kishte andej nga bangat e Luksemburgut? Linci bënte sikur e dëgjonte, por sa mund t'i dilnin trutë gomarit, aq mund t'i hynte gjë në kokë atij. Megjithatë, Monika i pëlqente. Kur erdhi në Tiranë për të rregulluar ngarkesën e re të mariuanës, ai pyeti për Monikën. Doli që ajo njihej si vajzë e mirë dhe rridhte nga damar i njohur. Atëherë Linci filloi të mendohet seriozisht për të ardhmen, kuptohet, me aq seriozitet sa mund të gjeje brenda asaj kafke, ku e tashmja qe shtrirë për shtatë palë qejfe.

Monika, që e kishte braktisur prej një viti punën, që kur Linci i kalonte nja gjashtë muaj të vitit në Milano, iu betua e stërbetua në Monza Lincit, se po të vazhdonte me budallallëqet e tij të rrezikshme e me ato zhdukjet pa lënë nam e



nishan, ajo nuk do ta priste më.

- Mirë-mirë,- ia pati kthyer i mërzhitur tjetri.- Boll! Ta dhashë fjalën se do heq dorë...

Atë natë ata fjetën në një hotel komod në Monza, të nesërmen ai e la Monikën në Milano, i fiksoi një takim në mbrëmje dhe ia mbathi, siç e kishte zakon, në Zvicër. Duheshin çuar ca bukë, siç e quante ai drogën, në Lugano dhe këtë punë nuk e mernte përsipër askush. Linci i eci përsëri. I kaloi policisë serbes nën hundë, çoi ngarkësën në vend, bëri transfertën e lekëve në llogarinë e tij dhe erdhi nja tre muaj vërdallë nëpër Evropë. Por mendjen e kishte te Monika. Sikur po dorëzohej përpara betimit homerik të marrë, kur ndodhej në burg, se nuk do të martohej kurrë. Atëherë atë e denoncoi e dashura e tij, një vajzë e urtë, me të cilën ai e pati ndarë rradakën të martohej. Ajo ligjëroi si zog në sallën e gjyqit, e bëri denoncimin edhe me fjalë të thjeshta, që ta kuptonin mirë gjykatësit, pra, kurse ai iu përgjigj akuzave vetëm me një fjali të trishtuar: "Po, unë, të kam dashur, o budallaqe!..."

Linci nuk e kishte ndarë mendjen të martohej menjëherë. Por për bashkëjetesë, ishte! Edhe ndonjë fëmijë mund ta bënte, hë për hë, me Monikën, sa pa iu bërë gjaku e sperma alkool i gjallë...Të tjerat, me të parë e me të bërë!

Ai e ndau mendjen të ndodhej në Milano më 27 gusht, ditën e emrit të Monikës, dhe i qëndroi besnik vendimit të marrë. Dhe, ja, sot, më 27 gusht ai po kthehej. Në kroskotin e makinës kishte një unazë të mrekullueshme për Monikën. Mall i vjedhur ishte, se s'blihej kollaj ajo stoli, por dhuratës nuk i bëhet biografija! Dhe as ai nuk ka ndërmend ta hapë barkun para tjetrës.

Duke u kthyer në Milano, Linci ndjen se po ndodh një ndryshim brenda tij. Ai kujton vuajtjet e tij të pafundme. Para syve i dalin bashkëvuajtës, duke hyrë pa e kthyer kokën pas në galeritë e burgut. Ai bën një si biçim apeli me mendjen e tij. Shumë njerëz nuk përgjigjen. Ata kanë mbetur në faqen e malit apo në barkun e malit, pa asnjë nishan mbi vete. Ca kanë vdekur nga druri, ca nga sëmundjet, ca kanë vrarë veten, ca i ka zënë galerija nën vete...Simoni i shkretë u gropos përgjithmonë, nga që i hapte vrimat me martinel diagonal, siç nuk lejohej, nga poshtë lart. Ai kërkonte të nxirrte sa më shumë mineral në sipërfaqe, që të fitonte sa më shumë ditë. Vdiq kur i kishte ngelur edhe një tremuajsh burg, megjithë ditën e fituara nga shtesa mbi normën...Atë e qau i gjithë burgu...Linci vendos ashtu turbull që, me t'u kthyer në Shqipëri, të japë sa lekë të nevojiten, për të gjetur varret e shokëve të tij fatkeqë. Pastaj i kujtohet përsëri Monika. I shfaqet vajza e trembur në Peruxhia dhe e uron veten që është zemërgjerë, me dëshirë për t'i ndihmuar të tjerët. Po mos ta kishte çarë kokën atëherë, tani do të gjendej përsëri vetëm, i ndryrë në ndonjë klub, gjysmë i dehur, duke kënduar po ato këngë të viteve '70-të.

Ai hyn në Milano në kohën që po bije muzgu. Ndalon në një kabinë dhe i

telefonon Monikës. Ajo ka dalë dhe vajza e tezes së saj, që është në brendësi të marrëdhënieve të tyre, nuk ia zgjat shumë. Ajo është një dhi e vërtetë. Nuk ia fal Lincit andrrallat që po i krijon Monikës. Po edhe Linci nuk e çan bythën shumë. Vendos receptorin në fole dhe vret mendjen ku ta kalojë natën sonte. Nuk e shqetëson puna e ditës së emrit të Monikës. Atë do ta gjejë nesër. Mjafton t'i mbushë mendjen vetes se edhe nesër është data 27 gusht dhe gjithçka do të shkojë mirë. Ai fillon të këndojë nën zë një këngë të Çelentanos. Ndihet mirë. Vendos të marrë ndonjë prostitutë të zjarret pranë stadiumit dhe kthen makinën andej. I vjen pak keq për Monikën, që do qajë sonte nga mërzija pse nuk është bërë i gjallë qoftë edhe për një urim Linci, por e ngushëllon e nesërmja. Ja, shfaqen zjarret dhe ai harron gjithçka. Fillon të studiojë vajzat që kthehen drejt tij. Sonte i do shpirti ndonjë zog të vogël. I janë mërziur gërdallat e mëdha. Ia ve syrin një brazilianeje simpatike dhe kthen makinën drejt saj. Por, teksa kthehet, ngrin në vend. Një bisht syri ka dalluar një vajzë që ngjason me Monikën. Po kjo çudi, habitet ai dhe ndalon para këmbëve të sozisë. Tjetra afrohet, duke u tundur lehtë, dhe, nëpër natën që thyhet vetëtimthi nga flaka e zjarreve, ai njuh Monikën. Bëhet bezhë në fytyrë, por nuk ndjehet. Ia bën me gisht të afrohet tjetrës dhe ul xhamin e makinës. Tjetra nuk dallon gjë.

- 50 mila in makina, 100 mila in kaza,- shqipton mekanikisht ajo.

- Sali!- i thotë shkurt Linci.

Tjetra hyp në makinë dhe struket në sediljen e saj. Linci i jep gaz makinës dhe nja një kilometër më tutje ndez dritën e kabinës dhe kthehet nga Monika.

- Sa kohë ke që e bën këtë punë?- e pyet ai.

Monika shtang, kur shikon Lincin. Në fillim nuk i beson syve, pastaj belbëzon:

- Mbaje makinën, të lutem! Do zbres...

Linci frenon. E ndjek me sy tjetrën tek zbret dhe nuk ndjen asnjë dëshirë për t'i folur. Rikthehet në rrugën e zjarreve dhe fton në makinë brazilianen.

- 50 mila in makina, 100 mila in kaza,- shqipton mekanikisht tjetra me një akcent të lehtë.

- Sali!- i thotë shkurt Linci.

Mendja i qëndron te Monika. Ai kujton përbetimet e saj, ledhatimet dhe lotët, lutjet dhe fjalët e saj për të ardhmen e tyre...Nuk duhet ta bënte këtë gjë, mermërit me vete Linci, pavarësisht nga sjellja ime. Meqë fjalët kanë qenë të sajat, ai mendon se ajo duhej të kishte më shumë respekt për vetveten. I tregon shkurt brazilianes se çfarë i ndodhi pak çaste më parë. Tjetra trembet, kur merr vesh se Linci është shqiptar, por tjetri e qetëson, kur e fut në një hotel luksoz. Kur mbarojnë atë punë dhe ajo bëhet gati të largohet, i thotë Lincit me një trishtim të lexueshëm në fytyrë:

- Unë punoj si prostitutë, sepse nuk kam kë të pres...Mos e ngarko me shumë faj kolegen time! Asnjë nga ne nuk e di se ç' do të ndodhë nesër, në një kohë që të

gjithë ne duam të jetojmë!...

Ajo ikën. Dalëngadalë, Linci qetësohet..Betohet përsëri mos martohet kurrë. Ai bën një llogari elementare: humbi Monikën, por nuk do të ushqejë më iluzione të rreme për të ardhmen. Llogarija i del me fitim të konsiderueshëm dhe ai i rikthehet këngëve të tija moskokëçarës. Ia hodha bythës edhe kësaj radhe, thotë i lumtur. Porosit një shishe verë të mirë fare dhe i këput një dush për shtatë palë qejfe. Është sërisht i lirë dhe ai e di mirë se ç'do të thotë LIRI. Unaza, ai lak i shtrenjtë vetëtitës, ka mbetur e kyçur në kroskotin e makinës. Realisht, atje e ka vendin, filozofon i përgjumur dhe i kënaqur Linci. Dhurata bëhen atëherë, kur individi ka respekt për vetveten...

Dy çaste më pas gërrhet.

## NË KËRKIM TË NJË NJERIU

Aleksandri porositi edhe një kafe të dytë me vështrimin gjithë nga rruga nën shi. Andej kalonin pak njerëz, kryesisht gjimnazistë me çantat e vendosura mbi kokë, të rrëmujshëm e të shpenguar deri në admirim, duke kërcyer mbi pellgjet e ujit. Kështu pat kaluar edhe rinia e tij, me ëndrrat syhapur e dyluftimet majë biçikletave rrangalla me çadrat drejtuar njëri-tjetrit, si heshtat kalorsiake. Sandri nuk ua ndante sytë njerëzve pa një lek në xhepat e xhupave xhins e me sytë më të kthjellët në rruzull...Një tip i tillë i hynte në punë Aleksandrit tani, tani që punët i kishte vënë në vijë. Duke shkarravitur mbi paketën "Marboro", sytë i zunë thënien e famshme të Cezarit. Edhe Sandri një biçim Cezari ishte tani: i kishte kthyer në realitet të gjitha ëndrrat e tij. Tani i duhej vetëm një kalë. Një kalë, në ndryshim nga perandori i madh, jo për të fituar, por për të udhëtuar i qetë larg. Ai nuk donte më të jetonte në Shqipëri. Ky vendim, i bluar gjatë në mendjen e tij, mund të konsiderohej ferman tashmë. Një ferman në fluturim, që priste ndalesën për t'u zbatuar. Ishte robtuar pesë vjet me rradhë rrugëve, ditë e natë, dhe kishte kapur lekë me thasë. Pse të rrinte akoma në këtë vend të përbaltur, ku megjithëse kishe shanse të mëdha për të fituar, kishe pak shanse për të jetuar? Lekë nuk i duheshin më. Tepronin ato që qenë mbledhur në vite. Dhe Aleksandri e pati ndarë mendjen t'ia mbathte. Le ta kryenin edhe fëmijët një shkollë për së mbari. Le të bëheshin edhe ata qytetarë të vërtetë evropianë, pa ato damkat përçmuese në shpinë. Tani i duhej vetëm një bashkëpunëtor i mirë e korrekt, sa për t'i administruar me ndershmëri ato pak prona që i kishin mbetur pa i hequr. Po me cilin të punonte? Sandri kaloi nëpër mendje gjithë miqtë e tij më të mirë. Franko nuk bënte për këtë

punë. ai ishte një konsumist i pandreqshëm. Fredi që lidhur me bektashinjtë. Me Fredin, po, punohej, mirëpo ai kishte lidhur çarçafin në kokë. Edhe tani, mesiguri, do ta gjeje në ndonjë tyrbe. duke u falur. Iliri nuk ia mbushte mendjen. Ai ta shiste vaporin me mall dhe hajde ta kapje pastaj! Akoma nuk i pati dhënë borxhin e vjetër, një 100 dollarsh që ia lyp i për një javë para nja dy vjetëve...Më i sakti i dukej Serxho. Ishte njeri serioz. i mëkuar për së mbari që fëmijë, dhe Sandri, si pagoi, e ndau mendjen të bisedonte një herë me mikun e tij të hershëm. I bëri një telefon Serxhos nga celulari, i la një takim në mbrëmje te kafe "Evropa", i tha të merrte me vete edhe Xhinën, mbase hanin ndonjë darkë të mirë, pastaj ndezi makinën dhe ia mbathi në Plazh. I kishin ca borxhe edhe andej dhe e patën lajmëruar se e prisnin...

I.

Kafe "Evropa" gëlonte nga njerëzit. Sandri i hodhi një sy klubit. Ishin po ato fytyra dhe ai vendosi ta priste Serxhon, duke pirë një kafe në banak. Ishte rritur me këtë Serxho dhe ai e pati martuar shokun e tij gjashtë vjet më parë, në një të dielë me shi, si dita e sotme, ku tortura më e madhe ishte të ruaje fustanin e bardhë të nusërisë të marrë me qira nga përbaltja. Tapë qenë bërë atë natë të paharruar. Pastaj Serxhio ia mbathi në Itali nja tre vjet, po nuk bëri hajër dhe, kur u kthye, ishte më trokë nga ç'u nis.

Sandri dalloj Serxhon me Rexhinën tek po vinin, duke kapërcyer gjithë kujdes rrugën dhe vendosi t'iu dalë përpara. Aty pranë që hapur një restorant luksoz peshku. Pesë minuta më pas ata po zgjidhnin peshkun në basenin e mbushur me akull të thërrmuar dhe Sandri nuk e la mikun e tij të priste gjatë. Ai i tregoi se ç'kishte ndërmend të bënte, ia shpjegoi tjetrit se e kishte zgjedhur thjesht si administrator të mallit dhe, kur Serxho pranoi duke falenderuar, Sandri i zgjati dorën.

- Na shkoftë mbarë!- uroi.- Për një vit do të na japësh lek borxh, po patëm nevojë!

- Fjala jote në vesh të Zotit!- uroi Rexhina.- Nuk paskemi qenë fare pa fat...

♣ I miri e ka fatin me vete,- tha Sandri.

Pastaj ai shtoi se nesër duhet të shkonte për nja dy javë në Itali. Do blinte një shtëpi në Milano dhe do mbaronte nja dy kontrata afatgjata për larës rrobash, që të fillonin menjëherë nga puna. Tek po paguante, ai nxori nga portofoli bashkë me lekët edhe një biletë llotosporti.

- Po kjo?- pyeti duke parë biletën.- Mbaje, ti,- i tha pastaj Serxhios, duke ia hedhur me indiferencë.- Po kapa gjë, tërhiqi lekët dhe m'i jep kur të kthehem nga Italia...Por mos e humb,- shtoi shpërfillshëm.- Jam superticioz mbas këtyre llotarive, ku historikisht vetëm kam humbur...

Serxho i hodhi një sy kurioz asaj letre të zbardhëllyer. Nuk ishte tifoz sporti e llotarish e as i patën interesuar ndonjëherë këto budallëqe. Po s' bëri zë dhe e futi biletën në portofolin e tij në një xhep sekret.

- Këtu nuk humbet kurrë!- tha.

- Mos ki merak!- e siguroi tjetrin Rexhina.- Vetëm ky nuk humbet gjë!

Pastaj ata iu rikthyen llogarive të fitimeve perspektive. Sandri ishte aq konkret, sa Rexhinës i dukej sikur i shihte lekët para saj në tavolinë. Ajo u zgjat, puthi Sandrin dhe mërmëriti një "faleminderit" të përlotur. Po shpëtonin nga borxhet e vogla dhe gërr-mërret për punë lekësh...

2.

Erdhi e diela dhe Serxho me Rexhinën u kujtuan për biletën e llotosportit. Ata u ulën para ekranit dhe filluan të ndjekin indiferentë rezultatet e ndeshjeve. Ndihehin të lumtur. Fati iu kishte trokitur pa pandehur në derë dhe Rexhina kishte filluar të hartonte planet se ç' do të blinte me fitimet e para. Ama, ca lekë do t'i fuste me fajde, sikur nami të bëhej! Kur mbaruan ndeshjet, ajo i shkruajti me kujdes rezultatet. Pastaj filloi t'i kontrollojë me parashikimet e Sandrit dhe i thirri e habitur Serxhos, që po rruhej në banjë. Sandri kishte fituar, kishte kapur rumbullak 13 rezultate.

- Nuk ka mundësi!- tha Serxho.

Por, kur e bëri edhe ai ballafaqimin, fishkëlleu i habitur. Ai i hodhi një vështrim të pafjalë prej idioti Rexhinës dhe, kur ajo e pyeti se pse e shihte ashtu, tjetri ia ktheu me zë të ulët:

- Do ketë fituar një dorë të mirë! Ka gjetur shumë bllofe...

- Vërtet?!- u shtang tjetra.- Hajde fat, hajde!

Ajo u gëlltit një herë, duke vështruar e trembur majtas-djathtas, pastaj pëshpëriti:

- Po sikur Sandri ta ketë harruar? Pastaj, e ku i mban mend rezultatet ai?...

Serxho nuk po ia ndante sytë.

- Për të mbajtur mend rezultatet, ajo nuk diskutohet që nuk i kujtohen. Kush e di në ç'klub i ka vënë, duke pirë, si ia ka thënë mendja...Në mos ia patë vënë ndonjë kamarier!

Rexhinës iu ndez një shpresë e madhe në portret.

- T'i themi që nuk kishte fituar?- iu lut Serxhos ajo.- Janë gjithë këto lekë...

- Po sikur t'i mbajë mend?- pyeti Serxho.- Jo, jo!- shtoi në çast i vendosur.- Mos e hap më këtë muhabet! Nuk futem kot në gjynah! Mos harro, se kur të gjithë na i kishin haruar emrin, ai ishte i vetmi që u kujtua për ne!...

Dhe hap e mbyll sytë gjendej në shkallë, a thua i trembej kësaj bisede, që po

të vazhdonte edhe dy sekonda, do ta fuste në mëkat.

3.

Kur u kthye, Serxho kishte pirë, kurse Rexhina qëndronte e ulur në kolltukun e madh me një vështrim të përhumbur. E ndjeu që tjetri kishte pirë.

- Është vetëm një biletë fituese.- tha ajo sikur po fliste me vete,- bileta ka fituar 39 000 dollarë...E pashë njoftimin në Televizor...39 000 dollarë!

Serxho nuk fliste.

- Pse nuk presim ç' do të thotë Sandri?- iu lut befaz Rexhina.- Po na e kërkoi biletën, ia japim! Ne bëjmë sikur nuk dimë gjë...Tërheqja e lekëve nuk është me afat. I merr kur të duash.

- Në fakt, po mos kishim biletën, ne nuk do të dinim gjë,- pranoi Serxho,- ne nuk kemi parë futboll...

- Asnjëherë!- e mbështeti tjetra.- Edhe atëherë, te darka e Fredit, kur luhej ajo finalja, ne shkuam në dhomën tjetër, nga që nuk shihnim dot futboll...

- Më kujtohet.- tha Serxho.- Bile atë natë ishte për darkë edhe Sandri...

- Tamam!- u hodh Rexhina.- Ta supozojmë se ti e pate harruar biletën në portofol. Di gjë se si kanë dalë rezultatet? Jo!

I ishte ngjalluar përsëri shpresa, se Serxho do ta mbante për vete këtë biletë të mallkuar.

- Dëgjo,- tha Serxho,- na bëj ndonjë meze të mirë dhe hajde pimë ndonjë gotë! Sandri e ka harruar llotarinë! Po na e kërkoi, ia japim...

I shqiptoi këto fjalë me një mundim të tmerrshëm, por kaq duhej që Rexhina të fluturonte në krahët e tij e lumtur. Ata u ulën të dy në tryezë, përplasën gotat dhe vendosën ta prisnin Sandrin një javë. Po mos bëhej i gjallë, do t'i thonin se e kishin hedhur biletën. Serxho i futi një të pirë të mirë dhe aty nga mesnata, gjysmë i dehur, filloi të filozofojë se fati qenka i çuditshëm: i kishte sjellë gjithë ato lekë pikërisht në prag të ditës së emrit!

Por befaz i plasi një ngashërim i rëndë. Nuk deshte ta shihte gruaja dhe, si mërmëriti një "natën e mirë", i ktheu shpinën në shtrat.

4.

Rexhina nuk flinte dot. I qëndronte para syve ajo copëz letre e verdhëlleme me një mori njëshash, dyshash e ikesh të vendosura kuturu nga ndonjë gjeni i lajthitur, por me një magji çudibërëse, kur kombinoheshin. Njëlloj si në atë përrallën me peshkun e artë. Po t'i kërkoi një gjë asaj letre të rëndomtë, ta bënte në çast realitet...Dua një shtëpi të madhe, kërkoi si e hipnotizuar ajo, duke përsëritur

përrallën e lashtë...Dhe, ja, shtëpia e bukur me oborr, me ca pemë shkalavarëse, me livadhin e gjerë me bar të qethur përpara, iu shfaq para syve!

Zot i madh, u lut në shtrat ajo, duke lëvizur gjithë kujdes, për të mos zgjuar Serxhon.

- Pse nuk fle?- u dëgjua zëri i Serxhos në terr.

Ajo heshtoi një hop. Nga jashtë vinte një lehurinë qensh.

- Po, ti, zgjuar je?

- Unë të pyeta i pari!

- Më rri mendja te llotarija,- u përgjigj më në fund ajo, duke psherëtirë.

- Edhe mua,- tha ai.- Ka një orë që një zë më përsërit në kokë se ajo është fati i tjetër kujt...

- Ne sikur e vendosëm një herë që ai e ka harruar,- tha ajo.

Po nuk kishte atë tonin e prerë, aq tipik, kur nuk donte më diskutime.

Qentë i shtuan lehurinat jashtë. Ndoshta i egërsoi sirena e një ambulance. që rrëshqiti diku anash banesës së tyre gjithë alarm.

- Sidoqoftë, unë e di që llotarinë e ka fituar Sandri,- psherëtiu ai.

Xhina u ngrit ndenjtur në shtrat.

- Pse flet në vetën e parë,- u ankua ajo. Pastaj shtoi zëullët: Por ne jemi të sigurt se ai nuk di asgjë për këtë punë!

- Kurse unë kam idenë se ai po më dëgjon!- vazhdoi në vetën e parë Serxhi.

Xhina u ngrit si somnambul, hapi dritën, pastaj ndezi kasetofonin. Dhoma u mbush me tingujt e një kënge të vjetër italiane, nga ato që tani transmetoheshin vetëm në ca emisione nostalgjikë. Gjithçka ndodhi pa vetëdije, si dikur, në kohën e diktaturës, kur ata ndiznin radion nga frika e përgjuesve, sa herë që biseda e tyre konsiderohej krim nga shteti. Tani të dyve u qe mbushur mendja top, se Sandri ndodhej i fshehur diku në këtë dhomë të mobiluar varfërisht.

- Na bëj një kafe!- urdhëroi Serxho, pikërisht atë moment kur këngëtari po përbetohej me një zë qarravitës për besnikëri të pafundme.

Serxho nuk ndihej mirë. Kur Xhina solli kafetë, fytyra e tij e rrumbullakët ngjasonte me një napolon flori.

- Ç'pate?- briti ajo nga verdhëllsia e frikshme e tjetrit.

- Më vjen për të vjellë,- iu përgjigj Serxho.- Më duket vetja sikur sapo kam kryer një krim!

- Vendose gjë?

Ai e soditi gjatë ankthin në fytyrën e tjetrës. Dhe i përzihet vazhdimisht.

- Vendos, ti! Unë jam dakort me çdo vendim tëndin!- tha befas me një zë tmerrësisht të lodhur.

Tani i erdhi rradha Xhinës të zverdhej. As ajo nuk kishte bërë kurrë keq në jetën e saj. Xhina u ndje befas e kapur në lak. Nuk po i shpëtonte dot shtrëngimit



dhe, ç' ishte më e keqja, litari i lidhej gjithmonë e më shumë frymëmarrës në fyt.  
- Dëgjo,- i tha me një zë lutës Serxhos, duke iu ngjitur në trup.- Në atë copë letër ka dyzet e tre shenja, i numurova vetë. A ka mendje në botë t'i rikujtojë ekzaktësisht? Ja, unë, që ti e di sa e fortë jam për punë kujtese, megjithëse i kam studiuar me laps në dorë një qind herë nga ora gjashtë e darkës deri tani, vdeksha, në i përsëris dot siç janë vendosur në letër!...As Ajshtajni nuk do ta përsëriste dot pa gabime gjithë atë gurgule!...Shiko, e mendova: ne blemë një letër të re llotarije, shënojmë dyzet e tre rezultate me pak ndryshime dhe i themi Sandrit "ja letra jote!"...

Fjalët e saj kishin një logjikë bindëse.

- Dakort! Po lekët kush do t'i tërheqë?- pyeti befas Serxho.

Xhina ngriu.

- Ky, po, ky është problem,- belbëzoï ajo.- Prindërit tanë nuk shkojnë dot. Ata Sandri i njeh...T'i japim ndonjë lek Benit? Ai i tërheq serbes dhe as Sandri nuk e njeh...

Serxho diç bluante në mendjen e tij.

- Po sikur të na i punojë edhe ai neve, siç po mashtrojmë ne Sandrin?- pyeti duke rrotulluar fjalët në gojë.

Xhina shtangu. Beni?...Por siç po dukeshin bathët...Tani shkoje për lesh dhe kthesheshe i rruajtur taze!

- Ke të drejtë,- belbëzoï ajo.- Ky njeri duhet gjetur mirë...

Nga gjithë kjo rrëmujë e ankth, të përziëra në lakmi, Serxhos po i buçiste gjaku në kokë me një zhurmë të frikshme. Më mirë të mos ua ngecte në dorë atë letër të mallkuar Sandri! Nuk do të fitonin asnjë lek, ama, do t'i binte shpirti rehat, si të ishte një copë pellg i atij Detit të Vdekur, që thoshin se nuk i njihte dallgët nga koha e krijimit. Tani, mirë u bë hajdut për vete, por i dukeshin edhe të tjerët si hajdutë! Ja, edhe Xhina kishte rrezik t'ia bënte tetshin, me t'i shtënë lekët në dorë!...A ka ndonjë njeri të mirë në këtë botë, dreqi ta hajë, uluriu përbrenda. Nuk mori asnjë përgjigje për të qenë, veç lehjeve të qenve, të rizgjuar nga ca të shtëna armësh, që vinin andej nga varrezat e periferisë lindore të qytetit.

Më hënkshin qentë, mallkoi veten ai Serxho që nuk e kishte njohur kurrë poshtërsinë, por hoqi dorë shpejt nga ky mallkim, kur mendoi se qentë do të tërboheshin, me të gllabëruar copat e atij trupi të mbushur me poshtërsi e tërbim. Tmerr për banorët e pafajshëm të kryeqytetit pastaj, që do të përlyheshin me jargë e do t'i vërsuleshin më dhëmbët jashtë njëri-tjetrit...

Po gdhinte. Një ditë e re me fat të ri, mendoi i trishtuar Serxho. Sot ai kishte ditën e emrit. E patën quajtur SERXHO me dëshirën që foshnja i pafajshëm të bëhej shenjtor dhe ai nuk ua prishi prindërve. U bë një shenjtor i zi, një Satana!

Ç'duhej bërë, u bë, trishtoi ai. Mendimi, jo veprimi, vlente dhe mendimi e

pati qelbur shpirtin. Sot, në ditën e emrit, ai qe gdhirë në një Brut. Por, edhe Bruti, si Cezari, lypte diçka të rrallë, një njeri. Një njeri të ndershëm! Kaq! Asgjë tjetër! Të tjerat, tani i kishte...

## SERAFINI

Atë mëngjes herët, kur më urdhëruan të filloja çështjen hetimore, ai nuk figuronte me emër, thjesht, sepse nuk kishin arritur ta identifikonin ende kufomën, që ndodhej në morg nga mëngjesi herët i 13 tetorit. Kufoma i përkiste një djali rreth 22-23 vjeç, me trup të brishtë e mesatar, me një fytyrë të vuajtur, por me pamje të qetë. Dukej vërtet si shenjtor! Mua më krijoi përshtypjen se ai e kishte pritur vdekjen bujarisht, duke qeshur, ndryshe nga ca portrete të shkalafitur prej tmerrit, me të cilët më pat lidhur puna më parë po në këtë morg. I hodha një sy teshave të tij. Dëshmonin se duhej të vinte nga ndonjë familje e kamur. Më bëri përshtypje ora e dorës dhe zinxhiri i artë i qafës. Kërkova mos gjeja ndonjë shenjë orientuese, por s'kishte asnjë orientim. Ora ishte një LONZHIN i sapoprodhuar dhe unë po e rrotulloja gjithë kuriozitet nëpër gishtrinë, kur ia behën gazetarët. Bëra sikur u mërzita, mirëpo, thellë, urova fatin që m'i solli aq shpejt. Nga ata mund të mësoja diçka për atë të shkretë, që shihte diku lart me etje, sikur ta dinte se sirtari do të mbyllej sërisht shpejt, për t'i krijuar terrin e përjetshëm.

Unë iu tregova me indiferencë gazetarëve se kufoma mbetej ende e paidentifikuar, se, sipas mjekëve, shkak i vdekjes duhej të ishte një overdozë heroine dhe se e kanë gjetur në një tarracë pallati në qendër të Tiranës.

“Kështu do përfundoni të gjithë!”, fillova të bëj sikur tallem, por ata, nuhatës si unë, filluan kërkimet për hesap të tyre, duke e kundruar kufomën gjithë kërshtëri e pa ia varur shumë parashikimeve të mija ogurzeza.

“Kap ndonjë drogmen, shef, dhe e identifikon ai menjëherë. Ne kot po vimë vërdallë. Kështu i bëjmë nder njëri-tjetrit”, më dha mend njëri nga gazetarët.

Nuk e kishte keq. Gjysmë ore më pas, aty nga ora nëntë e mëngjesit, ata të antidrogës sollën nja dy tipa me sytë gëlldoq, pak a shumë si të atij që ndodhej në sirtarin e morgut. bashkë me një femër me një fytyrë vrima-vrima, a thua kishte

lindur në Hiroshima. Vajza e njohu menjëherë kufomën.

“ Serafini!”, thirri, duke vënë pëllëmbët para gojës.

Quhej Serafin Marku. Unë nisa një njeri aty nga ora dhjetë të lajmëronte të atin, mirëpo ai erdhi vetë. Kishte dëgjuar për një kufomë të paidentifikuar te klubi i Fidelit dhe ia pati ndjerë zemra të shkretit. Sa hapën sirtarin e morgut, pa ia parë fytyrën, gjithë ai burrë u këput si i sharruar në dysheme. E njohu! Një Zot e di, si e njohu, duke i parë vetëm shojet e këpucëve! Pastaj unë fillova të pyes dëshmitarët e të afërmit e Serafinit, për të shkuar tek e vërteta. Kur gjithëcka përfundoi, ndjeva një trishtim të madh. Kisha parë e studjuar dhjetëra kufoma të masakruara, apo të larguara nga kjo botë në mënyrën më tragjike, por vdekja e Serafinit sepse më la një shije të hidhur. Më dukej sikur kishte vdekur më shumë se një njeri, ishte si një këmbanë rrënoqethëse me kumbimin e përzishëm të saj. Nuk dihej se kush kishte vdekur. Raportin e mbylla disa ditë më pas. Atje është shkruajtur në mënyrë kronologjike ajo që mund të quhet histori e ndodhisë, por e vërteta nuk duhet të jetë krejt ashtu. Serafini ishte kuruar në një klinikë speciale jashtë vendit dhe që shkëputur përfundimisht nga droga kohë më parë se të ndahej nga kjo botë. Ai nuk pinte më as alkool dhe vështirë që, dikush pa kontakte apo njohje të mëparshme me të, të dyshonte se ai djalë i rregullt dikur drogohej po kaq rregullisht. Pse u rikthye te droga ky njeri? Mua më rezulton se ka qenë një vajzë, si punë e fejuar me të, shkaktarja, pasi ajo drogohej, megjithëse këtë e mohonte kategorikisht. Por edhe ajo nuk mund të jetë shkaku i vetëm, sepse një deziluzion, apo një tundim, nuk mund të çojë drejt vdekjes një njeri. Kështu, ne do kishim mijëra vetëvrasje në ditë dhe do të ndalonim për hetime gjithë Shqipërinë, pa përjashtim. Ndoshta faji ndodhej në një vend tjetër. Unë nuk e harroj atë frazën, që lëshoi si kalimthi shefi i antidrogës: “Me gjithë këtë drogë, që po qarkullon sheshit, mos u çudit, po e nisëm edhe ne ndonjë ditë!...”

Në fakt, për një gjë ne ramë në një mendje: ai ishte një krim dhe ishte kryer në mes të sheshit!

## **KAMARIERI**

Të shtunën, kur ia nisi aty nga dreka ai shiu i madh, Serafini hyri me vrap në lokal. Ishte bërë helaq dhe, pa u ulur mirë, më kërkoi një çaj. Pat hequr dorë nga konjaku, që kur bëri andej nga Maqedonia një kurë të gjatë kundër drogës. Unë ia çova çajin me limon. Kur ia servira, e vura re që dridhej si qen.

“ Ke ftohtë?”, e pyeta.

“ Nuk e marr vesh, ma ktheu, edhe nuk kam ftohtë, edhe seç kam ca të dridhura”.

“ Xhins qeni je, ti, bëra humor unë, nuk të vjen ngordhja nga të dridhurat!...”

Ai qeshi. Po se si qeshi, si me mërzi, si me neveri.

“ Mbase më mirë të isha qen, shtoi pastaj, kush e di na mbante Zoti më me hatër!...Qeni, të paktën, është i rrethuar me vëmendje dhe dashuri!...E di ç’ke, ti? A nuk ma bie edhe një konjak, t’ia fus çajit brenda...”

Me mua fliste, kurse sytë i mbante nga rruga e mbushur me klube e restorante. Mbase priste ndonjë njeri! Unë kujtova se u tall, por ai e donte konjakun vërtet. I çova një “Skënderbeu” të vjetër, që Fideli e ruante për vete, dhe Sero e mori vesh menjëherë, sepse më pyeti ku qe zhdukur Fideli.

“ Pronari ka ikur në Greqi”, e sqarova unë.

“ Mirë e paska bërë!”, ma ktheu ai me sytë andej nga rruga, duke e përzier konjakun me çajin me limon. “Mbase na sjell ndonjë nga ato statujat që bëjnë shurrën gjithë ditën!...”

Unë ika, duke qeshur, në banak, për të marrë porositë e fundit. Po ai Sero kishte ngelur! Që në klasën e dytë fillore e deri në maturë ne patëm qenë shokë klase e ai gjithmonë, ashtu, si ngadalë, do ta këpuste një xhevahir. Kur u ktheva, ai kishte dalë jashtë në gjithë atë shi. Ishte me Enxhin, atë kaçurrelsen kinge, që thuhej lart e poshtë se e kishte si punë të fejuare. Ajo qëndronte nën çadër, kurse ai pingul e në shi. Seç folën nja dy minuta, pastaj ajo ia mbathi. Kur u kthye në lokal, Sero dukej si pulë e lagur. Më kërkoi prapë konjak.

“ Nuk ka më nga ai i miri?”, e paralajmërova, më shumë se nuk desha t’ia fillonte prapë, po, për mua, le të bëhej dru, po të deshte. Unë lek do të merrja, bashkë me bakshish biles!

“ Sille si ta kesh!”, tha ai, duke m’i blerë mendimet. “Një bakshish të mirë do ta japë vëllai, se, ti, si pulat je: mbeturinat të bëjnë të lumtur!...”

Piu nja tre dopio konjak, ashtu, tek pullë, mbaroi një paketë cigare dhe mbas nja dy orësh, pagoi e iku. Kur doli, i merreshin pak këmbët. Nuk kaluan dy minuta, kur hyri në lokal i ati.

“ Ishte këtu Serafini?”, më pyeti gjithë ankth i shkreti.

Unë i thashë se sapo doli.

“ Nga shkoi?”, vazhdoi ai.

“ Nga Shallvaret!”, i thashë dhe shtova se sot Serua piu nja tre dopio konjak.

Plakut të Seros i iku fytyra. Ia dha vrapit nga Shallvaret dhe nuk u kthye më, sa isha unë në turn. Të nesërmen në mëngjes, aty nga ora dhjetë, aq do ketë qenë, unë dëgjova nga çunat e “Kohës...” se në të gdhirë kishin gjetur një djalë nja 25 vjeç në një shkallë te pallatet e Tiranës së Re të vdekur nga overdoza, por akoma nuk merrej vesh cili ishte. Në atë kohë erdhi prapë babai i Seros. Ai nuk po e gjente dot Serafinin dhe i binte të isha unë i fundit, me të cilin ishte ndarë. Ngrita supet, ama, nga brenda seç më këllciti.

“ Prit, të pyes një herë!”, i thashë.

Njëri nga gazetarët kishte qenë në morg dhe e kishte parë kufomën. Ai qe një peqinas, që i pëlqente të tregonte hollësisra. Kur më tha se i vdekuri ishte kaçurrels, brun, me pak mustaqe, me një xhaketë me kuadrate të vogla ngjyrë blu, mua më ra tabakaja nga dora. Babai i Serafini u afrua menjëherë, mbas gjithë asaj zhurme që tmerroi klientët.

“ E, ka ndonjë gjë? ”, më pyeti.

“ Këta nuk e njohin, belbëzova unë, po seç kanë gjetur një djalë të vdekur nga droga... Është i pidentifikuar akoma, në morg... Serua nuk e merrte më, po ku i dihet... ”

“ Serafini! ”, tha ai i shkreti, pa u ngushëlluar hiç prej atyre shtesave të mija, dhe ia mbathi.

Një orë më vonë u mor vesh se ishte vërtet Serafini. Nuk e mora vesh se si shkoi ajo punë! Ai e pati lënë atë drejt droge, punët mirë i shkonin, një Zot e di pse e filloi prapë! Në fakt, thonë se ai zakon nuk harrohet kollaj, por ai qe kuruar në një spital të mirë dhe, ç’ ishte më e rëndësishmja, nuk bënte xhap pa plakun me vete, apo pa atë kaçurrelsen, që thoshin se e kishte si punë të fejuare. Mua më duket se ai ndihej shumë i vetmuar. Ca kohë para se të ikte për fare ne ndodheshim bashkë në një mbrëmje ditëlindjeje të një shokut tonë të hershëm. Kur e pyeta se pse nuk dilte fare nga klubi, ku punoja, ai ma ktheu: E ç’ të bëj atje? Se mos ka kohë njeri të merret me mua!...

Unë shkova në varreza me Fidelin, kur ky u kthye nga Greqia, dhe i ndezëm nga një qiri te varri, Fidelit i shpëtuan nja dy lot para varrit mbushur me lule e tha nëpër dhëmbë “ Ç’ pate, o idiot! ”. Nga ajo ditë mbaroi ai muhabet. Ashtu, qe shkruajtur ai fat! Nganjëherë, më duket se fajin e kam unë, që i dhashë konjak, kur e dija se si e kishte atë drejt halli, po ku ma priti mendja?

## **BABAI**

Serafini qe djali i jonë i vetëm. Jo vetëm se ishte mashkulli aq i dëshiruar për prindin shqiptar, por edhe sepse ai që i vogël shqiptonte çudira për moshën, na bëri ne, burrë e grua, të marroseshim pas tij. Unë zihesha me gruan kush ta merrte nga kopshti Seron e vogël! Mendo çfarë lidhje qe vendosur mes nesh e atij fëmije! Kurse gruaja, sa herë mërzitej me ndonjë diçka, vetëm me djalin bisedonte. “ Ky është komplet si unë! ”, thoshte ajo.

Sa ishte i parritur mirë, Serafini nuk të hapte asnjë problem. Merrte librin dhe lexonte orë të tëra, a thua nuk ndodhej në shoqëri me të tjerë. Në gjimnaz mësonte shkëlqyeshëm, por, kur ishte në vitin e katërt, filloi të marrë drogë. Ne nuk e kuptuam menjëherë. E para e pikasi gruaja ime, duke i rregulluar mbulesat një natë, teksa ai flinte. Ajo dalloi gjurmët e shiringave dhe më thirri mua e tmerruar.

Qenë ca njolla si pika të errëta e të kuqe. Nga ai çast, unë lashë punën, dola në pension para kohe dhe merresha vetëm me Seron. Nuk e lija asnjë çast vetëm, por ai, herë pas here, më zhdukej nga sytë në mënyrën më të habitshme dhe e merrte racionin. Menjëhërë qetësohej e binte në një paqe të madhe. Mirëpo ai filloi ta merrte shpesh e më shpesh heroinën dhe u rëndua aq shumë, sa që rëndom e kapte pendesa dhe shante vetveten. Ca nga këmbëngulja e jonë e ca nga sikleti që po hiqte, dy vjet më parë atij iu mbush mendja ta braktiste drogën. Unë e çova në Maqedoni, te një profesor i njohur. Qëndruam tre muaj në klinikën e tij në Shkup dhe, kur u kthyem në Tiranë, Serua ishte i shëruar plotësisht. Nuk pinte më as pije alkoolike e as coca-cola dhe filloi të shoqërohej me një vajzë studente në arkitekturë, fëmijë e një shoku tim të fëmijës. Edhe ajo vajza kishte marrë dikur drogë, por ne nuk e dinim se ajo vazhdonte ta merrte, ndonëse jo me ato doza që e përdorte në fund Serua ynë. Që ajo drogohej, këtë unë e mora vesh disa ditë para se të vdiste Serafini. Ma tregoi ai vetë një mëngjes, duke pirë cigare në ballkonin e apartamentit tonë.

Lidhja e tyre u forcuua shumë dhe ata vendosën të fejojeshin nja gjashtë muaj përpara. Shkuan të dy me pushime në Dhërmë dhe, kur u kthyen, ai ishte gjithë energji e me mendje që të konkuronte për të studjuar ne mjekësi. Nuk donte të ishte inferior para të fejuarës së tij. Por kjo nuk u realizua, sepse në gusht atij i mblodhi gjuri ujë dhe u detyrua të qëndrojë një muaj i shtrirë në shtrat. Në atë kohë ai filloi të nervozohet me Enxhin. Ne nuk na tregonte gjë, por unë dëgjoja bashkë me gruan zërat e lartë që vinin nga dhoma e tyre. Ai ankohej, duket, për shoqëritë e tjera të Enxhit, kurse ajo e akuzonte Seron tonë për xhelozira idiote. Dy javët e fundit marrëdhëniet e tyre u acaruan shumë. Siç më tregoi atëherë Serua, ai i kishte kërkuar Enxhit mos e shoqëronte më të motrën e saj në eskursionet me ata bankierët e huaj, ku ajo punonte si përkthyes. Enxhi pranoi mos shkonte më, por menjëherë e mashtroi djalin. Të shtunën e fundit, ne shkuam bashkë te shtëpia e Enxhit. Nëna e saj i tha Seros se Enxhi ndodhej në fakultet në një kolokium. Serua, që kur merrte drogë, nuk besonte kollaj. Për gjëra që i vlerësonte, ai kërkonte gjithmonë provën.

“ Hajde, më tha mua, që të më besosh se kam të drejtë!”

Më futi nëpër ca rrugica dhe, para se të dilnim te rruga e Kavajës, ai më tregoi me dorë një vilë, ku ishin parkuar dy fuoristrada me targa të huaja.

“ Këto janë makinat e atyre bankierëve dhe tani atje brenda është Enxhi me të motrën, atë kurvën e qelbur!...”

“ Serafin, mos u bëj i marrë!”, iu luta.

“ Do presim, sa të dalin!”, më tha ai.

Unë nuk desha të rrija atje, edhe sepse druhesha mos Enxhi ndodhej vërtet brenda, por ai më mbajti me zor dhe unë nuk ia prisha, sepse dëshiroja, tek e

fundit, t'ia mbushja mendjen me fakte, se ai nuk kishte asnjë të drejtë në pretendimet e tij.

Qëndruam mbi një orë në skaj të rrugicës, derisa u hap porta e vilës dhe dolën disa meshkuj e femra. Ishin gjashtë, tre meshkuj e tre femra. që qeshnin e fërkoleshin, si macet në shkurt. Me ta ishte dhe Enxhi me motrën. Nuk arrita ta mbaja dot, sepse ai iu doli përpara dhe thirri Enxhin. Ajo u err e u bë bishë.

“ Ç'kërkon këtu?”, é pyeti gjithë nerva.

“ Desha të bisedoja pak me ty”, ia ktheu ky i imi.

Mendova se do të bënte skandal, por toni i tij qe i butë, fare paqësor.

“ Tani nuk kam kohë!”, tha ajo dhe bëri të ikte, por ai e kapi nga krahu dhe nuk e lëshoi.

“ Ti, sikur më dhe fjalën që nuk do të ngatërroheshe më me këta?”

Mua m'u duk nga zëri sikur ai ishte gati të qante.

“ Ti, bën mirë mos gjurmosh më të tjerët nga mbrapa, aq më tepër kur nuk janë prona jote!”

Ajo e la Seron tim në rrugë, fillikat, duke parë makinat që largoheshin dhe, kur iu afrova, unë e pashë përlojtjen e djalit të përzier me ca dënosa të mbytura.

“ Hajde, Sero!”, i thashë me të butë.

Hymë në një kafe aty pranë, unë porosita kafe e ai çaj dhe filluam të bisedojmë. U mundova ta qetësoja, duke e trajtuar si pa rëndësi gjithçka, mirëpo ai e kishte kuptuar mirë se ç'po ndodhte.

“ Ajo nuk më do më!”, më tha.

“ Po mirë, kjo është vajza e vetme që ka bota?”

Ra një heshtje mes nesh. Ai vizatonte me gisht në suprinën e tryezës së vogël.

“ Pse më mashtroni?- më pyeti pastaj.- Unë jam sjellë aq mirë me Enxhin...”

“ Gjëra që ndodhin, e qetësova, sot bota ka ndryshuar shumë. Ajo që dje quhej tradhëti, sot konsiderohet qejf...Edhe, ti, Sero, duhet të ndryshosh!...”

“ Unë në këto gjëra nuk ndryshoj dot!”, më tha.

Unë mendoja se droga i kishte shkatërruar reflekset tradicionale tek ai dhe se vetëm Serua nuk do të bëhej kurrë xheloz, mirëpo kisha gabuar. Ai ndihej i tradhëtuar dhe i fyer. Tre ditë e tre net e kërkoi papushim Enxhin në telefon, por ajo nuk i dilte. Pastaj, ditën e tretë, ai shfrytëzoi momentin, kur unë zbrita të blija bukën, dhe ia mbathi te klubi i Fidelit nëpër gjithë atë shi. Atje shkoi për të pritur Enxhin, sepse ajo kthehej gjithmonë nëpër atë rrugë nga fakulteti. Te Fideli unë nuk e kapa dot. Po mos më kishte ndaluar në rrugë një miku im i vjetër, i dehur që në mëngjes, unë do ta gjeja në klub Seron. Mirëpo nuk qe e thënë.

Nga çasti kur më treguan se ai ishte nisur për nga Shallvaret, unë e kërkova papushim, bashkë me gruan dhe miqtë tanë të afërt. Ai qe zhdukur. Te Enxhi kishte thërritur një herë aty nga ora tetë apo nëntë e darkës, por nuk i qe përgjigjur



njeri, sepse e kishin kuptuar nga zëri që gjendej plotësisht i dehur.

Atë e gjetën në tarracën e një pallati, nga ku dukeshin dritaret e Enxhit, në orën pesë të mëngjesit, të mbaruar. E gjeti një burrë, i cili kishte dalë në tarracë për të rregulluar antenën, që të shihte një ndeshje të rëndësishme boksi. Në morg nuk e identifikuan dot për një kohë të gjatë. Unë shkova në spital, me ta marrë vesh lajmin te Fideli. Sapo e hapën sirtarin e madh, u këputa. E kuptova nga shojet e këpuceve që ishte im bir. Funerali i tij u bë madhështor. Mijëra njerëz i dhanë lamtumirën e fundit Seros sonë. Shumë pjesëmarrës në varrim, siç më thanë më vonë ata të antidrogës, ishin të rinj e të reja që drogoheshin, apo ishin droguar dikur. Ata qëndronin të ngrirë ndoshta duke menduar fatin e tyre nesër. Po Serafinin tonë nuk e vrau droga, atë e vrau zhgënjimi dhe njerëzillëku. Po mos ishte njeri, nuk do të vdiste. Po kush e dinte, që ai, i shkreti, kishte ngelur njeri...

## ENXHI

Ju doni të dini kam gisht, apo jo, në vdekjen e Serafinit? E kam thënë dhe po e përsëris: unë nuk hyj fare në atë mes! Ai, mbase, nuk donte të jetonte...E them këtë, sepse Serafini ka qenë, që kur e kam takuar për herë të parë, në mëdyshe: ia vlen të vish vërdallë e të kullotësh kot në këtë botë, apo është më mirë mos jesh fare?

Unë u njoha me të fiks dy vjet përpara ditës që vdiq. Them fiks, sepse, mbaj mend, që jemi takuar atë ditë, që ishte dita e emrit të tij, shën Serafino, ku të gjithë pinin e këndonin në kor " O Serafino..." dhe vdiq po në këtë ditë. Atë periudhë edhe unë merrja nga pak drogë. Të lehta, jo si Serafini. Droga bëhej sepse që ne të takoheshim nëpër ca mbrëmje, të cilat sot më kujtohen turbull, se, tek e fundit, as dua t'i kujtoj. Atëherë atij i kishte dalë nami si drogmen i fortë, kurse unë sapo kisha filluar të futesha në atë rrugë, më shumë për modë, meqë thuajse të gjithë studentët e Tiranës, apo Durrësit, merrnin herë pas here droga të lehta.

Herën e parë që u takuam, qemë të dy në ajër. S'kuptonim ç'bëhej dhe, të nesërmen e asaj mbrëmjeje, unë e mora vesh që kisha kryer një akt seksual me Serafinin në banjën e shtëpisë ku qemë mbledhur. Më erdhi shumë turp, kur imagjinoja se ç'duhej të kishte ndodhur në atë gjendje që ndodhesha atë natë, sepse prindërit tanë ishin miq të vjetër, mirëpo nuk u takuam nja gjashtë muaj, sepse ai iku në Maqedoni, për t'i shpëtuar drogës. Kur e pashë përsëri mbas nja gjashtë muajsh, ai pati ndryshuar shumë. Ishte shëndosur, nuk merrte më drogë, nuk duronte dot as pijet alkoolike, vetëm pinte shumë duhan. Ne u takuam te Fideli. Atij nuk i kujtohej gjë lidhur me atë mbrëmjen e shkuar, sepse u bë i vëmendshëm ndaj meje e nisi të më sillte rrotull me ca elozhe fantastike, kështu që mua s'm'u desh të jap shpjegime. Më pyeti se si ia kaloja dhe a merrja më

drogë dhe unë i tregova të vërtetën, që, nganjëherë, pija ndonjë cigare me droga të lehta.

“ Hiq dorë, po më dëgjove, se do shkatërrohesh! Edhe unë ashtu e nisa”, më këshilloi.

Vura re për herë të parë se ai ishte djalë simpatik, me humor, të zi, vërtet, po kishte humor. Vetëm se ndihej që ishte depresiv. Nuk i pëlqente ambjenti shqiptar dhe më kujtohet se nga ai e dëgjova për herë të parë atë thënieën: Guri i rëndë në vend të vet...por më i rëndë në traget!

Ai deshte të ikte nga Shqipëria. Familja e tij kishte boll lekë e miq, kështu që pengesa të këtij lloji ai nuk llogariste, por, megjithatë, nuk iku. Nuk iku, sepse u lidh me mua. Të gjithëve iu pëlqeu ajo lidhje: prindërit e tij e pranuan me qejf, sepse atij i duhej një njeri për ta mbajtur larg nga njerëzit e drogës, megjithëse ata e ruanin, sa herë dilte nga shtëpia. Edhe prindërit e mij u kënaqën, sepse e siguruan vajzën në një familje që e njihnin, që kishte emër të mirë dhe pasuri. Mua ai më pëlqente, sepse ishte shumë xhentil dhe i zgjuar, tip modern. Jetën e tij, mënyrën e tij të të sjellurit e organizonte një tolerancë e çuditshme, e cila, mua, nga pikëpamja arkitektonike, më dukej si një element pa shumë garanci reale në ndërtim. Por ai më qetësonte, kur ma kthente moskokëçarës: Arkitektura nuk ka lindur për të respektuar tullën dhe hekurin, por për të shpikur elementë të rinj ndërtimi!...

Kështu ne filluam të bashkëjetojmë, deri sa vendosëm të fejojeshim. Në atë kohë motra ime e madhe filloi punë si sekretare e përkthyesë me Bankën Botërore dhe shkante herë pas here në eskursione apo mbrëmje me punonjësit e bankës. Një herë ajo më ftoi edhe mua. Shkuam në Dajt. Ishim katër çifte. Katër të huaj me katër vajza shqiptare. Atje pinë të gjithë dhe nuk ndodhi asgjë. Mirëpo unë i kisha pëlqyer një zviceriani dhe ai më ftoi përsëri. Herën e dytë u mblodhëm në vilën e tyre. Këtë herë ishim më pak, vetëm unë me motrën dhe zviceriani me një italian. Motra ime gjeti një sebeb për t’u larguar me italianin. Kështu ne ngelëm vetëm. Kisha pirë pak dhe kur u kujtova ta mbaja larg tjetrin, ishte vonë. T’i bie shkurt, unë rashë në shtrat me atë. Por, duke e dashur Serafinin, kjo nuk m’u duk ndonjë tragjedi e madhe, sepse mendova që nuk do ta takoja më zvicerianin. Mirëpo nuk ndodhi kështu. Ne u takuam edhe herë të tjera. Ai më jepte libra të mirë arkitekture, pastaj më mori edhe një javë në Gjenevë. Unë i thashë Serafinin, se isha e ftuar në një takim internacional studentësh, që studionin për arkitekturë, mirëpo ai filloi të dyshojë. Nga ajo kohë, u bë xheloz i bezdisshëm. Kërkonte më këmbëngulje që unë mos shkoja më nëpër mbrëmje me të njohurit e motrës sime, bile, asaj nuk i foli më. I dhashë fjalën se nuk do të shkoja më, më shumë për të shpëtuar nga ato pyetjet e tij bezdisëse pa fund, mirëpo ai më kapi një herë në flagrancë, kur po dilja nga vila e tyre. Sinqerisht, në atë periudhë unë kisha filluar mos ta doja më Serafinin dhe kërkoja një shkak të fortë, për ta prishur lidhjen

tonë. Ai më kishte ruajtur bashkë me të atin. Ka qenë rreth një javë para se të vdiste. Unë u nevrikosa, që ai më kishte gjurmuar dhe e përzura, duke e sharë. Atë ditë vendosa të ndahem. Nuk desha ta shikoja më! Më mërziste xhelozija e tij dhe ai trishtim e skepticizëm i pafund, që ruante përbrenda. Prej atij kishte filluar të më dukej edhe mua bota pa kuptim, kurse, në fakt, bota nuk është edhe aq për t'u përçmuar. Ca thonë se depresioni atij i vinte nga droga, por unë nuk besoj. Kam përshtypjen se atë e mërziste shumë parazitizmi, qëndrimi pa punë e pa shkollë, limontija, shtyrja e ditës me mendimin se ku është tani Enxhi, me cilin po bisedon dhe në ç'orë do takohem me Enxhin. Kjo është e vërtetë, sepse ai u bë gati të hynte në konkurs për shkollën e lartë, mirëpo vrau gjurin dhe nuk arriti dot të përgatitej.

Faj për gjithë atë depresion kanë njerëzit e tij. Unë iu pata thënë një mijë herë se Serafini duhej të merrej me diçka, ndryshe do vriste veten, por ata asnjëherë nuk më besuan, edhe sepse iu hynte tmerrri nga ideja se mund ta linin atë jashtë kontrollit të imët. Serafini nuk ishte njeri që kontrollohej, ai duhej të respektohej! Unë vetë kam bërë gjithçka, që ai mos mërzitej. Ai nuk është gjallë sot, që të flasë të vërtetën, por kjo është e vërtetë, aq e vërtetë, sa për ca gjëra të bëra me të kam aq neveri, sa nuk do t'i provoj më gjithë jetën!...

Siç thashë, e ndava mendjen t'i prishja marrëdhëniet me Serafinin dhe as i dola më në telefon, as e kërkova për ta takuar. Një ditë para se ai të vdiste, binte shi. Unë kthehesha nga shkolla, ai po më priste te klubi i Fidelit. Më doli përpara dhe nuk më linte të ecja.

“ Të lutem, hape rrugën, i thashë, se unë nuk dua të kem të bëj më me ty!”

Tek e fundit, kjo ishte e drejta ime. Ç'kuptim ka që të bësh me jetën tënde sepap për të tjerët?

Ai filloi prapë të më kërkonte llogari. Kur më tha se, po mos e përsërisja më, do ma falte fajin, më hypën nervat keq fare!

“ Ti, do më falësh mua?!- i thashë.- Ik dhe mos më dil më përpara, sepse lidhja jonë ka mbaruar!”

Unë e shtyva dhe ika. Ai ngeli në shi. Aty nga ora tetë e darkës erdhi dhe filloi të më thërrasë poshtë pallatit. E morëm vesh që ishte i dehur dhe nuk dolëm. Ai filloi të shante që poshtë me fjaë të ndyra: “Dil, k-ja e keqe, se e di që je brenda!...” Shau sa shau, pastaj se kush e largoi dhe nuk u ndje më. Megjithëse s'desha të dëgjoja më as emrin e tij, telefonova në familjen e Serafinit dhe iu tregova se ç'po ndodhte.

“ Gjejeni menjëherë, iu thashë, sepse ka pirë dhe kjo është shenjë e keqe për atë!”

Ata s'e zbuluan dot se ku ishte futur. Nuk lanë derë drogmeni pa trokitur, por s'i ranë dot në gjurmë. Duke u gdhirë ajo ditë, e gjetën të vdekur në tarracën e një

pallati nja një qind metra larg pallatit tim. Qe bërë shoshë me gjilpëra dhe kishte lënë një letër, për të cilën askush nuk ka folur, ku shkruante se e ndjente veten të tepërt në këtë botë monotone, të mbushur me këshilla dhe me aspak liri...

Mua më erdhi keq që përfundoi ashtu. Jo vetëm i shkova në varrim, por edhe prita si e fejuara e tij tre ditë vizita ngushëllimi, në shtëpinë e tij. U bëra tre ditë vejushë kot fare! Atje mora vesh se ku e kishte gjetur drogën. Ia kishte marrë një njeriu që punon në antidrogë, një njeriu që prindërit e tij e kishin lutur t'ua gjente atë natë djalin dhe ai u kishte thënë se nuk e njihte Serafinin. Këtë ma tregoi i trembur një shok i tij, me të cilin ai e pati blerë drogën.

Serafini ishte njeri i mrekullueshëm, por depresiv. Edhe kur shikonte sport, qante! Shumë njerëz më bëjnë mua fajtores, por kjo nuk është e drejtë. Ai njeri ishte shkatërruar përgjithmonë nga droga dhe mos një ditë, një ditë tjetër ne do të ndaheshim dhe gjithmonë ai do të fyhej nga ndarja, sepse edhe po mos gjente ndonjë arsye reale, ai do ta shpikte nga mendja e tij arsyen e ndarjes, që pastaj do ta prekte në sedër! Unë nuk e kisha ditur se sa arkaizëm zbulohet në rrënojat e një njeriu, siç nuk e dija që dashurija e vërtetë, në kuptimin e gjerë të fjalës, vdiska shumë përpara vdekjes së trupit të njeriut. ♣

## **NËNA**

Serafini ishte një djalë i qetë, nuk e ngrinte zërin kurrë. Atij i pëlqente të lexonte libra artistikë me orë të tëra, aq sa më nervozonte, kur bëhej i shurdhër ndaj gjithçkaje, vetëm prej librit. Kisha frikë se mos burgosej nga bota librave dhe bëhej njeri idealist në jetë, ushqim për të gjithë. Ne ishim familje moderne, si të thuash, sepse burri im merrej me internierët e banesave, kurse unë kam punuar gjithmonë në Ministri të Jashtme, kështu që kam udhëtuar shumë jashtë shtetit, që në kohën e diktaturës, dhe sillja gjithmonë veshje apo paisje moderne në atë varfëri të atëhershme. Gjithçka shkonte mirë, ishim të lumtur, deri sa Serafini filloi drogën. Kur e kuptova të vërtetën, që ma pohoi më në fund edhe vetë djali, sa nuk luajta mendsh. Nuk dija se si ta ndaja nga ajo botë dhe gjithë ato vite unë e di ç'kam hequr, deri sa ai vendosi vetë të kurohej e të hiqte dorë. Ai e mori këtë vendim, sepse e pa që kishte marrë rrokullimën. Erdhi një kohë, kur Serua nuk fliste asnjë fjalë, po mos kishte marrë drogë. Kur e merrte, i hypte një ndriçim mendor i llahtarshëm dhe mund të të mbante gjallë gjithë natën me qyfyre e vëzhgime të holla intelektuale. Rëndom, nuk mbante mend se ç'kishte bërë, pa llogaritur borxhet që merrte lart e poshtë e që duhej t'i laja të gjitha unë. Por ai e mori vendimin edhe sepse i vinte keq për të atin, të cilin unë e bëja gjithmonë e më shumë, në ca skena hysterike, shkaktar për atë gjendje. Serafini tentoi edhe më parë të ndahej nga droga, mirëpo nuk i ndaheshin ata që ia shisnin, derisa ai tundohej dhe e bënte

prapë. Mua më tregonte se vazhdonte të çpohej, nga që nuk ndihej i fuqishëm seksualisht me femrat, po mos kishte marrë racionin e drogës. Në atë kohë e mendoj disa herë vetëvrasjen. Kur ishte i kthjellët, e kuptonte se nuk hiqte dot dorë nga droga dhe më thoshte se do të qe më mirë mos jetonte fare. Kështu do të mbaronin një herë e përgjithmonë edhe të gjitha telashet tona. I bënte këto biseda qetësisht, duke parë nga maja e ballkonit trotuarin poshtë, si për të vendosur, të hidhej apo jo. Unë filloja qaja dhe ai më përqafonte, duke më thënë se kishte bërë shaka, por këto shaka përsëriteshin gjithmonë. Pastaj, kur shkoi në Maqedoni, menduam se na shpëtoi Zoti. Kur u kthye pas katër muajsh, dukej i shëruar plotësisht. Nuk kishte qejf të dilte jashtë, dilte sa për të pirë një kafe me të atin dhe shihte me orë të tëra televizor në dhomën e tij. Nuk lexonte dot si më parë, mbase sepse i qenë dobësuar sytë nga droga e nga ilaçet, o mbase se librat nuk e çudisnin më, mbas gjithë asaj eksperience të rrallë që kishte fituar nëpër ato labirinthe e drogës, ku edhe mua më ra rasti prej Serafini, të njihja gjithfarë personazhesh e fatesh të habitshëm.

Kishin kaluar ca muaj, nga kthimi prej Maqedonisë, kur njohu Enxhin. Ajo ishte një nga vajzat e dy miqve tanë të vjetër. Ishte vajzë e bukur, me ca sy, që të thithnin menjëherë. Ata u lidhën shumë, aq shumë, sa shpesh ajo rrinte me orë të tëra në dhomën e tij, deri sa një ditë na thanë se kishin vendosur të fejojeshin. Atë natë i thashë tim shoqi: "Stefan, më duket se shpëtuam!"

"Duhet pasur akoma nën kujdes, ma ktheu ai, nuk duhet lënë të takohet me ata që ia shisnin drogën. Ata nuk i ndahen, sepse nuk kanë lekë!..."

Burri e kishte braktisur punën. Tani ai qe ngjitur pas Serafini dhe nuk i ndahej, as kur djali hynte në banjë. I dukej se gjëma mund të ndodhte hap e mbyll sytë. Mendoni, burri nuk fjeti kurrë, nga ajo kohë, përpara se ta zinte gjumi Serafinin, dhe nuk u zgjua kurrë qoftë edhe një minutë më vonë se ai! Unë druhesha se mos e bezdiste djalin, mirëpo ata shkonin mirë bashkë, sepse im shoq dinte t'i tregonte bukur historitë e tij nga koha kur kishte qenë student në Budapest.

Lidhja e Serafini me Enxhin na dha mundësi të merrnim frymë lirisht, sepse tani atë e kontrollonte edhe ajo. Enxhi na garantoi ne, se, sa të ishte ajo në atë mes, Serafini nuk do të afrohej kurrë me drogën dhe kështu ndodhi vërtet! Sa kohë që ata patën marrëdhënie të mira, ai as coca-cola nuk pinte e as filmat me ndonjë personazh që drogohej nuk pranonte t'i shihte. Por ishte herë-herë shumë depresiv. Mua më lutej vazhdimisht t'i gjeja ndonjë vend pune, mirëpo ne as mendonim ta fusnim edhe ca vjet në punë. Na dukej sikur do të fillonte mallkimi i madh nga e para. Qëndrimi pa punë e mërziste. Iu hapën kockat nga qëndrimi vazhdimisht shtrirë dhe sikur iu zmadhua goja nga ato gogësimat pafund që lëshonte. As ne nuk i flisnim dot, që të merrej me diçka, sepse e dinin që ai nuk kishte çfarë të bënte. Veç Enxhit, atij nuk i hynte në sy asgjë, sado tunduese t'ia paraqisje. Tani

rri e mendohej se a më ka kërkuar, veç punës, ndonjë gjë, që kur u kthye nga Maqedonija? Asgjë nuk më ka kërkuar! Asgjë!

Mbase limontija, boshllëku, mbase edhe Enxhi nuk u soll fort mirë, dhe ai nisi të bëhet xheloz, gjë e pa imagjinueshme për familjen tonë. Mua ma qante hallin veç. Më tregonte, duke parë majtas-djathtas, se ajo shoqërohej me ca të huaj, që atij nuk i pëlqenin dhe dyshonte se Enxhi e tradhëtonte.

Enxhi ishte vërtet një vajzë shumë seksi dhe unë e dija se ajo ndodhej e rrethuar nga komplimente e meshkuj në çdo çast që të ishte e ekspozuar. Ia thashë disa herë me kujdes këto gjëra Serafini, duke dashur t'i tregoj se me një femër si Enxhi, nuk interpretohen faktet si me një femër të rëndomtë. Ai, për habi, nuk hapte kurrë rrugë. Atëherë unë i tregova se ç'më kishte ndodhur mua vetë, kur isha e fejuar me Stefanin, me një të njohurin tim student.

"Ti, re në shtrat me atë kur ishe e fejuar me babin?", më pyeti ai pasi dëgjoji historinë time të ngatërruar.

"Po!- i thashë.- Ai ishte një moment dobësisje, që nuk u përsërit më..."

"Po babi, e mori vesh?"

"Diçka kuptoi, por, kur unë u ktheva në jetën normale, ai e quajti një histori që duhej harruar...Edhe ai ka patur ndonjë histori të vetën, unë e di, por ato janë fikur dhe nuk janë ndezur më...Po të ishim bërë xhelozë, ne do të ishim ndarë me kohë e vakt..."

"Mirë do kishit bërë!", i shpëtoi atij.

"Pse?!"

"Sepse unë nuk do vija fare në këtë jetë të qelbur, të mbushur me tradhëtarë e kriminelë!"

E kuptova se ai nuk hiqte dorë nga xhelozija, ishte i pushtuar prej saj, dhe vendosa të bisedoj një herë shtruar me Enxhin. Shkuam të dyja te restoranti i hotel EUROPARK-ut, ku ndiheshe i patrazuar nga njerëzit. Atje, mes gjithë atyre farfurinave, unë i tregova asaj hollësisht për vuajtjet e Serafini. Ajo më dëgjoji pa më ndërperë as edhe një herë, as kur nuk ishte dakort me pretendimet e Serafini. Kur mbarova, iu luta të fliste hapur me mua. Ajo m'u betua se nuk do më fshihte asgjë.

"Shiko, ia nisi ajo, Serafini nuk është mirë! Këtu nuk bëhet fjalë nëse unë bie në shtrat me dikë tjetër, apo jo, sepse këtë gjë ai nuk e di me siguri kurrë! Ai di që unë bisedoj me një mashkull tjetër dhe që ha një drekë, apo një darkë me këtë mashkull në shoqëri edhe të njerëzve të tjerë. Pra, ai bëhet xheloz thjesht për marrëdhëniet e mija shoqërore. Kjo nuk është e drejtë, sepse edhe unë, edhe ai, do kemi dhjetëra kolegë e miq gjithë jetën. Gjithë jeta nuk shtyhet me xheloz...Por ai është xheloz për gjëra të tjera, shtoi ajo me një ton si të mbytur. Ai vetë është aq depresiv, sa nuk i duket asgjë interesante. Kur unë i flas me entuziazëm për diçka,

ai çmendet nga inati. Shkumbëzon!...Edhe seksualisht nuk është mirë. Duket, droga ka bërë të vetën...Po nuk e preke, po nuk i bëre edhe ca gjëra të tjera, që nuk dua t'i përmend, ai nuk kthehet në mashkull. Nuk ka më pasion, sikur ka rënë i gjithi në një gjumë të madh...Ai është i zgjuar, i kupton të gjitha këto, e di mirë që ca veprime në shtrat unë i urrej për vdekje, por i bëj vetëm që të kënaq veten, kur kam nevojë...Kështu nuk shtyhet! Xhelozija e tij dhe perversitetet më kanë ardhur në majë të hundës! Më merr në pyetje si në hetuesi! Deri tani e kam toleruar, sepse vërtet e dua, por kështu nuk vazhdohet! Dakort, e dua, por unë dua e vlerësoj shumë njerëz dhe nuk do martohem me të gjithë ata...Ju duhet ta përgatisni Serafinin për ç' do ndodhë nesër!..."

"Mendohu edhe një herë!", iu luta.

"Vendoseni veten në pozitën time, më tha, pastaj më gjykoni. Brenda në javë më ka thënë 362 herë "kurvë", 513 herë "shkërdhatë", 1000 herë "racë prostitutash"!...Këto "qelbësirë" e "plehrë" janë komplimente!..."

Ajo filloi të qante. Papritur, u ngrit e ia mbathi. Kujtova se iku në banjë, për t'u pastruar, mirëpo ajo nuk u kthye më. E dija se kishte të drejtë, pasi gjithë ato sharje unë i kisha dëgjuar me gjithë tim shoq nga mbrapa derës, kur ata shkëmbenin fjalë në shtëpi. Nuk dija vetëm që ajo ndihej e fyer dhe e lodhur deri në këtë masë dhe se im bir kishte degraduar si mashkull.

Kjo bisedë u bë një dhjetë ditë para se Serafinin ta gjenin të mbaruar në tarracën e pallatit karshi dritareve të Enxhit. Unë u takova me Enxhin, kur ajo u vesh me të zeza dhe erdhi të presë ngushëlluesit, si e fejuara e tij. I tregova për ankthin e asaj dite pa fund, kur ai u zhdruk, i tregova për lemerinë në morg, ku tim shoqi i ra të fikët dhe i thashë se, po të donte, mund të mos priste njerëz në shtëpinë tonë. Nuk kishte pse ta mernte vesh gjithë bota se ajo kishte qenë e fejuara e Serafinit. Ishte e re me fatin përpara, kurse shumë njerëz janë akoma derra të dashuruar pas cipës së virgjërisë...

"Unë e kam dashur Seron, më tha ajo, dhe do ta respektoj e kujtoj gjithmonë, për vlerat që kishte. Për të kaluarën time nuk i jap llogari askujt e as i kërkoj llogari njeriu! Le që këtu ka aq shumë thashetheme, sa skandali më i madh nuk përflitet më shumë se tre ditë!"

"Bëj si të duash!", u tërhoqa unë.

"Ashtu do bëj!- ma ktheu.- Unë nuk kam turp, sepse turpi nuk është për të gjallët! Turpi është për të mbaruarit!..."

Unë kam dëgjuar lart e poshtë se shumë njerëz bëjnë fajtores Enxhin për vdekjen e tij. Pavarësisht se nuk jemi takuar më, pavarësisht se shumë shpejt ajo krijoi intimitete të reja, që mua më dhembnin, them se ajo nuk ka asnjë faj në këtë mes. Faji është i joni, i imi dhe i burrit tim, që, kur shihnim e dëgjonim për njerëz që shpërdanin drogën, nuk luajtëm asnjë gisht. Dhe djalim tim e vrau droga. Po

dëgjuat për ndonjë shpërndarës droge, që do të gjendet i vdekur si djali im. majë ndonjë tarrace i vetmuar e pa njeri te koka me orë të tëra në morg, dijeni se Kanuni është rízgjuar, megjithëse një jetë e vetme .nuk mund t'i lajë ato dhjetëra jetë të ikura dëm kot fare...Zoti e mbajhtë afër Serafinin tim, sepse ai ka ende nevojë për kujdes!

**NËNTOR, 1996**



## NJË DITË NËNTORI ME SHI

Tani kishim mbetur vetëm ne të dy në sallën e madhe të ngritur ngjitur me murin e burgut dhe do të na duhej të prisnim edhe nja dy orë të mira. Mbas shpinës sonë, nga sporteli i qelqtë, një nënoficer krruante hundën për qejf të tij, duke gogësirë rregullisht. Përballë kishim një mur të palyer prej kohësh, të veshur me lagështirë, që formonte një peizazh të çuditshëm, kurse bri nesh, nga dritaret me xhama të palarë hapej një fushë e përgjumur nën shiun e shtruar, që nuk dihej kur pati nisur. Vajza, një bukuri e egër, e veshur me xhinse të zeza e një xhup të madh prej leshi, si në gri, shihte vazhdimisht nga dritarja. Ajo mbante mes këmbëve një çantë me ushqime dhe mbushte herë pas here gotën e saj me kafe, nga një termus i vjetër kinez. Sa herë e kryente këtë rit, hidhte një vështrim nga unë. Po t'ia tundja kokën lart-poshtë, ajo ma mbushte gotën edhe mua. Pastaj kthente kokën prapë nga hapësira e lagur, që të fuste drithma në shpirt, duke gjerbur lehtë kafënë. Dukej tip nevrastenik. Pinte cigare me gishtrinjë që i dridheshin dhe e fikte cigaren shpejt, gati në gjysmë, me ca të goditura të shpeshta në taketuke. Unë po vrisja mendjen se sa vjeç duhej të ishte, kur ajo më pyeti befas:

- Po, ju, kë keni në burg?

- Nipin,- i thashë.

- Hera e parë që iu shoh,- më tha.- Sa vjet ka brenda?

- Dy,- ia ktheva,- ka për të bërë edhe tre të tjera, po nuk i bënë ulje dënimi...E

ka për herë të parë...

- Ç'ka bërë?- pyeti ajo me indiferencë të hapur, sa për t'u kapur në bisedë, duke i mbushur sërish gotat tona me kafe.

Ajo u ngrit për t'i hedhur kafe edhe nënoficerit, pastaj u ul sërish bri meje.

- Nuk e di saktësisht,- i thashë,- unë sapo jam kthyer nga Gjermania, ku ika që në '90-tën. Vëllai im me gruan e tij vdiqën në një aksident rrugor një vit më parë. Tani ky nuk ka më njeri, kështu që detyrohem ta takoj unë. Por nuk do të flasë për dënimin dhe as për ç'ka bërë...Është tip i vështirë, një nga ata që. po e pyete "Ku është balta më e ëmbël se mjaltja?", të përgjigjet: "Te malli im!"...

Vajza kukurisi.

- Qenka tip i lezetshëm,- tha.- I zbërthenka vjershat patriotike tamam!

- Kështu, duket qingj,- ia ktheva edhe unë duke qeshur.- Ta shohësh. e merr për ndonjë student të turpshëm. Por është gjarpër! Rri urtë gjashtë muaj, ama, kur zgjohet, të bën gjëmën...

- Mbase nuk ka faj, i shkreti!- psherëtiu vajza me sytë nga fusha. ku po çapiteshin nja dy qen të lagur, që nuk merrej vesh ç'po kërkonin në gjithë atë qamet.- Kjo është jetë e poshtër,- shtoi pastaj,- edhe të lind, edhe të bën të vuash!...Po, shyqyr që jemi gjallë! Ka edhe më keq...

- Me optimizëm qenke mirë,- vëreja unë.

- Në një copë të zezë, pika e bardhë duket një sahat larg,- ma ktheu ajo.- Të duket sikur është optimizëm,- shtoi,- është vetëm një yxhym, sa për të kapërcyer lumin! Ndryshe, të luan tepeleku i kokës!

Unë e kisha harruar këtë filozofi, por as nuk e besoja, që. një vajzë e re. simpatike. të gjykonte kështu.

- Sa vjeç je?- e pyeta.

- Njëzet!

- Për cilin pret të takosh këtu?

Ajo më hodhi një vështrim të gjatë. Po mendohej, ia vlente të fliste, apo jo. Duket, nuk ruante ndonjë mendim të mirë për intimitetet me njerëzit e çfardoshëm.

- Është një djalë që dua,- tha më në fund me sytë sërish nga moçali për bri.- Domëthënë, më pëlqen,- saktësoi, duke ndezur sërish një cigare, këtë herë nga paketa ime.

- Ç'ka bërë?- e pyeta pa e kuptuar as vetë se pse e ula zërin.

Ajo nuk foli. Filloi të sodiste me kuriozitet çakmakun tim, një ZIPPO vërtet interesant, që e kisha gjetur rastësisht në një berrari në Hamburg. Dukej sikur nuk e pati dëgjuar pyetjen time, po unë e dija se do vinte një moment, që do ta hapte gojën dhe prita me durim. Kaq gjë e mbaja mend akoma nga vendi im: shqiptarët, po u menduan, flasin! Të menduarin e kanë si bubullimë e vetëtimë bashkë. Se s'bën ke shi nga mbropa!

- Më ka përdhunuar mua!- tha më në fund qetësisht. Dhe vërtet që nuk i lëvizi as qerpiku e as iu drodh zëri. Ishte shumë polare atë çast.

Unë shtanga. Ishte një përgjigje, që nuk e prisja. Nuk po merrja vesh asgjë.

- Ku?- bëra pyetjen më idiote dhe nuk do më vinte çudi, sikur ajo ta vinte

dorën në mes të kofshëve e të më hakërrohej "Këtu!". Por vajza e kuptoi mirë pyetjen time.

- Në Greqi,- ia nisi me bezdi ajo.- Unë punoja ndihmëskamariere në një piceri të madhe, ku ai vinte shpesh. Më njohu që isha shqiptare dhe filloi të më vijë rrotull, por unë i rrija larg, sepse e nuhata që donte të më nxirrte të punoja në rrugë. Në Greqi shqiptarët bëhen të këqinj me njëri-tjetrin...Si qen të lëshuar nga zinxhiri, janë...Ai nuk ndahej. E m'ori vesh ku banoja dhe, një mbrëmje, më zuri pritë bashkë me dy shokë, kur kthehesha nga puna...Më futën me zor në makinë, m'i grisën të gjitha plaçkat dhe...mbaroi çdo gjë. Pastaj më hodhën në rrugë...Më gjetën policët grekë. Ata e kishin në album këtë! Sa e pashë surratin e tij, vura gishtin...Kështu e kapën...Dy të tjerët, shokët e këtij, nuk i gjetën dot. Ata u kthyen në Shqipëri. Tani ia kanë mbathur në Itali, më duket...Unë dëshmovava në gjyq, ndejta ca kohë në një shtëpi rehabilitimi, sa m'u zhdukën ato ëndrrat e këqija, pastaj u ktheva në Shqipëri...Tani jam pa punë. Kam futur ca nga ato lekët e Greqisë te VEFA dhe jetoj...Mirë! Shtyhet!...Jeta me fajde nuk është fort e keqe!

Gjithë këtë ngjarje e tregoi me një zë të akullt, a thua po bisedonim nën shi për ndonjë ndodhi të rendomtë.

Unë e shihja i habitur.

- Po këtu pse ke ardhur?- arrita të belbëzoj më në fund.

- Kur e sollën që ta kryejë burgun në Shqipëri, më shkruajti një letër,- psherëtiu ajo.- Ma dërgoi me të motrën...Kërkonte ta takoja vetëm një herë...As vetë nuk e mora vesh pse pranova. Më shumë prej motrës së tij, ajo e shkreta ishte moshatare me mua dhe vetëm qaravitej...Atëherë ky ndodhej në burgun e Tiranës...Nejse, shkova...Ai më kërkoi të falur...Po munde, më fal, tha. Mos kërkoi të më ulet dënimi! Vetëm, ti, nga ana jote, më fal!...Ishte në një depresion të madh...Të kam falur, ia ktheva. Do gjë tjetër nga unë?...Po deshe, kur të jesh e lirë, hajde më shiko ndonjëherë!...Do vi, i premtova, se vërtet më erdhi keq! Ç'kishte për t'u qelbur, u qelb! Në tokë të huaj njeriu bën poshtërsitë më të mëdha, pa qenë i keq...Tani sikur kemi vendosur të martohemi bashkë, me të dalë nga burgu...Po nuk kam fat,- shtoi dhe një pikë e madhe loti i ra papritur nga sytë e egër blu drejt e në kompesatën e tryezës të lyer me bojë vaji jeshile.

- Pse nuk ke fat?- e pyeta.

Ajo psherëtiu.

- Ai është betuar t'i vrasë ata dy shokët e tij, që më përdhunuan bashkë me këtë në Athinë! Thotë që nuk e patëm lënë muhabetin ashtu, ata nuk duhej të më preknin mua. Dhe e bën! Nuk përton për këto punë, megjithëse, po ta njohësh, habitësh. Ka shpirt të mrekullueshëm...Fat i thua këtij, ti?

- Ky nuk është fat,- pranova,- ky është shah-mat!

- Gjithë jetën shah-mat ne! S'luajtëm një herë të qetë...Ngado që ia mbathim,

edhe në vrimë të miut të futemi, vetëm kur zgjatet një kokë idiote katrore, që thotë: Shah!...Unë tani rri me ankth. Nuk fle dot natën. Kam frikë mos arratiset nga burgu, për t'i vrarë ata, që vetë i mori me vete atëherë...Më duket sikur do çmendet...Nganjëherë e shoh në ëndërr sikur ka varur veten...Ç'e pyet! Po luaj mendsh për veten time!...

- Kaq namuz paska?- e pyeta.- Apo i vjen zor, ngaqë këtë histori e dinë edhe të tjerët?

- Idiot!- tha ajo.- I ka ngelur ora te filmi "Skënderbeu"...I jam lutur një qind herë ta harrojë atë histori, ose ndryshe nuk do t'i shkel më në burg, kurse ai...Po në një vend i rreh çekiçi!...I është bërë fiks!...

- Ndoshta e egërson atmosfera e burgut,- e qetësua unë,- kur të dalë. do të urtësohet...

- Dhëntë Zoti!- uroi ajo. Por sakaq shtoi se në këtë vend nuk kishte Zot dhe qe fare e kotë të rroje me shpresa.

- Mos na lëntë Zoti pa fat e pa shpresë!- i thashë unë, mirëpo ajo më bëri një shenjë mishëruese me dorë, që mund të përkthehej "a nuk më le rehat, o xhaxhi!", kurse me gojë shtoi:

- Fatin nuk e bën Zoti, por njerëzit, kurse sa për shpresën, sa është dhalla kos, aq është edhe shpresa jonë shpresë! Ujë është shpresa jonë! Ne kemi një shpresë vërtet, por pa "sh"-ë! Kemi, hasëll-hasëll, një PRESE, që po na pret kokat me rradhë, ja, ç'kemi!...

Atë çast nënoficeri thirri nga sporteli i tij.

- Katerina dhe, ti, zotëri, bëhuni gati, se për pesë minuta njerëzit tuaj do të vijnë!...

Asaj iu ndez fytyra në çast. I harroi filozofimet e zynta. I ra një purpur dhe një padurim mallëngjyes. Fiku cigaren me ngut dhe u çua në këmbë. Ne duhet të hynim në një sallë përbri. Çuam çantat tona të ushqimeve për kontroll dhe, si na i kthyen, hymë nën vështrimin e një polici në sallën e takimit. Ishte një sallë e ftohtë, me hekura të trashë në mes dhe stola të thjeshtë dërrase anash. Në mur kishte ngelur një parrullë nga koha kur kjo sallë duhej të kishte qenë ndonjë mensë ushtarësh: "Shokë ushtarë, lani duart! Pastërtia është shëndet dhe shëndeti lumturi! Enver"...

- Ti, sot ke ditën e emrit,- i thashë.- Gëzuar dhe mos u mërzi! Unë kam parë shumë më keq nga ty!...

- Vuajtja nuk duhet të trashëgohet!- tha ajo.- Pse ka vuajtur brezi i jot, brezi im duhet të ketë shumë më pak halle!...

- Ke të drejtë!- i mbajta krahun.- Po, edhe pa halle, ne shqiptarët sikur nuk jetojmë dot...Nuk na shijon. Na duket jeta tejet monotone...Sidoqoftë, sot, ti, duhet të ndjehesh e lumtur. Sot je vërtet shenjtorë!...

Po përsërisja si papagall fjalët e një prifti gjerman, ku unë kthehesha herë pas

here, sepse më pëlqente ajo fytyra e tij e kuqe nga birra dhe predikimet e mbushura me ndodhi reale nga jeta e përditshme. Ai prift edhe Jezu Krishtin do ta rumbullonte me birra, po t'i vinte në kishën e vogël pranë stadiumit...

- Tallu, ti, tallu!- tha ajo, pikërisht në kohën kur u shfaq në derë nipi im me një djalë të pashëm me trup atleti. Ai më hodhi në vështrim hetues plot me mëri e mosbesim brenda, po duket mosha ime e pjekur një-farë-soj dhe mërmërima e nipit tim "xhaxhai" e qetësuan.

Ata u strukën në cepin e dhomës. Unë dëgjova fjalinë e parë që shqiptoi tjetri:

- Kush të solli deri këtu?...

Pastaj u ktheva nga nipi im jetim, që nuk e kisha parë prej pesë vjetësh. Tinko i vogël tani ishte bërë goxha div me një pamje prej kriminel, që më shtinte të dridhurat edhe mua, kur ia hidhja sytë. Ne biseduam gjëra të lehta. I tregova se varret e prindërve të tij i kisha përfunduar...

- Si kanë dalë?- pyeti ai.

- Si një shtëpi prej mermeri,- ia ktheva.- Të vjen të vdesësh, kur i shikon!

Dhe ai egërsirë më habiti, kur tha:

- E meritoni ata, o xhaja!

- Më vjen mirë, që flet kështu! Kur të dalësh, do rrimë bashkë...

- Të dal një herë,- tha ai, duke gjerbur kafënë, që na serviri sërisht Katerina.-

Po këtu nuk kthehem më!

Ne e lamë që do të shiheshim prapë pas një muaji dhe u ngritëm. Atë kohë, nga qoshja e Katerinës, u dëgjua zëri i djalit.

- O xhaja i Tinit, a do ta marrësh edhe Katerinën deri në Tiranë?

Toni i atij djalit ishte lutës, kurse halli dhe qetësija më e madhe e tij qëndronte te fakti se kush do ta sillte dhe kush do ta përcillte Katerinën nga burgu.

- Do ta çoj unë,- e qetësova.- Dhe do ta marr me vete, sa herë të vij të takoj Tinin!

- Ta paça borxh!- tha ai.

- Ju dilni me mend në kokë dhe mos u ktheni më këtu, po borxhet lahen kollaj fare! Po nuk na i nxorët shpirtin, me këto bredhjet, si zagarë, burgjeve nëpër dimër, jemi larë!...

Nuk mora përgjigje. Prita Katerinën, sa mbaroi takimin, pastaj ne u nisëm me makinën time nëpër shiun, që nuk dihej kur kishte filluar dhe kur do të mbaronte.

**TETOR, 1996**

*Shën Katerina*

*Lindi në Aleksandri në shekullin e III pas Krishtit. Katerina ishte vajza e perandorit Kostand dhe dallohej për pamjen e saj të mrekullueshme. Emri i saj i*

vërtetë ka qenë Dorothea (dhuratë e Zotit). E ndërroi në Katerina, që do të thotë "tre kurora". Kronikat tregojnë se ajo kishte një kulturë të plotë artistike e mjekësore. Shumë njerëz të lartë të Senatit e lakmuan për t'u martuar, por nëna e saj, që ishte një e krishterë e fshehtë, sepse aso kohe perandori Maksimilian në fron kishte filluar përndjekjen e egër ndaj të krishterëve, vendosi të këshillohej përpara se ta merrte këtë vendim të rëndësishëm me një asket të urtë. Ai i dha Katerinës një ikonë të shën Marisë me Jezu Krishtin në krahë dhe i rekomandoi vajzës të lutej gjithë natën para ikonës. Për asketin e urtë ky ishte njeriu, me të cilin duhet ta lidhte jetën Katerina.

Katerina e dëgjoi asketin. Historia tregon se ajo e pa Jezuin dhe u mrekullua e dashurua pas tij përgjithmonë. Mbreti Maksent e përndoqi këtë shenjtore dhe e nxori Katerinën në gjyq. Lutjeve të mbretit për të kthyer rrugë, nëse dëshironte t'i falej jeta, ajo iu përgjigj: "Jeta dhe lavdija e kësaj hote nuk më gënjejnë!"

Më 25 nëntor 305 Katerinës i prenë kokën. Trupi i saj ngeli në majën e malit Sina dhe ky vend u bë i shenjtë për njerëzit. Në shekullin VI, në kohën e Justinianit, në malin Sina u ndërtua një manastir.

Një nga këshillat e saj ka qenë: "Mos u grindni për gjërat e kota të hotës!"

## KOHË ME ERË

Rudi ndihej tmerrësisht bosh nga mërziya e vetmija bashkë në hotelin luksoz buzë detit. Kishte qenë disa herë në stinën e verës në Rimini, por sezoni veror ndryshonte kaq shumë këtu. Tani, në vend të asaj atmosfere të rrëmujshme plot me njerëz e vajza të bukura, me zhurmat e diskotekave e plazhin prehës, kishin mbetur vetëm hollet e boshatisura, një gjysmëndriçim, zhurmërimi kërcënues i dallgëve të detit dhe një ngjyrë hiri e gjithëpushtetshme. Mendoi për të njëqindën herë t'ia mbathte andej nga Bolonja apo Firencia, mirëpo sikur përtonte dhe i dukej se andej do të gjente ndonjë kohë bore e shiu bashkë. Do t'i duhej të priste deri të dielën në mbrëmje në këtë vetmi torturuese, deri sa të kthehej në qytet nga pushimet e fundjavës partneri i tij italian, kurse në këtë muzg ishte vetëm e premtë mbasdite, e premtë e zezë, 13 dhjetor. Vendosi të dilte një herë plazhit dhe, megjithëse jashtë ishte ftohtë e frynte erë, Rudi hodhi krahëve pallton luksoze dhe sakaq ndodhej në breg. Nëpër muzg po zhdukeshin pulëbardhat e fundit dhe leshterikët kishin zaptuar plazhin e braktisur tashmë. Ai u ul në një bankinë, i mbledhur krruspull, me vështrim përpara, larg, andej nga vareshin ca re të rënda e nuk dukej asgjë. Andej ishte Shqipëria, vendi i tij. Nuk ndjente asnjë mall për atë vend, ku ishte rritur e ku qe pasuruar aq shpejt. As në gjithë këtë vetmi e mërzi bashkë. Tani atje do të ndodhej në ndonjë kafene a pijetore, duke dëgjuar po ato biseda e ankesa pa fund, do qëndronte i heshtur duke kundruar parakalimin e varfërisë, do paguante ca gjoba absurde sot e do ngrinte çmimet nesër...Po kështu gjithmonë, thjesht një mekanizëm ore, ditë-natë, 12 e natës-12 e ditës, tik-tak, bardhë e zi, pa ëndrra, gjithçka një paragjykim...Ishte shumë i pasur, njeri i mençur

e aventurier me fat, qenie që e nuhaste monedhën si qen karçofi dhe e nxirrte, edhe sikur të ndodhej e groposur, nga fundi i dheut. Por vetëm kaq! Në atë vend vazhdonin të jetonin njerëz-faraonë, njerëz që pasuroheshin dhe pastaj varroseshin bashkë me pasuritë e dëshirat, pa lënë gjë mbi tokë, veç varrit...Ah, po, shtoi ai në atë meditim, lenë edhe ndonjë tualet, ose çipçbërës!...

Kishte rënë nata, kur Rudi u ngrit. Dritat e hotelit vezullonin zbehtë. Tani nuk ndodhej thujse askush në këtë humbëtitirë dimërore. Edhe prostitutat, që rëndom strehoheshin këtej në dimër, duhej të qenë nisur për në punë. Rudi nuk u kthye në hotel. Iu kujtua që atje pranë ndodhej një kafe luksoze, me ca çmime të çmendura e fotografi origjinale me autografe klientësh të njohur të varura nëpër mure, dhe mori majtas. Edhe në kafe ishte një zbrazësi. Ai zuri një cep, në tryezën ku ishte gdhendur emri i Alberto Moravisë, dhe bëri një shenjë nga banaku. Atje qëndronte e mbështetur një kamarierë e bukur zeshkane, me ca flokë të rëndë, të gjatë e vezullues. Mbase një tip si kjo ka patur parasysh kur ka shkruar "Çoçaren", mendoi ai për shkrintarin e madh...

- Një Branka,- i tha tjetrës pa ia hedhur sytë.

Mendja po i qëndronte tani tek tenda e madhe, që krijonte një tarracë komode para lokalit. Duhej gjetur fabrika. Tani, kur kioskat e klubet në katet e para të pallateve po ktheheshin në modë në Shqipëri, ky ishte një biznes i mirë. Të gjithë faleshin për pak më shumë hapësirë. Po marr nja një mijë copë, vendosi ai, duke llogaritur përafërsisht sa mund të shiteshin tendat në vendin e tij, atë kohë kur kamarierja i shërbeu Brankën. Rudi pyeti zeshkanen për pronarin dhe, kur ajo i tregoi një burrë, që diçka lexonte i mbështetur brenda banakut, ai u ngrit e shkoi drejt tjetrit. E pyeti italianin hollësisht për tendën dhe doli se fabrika ndodhej fare pranë, mes Riminit dhe Bolonjës.

- Pronari është këtu në Rimini,- shtoi tjetri,- po të duash, mund t'i bëj një telefon...

Dy çaste më pas Rudi bisedonte me pronarin. I tha tjetrit se ishte një tregëtar nga Shqipëria dhe se kishte interes për tenda lokale. Tjetri i premtoi t'i paraqiste të nesërmen ofertën dhe Rudi, si falenderoi, shkoi sërisht në tryezën e tij. Tani ndihej më i qetë. Kishte përshtypjen se gjithçka do të ecte mirë me tendat, ndërkohë që kamarierja nuk po ia ndante më sytë. Sonte mund të flemë bashkë, o xhan, mërmëriti ai me vete. Planin e realizuam, përpara xhepit jemi faqebardhë...Nuk kishte shkuar ndonjëherë me italiane dhe tani po bëhej vërtet kurioz. Duhet të qenë të nxehta në shtrat këto llafazane të vockla...Kamarierja diç bisedoi nën zë me pronarin, pastaj u çapit drejt tavolinës së Rudit...Hajde, zogu i vogël, mërmëriti Rudi nën zë, duke kundruar trupin e tjetrës qetësisht.

- Mund të ulem?- pyeti shqip kamarierja.

Rudi u pre në fytyrë.



- Patjetër,- tha.

Tjetër gjë po priste dhe sikur nuk i erdhi mirë që përpara i doli një bashkëpatriote.

Doli se ajo ishte shqiptare. Studionte prej tre vitesh për stomatologji në Bolonjë dhe punonte rregullisht tre ditë në javë si kamariere në Rimini.

- Ç'bëhet andej?- pyeti tjetra, duke bërë më kokë nga deti, ku nuk dukej më asgjë.

Që andej vinte vetëm një zhurmë dallgësh në veshë.

- Siç e ke lënë, një kryevepër!- tha ai.- Tani ka rënë edhe poliomeleti...Kurse dhëmbë të prishur ke me tonelata! Të isha në vend tënd, do të isha specializuar për vënie protezash...

- Merret vesh,- ia ktheu ajo.- Unë shpëtova, as emrin nuk dua t'ia dëgjoj më! Sa herë dëgjoj "Albania" këtu, më dridhet mishi! Vetëm çudira bëjnë! Nganjëherë më duket se kanë lindur me krehër e makinë berberi në dorë! Të vetmit janë për të krehur e qethur tjetrin!...

- Mirë e ke,- e mbështeti tjetri, duke kthyer gotën,- por mos harro edhe tiparin themelor dallues që na karakterizon: nuk e njohim kurrë pyetjen "pse"!

- Mbushe edhe një herë,- i tha tjetrës pastaj, duke i treguar me gisht gotën e zbrazur,- dhe merr ndonjë gjë për vete bashkë me pronarin...Të dëshmojmë xhentesë, të paktën!

Të dyve iu dukej e çuditshme, që kishin lidhje me Shqipërinë, me atë vend ku njerëzit nuk ngriheshin në këmbë, kur egzekutohej Hymni i tyre, nga frika mos iu zinin vendin, apo iu futnin ndonjë gisht nga mbrapa. Dhe, megjithatë, rreth një orë folën vetëm për Shqipërinë, për çudirat e paimagjinueshme të atij vendi, që, kur i kujtoje, habiteshe si ishte gjallë akoma.

Pastaj ajo e pyeti më hollësisht Rudin për veten e tij dhe ai i tregoi thjesht se ishte një njeri 30- vjeçar i biznesit, se kishte kapur ca lek, duke thyer embargon ndaj Serbisë, dhe se fitimin e lekut e shikonte si një formalitet, që as e pasuronte e as e varfëronte më. I shërbente vetëm për siguri dhe afirmim.

- Nuk ka gëzim në atë vend,- përfundoi Rudi.- Ka veç xhelozit dhe intriga. Kështjella e Hamletit është një naivitet i gjallë para Shqipërisë!

Tjetra vizatonte me gisht në tryezë.

- Qartë!- tha.- Ç'vlerë kanë vathët, kur nuk ke veshë?

Rudit iu qesh, kur mendoi se tjetrës duhej t'ia kishte kujtuar veshët helmi në vesh i tragjedisë së famshme...

Heshtën një hop, pastaj ajo i tregoi tjetrit se edhe jeta e saj ecte në një boshllëk dhe, po të gjeje gjë brenda kësaj hapësire kohore, vetmi e mërzi do të hasje me bollëk. Ja, ajo kishte emrin Luçia dhe sot ishte dita e emrit të saj. Një ditë emri e trishtuar në vetmi, se pse përkufizoi ajo. Një ditë e krijuar fare kot, sa për të të

hypur nervat...

Rudi tundi kokën lart e poshtë në formë pohimi. Ndoshta ishte i vetmi vend në botë ku me këtë lëvizje pohohej e mohohesh bashkë. Nuk kishte burrë ta merrte vesh se ç'mendoje realisht!...

- Merri leje pronarit dhe shkojmë hamë darkë bashkë,- tha formalisht Rudi,- duhet shtyrë edhe kjo festë! Të paktën, ne t'ia bëjmë hyzmetin!

Luçia u mendua një hop.

- Ku do të shkojmë?- pyeti pastaj, por, kuptohet, po dyzonte ta pranonte apo ta refuzonte ftesën. Nuk e njihnte këtë njeri, ndërkohë që nuk do të ishte çudi të kishte të bënte me një person krejt të ndryshëm nga ai i paraqitur prej atij vetë. Ehu, sa kishte dëgjuar ajo për shqiptarët mendjendritur! Grackat e tyre qenë tepër të sofistikuara dhe, kur i merrje vesh, rrezik kishte mbetur shtatzanë!

- Ku t'iu dojë bytha!- tha Rudi.

Luçia kukurisi. Gati e kishte harruar tashmë këtë shprehje vulgare të vendit të saj. Çoi në mënyrë të pavullnetshme dorën te vithet e saj të bukura, pastaj bëri me dorë nga deti i zi.

- Është një restorant fantastik këtu, brenda në det, po sonte nuk jam e veshur për të darkuar atje,- tha.

Restoranti ishte vërtet fantastik, por ajo e zjodhi më shumë për të qenë në qendër. Nuk mund ta refuzonte më atë ftesë, të cilën sikur e lypi vetë dhe sikur i pëlqente, por edhe nuk ia mbante të largohej cepave me këtë të panjohur.

Rudi shihte gjithë nga deti dhe nuk e kishte parë ende seriozisht në sy tjetrën.

- Na hahet, hamë, na vishet-vishemi,- perifrazoi një poezi të njohur për të dy.

Iu kujtuan tendat dhe nënqeshi nën buzë.

- Përpara, se italianët do të paguajnë!- urdhëroi pastaj, duke u ngritur në këmbë e duke shkruar trupin e përgjumur.

Morën leje dhe pesë minuta më pas ndodheshin në shëtitore. Ajo e zhytur në xhupin e saj të madh prej kamoshi ngjyrë miu, ai elegant e jakëngritur. Rudin i zunë sytë një Alta Moda dhe ktheu rrugë, duke shtyrë Luçian lehtë. Fliste një italishte të pastër, por shitseve iu la të kuptonin përmes një diksioni të keq, që ishte i huaj.

- Dua një veshje complete për zonjushën,- tha,- nga të këpucët e të mbathurat deri te palltua! Zonjusha ka ditën e emrit sot,- shtoi duke iu buzëqeshur ironikisht vajzave italiane në banak, që po çapëlenin syçkat.

Luçia u skuq e u turbullua, por Rudi e shtyu lehtë në duart e vajzave që shërbenin dhe vetë kërkoi leje të bënte një telefon. Ajo e dëgjoi Rudin se si urdhëroi dikë në Shqipëri ta përfundonte kontratën me Ministrinë e Arsimit, pastaj pa fytyrën ironike të tjetrit përballë, që buzëqeshi i kënaqur, pas kush e di ç'shpjegimi që mori nga andej. Ai u kënaq, kur Luçies i veshën një kostum të mrekullueshëm

stofi skocez dhe një pallto të zezë kashmiri. Kërkoj taksì, ndërkohë që tjetra po vishej, dhe u befásua kur pa Luçien të ndërruar. Ishte vërtet një pamje e mrekullueshme. Ajo vajzë nuk ngjante më me kamarieren e rëndomtë të lokalit dhe flokët e rëndë i vareshin magjishëm deri në mesin e shpinës së plotë, duke ia shtuar vlerën asaj veshje aq elegante. Rrezatonte një bukuri e fisnikëri të habitshme.

- Ja që edhe lekët u dashkan,- psherëtiu Rudi, duke kundruar admirueshëm vajzën.- Tani dukem unë si zhuls,- shtoi.

- Nuk më besohet,- pëshpëriti Luçia, duke e kapur tjetrin intimisht për krahu.- Më duket sikur jam në ëndërr!

Mori si përgjigje një lëvizje indiferente dore.

- Ti ke ditëlindjen sot,- shtoi Rudi pastaj,- le të bëjmë edhe ne një herë në vit figurë të mirë! Jemi apo nuk jemi patriotë? Duhet ngritur lart figura e Atdheut! Tek e fundit, e meritojmë të jetojmë një ditë në vit si në ëndërr!

Kishte shumë tallje në atë patetikë të shqiptuar mekanikisht.

- Jemi patriotë der' në palcë ne,- tha ajo,- veçse pa Atdhe!

- Një Atdhe, që të fut në dhe,- rimoi Rudi në hava.- Ja, edhe unë, u tregova sonte patriot dhe e hëngrta tamam! Tre milion lireta, pa hyrë akoma në restorant! Kush e di sa do hyjë në ujë karta ime sot!- hamendësoi po aq mekanikisht ai.

- U pendove?- pyeti Luçia.

- Jo!- ishte përgjigjia, gjithë aq e vdekur dhe indiferente.- Tani po mendoja për lulet. Desha të të dhuroja edhe lule...Ti më je si një gonxhe,- nisi të këndoje nën zë qetësisht.

- Ti po tallesh?

- Nuk jam aq i zgjuar,- tha Rudi.- Këngën ma kujtuan lulet...

Dhe nuk foli më, deri sa hynë në restorant.

- Paske shije,- vërejti Rudi, duke hedhur vështrimin në sallën e ngrohtë, - megjithëse,- shtoi,- nuk ka shqiptar që mos ketë shije. Është e vetmja gjë që mami natyra na ka falur me shumicë...

Luçia nuk po ia ndante sytë. Këtej po shpenzonte lekët me grushta për një respekt religjioz kristian, nga ana tjetër shpehej "mami natyra"! Prit, kur të dalë edhe mysliman apo bektashi, tha me vete ajo.

- Jam kurioze,- foli më në fund pa ia ndarë sytë kuriozë,- kaq kavalier je me të gjithë që takon? Apo këtë punë e bën për t'i hutuar njerëzit?

Edhe Rudi po e shikonte në sy. Thellë po e lumturonte fakti, që Luçia ishte më e bukura dhe më aristokratja në këtë restorant. I pëlqenin ato kokat e vëmendshme të italianëve, që e ndiqnin me admirim Luçien, duke hamendësuar farë-farë gjërash për të, që shtriheshin nga erotika deri te prejardhja familjare. Po t'i tekej, ajo mund t'i vinte në rradhë nesër të gjithë burrat përreth. Nuk do të që një biznes fort i keq!...

- Unë nuk jam kavalier,- i tha ngadalë Rudi, duke u përkulur drejt saj,- kurse të hutuarit e njerëzve nuk përbën kënaqësi për mua. Me ty bëra një eksperiment, që nuk ma mbante ta bëja me vetveten: desha të dija, a mund të transformohet radikalisht një shqiptar? Dhe e mora vesh se është një punë që bëhet...Ti ishe e bukur. Tani ke edhe dinjitet. Sonte po tregohem kavalier, sepse kam mbaruar një biznes të mirë në Atdhe. Pastaj, si mysliman i devotshëm që jam, duhet t'i respektoj religjionet e tjera, apo jo? Vuaj nga sëmundja e tolerancës, ta hajë dreqi! Nuk po shërohem dot nga kjo sëmundje e rrezikshme...

- Edhe unë mësova diçka, Rudi: që nuk jemi të gjithë injorantë! Paskemi në familjen tonë kamkum edhe civilë tolerantë. Faleminderit!- përfundoi ironikisht ajo.

Dhe filloi të pijë me një moskokëçarje të hapur verë, një verë të bardhë të mirë, që vetëtinte në gotën e kristaltë e ta bënte botën vërtet të bukur.

Pasmesnata e gjeti Luçien plot hare e gjysmë të dehur në dhomën e Rudit. Ata bënë seks të harbuar deri në agim dhe, kur ajo u zgjua, Rudi nuk ndodhej në dhomë. Kishte kapërcyer mesdita. Në orën dy Luçia duhet të paraqitej në punë. Ajo kundroi plaçkat e hedhura nëpër dhomë, pastaj pa qesen me plaçkat e saj në një cep dhe u mendua një hop. As bëhej fjalë për t'u paraqitur në lokal me veshjen e mbrëmshme. Pronari do ta qërronte në çast nga puna. Do të bindej në mënyrën më të bindur që ajo e kishte vjedhur dhe, po të tregohet i gjerë në gjykim e mos t'i hynte bilancit në çast, do mendonte që Luçia natën punonte edhe si prostitutë. Zot, më ruaj, mërmëriti ajo duke hyrë në dush. Nën vrushkujt e ujit të ngrohtë mendoj edhe një herë për gjithë ç'kishte ndodhur një natë më parë. Nuk ndjente ndonjë pendesë të madhe. Ishte hera e parë që çuditërisht i dukej gjithçka normale dhe nuk e trembte asgjë. Ky njeri nesër do të ikte në punën e tij, ajo nuk do të kthehej kurrë në Shqipëri dhe, çfarë ndodhi? Kurrëfarë gjëje! Vetëm një kujtim mund të fluturonte nëpër mendjet e tyre si zog, derisa të ngordhte përfundimisht një ditë. Do të jetë ditë vere, kur zogu të ngordhë, mendoj Luçia. Në dimër zogu kishte të gjitha shanset për të jetuar në ato kujtimet që zgjohen në vetminë e dhomës. tek rri e mendon të shkuarën me zhurmërimën e shiut në vesh...

Kur zbriti në holl, ishte e veshur me teshat e saj. Nga xhamat e mëdhej ajo pa Rudin që bënte ec e jake nëpër plazhin e braktisur, me duar të rrasura në xhepat e palltos e me një vetmi si hije nga pas. E pa gjatë si çapitej, si iu binte topave të leshterikëve me shkelm, si hidhte vështrimet andej larg, mbi det, përtej reve të ulëta, pastaj u kthye e doli në rrugën që të çonte te lokali i saj.

- Rudi!- i thirri tjetrit nga rruga.

Priti sa ai ktheu kokën, e puthi tjetrin me dorë dhe vazhdoi rrugën e saj. I dukej e çuditshme gjithë ajo histori pa nisje e pa fund, që kishte ndodhur. Betimi i saj homerik për të mos patur marrëdhënie me asnjë shqiptar dhe shkuarja në

shtrat me Rudin, me këtë shqiptar të largët e të panjohur. Pse shkova, pyeti veten ajo. Dhe nuk dinte si t'i përgjigjej vetes. Pse shkova, do ta pyeste papushim veten, gjithë atë ditë e të nesërmen, duke qenë e bindur se ai nuk do të dukej më, deri sa ai të rishfaqej në klubin e boshatisur të dielën në mbrëmje vonë, atë kohë kur lokali ishte gati për t'u mbyllur. Hyri me një vetëtimë pas shpine. U ul po në atë tavolinë të skajshme dhe, kur ajo iu afrua, tjetri i tha me një ton të thatë klienti të panjohur:

- Një Branka dhe një ekspres!

Luçia ia serviri heshturazi porosinë, duke ia kundruar vetminë në fytyrë. I pëlqeu thellë-thellë distanca e vendosur menjëherë prej tjetrit. Luçia i qëndroi përballë e menduar. I dukej kaq tragjik dhe kaq i habitshëm njëherësh ky njeri i ardhur nga larg, nga një botë vërtet e pakuptueshme.

- E di ç'po mendoja deri tani?- e pyeti më në fund.- Po mendoja se pse erdha pambremë me ty? Ajo gjë absolutisht nuk është në natyrën time...

- Dhe në ç'konkluzion arrite?

- Në asnjë konkluzion!- tha ajo.

Rudi e vështroi gjatë me ca sy të ftohtë tejet hetues.

- Të kishte marrë malli për Shqipërinë.- ia ktheu pastaj.- Edhe ty, edhe mua...Dhe kjo ishte një çudi e madhe! Unë, për vete, në këtë përfundim arrita. Edhe unë gjithashtu kam menduar gjatë për historinë tonë të çuditshme...As unë nuk ia kam në natyrë këto historira!

- Mbase,- tha Luçia.- Po ç'rëndësi kanë këto gjëra? Unë u kënaqa pambremë. Faleminderit për të gjitha!

- Kënaqësia ishte e imja,- ia ktheu Rudi,- asgjë nuk mund të më ngushëllonte atë mbrëmje, veç teje. Ishte fat që u ktheva këtu dhe u interesova për ato tendat.

Ata fjetën përsëri bashkë edhe atë natë. Të nesërmen ajo la mësimin dhe e përcolli Rudin në aeroportin e Bolonjës. Kur ai u zhduk në terminalin e tij pa i thënë as formalisht që do të shiheshin prapë, a do t'i bënte qoftë një telefon, ajo qau. Dhe u habit se pse duhej të qante për një të panjohur, që vërtet u soll mrekullisht me të, por, tek e fundit, quhej plotësisht "kohë e shkuar".

Ishte vërtet "kohë e shkuar", por tani Luçia me Rudin kanë një bashkëjetesë tejet të rregullt, megjithëse ajo vazhdon të studiojë në Itali e ai vazhdon të fitojë në Shqipëri. Rudi i ka ngritur pak çmimet e mallrave që tregëton, për të nxjerrë shpenzimet e udhëtimeve çdo fundjave në Bolonjë. Ajo ka dëshirë që, kur të mbarojë studimet, të kthehet në Shqipëri e të hapë një klinikë private dentare të specializuar për vendosje protezash. Rudi tallet me të dhe i rekomandon të kërkojë ndihmë për zbatimin e projektit të saj te prodhuesit e ushqimeve të konsumueshëm përmes kafshimit, sepse, sipas Rudit, procesi i protezizimit do të rrisë dukshëm aftësitë kafshuese e përtypëse të shqiptarëve. Luçia e dëgjon, duke tundur kokën

shpërfillshëm. Ajo ka filluar të mbledhë në bankë lekët që i jep Rudi e që nxjerr nga puna e saj si kamariere dhe të dy kanë konverguar fillimisht në një pikë: nuk e shajnë më Shqipërinë si më parë. Bile, tani kanë qejf t'iu tregojnë italianëve fodullë se janë shqiptarë. Sikur janë pajtuar me fatin që iu ka rënë për hise.

**1996**

**PROFETI**





## PROFETI

Muhametin e arrestuan më 31 dhjetor të vitit 19... Atë ditë ai mbushte 22 vjeç dhe gjithë Tirana prej tre-katër vjetësh çmendej nga profecitë e tij si kiroman. Ta lexonte të nesërmen në mënyrën më të pabesueshme në pëllëmbën e dorës e në filxhan. Kjo edhe e mori në qafë.

Hoxha plak i kryeqytetit, mjekërbardhi i krrusur, që nuk e kishin futur në burg, duke menduar se ai tashmë jetonte ditët e fundit, pat vërejtur me habi se Muhameti fliste krejt si profeti i madh, bile, edhe strukturat e fjalive i kishte pak a shumë të ngjashme me ato të Muhametit të madh. Kjo ishte e çuditshme, po të kujtoje se Muhameti tokësor nuk kishte asnjë njohuri fetare dhe nuk do të përbënte ndonjë skandal, nëse ai nuk do të dinte as derën e xhamisë se ku binte!

Muhameti ishte fëmijë i braktisur. Atë e patën lënë të mbështjellë me një batanije të vjetër shajaku në derën e një vendi të shenjtë, pranë Maternitetit, dhe askush nuk mund ta shpjegonte se pse e patën thirrur "Muhamet", kur gjithmonë e në mënyrë absolute këtyre fëmijëve të gjetur në Befotrof iu viheshin emra të lashtë ilirë.

Në Befotrof e më vonë në Shtëpinë e Fëmijës ai ishte gjithmonë një fëmijë i vonuar. Vonë u ngrit në këmbë e vonë foli, aq sa e morën për fëmijë të lindur me difekte. Në shkollë nuk mësonte si gjithë të tjerët. E shihte librin gjatë, si të ishte një qenie me shpirt, dhe shkarraviste figura të çuditshme anash pjesëve të bardha. Gjithmonë hëngri dru për këtë punë, por kurrë nuk hoqi dorë nga ato vizatime shkatarrake e të pashpjegueshme, që vetëm ai u jepte një kuptim të caktuar, shpesh

gjakprishës. Kur e rrihnin, rëndom me thupër ose me hithra, i shihte edukatoret me ato sytë e tij kristal dhe vetëm belbëzonte "po unë nuk bëra gjë!..."

Ai ishte nga të vetmit fëmijë të asaj shkolle plot trishtim që arriti të mbarojë edhe gjimnazin. Memorja e tij habiste edhe mësuesit më me përvojë. Mjaftonte të dëgjonte diçka, gjithë duke u marrë me një punë tjetër, dhe nuk e harronte kurrë. Kështu, pa mundim, ai mori një diplomë të mirë, ku e vetmja vërejtje e shënuar në karakteristikën personale, i bëhej si nxënës që punonte pak me librin.

Prindërit nuk i kërkoi kurrë. Një ditë, tek dëgjonte historinë-kalvar, se si një shoqja e tij i kishte gjetur prindërit e vërtetë, ai i shpjegoi një edukatoreje, që e ndiqte gojëhapur, se prindërit e tij kishin vdekur. Babai qe përmbysur me makinë në humnerë, kurse nëna ishte fikur nga një guvernë në mushkri.

"E ku i di, ti, gjithë këto hollësi?" e kishte pyetur me mosbesim tjetra, e cila e dinte se Muhameti nuk i pati zënë kurrë me gojë prindërit.

"I kam parë të dy në ëndërr, pat shpjeguar me siguri Muhameti, më dolën në ëndërr. babai pesë vjet përpara, nëna prillin e kaluar, dhe më kërkuan falje, që më braktisën atëherë...Nuk më mbanin dot, se nuk i lejonin të martoheshin bashkë...Nëna ime ishte fshatare, nga Biza. Babai atje ngarkonte drurë...Për nënën më erdhi keq, sepse qau shumë para se të vdiste..."

Tjetra i kishte hequr vizën në çast këtij djali torollak e fantazist. Ajo e dinte nga përvoja se shumica e fëmijëve në këtë shkollë ishin të sëmure nga mentë e kokës në këtë pikë, por ajo u mahnit, kur ai i shpjegoi se, duke ndjekur ëndrrën, i kishte gjetur varret e prindërve, dhe kur zgjati dorën e brishtë, mori pëllëmbën e majtë të tjetrës, ia hapi me kujdes e, si ia vëzhgoi një hop, i tregoi ca të fshehta të jetës së saj, që vetëm ajo dhe Zoti i dinte.

Nga ajo ditë, Muhameti heshtaman e syndritur kaloi në qendër të vëmendjes. Gra të moshave të ndryshme mbanin rrallë, për të parë filxhanin apo pëllëmbën tek ai, derisa filluan të vinin netëve edhe ca femra të mbajtura nga familje në pushtët, që ai nuk i njihte, por nuk përtonte t'ua numuronte tmerret apo lumuritë, që i prisnin. Ca burra të tyre ai do t'i takonte më vonë në burg, burg që nuk e mori me tmerr e ankth të madh, pasi një zë i pëshpëriti në vesh, kur ndodhej ende në hetuesi, se do të dënohej herën e parë dhjetë vjet, pastaj edhe një herë, gjashhtëmbëdhjetë vjet. Normalisht, me ligj në dorë, ai duhej të dënohej dy vjet dhe, kur i shpjegoi hetuesit të tij se si dhe pse do të dënohej dhjetë vjet herën e parë, hetuesi çakëriti sytë. Në dosjen e tij ndodhej e strehuar pikërisht kjo pretendencë kriminale dhe as që bëhej fjalë të ishte Muhameti në dijeni të paragrafeve të pretendës. Kur hetuesi ia tha këtë çudi shefit të tij, shefi nuk e besoi. Ai u ngrit e shkoi në qeli, për të verifikuar gjithçka. Me zërin e tij të butë dhe vështrimin ëngjëllor, Muhameti ia përsëriti mekanikisht të gjitha.

- Na sill dy kafe!- urdhëroi shefi vartësin e tij, duke e vëzhguar i habitur

Muhametin.

- Unë s'e pi kafënë!- belbëzoi Muhameti.

- Sill një atëherë!- tha shefi.

Ai e pi kafënë, e përmbysi filxhanin dhe e urdhëroi tjetrin t'ia shihte.

Muhameti e pa gjatë atë labirint vijash e shenjash të zeza të ndërthurrura keqas.

- Shumë shpejt ne do të bëhemi miq,- i tha tjetrit,- ne do flemë bashkë gjithë ato vjet pranë njëri-tjetrit!...Miq të e tu i ke armiq, por tani është vonë, për t'i larguar...Një gropë është hapur. Meqë atje duhet të bjerë patjetër një njeri, ata kanë vendosur të të shtyjnë ty brenda...

Gjashtë muaj më pas Muhameti do ta ndihmonte tjetrin, të shtronte shtratin në kapononin e burgut.

Në burg Muhametin e çuan drejt e nga Gjykata në të dalë të dimrit. Kumbullat kishin lidhur lule dhe ai shihte gjithë çudi gjelbërimin e shpërthyer në mal nga dritarja e vogël e makinës së burgut. Nuk kishte parë kurrë një peizazh të tillë dhe sikur e mori burgun pa shumë mërzë. Ai iu tha "faleminderit" të gjithëve, si atyre që e ndihmuan të zbrisnin nga makina, edhe atyre që e regjistruan në bllokun e trashë hyrjen e tij në burg. Pastaj zuri një krevat në cepin e kapononit dhe nuk bëri zë. Po nami i kishte ardhur deri në burg, për ato profecitë e tij të mahnitshme. Sapo pranoi të shohë filxhanin e parë, policët e tërhoqën zvarrë në qelitë izoluese, ku e lanë një javë të mirë të lidhur si Krishtin. Muhametit nuk iu duk i keq izolimi, po të merrje parasysh se nuk e dëshironte shumë shoqërinë me njerëzit e panjohur. Policëve iu lut ta falnin.

- Unë nuk jam i keq,- belbëzoi ai,- vetëm se nuk di të them "Jo"...

- Të mësoj unë si thuhet "Jo",- iu hakërrua një gardian gjigant, i famshëm për goditjet e pashpirta, që u jepte të burgosurve, dhe për lidhjet mjeshtërore torturuese të duarve, që iu bënte të burgosurve.

Ai i këputi një grusht m'u në gojë Muhametit. Dy dhëmbë fluturuan dhe goja e djalit fatkeq u mbush me gjak.

- Mos më qëllo mua, po ik në shtëpi, se ke një njeri shumë sëmure,- i belbëzoi ai gardianit, duke pështyrë gjak,- vetëm, ti, mund ta shpëtosh atë!...

Mori edhe një shkelm të mirë vitheve për profecinë dhe u palos në çimenton e ftohtë. Dy orë më pas gardianin e lajmëruan të shkonte urgjent në shtëpi. Një qen i tërbuar i kishte kafshuar djalin...

Nga ajo ditë, Muhametin as e futën më në qeli e as i vunë dorë. I trembeshin për vdekje profecive e mallkimeve të tij. Askush nuk uronte më sherr me atë njeri, që parashikonte gjëra të çuditshme. nga prishja me kinezët, deri te ngordhja e qenit të shtëpisë...E transferuan në guzhinë, për ta marrë me të mirë, dhe shumë shpejt e thirrën me nofkën "Profeti". Muhameti, megjithëse i mbledhur krruspull

në cepin e tij, pranë një dritarje që hidhte vetëm dy orë dritë në kaponon, u bë dalëngadalë udhëheqës shpirtëror. Nuk shante kurrë dhe sa herë sillnin në burg ish-persekutues të këtyre të burgosurve pa faj e pa shpresë, e zbuste tërbimin e parë të turmës me fjalinë e prerë:

- Kur fal, mëson edhe të tjerët të falin!

Pastaj ai shpjegonte më gjatë të njëjtat gjëra: kush falet dhe me cilin vendoset paqja dhe, kur turma këmbëngulte për linçim, predikonte me zërin e tij të thellë:

- Faj, kur vritet një njeri, nuk ka arma!...

Nënteksti ishte i qartë dhe ky refren bëri që atij t'i dilte edhe profecia e dënimit të dytë, që i kishte bërë vetvetes, dënim që ai e meritonte, po të kemi parasysh faktin, se Muhameti parashikoi ca vdekje të lebetshme lart në pushtet. Fiks dhjetë vjet, pasi qe burgosur, i komunikuan se Gjykata e kishte dënuar edhe me pesëmbëdhjetë vjet të tjera...

- E dija!- tha ai pa i lëvizur asnjë qerpik.

- Çdo politikan armik e kupton fundin e tij,- tha ftohtë komandanti, një lab i egër, me ca flokë që i sillte vërdallë nëpër kokë, për të fshehur tullën e shëmtuar.

- Unë pelikan?!- u habit Muhameti.

- Politikan!- korigjoi labi.

- Ah, pordhan!- bëri sërish sikur nuk kuptoi Muhameti. Dhe shtoi një çast më pas me një zë që nuk lejonte diskutime: As kam qenë e as bëhem dot politikan, zoti komandant! Por fundin tuaj e di, është shumë i keq! Mbase Zoti nuk do t'i lejojë gojë t'iu pështyjnë...Ky fund, larg qoftë, do të ishte i keq për të gjitha palët!...

Dhjetë vjetët e para të burgut qenë kthyer në një shkollë të vërtetë për Muhametin. Në burg gjeje një mori me profesorë, priftërinj e hoxhallarë, që të mahnisnin me kulturën e kyçur në kafkat e dobëta. Muhameti përfitoi prej tyre, falë kujtesës së tij fenomenale. Ai mësoi latinisht e arabisht, anglisht e gjermanisht dhe mbushi kokën me gjithfarë njohurish. Me kalimin e viteve, ca nga profesorët e tij u liruan e ca vdiqën në atë mizerje. Kështu ai u kthye në një biçim enciklopedije lëvizëse, ku mund të gjeje gjithçka, nga emrat e ilaçeve e të sëmundjeve, deri te personalitetet e të gjitha racave e ngjyrave. Gjithmonë larg sherreve e politikës, Muhameti nuk përtonte të ligjeronte me filxhan përpara edhe ca gjëra, që të rrënoqethnin mishin, kur i dëgjoje. Në shkurt të vitit 1985 ai shqiptoi si pa të keq, duke parë filxhanin e Imam Sadikut, se shihte një zi kombëtare.

“Jashtë do qajnë, ca me lot e ca pa lot, shtoi ai, kurse brenda do bëjnë festë...”

“Pse nuk thua që qenka Enveri?”, belbëzoi nën zë Imami.

Muhameti psherëtiu, gjithë me vështrimin nga fundi i filxhanit.

“Ndjesë pastë, si ai duket!”, tha duke marrë frymë thellë. “Koka është e bardhë, kurse shpirti-sterrë!”...

“T’u bëfshin mjalte këto fjalë, uroi Imami, s’ma kishte pritur mendja se do të shpëtonim ndonjëherë! Po të doli edhe ky parashikim, do të ta bëj vajzën time për grua!...”

“Do ketë vdekje të keqe, tha Muhameti i futur në labirinthin e shenjave të mbetura nga llumi i kafesë, asnjë shenjë nuk do t’i ngelet! As mbi tokë e as nën tokë...Një qysqi e madhe i prish edhe varrin...”

“Zoti është i madh, psherëtiu Imami. Ja, edhe ty të sollti në burg, që mos luanim mendsh ne të tjerët!...”

Imami kishte të drejtë. Profecitë e Muhametit i mbanin me shpresë ata njerëz të rraskapitur, të harruar burgjeve, që iu kishte mbetur ora tridhjet vjet të shkuara. Ky njeri sikur vinte rregull mbi ato mendje gjysmë të çmendura, që vuanin nga lloj-lloj fiksimesh tashmë, dhe arriti t’i bënte deri të këndonin ata njerëz, që e urrenin gëzimin vetëm se ishte gëzim dhe se iu dukej një medalje e pamerituar për botën e pashpirt, ku qenë dënuar të jetonin.

Profecia doli shumë shpejt dhe Imami nisi një pusullë në shtëpi për gruan dhe vajzën. Atë vajzë kishte. Ajo lindi tetëmbëdhjet vjet më parë, kur Imami filloi të vuajë vitin e dytë të burgut. Që nga ajo orgazëm në një barake të fëlliqur për takime speciale me familjarët në Tepelenë, Imami nuk e pa kurrë vajzën. E urdhëroi gruan ta mbante fëmijën larg burgjeve dhe veç në ëndërr e shihte atë fëmijë, herë të vogël e herë të rritur, atë fëmijë që të kujtonte përrallën me vajzën e mbretit të paduruar.

Muhameti u martua në maj dhe në qershor vajza e Imamit i erdhi në burg. Një natë përpara takimit Muhameti nuk vuri gjumë në sy. Nuk e dinte se ç’përfaqësonte vajza e Imamit. Herë e shihte si një vajzë sakate, e herë si diçka kaba. Ishte rasti i parë që profecia e tij gjeniale ishte bllokuar. Asnjë zë nuk i pëshpëriste në vesh. Por ai arriti të shpëtojë nga ankthi, kur i tha vetes qetësisht: “Tani mos mendo më! Nuk e zgjodhe, ti, fatin tënd! Kështu qe shkruar!...”

Kur e thirrën të paraqitej në takim, ai pa me kuriozitet turmën e grave që priste përtej gardhit me tela. Nusja e tij duhej të ndodhej në turmën larashe të veshur varfërisht. Muhameti dalloi një vajzë, që u shkëput ngadalë nga turma, por nuk ishte në gjendje të fokusonte asgjë. Ata hynë të dy në dhomën e sapolyer me gëlqere të takimeve speciale dhe ai qëndroi i heshtur para tjetrës.

- Mua më quajnë Shpresa,- tha me një zë të shuar vajza e Imamit.

Ishte e gjatë, me një bukuri të pushtetshme dhe një gërshet i madh i varej deri mbi vithet e kërcyera gjithë hijeshi.

Habi si nuk ia kanë prerë, mendoi Muhameti, me këtë gërshet mund të varësh veten...

Vajza shihte e trembur përtej dritares-frengji.

- Po nuk ishe dakort me këtë lidhje, e prishim,- tha më në fund Muhameti,-

por Imami nuk i tregojnë...

- Jo!- tha Shpresa.- Ai nuk mendon dot keq për mua! Pastaj, një ditë kjo gjë do të ndodhte. Më mirë kështu!...

Të dy nuk guxonin t'i afroheshin njëri-tjetrit. Muhameti nuk kishte qëndruar kurrë pranë një femre, por edhe ajo ishte po aq sterrë në këto punë. Shpresës i erdhi në vesh zëri i të ëmës dhe u kthye nga tjetri.

- Ne tani jemi bashkëshortë,- belbëzoi e përsququr ajo,- nuk është turp të bëjmë dashuri bashkë...

- Ne jemi njerëz të mirë, sepse kemi turp,- belbëzoi edhe ai.- ky turp na ka ndarë për së gjalli...

Muhameti ndjeu se si iu afrua ngadalë tjetra, si i qëndroi përballë, duke i lëshuar një afsh të ngrohtë dridhës diku pranë qafës dhe e përqafoi Shpresën. Trupi i plotë i tjetrës dridhej tani në krahët e tij.

- Zoti e di që nuk ta kam me hile,- tha ai dhe puthi buzët mishtore të tjetrës me një dashuri hyjnore, të pastër, si ajo bluja qiellore që hapet në agim.

Kështu filluan lidhjet e tyre. Muhameti nuk donte të bënte fëmijë në burg, por Imami e urdhëroi një mbrëmje prerë:

- Bëje një fëmijë!

- Që t'ia ve emrin AUTOBURG?- pyeti Muhameti.

- Unë e ndjej që do të vdes shpejt,- tha Imami.- Dua një gëzim të madh! Ma jep!...

Edhe Muhameti e dinte që Imami do largohej. Filxhani i tij dilte blozë e më blozë. Atë nuk po e gryente ndonjë sëmundje. Po e fikte pak nga pak malli për njerëzit e tij jashtë telave, ku vërshonte 24 orë një tension i lartë vdekjeprurës. Tani Imami nuk hante thujse fare dhe shihte ca ëndrra të çuditshme me bukë misri të ngrohtë e djathë Libohove, me hudhra të njoma e pilaf të ngrohtë me lëng gjeli. Fytyra e tij kishte hyrë në ujë e qafa nuk merrej vesh si ia mbante atë kokë eshtake...

- Mirë!- pranoi dhembshurisht Muhameti.- Por edhe, ti, duhet të jetosh, që t'i vesh emrin!...

- Ta kam dhënë fjalën!- i vuri kapak bisedës Imami.

Thuajse një vit më pas, kur erdhi lajmi i lindjes së djalit në burg, Imami po fikej në shtratin e tij prej dërrasash të pagdhendura. Ai nënqeshi, kur i kumtuan gëzimin e madh dhe tha me mundim:

- Imir!

Me këtë emër u pagëzua fëmija i vogël në një zyrë të Gjendjes Civile në Tiranë një javë pasi Imami kishte dhënë shpirt. Atë ditë qau edhe Shpresa, edhe nënpunësja e zyrës Civile.

- Shpërndaftë dritë e ngrëntë errësirë ky fëmijë!- uroi ajo mallkimin e saj.

Ajo e mbante mend mirë këtë Shpresë. Kështu, me lot ia kishin vënë emrin edhe kësaj fëmije nja njëzet vjet më parë e atëherë ajo kishte uruar që shpresa të bëhej realitet për Imamin gojëflori, por profecia nuk kishte dalë.

- Amin!- tha Shpresa.

Tre muaj më pas, kur ajo shkoi të takojë Muhametin, ishte qershor i vitit 1987. Gjatë gjithë takimin ajo vetëm qau me dënosa të mbytura. Mbas shpine ndjente sytë e një oficeri, që nuk i ndaheshin.

- Mos qaj!- tha butësisht Muhameti.- Kur djali të bëhet tre vjeç, unë do të kthehem në shtëpi!...

- Ke harruar të numurosh, profet,- u tall oficeri që atje tej.- Kur të bëhet dhjetë vjeç!...

- Më lert' i bëj llogaritë siç kam dëshirë,- i tha butë Muhameti,- njeriu numuron sipas hallit që ka!

- Mirë është ta dish, kur numuron gabim,- vazhdoi të tallet oficeri.

Ai ishte një djalë i ri, i sapoardhur nga bangat e shkollës dhe donte të ngacmohej në këtë humbëtirë, ngaqë nuk dinte si ta shtynte kohën. Po Shpresën e njihnte mirë. Ata banonin në një lagje dhe ai kishte dëgjuar që fëmijë për Imamin e njohur e për vajzën e tij.

Muhameti befas u egërsua.

- Unë e di që të ha ujku e jo qeni i shtëpisë!- tha shkoqur ai.- Po, me këtë numurimin tim, ti dhe një mijë ditë pushtet ke, pastaj do marrësh malet!...

Oficeri nënqeshi lehtë. Por nuk deshte sherr me profetin.

- Si ma lexove fatin?- pyeti.- Nuk më pe as dorën, as filxhanin!

- Të pashë gjakun!- ia ktheu Muhameti.

- Nga unë nuk të vjen asnjë e keqe,- vendosi paqen oficeri,- unë jam fqinj me Shpresën dhe njerëzit e mi e kanë dashur Imamin. Fatin e pati të keq e vdiq, i shkreti, po ca borxhe na duhet t'ia lajmë!...Imami ka vënë shumë emra kalamajsh në lagjen tonë...Ti. Shpresa,- shtoi duke u ngritur,- për çdo hall me Muhametin, letra, ushqime, plaçka, shko te nëna ime! Dhe varri i Imaminut është poshtë dardhës së egër, atje ku fillon humnera...Ta tregon tamam vendin Muhameti!...

Nga ajo ditë ata u bënë miq. Oficeri sikur u hipnotizua nga profecitë e tjetrit, që, për habi, dilnin gjithmonë. Ai nuk vuri dorë mbi të burgosurit dhe, kur e xhveshën për zbutje të luftës së klasave në fundin e vitit 1989, gjë që Muhameti e pati parashikuar nja një muaj më parë, i la profetit për kujtim të gjitha librat e tij.

- Shpëtove, o mik!- i tha Muhameti në ndarjen e fundit.

- Kur të dalësh, do të të pres te dera!- i premtoi tjetri i përlotur nga një mallëngjim i beftë.

- Më 31 dhjetor të vitit 1990 unë mbush 40 vjeç. Vitin e Ri dhe ditëlindjen time do ta festojmë në shtëpinë tënde. Piq një gjel të mirë dhe më prit!

- Më premtò!- e vuri në betim oficeri.

Muhameti u mendua një hop. Dukej sikur bënte ca llogari të ngatërruara me mendje.

- Për kokë të Imirit e për shpirt të Imamit, o Dritan!- u betua Muhameti.

Tjetri e shtrëngoi në krahët e tij muskulozë prej djali të ri dhe iku. Pastaj, ktheu kokën dhe një herë e tha:

- Mos më ler në gënjeshtëri!

- Orën nuk ta them dot.- qeshi lehtë Muhameti.- Në këtë vend çdo orë punon për hesap të vet!...

Kështu u ndanë, duke qeshur. Askush nuk besonte në këtë profeci, por, kur Muhameti do të trokiste më 31 dhjetor të vitit 1990 në derën e Dritanit dhe kur Diti të shihte në prag figurën e rrekosur të profetit, të pandehur për lypës nga nëna e tij, do sharrohej i hutuar në karrige.

- I gjithë burgu të bën të fala e të është borxhli, që më vure në betim.- tha Muhameti.- kanë kaluar një vit, duke qeshur, të sigurt se do liroheshin bashkë me mua!...

Gjithëcka ishte e vërtetë. Askush nuk pati vdekur atë vit të madh shprese, të parashikuar si viti i fundit i skëterrës nga profeti. Vetëm se njerëzit qenë hequr më shumë nga padurimi dhe një egërsi iu vetëtinte herë pas here kërcënueshëm nëpër sy, një egërsi që e trishtonte Muhametin dhe e detyronte të mërmëriste nëpër dhëmbë: "O Zot, mësojua këtyre njerëzve, që lirinë e sjell paqja!..."

Mrekullitë e hershme të tij dhe vitet e gjata të burgut e kishin shndërruar Muhametin në sytë e njerëzve në një Mesi tokësore. Njerëzit e vështrojnë të mahnitur në rrugë dhe përpiqeshin ta preknin me dorë, gjë që ia dhunonte lirinë e fituar më në fund. Një zë i pëshpëriti në vesh të merrte familjen dhe të largohej nga ky vend, ku nuk e jetonte dot jetën e tij, por Shpresa nuk pranoi.

- Këtu kemi varret e prindërve!- tha ajo me një ton, që nuk jepte asnjë shans për kompromis.

Në gjithë atë kaos lirije e ndryshimesh, Muhameti iu rikthye dhuntisë së tij. Tani rrada e njerëzve plot shpresa e zhgënjime shtrihej gjithmonë e më shumë dhe në llumin e kafesë zgjatëshin e bëheshin realitet gjithfarë çudirash, të paparashikueshme edhe nga mendjet më diabolike. Muhameti vërtet tregonte shumë të vërteta, por ai filloi edhe të gënjente nga pak. Një zë i brendshëm i thërriste të predikonte paqe përpara shpirtërave të shqetësuar.

- Ti, duhet të harrosh!- i tha një ditë ai një ish-mikut të tij të burgut, duke i vëzhguar fundin e filxhanit.- Po harrove, do ngjitesh lart, po të shtyu kujtesa drejt larjes së hesapeve, do kthehesh andej nga sapo ke dalë!...

Tjetri e pa gjatë profetin e çuditshëm, që kishte parashikuar aq çudira në terrin e Spaçit dhe që kishte arritur të mbante gjallë qindra shpirtëra të shpartalluara



si gjethet e vjeshtës nën murlan.

- Shpëtove edhe një njeri,- mërmëriti syulur kërkuesi i së nesërmes.

- Dy!- saktësoi Muhameti.- Po ta kesh zemrën e mirë, do shpëtojnë më shumë!...

Gjashtë muaj më pas Muhameti pa sërisht fytyrën e mikut të tij të vjetër në prag. Mbante djalin në prehër dhe po i këndonte një ninullë të sajuar aty për aty: "Rritu, zemër, sa më shpejt, ta bësh botën të ecë drejt..."

Pastaj shtoi në mënyrën më të habitshme:

- Dhe në jetë, po të falësh, si ky xhaxhi lart do dalësh...

- E ku e di, ti, ku ndodhem unë sot, lart apo poshtë?- pyeti i habitur tjetri, të cilit vërtet sapo i kishin komunikuar vendimin, që e emëronte ministër.

- Po ra era mish i pjekur në derë, domethënë që do ta gjesh në tryezë!- tha me bezdi Muhameti.

Ai lëshoi Imirin dhe e ftoi tjetrin të ulej. I përgatiti një kafe të fortë, ia vuri përpara, e ndoqi si e gjerbte, e pa si e përmbysi filxhanin, pastaj, kur kush e di ç'sinjal i vetëtiu në mendje, mori filxhanin gjithë kujdes. E pa gjatë dhe, në fund, psherëtiu pa hapur gojë.

- Ç'thotë filxhani, o Muhamet?- pyeti tjetri.

- Nuk po flas, sepse, ti, nuk ke më asgjë në dorë!

- Kush e ka?- belbëzoi tjetri zëulët, si në burg, i friksuar kush e di nga ç'instikt i hershëm.

- Zbret një njeri nga malet,- tha Muhameti,- ky e do vallen ndryshe. Mban një dajak në dorë. Është i mirë me kë kërcen, është i keq me kë s'dëgjon...E keqja është se ai i di gjërat më mirë se sa ne!

- Atëherë, duhet dëgjuar!- belbëzoi ministri.

- Po i besove, do ta dëgjosh, por tani njerëzit janë si fëmijët: nuk duan t'i ushqesh me zor, edhe sikur t'iu vesh përpara gjënë që duan më shumë! Ky mbret nuk të bind, ky ta fut lugën me zor në gojë!...

- Mbret, the?

- Edhe po nuk vuri kurorë, mbret do të jetë! Shqiponjën e do me një kokë dhe, sa të jetë në fron, me një kokë do ta lerë! Po t'i afroresh, të kafshon! Po i ndejte larg, të ushqen! Burgjet do mbushen prapë dhe do shpëtojnë pa u lagur, kush e kupton kur do fillojë rrebeshi! Kaq!- tha i lodhur Muhameti.

Ra një heshtje e rëndë mes tyre.

- Po, unë, si të bëj?- pyeti gjithë zëulët tjetri.

- Nuk e di!- ia ktheu duke ngritur supet Muhameti.- Veç kush rri afër mbretit, shikon nga parajsja dyert e hapura të ferrit! Unë nuk do t'i afrohesha!...

Ai filxhan e mërziu profetin. Muhameti iu betua Shpresës se nuk do të shikonte më nëpër ato rebuset e llumit të kafesë, edhe sikur këtë gjë t'ia kërkonte mbreti

vetë! Por profeti profet mbetet. Katër vjet më pas në portën e tij të mbyllur tashmë do të trokisnin me këmbëngulje një mbrëmje vonë. Muhametin e kërkonin te “Mbreti”.

- Ç’punë ka ai me mua?- pyeti i çuditur ai.

- Nuk e di!- ishte përgjigjia.

Ishte një natë e ftohtë dimri, gjithë shi e erë fishkëlljese dhe, kur profeti hyri në zyrën e madhe të “mbreti”, vuri re se shqiponja, e gdhendur në një copë druri ulliri, ishte me një kokë, që nuk merrej vesh nga ç’anë shihte.

Mbreti e donte për t’i parë filxhanin. Ai ecte pak shtrembër. Nuk ta ndante vështrimin, por sytë një shqetësim i brendshëm ia lëvizte vazhdimisht në zgavrat e thella.

- Pse më mundon kot?- i tha butë Muhameti.- Ti nuk beson!

- Ku e di, ti?- e pyeti mosbesues mbreti, po u mor vesh që nuk e treti mirë njëjësën e profetit, sepse një vështrim i denjë vetëm për fundërrirat ra mbi figurën e mbledhur të Muhametit.

- Një mbret, që beson, as e merr zvarrë e as e kontrollon profetin.- shpjegoi me bezdi Muhameti.

As atij nuk i pëlqeu ajo e parë plehrë e mbretit të veshur bukur.

- Gabon, i dashur,- tha mbreti,- unë të thirra, sepse besoj dhe sepse kam dëgjuar shumë për ty...Më vjen keq që ke vuajtur edhe gjithë ato vite në ferrin e komunistave...Ti, meriton shumë më tepër!

- Unë nuk kam vuajtur! Po të jesh mes njerëzve të mirë, pa faj, nuk ka vuajtje!- tha me ton pajtues ai dhe shtoi po aq butë, duke bërë të ngrihet: Kam tre vjet, që nuk shoh më filxhanë...Nuk del asnjë gjë, kur qeni ha të zotin e vet!

- Sillni kafetë!- urdhëroi mbreti pa ia vënë veshin tjetrit. Ishte harbut, një harbut i veshur gjithë sqimë. As mori mundimin ta pyeste profetin, nëse e pinte kafenë në atë orë të vonë, apo jo.

Ua servirën kafetë dhe mbreti nisi ta gjerbte gjithë zhurmë. Kishte një padurim të madh, i cili i dukej edhe në pirjen e kafesë. Pa kaluar minuta, ai e përmbysi filxhanin. Priti sa e mbaroi kafenë edhe Muhameti, pastaj u zgjat dhe e ktheu dhe filxhanin e tjetrit, duke e derdhur llumin në pjatën e vogël. Muhameti e ndoqi gojëhapur.

- Ç’thotë filxhani im?- e urdhëroi mbreti.

Profeti e pa gjatë atë filxhan, që sepse i rëndonte aq shumë në gishtrinjë, a thua që derdhur prej tunxhi. Ishte një filxhan i keq, plot sherre e pusira, që edhe profetin e futi në bela.

“ Nga t’ia filloj? ”, vrau mendjen Muhameti. “ Po i bie drejt! ”, vendosi në çast. Nuk i rrihej më në atë zyrë të stërmadhe, ku të dukej se të shihnin nga të gjitha skutat.

- Je mbret!- ia nisi Muhameti.- Por pa kurorë! Ti e ve në kokë, të tjerët ta heqin. Qejf nuk të kanë! Brenda të quajnë bela, jashtë të shohin si gjemb në këmbë...Dëshirën për ta bërë mirë këtë vend e ke të madhe, por fundin e ke plot siklete...Ti, fle pak, sepse gjumi të tremb...Ke shumë frikë, se pse, nuk e di, dhe kjo frikë të bën të gabosh...Nga larg, nga ku pret lajme të mira, mos shpreso më! Lajmet, për ty, do të jenë gjithmonë të këqija! Mban një karrige përqafe, siç ke mbajtur fëmijët...Kaql- tha Muhameti.

Mbreti e pa gjatë profetin me ato sytë e kuq e të verdhëllemë bashkë. Pastaj nënqeshi lehtë, u zgjat në tryezë, mori filxhanin e Muhametit dhe nisi ta shohë.

- Ti, do bësh një rrugë të gjatë,- ia nisi butë profecisë mbreti,- që tani do ta bësh!...Do shkosh atje ku e ke vendin, në burg!- tha ai.- Qelbanik! Komunist!...

Muhametin e flakën në një qeli rrëzë malit të Dajtit. E lanë atje gjashtë muaj të izoluar, në të ftohtë e në të nxehtë, me gardian te dera. Gardianët e shëndoshë nganjëherë shpinin trupin, duke i këputur ndonjë shkëlqim futbollisti vitheve, por ai nuk ankohej. Vetëm një herë iu kthye një djali të ri dhe, duke fërkuar gollganin e lënduar, e pyeti tjetrin butë:

- Ty, sikur të njoh!

- Me komunistë të fëlliqur, si puna jote, unë s'kam patur punë kurrë!- ia priti tjetri, duke u bërë gati ta qëllonte sërisht.

- Prit!- ia bëri me dorë profeti.- Çfarë e ke pasur Laze Koçiu?

- Baba!- belbëzoi tjetri i hutuar.

Muhameti u përlot.

- Ti, qhesh Engjëll?

- Ku e di, ti?

- Kam qenë në burg me Lazen e shkretë. Kur linde, ti, emrin ta vura unë...Pastaj Lazja vdiq. E varrosëm matanë telave...Ka qenë burrë i madh!...

- Më fal,- belbëriti i sharruar gardiani.- Unë të dija komunist...Më fal!

- Edhe komunistët janë njerëz,- mërmëriti Muhameti.- Nënës bëji të fala nga unë, plakës së Lazes çoji një paketë cigare prej meje...Kur isha jashtë, i dërgoja cigare çdo fillim muaji...

- Po, unë, çfarë të bëj për ty?- mërmëriti gardiani, duke parë i trembur përreth.

- Çoji një letër nga unë gruas sime!

Muhameti i shkruajti Shpresës një letër të gjatë. Për herë të parë në jetën e tij, ai njeri ankohej për fatin e keq. I përshkruajti gruas vuajtjet e tmerrshme të vetmisë dhe në fund e këshilloi të mendonte për një fat më të mirë për veten e saj dhe Imirin. Fati i tij paskësh qenë shkruar të mbetej gjithmonë sterrë i zi. Ai ndjente qentë e tërbuar, që i lihnin përreth e që do ta bënin copa, po t'i lëshonte nga zinxhirët djalli i madh...”Që tani më dhembin vendet, ku do më kafshojnë qentë!...”, shkruante në atë letër ai.

Në qeli Muhametin nuk e pyeti asnjë hetues. Mbas letrës ra një heshtje e çuditshme. Tani te dera nuk qëndronte më asnjë gardian, por sy të vëmendshëm e kontrollonin pa pushim. Gjashtë muaj ai qëndroi fillikat para mureve të errët, duke parë filma të frikshëm me jetën e tij e me ç' do të ndodhte nesër. Shihte gjak e inat, qen, që kafshonin, ndjente ulurima e në hundë i hynte një aromë e rëndë pislleku, a thua kishte ngordhur ndonjë mace e zezë brenda qelisë së tij, dhe, kur i thanë se do ta lironin për mungesë provash, fytyra e tij mezi dallohej nën mjekrën e dendur të rritur nga gjithë ai siklet. Te dera e repartit-burg atë e priste Shpresa me Imirin dhe një njeri të panjohur, që shihte gjithë nervozizëm orën e dorës. Tjetri ishte i huaj. Muhameti kuptoi me habi se ata nuk po shkonin në shtëpi. Kur dolën në autostradën e Durrësit, Shpresa i tha duke parë nga dritarja se shtëpinë e kishte shitur dhe se tani po shkonin në aeroport. Profetit nuk kishte nevojë t'i flisje më gjatë.

- Për gjithmonë?- pyeti ai.

- Unë nuk kthehem më!- tha mbytur ajo.- Që sot ne jemi azilantë! Do kemi një shtëpi të mirë e nga një pension të përjetshëm...

Ai e pa gruan e tij të bukur e të hequr nga gjithë ai mundim se si fshiu një lot të madh që iu var në mollza. Ishte i sigurt se Shpresa tani po mendonte për varrin e Imamit, për të cilin nuk do gjendej më njeri t'ia shkulte barërat e egra e t'ia pastronte mermerin.

I huaji e çoi Muhametin e rreckosur e të palarë, këtë njeri të dalë nga ferri, që të trembte me pamjen e tij, deri te dera e avionit. Ai nguli këmbët në pistë dhe nuk u shkul që atje, deri sa avioni u ngrit në qiell për të mos u kthyer më. Njëri nga nënpunësit e aeroportit, një polic civil, i pëshpëriti gjithë pasion e krenari për racën e tij shqiptare, që krijonte çudira deri në çudi:

- Nuk ka profet më të madh se Muhameti!...Me siguri, do ta ketë kërkuar ndonjë President i madh në botë, për t'i treguar fatin!...

Të huajit iu kujtua një thënie e gjyshes së tij, se profet ka atje ku ka liri.

"Rruga e mbarë, o profet!", uroi nëpër dhëmbë ai, duke u kthyer në rruginën, që të çonte drejt daljes. Ndihej i mërzitur, që nuk kishte pasur kohë ta pinte një kafe me Muhametin. Ishte kurioz të dinte të ardhmen e tij, e cila, në këtë vend, tani po i dukej tepër e zyrtë.

**TETOR, 1996**

**DISA NJERËZ**

## DY SHQIPTARË NË DYSELDORF

Në Dyseldorf binte shi. Një shi i zyrtë, pa pjerrësi, i shtruar, që s' dihej kur kishte filluar e kur do të mbaronte, por që gjithsesi Elios i krijoi përshtypjen aspak optimiste se ky shi nuk do të mbaronte kurrë dhe ai e qau vizitën e shumëpritur në këtë vend, vizitën e ëndërruar prej kohësh në këtë vend. Tani ndjehej i penduar që erdhi në Dyseldorf. Binte një shi aq i poshtër, sa për të do të ishte njëqind herë më mirë të qëndronte në Tiranë. Do të ndodhej tani në ndonjë lulishte gjithë diell duke kundruar vajzat e bukura në rrugë e duke pirë ndonjë nga ato birra gjysmë të skaduara, por të ftohta ama. Po t'ia kishte qejfi, mund të shtrohej edhe në mejhanet gjithë tym, ku bëhej humori më i zi i botës e ku njerëzit përshëndeteshin gjithë hare "gjallë qënke akoma, o gomar?". Kurse ai zgjodhi këtë shi të poshtër, kur kishte gjithë atë Tiranë homerike, me seks e kolerë, me pisllek e me ballo moderne, me qofte zgare prej ndonjë viçi te ngordhur e me karkaleca që t'i servirnin ende të gjalla në pjatë. Ç'do të bënte në këtë qytet ku nuk të zinte barku kurrë e ku, po të të ngrihej mendja të vdisje, s'vdisje dot.

Shi plehrë, mërmëriti ai edhe kur hyri duke u dridhur në hotelin komod, po që ishte gjithë aq i flohtë e mos më tepër, nga boshësia në holl. Elio priti sa u shfaq emri i tij në kompiuter, gjithë duke mallkuar veten që la atë parajsë pislleku për Dyseldorf-in, pastaj mori programet e konferencës dhe u ngjiti në dhomë. Diskutimi i tij ishte programuar për fat të nesërmen në mëngjes dhe ai e ndau mendjen t'ia mbathte nga konferenca fill pasi të fliste. Ia vuri fajin shiut. Ishte vërtet një shi idiot nervashkatërrues me të rënë në kontakt me të e që binte pa pushim, me të njëjtin ritëm, si të bënte pjesë vërtet në racën gjermane. Elio ndjeu flohtë edhe në dhomë, në atë hapësirë komode me katër yje, me dritaret që shihnin

nga shtëpia ku kishte lindur Hajneja dhe rrugën e vjetër me kalldrëm, ku poeti i madh ishte çapitur për herë të parë e kishte filluar të shkruante vjersha, ngaqë s'dilte dot jashtë prej këtij shiu, që, rrezik, s'kishte pushuar nga ajo kohë e hershme. Ishte vetëm dhe ndjehej vetëm, vetëm fare, sic që ndjerë gjithmonë, dhe ndoshta kjo ia fuste ftohtësirën edhe më tepër në trup. I ulur në shtrat, ai filloi të gërmojë nëpër xhepa, deri sa gjeti atë që kërkonte, një numur të stërgjatë telefoni, për të cilin mori mundimin e erdhi deri në Dyseldorf e nga i cili, tek e fundit, nuk priste ndonjë gjë të madhe. Iu kujtua përsëri ajo vjeshtë e largët e kujtuar e stërkujtuar qindra herë, kur tre vjet më parë ai qëndronte në një kafe verore me Ildën dhe i lutej asaj që ta kalonin natën e fundit bashkë në plazhin e Durrësit. E shihte si ta kishte përballë atë vajzë cinike e të bukur njëherësh, pastaj ia dëgjonte kthjelltas atë "JO"-në e poshtë të përhershme e të pandërprshme e të paepshme, si ky shi gjerman, që nuk jepte asnjë shenjë mirëkuptimi e që vërtet nuk dha asnjë farë gjëje të shumëpritur...

Hajde, ti, në Gjermani, ia pati prerë shkurt Ilda, atje pastaj bëjmë ç'të duash ti. Ta kam dhënë fjalën...

Po ne jemi këtu, pse ma përmend Gjermaninë. Me morra do të vij unë në Gjermani...

Dashuria atje e ka bukurinë, kur sakrifikon, tallej ajo, e ç'janë katërqind dollarë për të fjetur me mua?! Apo nuk ia vlej...

Elios iu shfaq në mur fytyra e Ildës. Me ato sy të gjelbër nën flokët e dendur të zinj, me gojën e bukur, me buzët paksa të fryra e atë hundë nazike me një hark gati-gati të padukshëm, me ato duar delikate, që ia kishte lënë bujarisht t'ia puthte dhjetëra herë, ajo prapë shkaktonte dhimbje, të mprehta, si ajo që Elios i kaloi në gjoks e që i rikujtoi edhe një herë atë vargun e famshëm të çajupit drejtuar shqiptarëve "Mjaft punove për të tjerët, o fatkeq..." Ja, edhe ajo kishte ardhur të zbukuronte Gjermaninë, meqë Shqipëria boll e bukur ishte e tani duhej të tregohej bujare edhe me botën. Mut, shau Elios nëpër dhëmbë, duke i rihypur xhindet me vendin e tij të vogël gjithë diell e me kolerë sheshit, ku gjysma e miletit tani do ishin rrumbullosur. Ai pa orën e dorës. Ishte nëntë e mbrëmjes dhe tek dilte për të ngrënë diçka, mëmëriti nëpër dhëmbë se edhe kështu, veç me shi e pa të dehur sikur bota nuk ka lezet. Ne piceri atij iu kujtua prapë Ilda, këtë herë tek shihte ca gjermanë gerdalla e të shpelarë, që hanin si lubi picat e gllabëronin birra me gota të mëdha. Kurse ajo, ajo do ta shndërronte pa asnjë lloj shnderimi këtë lokal të rëndomtë në një restorant luksi me hirin e saj.

Nuk bëj dot dashuri në këtë batak, këmbëngulte atëherë Ilda. Ti duhet ta kuptosh se prandaj unë dua të largohem që këtu, për fare të zhdokem! Ku të bësh dashuri? Sipër morrave? Me kë të bësh dashuri? Me ty, që ke dy muaj pa u larë dhe pret ditëlindjen të lahesh?...Hajde në Gjermani, po deshe!...

Ti, mos u justifiko, përpiquej ta thyente Elio. Thuaj që nuk dua dhe pikë mbaroi...

Dua, këmbëngulte ajo, bile të dua edhe ty, po jo këtu, ku fundi është kaq pranë e ku ne rrimë presim me cigare në buzë fundin tonë, a thua s'duam t'ia prishim Zotit atë profecinë e tij për apokalipsin. Pse nuk vjen me mua? Nuk ta mban? Apo më do vetëm për një natë seksi? Për një natë gjen plot, o Elio, i gjen edhe pa shpenzime, edhe më të bukura se unë, se, ti, je i preferuar, që kur bëje ato golat fantastikë në stadium...Le që do të ketë edhe luftë...

Sa e poshtë ishte, kur s'lëshonte pe! Një mijë argumente nxirrte, nga më kriminalet. Dhe, ja, kështu, jo më do, jo s'më do, jo ka luftë, jo s'ka luftë kishte kaluar e qe bërë hi edhe ajo natë e fundit shpresash e ëndrrash, si të bënte realitet thënien e Ildës se nga ky vend mos prit lumturi e qetësi shpirtërore...

Pastaj një letër nga bota tjetër, një fotografi e Ildës, ku ajo qeshte, si për t'i transmetuar zotërisë së tij se tani ishte vënë në posedimin e një landi të tërë, bashkë me lumturinë e pashoqe, që ia dha fati në dorë, një numur telefoni dhe poshtë tij një copëz letër me atë shkrimin shkatarraq prej njeriu të shkujdesur të Ildës, ku ai mbante mend mirë se ishin shkruar fjalët: "Të dua dhe po të pres! Fito lekë, që të ndjehesh i lumtur!" Si nuk e gris atëherë letrën nga nervat! Tani ai nuk dinte asgjë më shumë për njeriun që ia hëngri zemrën me gjithë melçinë, nuk dinte as më elementaren, ishte gjallë, apo pati vdekur, ndodhej në Gjermani, apo e kishte thyer gjëkund atë qafën elegante, kishte më atë numër telefoni, apo e pati ndërruar...Ajo idiotja e di se është e lehtë të kërkosh në 70 milionë njerëz, mallkoi, dhe për herë të parë i hypi inati me bashkimin e Gjermanisë. Të paktën do ta kërkonte në një territor e numër njerëzish më të kufizuar.

Elio pagoi dhe u çua. Eci ngadalë nën shi dhe sesi iu duk befaz vetja, si njeri i ngritur nga varri, që plotësonte një amanet, ja, një Kostandin balade, që bridhte nëpër shi në kërkim të Ildës së tij, jo se e deshte tani, por vetëm për të mbajtur atë pakt të hershëm të premtuar dikur. Unë jam idiot, i dha përfundimisht epitetin vetvetes. Vij nga fundi i botes për të fjetur një natë me një femër. Sikur ka pak Tirana...Por sërisht nuk gjeti ngushëllim. Kishte diçka tërheqëse kjo lidhje, ndoshta thjesht fjalëmbajtja, ky koncept arkaik i konservuar mrekullisht në vendin, ku s'kishte asnjë punishte konservash e ku po të provoje të haje ndonjë konservë vendi mund t'i tundje këmbët hap e mbyll sytë. Po i bëj një telefon nesër, mbasi të mbaroj diskutimin në konferencë, vendosi ai me përtesë, dhe fjeti. Kishte bërë një gjumë të ngatërruar, me femra e politikanë, me qen e mace nëpër këmbë e me një gjarpër, që i rrotullohej rreth qafës. Kur u zgjua, binte sërisht po ai shi dhe gjithashtu zhurmëronte i njëjti shi edhe kur ai formoi numurin e Ildës nga hollitë e konferencës. Ndjehej i lodhur me receptorin e lehtë në dorë dhe po i dëgjonte gati me dremitje sinjalet që vinin nga përtej. Veç ngriu e ndjeu një therrje të mprehtë në gjoks, kur



dëgjoji nga përtej zërin e saj, atë zë që nuk do ta ngatërronte kurrë e që vinte paksa thuthuq. Iu zu fryma, ndjeu një rrahje të fortë zemre dhe as vetë nuk e kuptoi se si arriti e shqiptoi “Jam Elio...”

Ra heshtja, një çast të vetëm ndoshta, por tmerruese, aq sa atij t’i shkonte nëpër mend gjerë e gjatë mendimi se ajo mund ta mbyllte telefonin, duke bërë sikur nuk e kishte kuptuar gjuhën, por erdhi shpëtimi, kur dëgjoji zërin e saj të mbytur menjëherë nga ndonjë ndjenjë e çuditshme ta pyeste:

-Nga po më merr?

-Nga Dyseldorfi...

Ra përsëri heshtja, një hop, aq sa për të vendosur gjithçka, por koha s’duhej të kishte qenë plotesisht e mjaftueshme, derisa ajo pyeti ashtu kot:

-Domethënë, erdhe?

-Unë e di që jam në Dyseldorf,- ia ktheu ai.- ti e di në bie në Gjermani apo jo ky qytet...

-Mos më çaj kokën shumë,- uluriu nga përtej ajo.- Ma jep adresën, po të saktë, jo rrapa-zhrrapa, si në Tiranë!...

Elio përfshiu një program të konferencës dhe lexoi duke rrokjezuar fjalët adresën e hotelit. Dridhej i tëri dhe dëshironte t’ia përsëriste edhe një herë adresën tjetrës, po ajo nuk e la.

-Mbas orës tetë të mbrëmjes mos më lëviz nga hoteli!

-Kur mendon të vish?- guxoi e pyeti Elio, gjithë me atë rrahje të çmendur zemre në gjoks e me një përpjekje kolosale për ta mbajtur zërin zap.

-Në këtë çast unë nuk di asgjë, por ti qëndro siç të porosita në hotel...

-Po shkoj të hyj në vaskë,- u përpoq të bënte humor Elio dhe mori pikërisht atë përgjigje që priste:

-Nuk do të bësh keq, se me një dush nuk ka perendi të ta nxjerrë zhulin...

Elio dëgjoji si kërciti receptorin matanë. Ishte prerë harbutërisht gjithçka, pa përshëndetje. sië nisi, me atë brutalitetin për të hyrë direkt e në temë e as pa pyetjen më të thjeshtë e më formale të kësaj bote “si je?”. Mut jam, u përgjigj ai për të dy, duke braktisur konferencën. Binte shi, shi gri, që nuk ishte më aq i zi, por që gjithsesi quhej SHI dhe Elio, pasi ia porosi në recepsion që priste në dhomë një vajzë shqiptare, me të cilën do të përktente disa materiale të konferencës, u xhvesh e hyri në vaskë. Ishte akoma i fortë fizikisht, nga koha kur merrej me futboll, dhe në atë dremetje të ngadaltë ai rikujtoi sa i pafat kishte qenë, si gjithë të tjerët në atë vend. Ishte shpresa e mesfushës në Shqipëri dhe e përzunë nga futbollit si qen, për punë cmire e biografije, që ia sajuan si deshën atje ku ai nuk hynte e nuk dëgjonte dot, vetëm që mos ta merrnin në Holandë. I pati flakur këpucët duke qarë atëherë e s’patí lutje a premtim në botë t’ia kthente mendjen të hynte prapë

në fushë. Luani me ata që morët në Holandë, kishte thënë e qe zhdukur nga stadiumi. Pastaj, pesë vjet për t'i botuar një vjershë të vetme, në një kohë që botonin tre mijë autorë në vit e kur i gjithë populli shqiptar mund të quhej popull shkrimtar...Poshtërsisht i shkoj gjithçka e askush nuk e vrau mendjen për lotët e tij, për ato lotë që iu shterën kur i vdiq nëna. ajo grua e urtë dhe e bindur, që s'dinte ç'të bënte për t'u ndjerë i lumtur djali i saj. Atë e kaptoi një gjumë i trishtuar në vaskë, pikërisht atë kohë kur Ilda, qindra kilometra larg, shihte e përhumur rrugën nën shi, duke kujtuar Elion e hidhur të Tiranës, por gjithsesi human, me atë shprehje mirësjije në fytyrë e me ato kunjat e tij, që të bënin të qeshje me lot edhe kur ndodheshe përballë fatkeqësisë. Ishte fisnik ai dreq dhe ajo pati menduar atëherë, kur lëshoi fjalinë idiote. se Elio nuk do të bëhej më kurrë i gjallë, kurse ai shqiptar i mallkuar, shqiptar i pandreqshëm, i pamodifikueshëm në shekuj, ishte ngritur si në Baladë nga varri dhe i qe shfaqur me ca trokitje telefoni nëntë qind male larg, nën një kasaphanë shirash dhe ajo, po aq e pamodifikueshme sa ai, duhej të braktiste gjithçka, për t'iu përgjigjur si një Doruntinë e qelbur prej lluce e balte bashkë Kostandinit idiot. Nisu Doruntinë kurva, i dha zemer vetes, tek pa taksinë, që po e priste në rrugë. I hodhi syrin e fundit asaj krijese arkaike në pasqyrë dhe u trondit. Kishte dashur gjithmonë të ishte e bukur, por kaq e bukur nuk qe ndjerë kurrë. Ishte aq e bukur, sa nuk qe më Ildë dhe, tek mbyllte derën e rëndë, mendoi se ky mund të quhej nur vdekjeje. Tamam Doruntinë. Deri në stacionin e trenit ajo mendoj e stërmendoj baladën e lashtë. Asgjë nuk kishte ndryshuar, gjithçka shkonte sipas logjikës së lashtë, përjashtoj mjetet e udhëtimit, takimin dhe komunikimin. Kostandinit i pati ngordhur kali rrugës, ose në hotelin e Dyseldorfit nuk kishte tagji. mundej që edhe kali të qe i pafuqishëm për të vazhduar rrugën...Pastaj telefoni...Doruntinë, eja se kam ngelur në rrugë të madhe...E çuditshme, po ajo gjithmonë pati dyshuar te vërtetësia e baladës. Kishin dashur ta fshihnin të vërtetën ata horra, që ia patën dhënë dorën e fundit ngjarjes tragjike, e cila, me siguri, ishte tjetër gjë fare. Vërtet personazhet mund të kishin vdekur të dy dhe ndonjë mbajtje fjale mund të rrotullohej në atë mes, veç vëlla e motër ata nuk ishin dhe për këtë Ilda e kishte mendjen top. Asaj ia thoshte ajo kapllloqja e saj, se ata të dy duhet të qenë dashur shumë, por, meqë Doruntina ishte vajzë pak e lirë, Kostandini nuk u martua me të për të mos dëgjuar fjalë lart e poshtë, pastaj, kur Doruntina iku ca male larg e martuar me një burrë të vjetër, por që kishte ca para, i dërgoi fjalë atij se e priste. Dhe ai gomari shkoj. Atje duhet t'i kenë kapur në flagrancë në ndonjë stallë kuajsh dhe i kanë vrarë të dy. Pastaj vrasësit, për ta mbuluar të vërtetën, i bënë motër e vëlla dhe ngritën baladën. Edhe besën e futën në baladë që t'i mbanin shqiptarët skllëvër, siç ndejtën! 500 vjet nën turkun, meqë i dhanë fjalën, u ndanë në tre fe, meqë dhanë fjalën, mbetën në tre fe, meqë dhanë fjalën, 50 vjet nën komunizmin, meqë dhanë fjalën...Ehu, e ku i hante ajo këto dokrra! S'deshte asnjeri

të luftonte, se nuk ua mbante, dhe pastaj justifikoheshin: Ç't'i bëjmë? Kishim dhënë fjalën!...Dhe, meqë kishin dhënë fjalën, e bënë edhe vendin, edhe veten, kolerë!...

I hypën xhindet dhe portreti iu zbut vetëm kur filloi të vrasë mendjen se ku mund të ndodhej tani Elio. Në vaskë, e ndau mendjen ajo, dhe nuk gaboi shumë në distancë. Ai ndodhej vërtet dy metra pranë vaskës, në ËC, i zverdhur nga një diare e papritur. Edhe atij i qe kujtuar në atë dremitje pa fund e krye balada ngjethëse me atë fund që bëhej edhe më i tmerrshëm, kur të shkonte si padashje mendja se tani ishte ti Kostandini më i ri. Elio u përpoq t'i qëndronte larg fundit të baladës. Sikur nuk i pëlqente të shkonte në varr me këmbët e veta, ama një ankth të tmerrshëm e ndjente dhe, kur tingëlloi telefoni, kërcëu përpjetë i tmerruar. Ishte recepsioni. Poshtë e kërkonte një vajzë, Dorina, jo, Dorilda, jo...Doruntina! Elio ngriu. Po, belbëzoi, atë po prisja...Ishte ora dhjetë e natës. Gati-gati si në baladë. Edhe atje binte shi, derisa Kostandini ishte i përbaltur. Kalldrëm, po, kishte sa të duash. Dhe, si për t'ia vënë vulën gjithçkaje, u desh edhe ai pajton i mallkuar i tërhequr nga një alamet kali, që kaloi gjithë rrapëllimë nën dritaret e tij...I trembur, si gjysmë në kllapi, pa i besuar më vetvetes, ai hapi derën. Rrugina e katit ishte e zbehtë nën një dritë të verdhëlleme hënore. E shurdhët, si një shteg pa njerëz. Dëgjohej vetëm troku i ashensorit, si në baladë, pastaj kërciti një derë dhe, ja, tek u shfaq e bukur Il...

-Kostandin,- ngashëreu ajo,- shpirti im!

Vrapuan në rruginë të dy dhe dy çaste më pas ai ndjeu gjuhën e saj të ngrohtë në gojën e tij. E ngriti në krahë atë krijesë që kishte ëndërruar aq shumë dhe as vetë s'e mori vesh si arriti e belbëzoi i ndezur nga ai kurm i ngrohtë:

-Doruntina, unë erdha!

-Atë e kam të qartë,-gulçoi ajo gjithë duke e puthur ku të mundte njeriun që e kishte pëlqyer gjithmonë dhe që as vetë nuk e kuptonte pse e pati torturuar aq keq në atë vend që quhej Shqipëri e ku ajo i çoi dëm nja njëzet vjet të mira.

Në shtrat ai mendoi edhe një herë turbull përmes gjithë atij eksitimi për baladën, në kohën kur po orvatej t'i hiqte gjimbajtëset e vogla të saj, por këtë here po pyeste veten në kishte gjimbajtëse në kohën e Doruntinës apo jo, sofistikim që duhej të qe shpikur më vonë, po të niseshe nga pikturat e asaj kohe, ku s'gjeje asnjë gjoks të karrocuar e që nga të gjithë mund të pranohet se ishin gjinj me taban, pak të rënë vërtet, por, sidoqoftë jo gjinj mashtrues, si këta të sotmit, që nga pjepra në të parë shndërrohen në domate të kalbura Kavaje në të prekur...Gjinjtë e saj ishin të plotë e të butë, aq sa duheshin, dhe ai harroi gjithçka mbi ato duna mahnitëse që përhapnin një aromë qumështi pa hile katundarësh të ndershëm. Trupat e tyre të lakuriqtë u mbuluan nga klithmat, si në baladën e lashtë, ku, mesiguri, ka pasur një tufë me "OH" e me "MOS", të fshira pastaj nga duart e

redaktorëve kriminelë, që nuk donin të nxinin realitetin, dhe gjithçka organizohej nga një etje e pakuptimtë dy palëshe, a thua trupat e tyre rrezikonin të zhbëheshin nga çasti në çast dhe ata ndodheshin kësisoj në cejtnot. Ai ndjente buzët e saj ta puthnin në çdo pjesë të trupit, ngjethej e rirforcohej me magji nën ato buzë, dëgjonte qartas rënkimin "oh, Kostandini im", ndjente fare kthjelltas pas çdo kafshimi që i bënte gjinjve të saj e pas çdo shtrëngimi kockathyers lutjen "Mos, Kostandin" dhe e humbi vërtetë sensin e kohës. Zhvillohej në fund të shekullit njëzet një betejë e vërtetë mesjetare mes fisnikësh të lartë, mes njerëzish që dinë ta japin e ta mbajnë fjalën, mes kufomash që ngrihen nga plehërat e që shkojnë në plehëra përsëri, që iu pëlqen të dalin me maska mjerimshëse përpara botës, si kllounë, e që pastaj qajnë në vetmi...

Nata ishte plot me ëndrra të çuditshme për të dy. Të dy shihnin në variante të ndryshme baladën e Kostandinit me Doruntinën. Kostandini i tij u hoq sikur u vra në një betejë, që të vidhej e të shkonte të takonte Doruntinën, të cilën e kishte rrëmbyer një bandë që organizonte prostitucion në krahinë dy male përtej. Ai preu nja dy koka e këmbë, që s'merrej vesh të kujt qenë dhe u vra nga vetë Doruntina, e inatosur që ai ia ndërpreu aktin seksual në atë sekondë që po i vinte orgazma, si kriminel i vërtetë, dhe nga mënyra e të sjellurit aq brutalisht me klientët penishekurt të saj...Kurse Doruntina e saj ishte një prostitutë e ndershme, e cila, e detyruar për të mbajtur me bukë veten dhe nënën e saj, merrej me lesbizëm, edhe për këtë shtyrë nga halli dhe jo urrejtja për meshkujt, meqë në krahinë, për shkak të luftës, kishte fare pak burra të rinj, gjë që bëhej shkak të gjendeshe e copëtuar në ndonjë kanal, po t'ia rrëmbeje ndonjëerës burrin nga shtrati...Fundin e kishin pak a shumë njëlloj të dy, me vdekje, por ndërsa tek ai vdisnin veç e veç, tek Ilda vdiqën të bashkuar në shtrat, tek bënëin atë punë, pikërisht në çastin kur i premtoan njëri-tjetrit se nuk do të ndaheshin kurrë.

U zgjuan në mesditë, të lodhur e të përqaftuar me njëri-tjetrin, ashtu siç i pati zënë gjumi afër agimit. U puthën lehtas dhe Ildës i rrodhën lotë.

-Mos qaj!-iu lut ai.

Ajo ndolli hundët dhe hyri në dush. Nuk i hiqej nga mendja vdekja e Doruntinës me atë nur dallditës, që fërgëllonte e tëra dhe e ndjente deri në shpirt penisin e fortë të Kostandinit, duke rënkuar e lumtur në atë shtrat të shtruar me dërrasa të gjera. Ishte një klas i lartë dhe nuk e meritonte atë fat tragjik...Ajo degjoi zërin e tij, që po i kërkonte të shkonin në një restorant të mirë, ku gatuheshin midhje, dhe ajo, duke u krehur, iu përgjigj qetësisht:

-Di unë një të mirë, Elio...

Atë e drodhi dhe e ftohu rikthimi te emri i parë. Po mbaronte balada, ajo baladë aq e bukur, e mbushur me qetësi e dritë, me dashuri dhe jetë, me ringjallje e sfida ndaj vdekjes, me udhëtime të marra me hënën në sup e me mendimin më

hyjnor se dikush të do e të pret...Unë nuk jam Elio, deshi të ulurinte ai tek po vishte xhupin e trashë, por s'nxori dot asnjë klithmë dhe ideja se mos tani ishte i vdekur vërtet, si ai Kostandin fatkeq, e bëri të dridhet. E përse të mos jem Kostandin, dreqi ta hajë, tha. Ç'ndryshim qëndron në mes? Unë i vdekur se i vdekur jam edhe si Elio...Megjithëse, më mirë të mbetej Elio. Të paktën do të jetonte edhe nja gjysmë shekulli, jetë qeni vërtet, ama jetë ishte. Shisje ndonjë veshkë, po të ishte keq, dhe e shtyje mirë ca vjet. Do të ishte vërtet një gjysmë shekulli monoton, i mbushur me shkëlqje dhëmbësh e dhembje ulçere, me masturbime shpirtërore e fizike mekanike, ama, nuk do të ishte keq fare...Por edhe Kostandin nuk mund të quhej humbje fatale, kur kujtoje se një natë si ajo e porsakaluara, me një prehje e seks hyjnor, ia vlente të ndërrohej me gjysmë shekulli jetë zhulse... E ku kishte kaluar ai gjithë jetën e tij një natë të tillë, një natë që të bënte si me magji qenie njerëzore, tipik dykëmbësh, e që të pëshpëriste ëmbëlsisht në vesh: "Ishe kafshë, zemra ime, tani u bëre njeri! Mos e humb këtë shans!..." Kishte qenë vërtet diçka madhështore të qenit njeri, aq sa Elios i erdhi keq që ky transformim u bë me kaq vonesë, dhe ai akoma dyzonte në rruginat e qytetit të vjetër nëse mund të ndërrohej një jetë njerëzore 24-orëshe me një jetë të tërë shtazore...

Ilda e futi në një restorant belg. Ishte një lokal i qetë, i veshur me dru e i shtruar me tapet të kuq, mbi të cilin binte një dritë e zbehtë nga dritaret e mëdha të zbukuruar me ca perde të punuara me dorë. Porositën midhje të shoqëruara me verë të bardhë, që i vishte sa kaq gotat me avull e të bënte të harroje të gjitha hallet e kësaj bote. Elio kthente gotat ngadalë nën shushurimën e vazhdueshme të shiut, kundronte kishën e madhe përbri të lagur e të hirtë, shihte atë Ildë tmerrësisht të bukur e të hequr paksa nga nata e gjatë pa gjumë dhe nuk i shpëtonte dot pyetjes torturuese: Më mirë Elio, apo Kostandin?

-Eshtë e njëjta gjë! Në të dyja rastet do të përfundosh në varrezat publike! Ju andej s'keni akoma varreza private, apo jo?...As idenë e varrezave nuk e keni!...

Kishte një cinizëm të poshtër dhe kjo femër, një cinizëm shqiptar që gjithë Gjermania bashkë s'kishte mundur t'ia hiqte dot. Habiteshe nga mund t'i buronte kjo ashpërsi një qenie të tillë kaq delikate, me një hir më shumë ideal se real, që e detyroi edhe pronarin e lokalit të afronte diçka nga ana e tij.

Ilda porositi verë, verë të mirë fare, tha, meqë afron pronari.

-Kjo, që thua, ti, dihet mirë,- u nxeh Elio, duke i ulur nervat me midhje e verën e mbetur në kanë,- problemi është te formalizmi, deri në ç'pikë duhet respektuar ai? Ja, për këtë të kërkova mendim, jo për të dëgjuar ato filozofimet e tua autodidakte, të përfutuara nëpër ofiçinat e Lej Fenërve...

-Ti kërkon të bëhesh më tragjik se Shekspiri me një lëndë tepër komike. Atje të gjithë jetojnë formalisht dhe po e more jetën një çast seriozish, mbarove, ike nga faqja e dheut!...

E artikuloi fare qetësisht këtë fjali kriminale, duke kujtuar atë kohë, kur edhe ajo vetë jetonte me iluzione e u përpoq që t'i rregullonte marrëdhëniet e saj me Fred piktorin me logjikë e arsye. E deshte ai Fredi i shkretë dhe ajo ia bëri mendjen çorap, pasi ai e shvirgjëroi në studion, ku të bëheshin prapanicat ngjyrangjyra nga bojërat, si ato surretërit e mohikanëve të Feminor Kuperit. Ilda nuk ia hodhi atij, vetëm se, kur arriti në përfundimin që të dy e donin njëri-tjetrin, kërkoi të martoheshin bashkë. Po Fredi ia thyen penelat në kokë e ia futën atje ku s'thuhet, kur pohoi se ishte dakort të martohet me Ildën. Dhe kush e bëri këtë? As mamaja e as babai. S' ishte nevoja e ndërhyrjes së tyre otomane. Fredin e masakruan artistët, ata artistë të qelbur gjoja të emancipuar, që e mbajnë në pranga gjithë ndryshk edhe vetë ndjenjën e tyre...Pa m'u qërro me gjithë ata plehra, iu hakërrua me mendje Elios, ndërkohë që ai ia kishte ngulur sytë me çudi.

Ilda s'po duronte dot pa ia përplasur në fytyrë nja dy fjalë.

-Jetova 20 vjet në atë vend dhe, të lutem, mos ma hap barkun! Veç me këmbë më shkelën dhe askujt s'i bëra keq, mos them se ca kafshë i lumturova. Më tha njeri "Faleminderit"? Po, më quajtën "kurvë"!...

Ai kundronte harkun e bukur të fytyrës së saj të egërsuar, të përkulur paksa mbi kovën e midhjeve e që dukej si një shën Mari e stampuar në fasadën e kishës gjigande, kujtoi se nën rrobat e saj fshihej një trup i derdhur pa pikë dhjami të tepërt, që sikur t'iu binte në dorë kanibalëve, do t'iu hapte një telash të pafund, derisa të gjenin vaj për ta lyer para pjekjes; sikur i ndjeu në pëllëmbë gjinjtë e plotë me thitha të vogla në majë dhe as vetë nuk e mori vesh se si ia tërhoqi brutalisht e me vrull kokën e kapur për flokësh, si ia gjeti buzët, si e puthi gjatë me afsh e si belbëzoi "të dua, egërsira ime", kur të tjera fjalë i qenë rreshtuar si ushtarë ballkanas të tërbuar nga inatet e vjetra në kokë.

Më vrave, murmuriti ajo dhe s'foli më. Futi me anë të një guaske bosh edhe nja dy midhje të tjera në gojë, pastaj guxoi e ngriti sytë e gjelbër. I qenë zbutur sytë dhe ai parashikoi turbull se pas 30 sekondash ajo do të përlotej. Në të vërtetë ajo nuk u perlot. Qau, dhe qau më shpejt nga ç'mendonte ai.

-Mos më hap zorrët!- iu kthye pastaj refrenit të vjetër, duke ndjellë hundët.- Ne jemi popull që ia kemi bërë vetes fatin e keq...Ndryshoni diçka në atë vend të qelbur,- shtoi me pikëllim,- të kthehemi edhe ne atje. Pse u qenka shkruar të jemi të shpërndarë si zogjtë e kllloçkës në të gjithë botën? Asnjë nuk na do neve këtej, kemi frikë të themi se jemi shqiptarë...

-Nuk je mirë këtu?- pyeti për herë të parë Elio. Por u pendua në çast për pyetjen. Më mirë ta kishte mbyllur gojen, dreqi ta hante!

-Jam krejt shkëlqyeshëm,- u ngërdhesh e u përgjig me rrëmbim ajo, a thua se kishte frikë mos ia hiqnin atë çast të drejtën e fjalës.- Relaksoj popullin punëtor gjerman, i cili ka nevojë të rigjenerohet për të përballuar me sukses

revolucionar punët e mëdha që e presin nesër...

Elios i iku fytyra.

Lëshoi nje "Si" me pamje idioti, pastaj e përsëriti prapë pyetjen më të shkurtër që mund të gjendej. Ajo nuk qante më. Tani ishte po ajo Ilda e vendosur dhe kryeneçe, ai njeri që nuk përkulej kollaj e qe të bënte ta harxhoje kohën kot për ta bindur se nuk e kishte fare mirë.

-Po!- ia ktheu ajo thatë, fare thatë e fare shkurt, me një ton që nuk pranonte as dyshime e as diskutime.

-Jo!- tha Elio. Ndjehej menjëherë i fraskapitur.

Mori prapë me vete një "Po" të prerë. Pastaj, në atë heshtje që u shtri në tryezë, u dëgjua sërisht zëri i saj, i zbutur tashme e gjithaq i lodhur, sa fytyra e Elios.

-Edhe mua më duhet të jetoj, por kam pasur fat. Dy vjet më parë më gjeti një i pasur, më dha një apartament, më mban me gjithë të mirat, nuk më fyen dhe unë e çlodh...

Tani kish filluar t'i ndillte hundët prapë e një zot e merrte vesh se nga ç'vrinë e trupit po i nxirrte lotët fshehtas.

...Nuk është i keq, dreqi...Tani kam edhe një llogari në bankë...

Elio porositi, kërkoi prapë verë nga kamarieri me kostum të zi e përparësë të bardhë, ajo kërkoi midhje të tjera.

...Pa atë do te kisha marrë fund,- po lllomotiste ajo, ama ishte fare e qartë se në tryeze po bridhte një trishtim qelbac, që s'përzihej kollaj. E dinte ai që ajo mut balade mbaronte me vdekje! Po nuk ia kishte prerë mendja se Doruntinën mund ta kishin hequr qafe, pikërisht kur ndodhej e ndryrë në një dhomë të errët, duke numëruar leket e lëna mbi shtrat nga klienti i fundit...Mbase, i vetëtiu në mendje, po të qe ajo Doruntina, sipas të gjitha gjasave atij i takonte të quhej Kostandin dhe e hoqi mendjen me vrap nga Ilda. Ç'më duhet mua se ç'bën kjo me atë hamshorin e saj, e ndau mendjen, dhe në të vërtetë atij as i hynte gjë në xhep e as ia përfillte mendimin njeri...Kishin ndjerë një dobësi dikur për njëri-tjetrin, patën lidhur një besë, e mbajtën fjalën të dy dhe, domosdo, historinë do ta mbyllte fjala më e bukur e gjuhës shqipe: Udhë e mbarë!...Por as vetë s'e mori vesh se pse arriti e i tha tjetrës me zë të shkoqur:

-Sinqerisht, me vjen keq për ty!

Vajti si idiot puro e futi në atë mes edhe fjalën "sinqerisht" në krye!

-Ty të vjen keq për mua?!- u xhindos ajo.- E ç'punë ke, ti, me mua? Ah, po, të vjen keq si patriot! Po përdhos figurën e Atdheut tonë të lashtë me histori të lavdishme...Po edhe gjermanet janë kurva,- e shkoqi zërin ajo,- e njohin mirë mjeshtërinë e prostitucionit...Ti, mund t'i provosh vetë, po nuk më besove mua. Veçanërisht në seks oral i ke unikale, t'i bëjnë xixë ato hallatet e tua të palara,

fringo të reja t'i bëjnë...

Elio bëri një "mjaft" me dorë.

-Mos ma merr për ters,- kërkoi paqe i lodhur,-as kisha ndërmend të të fyeja, e para, se nuk kam të drejtë ta bëj këtë, e dyta, sepse ti nuk ke asnjë detyrim ndaj askujt, që t'ia marrësh parasysht mendimin. Po mua nuk më pëlqen profesioni i zgjedhur nga ty,- u nxeh befas,- nuk më pëlqen, dreqi ta hajë, se të dua! Të dua!...Kaq të thashë e nuk të detyrova ta marrësh mendimin tim si urdhër për zbatim të menjëhershëm...As kaq nuk më lejon?

-Jo! Nuk të lejoj!- ia preu Ilda.- Ti nuk ke të drejtë të më japësh mend mua, sepse ju andej jeni kolektivisht prostituta! Ç'punë bëni ju atje? I nxini jetën atyre që e kuptojnë jetën jashtë kornizave tuaja të qelbura e të krimbura, i katandiset gjysmën e të dashuruarve në Romeo e Xhuljeta, bëni shurrën ku t'iu kapë, visheni sipas modës së fundit dhe s'keni as ujë për të pirë, pa le për t'u larë, krenoheni me historinë dhe hani sot ca ushqime të skaduara...Midhjet qenkan të mira,- shtoi pastaj. Nuk i pëlqente më kjo bisedë. Që kur arriti dhe ia tha atë fjalinë më të vështirë tjetrit, i humbi interesi për këtë temë. Filloi ta kthejë verën mirë dhe Elio e mori vesh se Ilda tani kërkonte të humbiste mendjen.

-Po, ti, ke shkruajtur gjë?- pyeti Elion.

Ai sapo kishte botuar një roman, ia kishte sjellë dhe përkushtimin do t'ia vinte në dhomë, po kishte hall mos ia lexonte ai baba-gjermani dhe bëhej xheloz. Ilda qeshi. Ai dinte vetëm fjalën "mut". Piu prapë verë dhe kërkoi të dinte se për çfarë bënte fjalë romani. Ishte historia e gjatë e një familjeje në dhjetëvjeçar in e fundit, që ia shkatërrojnë lumturinë përkujdesjet kriminale të shoqërisë...Ai e la rrëfimin në mes, sa e pa që ajo e kapi gotën përsëri dhe ia hoqi nga dora.

-Dua të dehem!- tha ftohte Ilda.- Më është mërzitur jeta dhe dua ta humbas mendjen. Mendova se ti do të kishe ndryshuar ndopak, por edhe në këtë rast gabova. Idiote! Mashtrohëm shpejt. Kështu është kur ke ideale dhe beson te e mira...E ç'pune ka e mira me ne, shqiptarët? S'ka ndërmend të vrasë veten ajo e shkretë!...

Tani e kishte zënë. Iu lëngëzuan sytë përsëri. Uli kokën e ia puthi me afsh duart Elios, iu mori erë, i futi në gjoks, ia mbajti atje dhe e pyeti gati duke u qaravitur:

-Kur do të vish prapë?...E di...Edhe unë të dua...U mërzita pak, se njeriu edhe mërzitet kur kujton budallallëqe, por që kur më telefonove kam qenë e lumtur...Asnjëherë gjatë këtyre tre vjetëve nuk jam ndjerë kaq e lumtur,- dënosi,- unë të kam dashur gjithmonë, gjithmonë të kam kujtuar, po kështu erdhën punët...Andej s'jetoja dot më, po keq andej e plehrë këtë!...Do vish prapë, më thuaj, t'i paguaj unë këtë herë të gjitha, biletat, shpenzimet...Do kënaqemi...Do vish në verë?...

Po kërkohet serisht fjala. Tani ishte ajo që kërkonte një premtim dhe



balada zgjohej në Gjermani këtë herë. Ishte rrotulluar mbrapsht gjithçka dhe Elio nuk po i duronte dot më lutjet e saj shpirtkëputëse. Ndihej vërtet i rraskapitur.

-Pse nuk kthehesh?- iu lut Elio.-Ti ke njerëz atje, pastaj nuk është më vendi siç e ke lënë...

-Ç'do bëj unë atje?- pyeti përhumbshëm ajo dhe s'merrej vesh kujt iu drejtua, shiut apo atij, që ia kishte ngulur sytë buzëve të saj të tharra tashmë.- Tani duhen shtyrë ditët,- psherëtiu ajo,- ky paska qenë fati yne...

Kishte shumë pikëllim në fjalët e saj. Ishte e kotë të merrje mundimin për ta bindur. Ai vend e kishte vrarë keq këtë njeri dhe ajo nuk do t'ia harronte kurrë plagët e hapura. Tek e fundit, edhe ajo ishte pjellë e atij vendi, i binte logjikisht të quhej Doruntinë dhe të kishte fatin e saj.

Një orë më pas ata ndodheshin sërish të kërlëshur në dhomën pa jetë të hotelit, ku ngjiteshin deri lart trokitjet e patkonjve të kuajve dhe zhurma e pajtoneve plot turistë, që vizitonin qytetin e vjetër. Atë e pushtoi përsëri magjija e asaj femre të bardhë e të lëmuar, të punuar aq mjeshhtërisht nga mëma natyrë, si për t'i bërë sfidë piktorucërve të botës, dhe Elio humbi serisht ndjesinë ndaj gjithçkaje. Notonte në një hapësirë të ngrohtë ujërash, pa menduar asgjë, i lumtur e i qetë. Në mbrëmje Ilda duhej të nisej. Ata u riputhën në sallën e madhe të stacionit të trenit dhe Ilda sërish i thirri se do ta priste gjithmonë, ndërkohë që sirenat paralajmëruese të nisjes ngjanin me sirenat e alarmit në luftë. Ajo u zhduk po aq shpejt sa ishte shfaqur, gjë që do të thoshte se ai ishte përsëri i vetëm mes shiut të pafund. Fare vetëm, si kjo Ildë, për të cilën e mori malli në çast. Po unë, ku të zhdukem?- pyeti veten. 31 vjeç. Vetëm. I humbur, apo i vdekur? I humbur, se zemra i rrihte ende monotonisht. I vdekur, sepse Ilda s'ishte më...Po Ildës përse nuk i thashë se e dua tamam, pyeti befas veten tek kthehej nëpër shi, përse nuk ia shpreha rrokje për rrokje që ajo më bën të lumtur, se bashkë mund të gëzoheshim e mund t'i shtynim jo keq këto dite që na kanë mbetur...Po sikur ajo të bindej për t'u kthyer në Shqipëri?...Ai u drodh. Nuk i përgjigjej dot pozitivisht kësaj pyetjeje dhe kaq mjaftoi që t'ia shprehte hapur konsideratat vetvetes me një "dhjeraman i qelbur, i vdekur me gjithë lecka e lidhëse këpucësh, që do të jetosh e s'ta mban bytha, se ke frike nga fjalët e atyre njerëzve pa asnjë vlerë për ty..."

Fjalja i rrihte tamam në kokë e përsëritej qartas, sikur atje brenda të ishte fiksuar ndonjë magnetofon, dhe atij gjithmonë e më shumë po i mbushej mendja, se tmerrohej nga drita e jetës, se kishte frikë të jetonte, se jeta e lodhte dhe rraskapiste aq keq, sa në çast bëhej për të vdekur. Sepse nuk ishte mësuar të jetonte e as në fis duket s'kishte pasur ndonjë gjysh a stërgjysh, që të kishte ditur ta jetonte jetën e t'i linte diçka në rrugë gjenetike trashëgim atij.

Në mëngjes Elion e zgjoi telefoni. S'deshte ta ngrinte njëherë, duke menduar se do të ishin sekretaret e konferencës dhe ai e kishte kokën plumb nga

mendimet e zyrtarëve të tjerë të kësaj natë. Po zija hingëllinte papushim dhe ai e ngriti me përtesë receptorin. Vetëm kur dëgjoi zërin e gëzuar të Ildës, që po e përshëndeste "mirëmëngjes", si dikur nëna e tij, u kthjellua në çast.

-Mirëmëngjes,- tha ai,- dhe faleminderit, që më more!

-Më vjen keq...Ti, nuk duhej të dyshoje kurrë tek unë...Më fal, që të mërzi ta dje në drekë...E di, unë u kënaqa...Ti, si je? Të dhemb ndonjë gjë sot,- u përpoq t'i jepte zërit një ton gazmor.

Ai e kuptoi se ajo po gëlltiste lotët andej. Dhe ndjeu gjithashtu një lëmsh në grykën e tij, a thua kjo ishte një sëmundje e tmerrshme ngjitëse, që të kapte edhe përmes komunikimit me telefon.

-Më fal, ti. Unë dje nuk arrita të të kuptoj ty. Ti, nuk ke frikë, do të jetosh, nuk pajtohesh me humbjen, pavarësisht nga format e luftës që zgjedh, ama, ti, jeton...Kurse unë...unë jam dhits, kam frikë nga dëshirat e mija...Kam frikë të ta shpreh dashurinë dhe nuk të lutem dot të jetojmë bashkë...

-Jo! Ti, i je nënshtruar vendit tënd, ashtu siç do të bëja edhe unë, po të kisha qëndruar atje, dhe tani nuk del dot nga ajo vallë...Ti, nuk ke faj, unë jam ndryshe...Po unë u mendova gjithë natën mbrëmë. Ndoshta ti ke të drejtë dhe unë mbase duhet të zgjedh një rrugë më të ndershme për të jetuar...

-Faleminderit,- foli Elio ngadalë.- Unë të fola, se të dua. Nuk kam dashur asnjë njeri aq sa ty, ndoshta as nënën time, por edhe ti duhet të jesh e sigurt se askush nuk do të të dojë as sa gjysma ime. Kaq shumë të dua, sa për herë të parë mbrëmë jam bindur se profesioni jot është një profesion dhe si i tillë, dua apo nuk dua unë, duhet respektuar...Meqë nuk e kam përdorur deri më sot këtë fjalë, po ta përsëris edhe një herë: Të dua shumë. Ilda!...

-Ja, këtë fjalë desha të dëgjoja nga ty, Elio. Faleminderit! Tani duhet ta mbyll telefonin...

Ajo dëneste.

-Si kaloi udhëtimi?- e pyeti ai, sa për ta zgjatur edhe pak bisedën.

-Mirë, si Doruntinë,- u përpoq të qeshte tjetra.

-Bie shi andej?

-Ka pushuar...Mirëupafshim, tani!- dhe ajo e mbylli telefonin për ta lënë të lirë shpërthimin e dënësës që i qe mbledhur si vullkan në gjoks.

Ilda mbylli telefonin dhe doli nga kabina e vogël nëpër shi. Hoteli i Elios ngrihej i zymtë përballë, një ishull në mes kësaj bote, si vendi i saj. Ajo mallkonte veten, që ishte rikthyer në Dyseldorf e ushqyer nga shpresa e marrë se ky njeri mund ta mposhte frikën dhe nuk do ta linte atë të vetmuar mes kësaj turme ujqërishe, që e kafshonin nëpër gjinj dhe e lëpinin ku të mundnin, duke shqiptuar një fjalë të vetme, jo lutëse, por urdhëruese: Që sot e tutje, ti, do të qëndrosh me mua!...Por

ishte mashtruar përsëri, si gjithmonë ishte mashtruar, e idiotërisht kishte fantazuar si do t'ia lante edhe mbathjet e si do t'i gatuate gjithë ato lloj gjellësh gishtrinjlëpirëse e thonjprerëse këtij dhjeramani të poshtër, që doli se nuk meritonte as shpenzimet e varrimit! Ishte mashtruar përsëri, sepse ishte kafshë, një kafshë, e cila nuk arriti të kuptojë asnjëherë dimensionet reale të frikës paramesjetare për të jetuar të njerëzve të vendit të saj.

E fundit gjë që mendoi, tek po priste trenin e saj, ishte se edhe Kostandinin, të vetmin shqiptar me emër, që sakrifikoi për dashurinë, shqiptarët e çuan me këmbët e veta në varr, kurse Doruntinën e detyruan të vriste veten nga turpi i fjalëve. Më ruajtë Zoti, që unë kam lindur e paturpshme, tha me vete Ilda, dhe vendosi t'i lëshojë një vështrim shpresëdhënës atij mashkullit të veshur gjithë sqimë, që po i rrinte në mënyrë trangullore përballë e nuk po ia ndante ato sytë e shpëlarë, prej njeriu që nuk ka parë diell me sy.

## SHQIPËRIA

Ne e thamë të gjithë shishen e uiskit. Tavolina ishte e mbushur plot me gota bosh e filxhanë kafeje dhe tavllat mbanin nga një grusht bishtash cigareje brenda, kurse njerëzit nuk dukeshin më nga mesi e lart. Qenë sharruar në mes nga perdja e dendur e tymit.

- Tani, mbathjani!- urdhëroi gjithë qejf gruaja e Francit.- Në këtë shtëpi nuk gjendet më asnjë pikë alkool!...

Ajo kishte nja një orë që shkëmbente ca shenja intime me të shoqin dhe shfrytëzonte çdo rast që i jepej për t'iu ngjitur në trup. Merrej vesh, i bëhej ajo punë.

Ikim, pranoi edhe i vëllai i saj.

Atij i qe bërë koka e vogël sa një grusht nga pija, por kush e di ç'poshtërsi po mendonte ato çaste, kur e nxirrte tymin e "Kamelit" nga të gjitha vrimat e kokës.

Ai ishte një biçim hibridi, që të jepte përshtypjen se e nëna, një goxha grua e bukur, e kishte zënë jo me spermë mashkulli, por me nitroglicerinë. I qeshnin tinëzisht sytë e vegjël, që, edhe kur gjendej në qejf, ia ruanin ftohtësinë e akullit.

Franci na u lut si Krishti të qëndronim edhe pak. Kishim lënë një bisedë interesante në mes, si mund të rregullohej Shqipëria përmes makroekonomisë, por ne nuk u dorëzuam. I pari u ngrit ministri i asaj ministrisë me emër tmerrësisht të gjatë, pas tij unë dhe pas meje kokëdardha. Kur dolëm në koridor, unë dëgjova Francin që psherëtiu "Falna mëkatet, o Zot!" dhe pashë kunatin që qeshi mbytur. Edhe ai ishte ministër, ministër i pa shpirt.

- Bëni nani-nani!- tha ai në ndarje me sytë që sa nuk po ia braktisnin zgavrat nga e qeshura.

- Na marrtë gjumi i madh!- ia ktheu Franci dhe kështu u ndamë.

Jashtë frynte juga. Në rrugët e shkreta qarkullonin vetëm policë dhe qenër pisanjosë, çka na e mbushi mendjen se sikur nuk kishte kuptim të mbylleshim nëpër shtëpira, duke braktisur këtë natë të ngrohtë. E ndamë mendjen ta pinim edhe ndonjë gotë dhe në atë çast ministri i ministrisë me emër të gjatë e pyeti kolegun e tij se ç'kishte që zgërdhihej.

- E di pse psherëtiu Franci "Falna mëkatet, o Zot"?...Do flerë me motrën time, por ata kanë njëzet vjet martesë, ti e di, janë martuar që kalamaj, dhe ajo i duket tani si motra e tij...

Tjetri, pak dhëmbëdalë, i prerë për bllofe e që i respektonte bllofët, filloi të qeshë me të madhe, siç e kishte zakon.

- Inçest, me dy fjalë...

- T'ia çojmë policinë në shtëpi,- sugjerova unë...

- Lere,- tha shpërthyesi ynë,- Do t'i pushojë zemra në vend Francit. Ai ndihet realisht fajtor në këtë pikë...

Ne po qeshnim me të madhe, sepse na u kujtua për drejt diskutimi tejet serioz i Francit se si mund të rregullohej sa më shpejt Shqipëria...

- Vetëm këtu nuk bën fajde ekonomia,- qeshte dhëmbëdali,- Francin, përshembull, e gatit dhe e sjell në derexhe të Zotit vetëm divorci! Ekonomia veç sa i vjën nga pak vërdallë...

Na hypi një e qeshur prej idioti dhe ne ia filluam përsëri të pirës, pikërisht atë çast, kur motra e nitroglicerinës doli nga banja me një penjuar të lehtë, që ia nxirrte në pah linjat ende të padeformuara të trupit. Ajo u nis gjithë qejf t'i hynte në shtrat Francit, duke u zhveshur ngadalë që në hyrje të dhomës, dhe asnjë nga ne nuk e dëgjoi kur ai i uluriu të shoqes që të fikte dritën. Të paktën, të bënte sikur nuk e dinte me cilën kishte rënë në shtrat. Në atë kohë ne po porosisnim dopiot e dyta. Na pati lodhur diskutimi për Atdheun.

## \* MIRËMËNGJES, VIRGJERESHE!

Ata u njohën në një koktej të garametshëm në Shkodër, ku, nga njerëzit e shumtë nuk mund të pije cigare e të mbaje gotën e pijes në dorë njëherësh. Gentit, me atë kokën e vogël sa një bilë bilardoje, i bënë përshtypje këmbët e bukura të Enit dhe u përpoq ta gjente ku e njihte këtë ëngjëll. Dha e mori, me atë kujtesën e tij mozaikale tashmë nga alkooli, por gjithçka iu kujtua, pasi pyeti gjithë edukatë, gjë e panatyrshme për të, Enin. Ah, po! E pati pasur dikur studente të tij në ekonomi, por atëherë ajo kishte qenë nja dhjetë kile më e dobët, si punë qingji pirës, e as që përbënte ndonjë objekt të denjë për kujtesën e tij, që, veçanërisht seksin e dobët, e arshivonte e seleksiononte me kujdes. Tani ajo punonte në një Institut Statistikash dhe, si e kaluan për mrekulli koktejin bashkë, duke kujtuar qyfyret pa fund të shkollës, e lanë për të pirë ndonjë kafe në Tiranë.

Gentit i pëlqeu Eni. Ajo fliste me një lirshmëri të admirueshme dhe ruante një bezdi fisnike në fytyrën e sytë ëngjëllorë, që të thithnin e të bënin për vete, si dy palë buzë mishtore. Nuk vuante nga konceptet arkaike, që te shqiptarët rëndom kanë rrënjë të thella, bile, i pëlqente të bënte seks rrethuar nga pasqyrat. Sikur i shijonte tamam, kur shihte nga çdo anë trupin e xhveshur nën një këmishë farfuritëse mëndafshi...

Do fle një herë me këtë, e ndau mendjen kokëgrushti, dhe e këshilloi pastaj atë qenie të vetvetes, të struktur thellë në gjoksën e brishtë, aq thellë, sa edhe ai mezi ia dallonte surratin, që mos e neglizhonte shpirtin e vogël. Duket ajo përbënte vërtet një objekt interesant seksual, derisa ai nuk e harroi. U takuan një ditë si rastësisht, në kafën ku ajo zbriste çdo ditë rreth orës njëmbëdhjetë, dhe, nga ajo ditë, filluan ta kryejnë këtë rit stomakshkatërrues sëbashku. Tjetra e njihte mirë Gentin. Ia dinte dobësinë për seksin, aventurat e tij të pafundme, të

ndërthurrura me ca drama të ngatërruara, dhe kënaqej, kur tjetri i vinte vërdallë e i përsëriste ato komplimente, që ajo i kishte parashikuar një ditë më parë.

- Je skematik, profesor,- e talli një ditë,- kurse shoqëria ka ecur përpara!

Genti i hodhi një vështrim të flohtë me ato zaret e tij të errët, vështrim kriminel i hodhi.

- Seksi ka një rregullore strikte, gati-gati ushtarake,- i tha ai flohtë,- formula më efikase është ajo që përdori Adami në fillimet tona, kur i tha Evës: A nuk e bëjmë bashkë atë punë!...Si thua?- e pyeti pastaj pa ia ndarë sytë dhe nuk u mor vesh se për çfarë e pyeti.

- Të mendohem!- ia ktheu edhe ajo, po ashtu, pa objekt të saktësuar se për çfarë do të mendohej.

- Mendja e femrës është në mitër! Po deshe të bësh qejf, mendo me mitër, po deshe të fitosh lekë, ver në punë trurin e pluhrosur!...

Kështu u ndanë atë ditë. Dhe nuk u panë ca kohë, veç ai i la kartvizitën e tij dhe i tha, se nuk kishte shumë kohë për të harxhuar kafeneve, si adoleshentët. Ishtë 37 vjeç dhe, po t'i lindte asaj qejfi për të kaluar ndonjë natë historiko-seksuale kokë më kokë, le t'i bënte një telefon.

- Nuk e dija që përbëja objekt historik,- u tall ajo. Dhe u tall bukur, kur nderi në fytyrë një buzëqeshje tejet të sinqertë prej çupërlinje të padjallëzuar.

Po Genti ishte kriminel.

- Historik jam unë, sepse e bëj mirë atë punë! Pastër dhe me rendiment! Kjo gjë duhet të figurojë edhe në statistikat tuaja!

Nja tre muaj Eni nuk u ndje dhe Genti e harroi, nëpër orgjitë e tij të zakonshme, me ca femra mes të njëzetave e dyzetave, që iu pëlqente t'i harronin hallet e kësaj bote në shtrat. Më në fund u hap nami se ai u fejuar me femrën më të turpshme të Tiranës, me një tip kokëulur, që duhet të dinte egzaktesisht sa pllaka kanë trotuarët e rrugëve që bënte rëndom, dhe Eni vendosi të tallet pak. Ajo e mori në telefon dhe ia nisi një urimi ironik për bashkëjetesë të lumtur e paqësore, a thua po lexonte informacionet politike të kohës së qepës, pastaj, kur mbaroi, e lumtur që e pati torturuar tjetrin, dëgjoi një zë të zvarrgur matanë fillit, që po pëlliste ngadalë:

- Liri- Demokraci! Liri- Demokraci!...

Dhe menjëherë më pas një zë të akullt, që shtoi kriminalisht:

- Ta theksova një herë: nuk kam kohë për të humbur me budallallëqet e tua! Nga ty pres vetëm një fjalë, dakort!

Dhe e mbylli telefonin.

Eni u nxi. Maskarai! E rimori tjetrin në telefon dhe i shpjegoi po aq kriminalisht, se ai ishte një hu që nuk arrinte t'i kuptonte sentimentet e të tjerëve. As asaj nuk i kërciste hiç nëse ishte fejuar apo martuar Genti. Bile, kjo ishte gjëja

më pak e rëndësishme në botë dhe, padyshim, me gjithë respektin për profesorin, nuk hynte as në rubrikën e aktualiteteve!

- E kupton që je një zagarr plak me nuhatje të skaduar, profesor?- përfundoi ajo.

- Kur do të vish?- pyeti Genti, a thua nuk dëgjoji asgjë nga ai lumë ofendimesh.

- Sonte!- premtoi ajo dhe as që e mori vesh pse.- Në orën tetë!

- Të garantoj kënaqësi!

Dhe telefoni kërciti sërisht.

Po, unë, idiotja?- pyeti veten Eni. Pse, kurvë jam unë, që ai sillet ashtu? Ia tregoj unë atij, qelbësirës, tha e xhindosur dhe ia tregoi vërtet! E la të ngrefur majë tavolinës, si maçok të larë e të krehur, e detyroi të mbartë në dhomë gjithë ç'pasqyra gjendeshin nëpër shtëpi, dhe as denjoi t'i dërgonte një mesazh për kthembdjen. Por as Genti nuk kërkoi shpjegime dhe kështu ra sërisht harresa, këtë herë ajo e madhja fare, deri sa ata u ripanë në një seminar. Genti u shtir sikur nuk mbante mend asgjë. Ata u ulën pranë njëri-tjetrit, treguan ca qyfyre të lehta dhe, diku andej nga fundi i seminarit, Genti i zgjati Enit një letër të bardhë:

- Zhubrose mirë,- i tha,- dhe unë do ta bëj sërisht, me një truk, kështu, siç ta dhashë...

Eni u mor nja pesë minuta me letrën, e zbrujti mirë e mirë, duke ia nxjerrë atij sendi të pa shpirt edhe inatin e pa shuar akoma për ato kunjat e poshtra, dhe pastaj ia zgjati me vështrim triumfator tjetrit, për t'ia parë tashmë atë magjinë e famshme.

- Faleminderit!- u përkul gjithë edukatë Genti.- Unë tani po shkoj në tualet, po nuk kisha një letër të përshtatshme për t'u fshirë!

Kështu u ndanë herën e dytë, ai duke qeshur si rapsod popullor e ajo si e menderosur. Ai ia lau borxhin deri më një, aq ligisht, sa Enit iu qa nga inati, po edhe ajo u betua se do t'ia merrte hakun nderit të saj të rënë dëshmor për dinjitet!

Në fund të vitit 1995, gati dy vjet pas zhubrosjes së letrës, Eni vendosi t'ia prishë Vitin e Ri Gentit, kur e mori në telefon e iu lut ta kalonin natën e shënuar bashkë. Po ajo nuk e dinte se ai ishte një aeroplan pa aerodrom dhe se truri i tij, sa një kokërr arë, mund të shpikte mashtrimet më të mahnitëshme, vetëm mos e lëshonte rastin fatlum t'i shpëtonte nga dora. Ajo mori në telefon atë kohë, kur truri i tjetrit po sorrolatej për të gjetur se me kë mund ta kalonte sa më mirë këtë natë të mërzitshme të mbushur me pilafngrënës e ca njerëz vitrinazhi përreth.

- Unë do të të pres deri në orën dhjetë e gjysmë të darkës në shtëpi. Më vonë, mos hajde kot, sepse nuk jam!

- Dakort!- i tha tjetra.





Merrej vesh, nuk do të shkonte, po, aty nga darka, erdhën e iu mërztitën urimet e pafundme të prindërve për dasmën e saj të shumëpritur dhe, si u fut në dush për të hequr nga trupi aromën e avujve të gatimeve, veshi një fund të shkurtër e një bluzë, që ia nxirrte kërthizën pak jashtë, hodhi pallton supeve e doli. Në dhjetë e një çerek ajo ishte para portës së Gentit. Vuri veshin mbrapa derës, duke menduar se si do të justifikohet, po t'ia hapte derën bashkëshortja e Gentit, pastaj shtypi butonin e ziles. Fundja një vizitë kortezije ish-profesorit të saj të dashur po i bënte! Xhelozija nuk mund ta privonte njerëzimin nga një ndjenjë kaq vitale, sa mirënjohja! U dëgjua një si kukuvajkë, tre herë ra, a thua edhe tre ditë jetë i kishin mbetur, dhe kështu, me këto mendime ogurzeza në kokë, e gjeti hapja e derës. Genti nuk i foli. I bëri një shenjë me dorë të hynte brenda dhe, ja, ku gjet brenda, si i bukuri shejtan, në apartamentin e ngrohtë. Ai ia hoqi pallton ngadalë, gjithë përkujdesje. Kundroi veshjen e saj estravagante, dalloi i kënaqur një alamet trupi të pjekur femëror, u përgatit i lumtur për ta kaluar si kont natën e bezdisshme, udhëhoqi rrugën gjithë pa folur, po nëpër mend po i shkonte ndonjë nga ato kunjat e tij vrastarë, përderisa po hezitonte të fliste. U ulën në një tryezë të përgatitur me gjëra gjysmë të gatshme, ia nisën me verë të bardhë dhe ajo, pa e marrë vesh as vetë, i tregoi tjetrit gjërë e gjatë për jetën e saj, të cilën Genti, aty nga mesnata, e cilësoi në mënyrë lakonike "Jetë muti"! Pastaj u ngritën të kërcenin, u puthën buzë më buzë, kur ia plasën fishekzjarret, lajmëtare të hyrjes së Vitit të Ri dhe Genti, që boll pat duruar i ngrehur, e tërhoqi tjetrën në prehër. Po ndjeu se diçka nuk shkonte, me t'ia kapur gjoksin me ato duart e tij delikate. Ndjeu një frikë patalogjike nga ana tjetër, një frikë, që, në thelb, po i dukej se nuk i përkiste Elës. Tjetra u mblodh si iriqi, nuk kthente më asnjë përkëdhelje dhe, sa më lakuriq mbetej, aq më shumë ngurtësohej. Veton e vuri te të mbathurat, nuk deshte t'i hiqte, por, kur ai ia grisi vandalisht ato dantella të pafajshme delikate, Ela mblodhi duart para seksit të saj mjekërgjatë dhe uli kokën mbi gjoksin e plotë vajzëror, duke u dridhur si një qen në shi.

- Fillove prapë?- e pyeti Genti i nervozuar.

Po e mërziste vërtet kjo femër idiote, që e meritonte ta nxirrte me shkelma përjashta, po ç't'i bënte asaj pune!...

Lakuriq, në prehërin e atij mashkulli të frikshëm, dhe me diçka tmerruese, që po e shponte nën vithet e forta, Ela tha "jo" dhe shtoi se kishte shumë frikë...Ishte e virgjër!

Ishte ora pesë minuta e një viti krejtësisht të ri.

- Natën e mirë, Virgjëreshë, dhe mirësevjen, dashuri!- uroi Genti, duke mallkuar punën e re që po i hapej tani.

E shtriu tjetrën brutalisht në tapet dhe u bë i shurdhër ndaj zhurmave të botës, ndaj protestave të saj e melodive aq humane, që buronin nga kompaktdisku.

Po ajo nuk e la. E tmerruar, Ela ndërthurri thonjtë mbas atij leshti të spërdredhur, si i mbyturi mbas flokëve të shpëtimtarit. Luftoi heroikisht, duroi kafshimet e gjinjve, e mbyti ekstazën brenda vetes, i vuri në zap ato valë marramendëse, që i merrnin herë pas here frymën, iu përgjigj të gjitha trilleve të pafundme të tjetrit për ca lëpirje neveritëse e zorršnjellëse në gojë, por këmbët nuk i hapi që s'i hapi dhe kështu sikur e shpëtoi virgjërinë.

Aty nga ora dy e natës, ai e kuptoi se kjo idiote, që ishte e gatshme t'ia dhuronte të gjitha vrimat e trupit veç njëres, nuk do ta lejonte që të kryente ritin e dëshiruar. Keq pati filluar edhe ky Vit i Ri! Keq! Me ca anakronikë anormalë, me ca qenie të rralla, tepër të rralla, që, për ters, i patën qëlluar për hise atij. Ai e detyroi Elën ta kënaqte mekanikisht dhe, si gjeti një lloj ngushëllimi, hyri në dush. Atje, nën vrushkujt e ngrohtë e avujt mbytës, Genti qeshte me vete, tek kujtonte seksin me pasqyra, leksikon dhe veshjen moderne të tjetres, dhe atë seks të ndryshkur pastaj, që mesiguri do të kishte zënë skorrje tani e rrezik ishte burim tetanozi! Kur doli, Ela qëndronte në tavolinë.

- Të lutem, më fal!- tha ajo.

- Qofsh e falur,- ia ktheu Genti,- po pse erdhe?

Ela e pa gjatë.

- Mendova se jam moderne,- tha pastaj e trishtuar,- por qenka e kotë!

Nuk bëhem dot!

- Unë do shkoj të fle,- tha Genti,- ti, po deshe, shtrihu në divan, po deshe hajde në dhomë! Bëj si të ta thotë mendja... Natën e mirë!

Ela ngeli vetëm në dhomë. Ajo mendoi përgjatë një ore, duke ndërruar papushim kanalet televizive, jetën e saj. U bë gati t'i shkonte e t'i hynte disa herë në shtrat atij kokëzarit të mallkuar, por dora që e tërhiqte dhe e mbante me një forcë mitike përbrenda, nuk mposhtej dot. Kishte lindur si pasojë e një përdhunimi mashkullor dhe ky përdhunim vazhdonte ta mbante të pranguar, me atë kërcënimin ogurzi se nuk do të shikonte një ditë të bardhë, nëse cipën e virgjërisë nuk do t'ia çonte të shoqit për pajë. Kishte marrë pjesë në Revolucionin Demokratik, hyri në grevën e urisë së studentëve me ndjenjën e flijimit, luftoi me heroizëm botën e vjetër plot dogma të mallkuara dhe, si përfundim, ç'kishte bërë? I pati hedhur edhe një shtresë beton armeje cipës së saj së virgjërisë, që, tani, rrezik as edhe martineli më i përsosur nuk do ta shponte dot. Dhe pse? Sepse edhe unë bëj pjesë në armatën e dhjeramanëve, ia plasi vetes në sy...Për herë të parë mendoi se Revolucionin tamam në këtë vend do të bëhej, kur vajzat të valëvisnin brekët e tyre si flamur kapitullimi të asaj bote që duhej të zhdukej...Po kush ta bënte?...

E shkreta unë, shtoi pastaj mes lotëve ajo. Tani e kishte mendjen top të xhvishej e t'i hynte në shtrat tjetrit, më në fund e kuptoi se gjithë ç'ka pati ruajtur si floririn e saj nuk qe gjë tjetër, veçse një pare kallp, pa vlerë e që kërkonte një

mal me energji për ta mbajtur orë e çast më vete, por kishte turp, shumë turp t'i hynte në shtratin e madh të jetës mashkullit. Eni nuk dinte absolutisht asgjë nga ajo që do të ndodhte. Nuk dinte si ta përballonte aktin seksual...I erdhën vetëtimthi në mendje ca rënkime epshore e ca skena erotike filmash , edhe ato të para tinëz, kur prindërit flinin, por i harronte mes tmerrit në çast...E ndjeu se, shumë-shumë, ajo do të përngjasonte në shtrat me një lopë ordinere pa as edhe një kromozon racor në gjak. Dhe turpi i turpërimit e vuri në gjumë.

Ishte ora dhjetë e gjysmë e mëngjesit, kur Genti hyri në kuzhinë. Ajo e ndjeu dhe u mbulua instiktivisht.

- Mirë mëngjes, Virgjëri!- përshëndeti qetësisht tjetri.

Ajo nuk ia ktheu. Vetëm se iu duk e çuditshme që gjuha formonte konstrukte kaq absurde, me dy fjalë krejt të kundërta: "MIRËMËNGJES...VIRGJËRI!"

*PRILL, 1996*

## NAIMI

- Të bezdis, po të shoh pak lojën mbrapa teje?

Unë kisha lënë një grusht me lekë deri atë kohë, por edhe kur më ecte, nuk e pëlqeja ta luaja pokerin me njerëz të njohur e të panjohur mbas krahëve. Më nervozonin sytë dhe psherëtimat “mësimëdhënëse” të tyre. Megjithatë, i bëra një shenjë me kokë të ulej. Atë njeri e njihja vetëm për fytyrë, meqë i pinim kafetë në të njëjtin bar ngjitur me restorantin, ku uleshim rëndom për të ngrënë peshk e për të luajtur poker. Kisha dëgjuar me një vesh se shkruante libra, por mua ky zanat nuk më interesonte më. Prej kohësh nuk kapja më libër me dorë.

Tjetri, një fytyrë zbehtë si i përvuajtur nga ndonjë sëmundje e brendshme, u ul, duke më falenderuar. Në gjithë atë tym duhani, fytyra e tij nuk ra në sy. Po as ai nuk kishte ndërmend të hapte gojë. Vështronte letrat e mija, pastaj sodiste lojën, duke pirë cigare herë pas here. Edhe unë herë pas here i drejtohesha pa e parë “nuk po hyn letër”, pastaj s’ merrja përgjigje dhe prapë humbisja. Kaloi kështu nja gjysmë ore e mbushur me “pas”-e e bllofe që binin erë një orë larg, si çorape ushtarësh, kur mua më erdhi një dy per me asa dhe dhjeta. Dikush para meje hapi podin dhe unë vendosa të lëshoj ruanë për të kapur një ful, mirëpo atë kohë ai më bëri një shenjë me këmbë dhe, kur ktheva kokën, e pashë që ua kishte ngulur sytë dhjetave të mija. Këto të mbaj, ia ktheva unë me një shenjë gishtash dhe ai ma kthehu “po” me kokë. Kërkova tre kartë, pa e ditur as vetë pse e dëgjova e pse i lëshova asat dhe, kur i hapa letrat ngadalë, pashë me zemër të dridhur një kare dhjetash me damë. Bëra sikur u tërhoqa dhe hodha me një pendesë të përkryer 50 dollarë në tavolinë, por dy minuta më pas loja kishte marrë shumë lart dhe tavolina kishte nja 3000 dollarë sipër. Atëherë kërceva mirë dhe, kur mbaroi ajo histeri, unë ua kisha zbathur brekët të gjithëve.

Kjo ishte çudija e parë që do të më jepte ai njeri, për të cilin unë vija kokën në satër, që nuk kishte hapur letra kurrë, kurse ai na doli një maestro që arrinte të llogariste me përafërsi edhe çfarë letrash do të vinin! Në kafë ai më tregoi se kishte luajtur vetë dikur, por pati hequr dorë që kur ishte detyruar të dënonte me tre muaj burg një partnerin e tij, atëherë kur kishte qenë ndihmës gjyqtar.

- Mua më kërkuan të luaja një natë, por unë isha me temperaturë të lartë. Nuk shkova vetë, megjithatë iu dhashë letrat e mija. Qenë letra të mira, hungareze...I kapën atë natë dhe, kur u formua trupi gjyqsor, unë isha ndihmës gjyqtar në atë gjyq. U bëra grusht, se letrat, prova materiale, ishin të mijat!...Nuk luajta më!...

Nga ajo mbrëmje ne i pinim kafetë bashkë, mëngjeseve vonë dhe atë të mbrëmjes, kur ai dilte nga shtëpia. Ai të krijonte përshtypjen e një njeriu të heshtur. Nuk para fliste. Ia ngulte sytë me orë të tëra rrugës së madhe plot njerëz dhe, kur e pyesja, "Çfarë shikon andej, o Naim?", ma kthente shkurt: "njerëzit!"

Naimi ishte shkrimtar, po as fliste për librat e tij, e as i kisha parë ndonjë botim. Një ditë më tha shkurt se nuk gjente dot sponsor për botimin e librave të shkruar kohët e fundit. Kjo duhej të qe e vërtetë, sepse ai tip nuk ta mbushte mendjen se mund t'i kërkonte gjë dikujt. Në verën e '95-sës unë shita me çmim astronomik një vilë, që pata ndërtuar për pak para dy vjet më parë në plazh, dhe vendosa t'i jap 3000 dollarë Naimit, për të botuar një libër të tijin. Ai më falenderoi dhe më paralajmëroi se lekët mund të mos m'i kthente, po mos ecte libri, por unë e sigurova se këto lekë ia kisha falur.

- Mbase duhet falur diçka, që të më eci prapë,- i thashë dhe e mbylla atë bisedë që na bezdiste të dyve.

Libri u botua pikërisht atë kohë kur Naimi u divorcua nga gruaja, për ca arsye intelektuale mospajtimi karakteresh e ngrënie hudhrash apo qepësh, dhe gjendej krejt pa strehë e pa gjë rrugëve, mirëpo shumë shpejt ai libër fitoi famë e mahnitë lexuesit. Ishte vërtet një libër me tregime të shkëlqyera, jo nga ato të sajuarat, të shkruajtura me një gjuhë që sot nuk e flet as gjyshja ime, por me të vërteta të mëdha, dhe unë dallova pas asaj fasade heshtamane e indiferente, pas atij njeriu që numuronte lekët e mezi paguante një kafe, një vëzhgues të hollë me shpirt të madh.

Ky njeri paskësh qenë e thënë të më habiste gjithmonë. Unë i ndërtova një shtëpi të bukur rrëzë Dajtit me lekët e fituara nga librat dhe i bleva një veturë të vogël, por të mirë, te tregu i makinave të vjedhura. Librat e tij filluan të botohen me shpejtësi edhe jashtë vendit dhe Naimi nuk qahej më për lekë. Tani, kur ngelesha ndonjëherë keq për të bërë pagesat e punëtorëve të mij të ndërtimit, unë merija hua nga llogarija bankare e Naimit. Por vetmija atë e grryente. Shpesh më tregonte se nuk jetonte dot pa fëmijët, të cilët nuk praninin ta takonin, dhe jo rrallë këto rrëfime përfundonin me përlojtje. Unë u përpoqa ta zbusja ish-gruan e tij, por, sa

më i famshëm bëhej Naimi, aq më shumë egërsohej ajo xhadë e keqe, një brune e bukur me një trup të kolmë, që kishte filluar t'i mbante me bukë fëmijët, duke kaluar netët me klientët e kamur nëpër hotelet luksoze të kryeqytetit. Në këtë kohë ai botoi romanin "Vetmija", një roman tronditës për fatet njerëzore e shumë i rëndë për mua, që njihja mirë Naimin dhe që e gjeja nëpër rreshtat e çdo faqeje. Ai roman e bëri përfundimisht të famshëm atë njeri, me të cilin tashmë ishte e vështirë të pije një kafe i qetë në publik, pasi të bënin fansat copë, duke të tërhequr për xhakete e duke të kërkuar autografe. Naimi filloi të udhëtojë shumë nëpër botë. Sa herë kthehej, ai sillte kukulla e lodra të shtrenjta për fëmijët e mij. Ulej e pinte një shishe verë të bardhë me mua, po nuk fliste thujse fare. Vetëm shihte fëmijët si luanin e si iu gëzoheshin lodrave dhe shkrihej fare me djalin tim të vogël, kur mërziqte dhe i flakërinte ato mallra aq të shtrenjta.

- Lere!- i thoshte butë gruas sime, që ngrihej duke bërtitur,- po u mëziti, tregon se ka interesa të gjera. Po i prishi, tregon se do t'i rregullojë nesër!...

Nga ky moment i hapej goja. Gruaja ime e pyeste në kishte gjetur ndonjë shoqe andej, ai ia kthente duke qeshur se qe lidhur me një franceze, por ajo ishte e ftohtë. Donte gjithë atë përkuqjesje...

- Si serbet nuk ka!- deklaronte pastaj.- Ato kanë tjetër koncept për jetën!...

- Mbyll gojën, se do të dëgjojnë këta të SHIK-ut!- e paralajmëronte ime shoqe.

- Pse shkon deri te SHIK-u,- shtoja unë,- ke kosovarët përpara!

- Këtë salcën e peshkut e ke qarë!- lavdëronte Naimi gruan time dhe ky ishte kapaku i asaj bisede.

Kështu ndodhte pothuajse gjithmonë.

Mes nesh kishte lindur një lidhje e çuditshme. Unë nuk dallohesha për ndonjë kujdes ndaj librit, kurse Mira, gruaja ime, ishte më ndryshe. Përpara se të lindte fëmijët ajo lexonte thujse gjithçka që i binte në dorë dhe, megjithëse nuk e përtypte dot divorcin e tij absurd, sipas saj, Naimin e donte vërtet. Tani që fansat e tij nuk na linin të qetë, ne pinim ndonjë kafe në plazh apo në mal dhe mbledheshim shpesh mbrëmjeve në sallonin e tij, një sallon i madh e i mobiluar bukur, me kompjuterin në cepin e murit ngjyrë limoni e me ca dollape në guzhinë, ku gjeje ushqimet dhe verërat më të mira të botës, që ai i sillte rregullisht nga jashtë. Shtëpia e tij, megjithëse e kisha projektuar e ndërtuar vetë, më ngjallte një zili të përhershme me atmosferën e saj. E mbushur me libra e piktura të dhuruara nga mjeshtra shqiptarë e të huaj, me lëndinën e bukur përpara, ku kishin filluar të hidhnin shtat ca bredha të bardhë e ca shkurre jargavanësh, ajo shtëpi të bënte të harroje të ngriheshe. Por Naimi nuk prishte qejf. Kur duhej të kryente ndonjë punë, ai ia mbathte në dhomën e tij, duke na lënë ne vetëm para pjatave e verës, pa kërkuar falje e pa dhënë shpjegime dhe Mira, që në fillim u ofendua nga kjo mënyrë të sjelluri, tani nuk ia vinte më re as përumbjet e as braktisjet e befta. Ajo pastronte

ndonjë gjë, pastaj vinte kompaktdiskun, duke zgjedhur muzikë që kërcelhej, dhe më ftonte mua të vallëzonim. Naimi nuk kërcente kurrë.

- Nuk kam haber nga kjo punë,- thoshte.

Rrinte e na kundronte ne, duke iu rrotulluar para syve, pastaj ngrihej e kërkonte nëpër sirtare ndonjë gjë për Mirën. Gjithmonë e harronte ku i kishte flakur sendet që kërkonte dhe, kur i gjente, shante veten nëpër dhëmbë: "Ah, po, ti, je gomar, o i shkretë!..."

- E teprove tani!- i thoshte si gjithmonë Mira me një pamje të kënaqur, duke parë nga unë.

- E di!- ia kthente si gjithmonë Naimi.- Leri, po deshe, ia jap ndonjë tjetre!- shtonte gjithë mirëkuptim.

- Po qe për ndonjë tjetër, këto janë të mijat!- vendoste Mira dhe, kur dhurata ishte ndonjë plaçkë, e provonte në çast. Po t'i rrinte e madhe, mërmëriste "ngushtohet", po t'i binte e vogël në trup, thoshte "qari i Ninës", për vajzën tonë dymbëdhjetë vjeçare, që po rritej me ditë.

Por Naimi po bëhej gjithmonë e më i mbyllur. Tani ai punonte shumë mbi një roman epope, për të cilin mua më shprehej se "po më ha të gjallë", dhe pyeste shpesh si në hava "Si thua, ç'po bëjnë ata të mijtë tani?"

Unë ngrija supet, kurse Mira, e cila ndodhej thujse gjithmonë mes nesh, belbëzonte një "si të gjithë fëmijët", por edhe atë e shqetësonte ai ngatërrim i menjëhershëm i bisedës së Naimit, nga letërsia apo jeta e përditshme, te fëmijët e tij.

- Ky nuk është mirë,- më tha një mbrëmje, tek ktheheshim në shtëpi nga një darkë që kishim ngrënë sëbashku.- Sikur të pranonte të martohej me ndonjë grua të mirë! Do harronte mendjen...

- Ku ka perëndi që ia hap atë bisedë!

Përpara nesh, gjithmonë përpara nesh, qëndronte një hënë e plotë, si bukë misri e sapo dalë nga furra. Nganjëherë atë e çponte për një çast maja e minaresë së xhamisë dhe ai teh përzverdhej nga drita.

- Ti, provoje një herë! Ai sikur po luan mendsh...

Unë e mbaja mendjen gjithë te hëna. Qentë lehnin si të dalë nga trutë, kurse trotuari para xhamisë atë darkë vonë ishte plot me foshnja cigane, nga ata që lypnin gjithë ditën. Tani po flinin dhe ndonjë besimtar i vonuar, që kalonte pragun e xhamisë, përpiquej mos t'i shkelte me këmbë ato krijesa të vogla.

- Ta mbarojë një herë romanin, mbase qetësohet,- ia ktheva unë.

Kisha vërtet një shpresë se kështu do të ndodhte. Mos nesër, pasnesër ai do të lidhej me ndonjë femër. Edhe bashkëjetesa ishte gjysma e të keqes, megjithëse ai nuk e kishte zakon të lidhej gjatë me një femër, mos them se vështirë të kishte bërë seks dy herë me të njëjtin njeri, aq sa qëllonte mos t'i mbante mend shumë

nga historitë e shkuara e t'i vinte vërdallë nëpër kokteje gjithë pasion pikërisht ndonjëres që i qe vërdallisur plot me komplimente uniforme mikluese një apo dy vjet më parë. Merrej vesh, hollësi të tilla nuk mund t'i jepja Mirës dhe ajo bisedë u mbyll, kur ne filluam të ankoheshin që e shihnim tempullin e shenjtë në atë gjendje.

Naimi e përfundoi romanin në qershor dhe Mira, që e lexoi e para, u entuziazmuu shumë. Unë isha i zënë me përfundimin e një pallati shtatkatësh dhe as më shkonte mendja të lexoja qoftë edhe një paragraf, por, nga ç'më tregonin mbërëmjeve ata të dy dhe nga ç'dëgjoja nëpër diskutimet e tyre pa fund rreth librit të ri, më dukej sikur isha edhe unë personazh në atë roman voluminoz, që Naimi nuk po vendoste ta jepte për botim.

- Lëshoje!- e këshillova unë.- Tani pesë më shumë, pesë më pak do ndryshojë. Më shumë do vuash, se sa do të fitosh!

- E di,- ma ktheu ai,- shumë gjëra dihen si të vërteta, por nuk pranohen si të tilla!

- Si shpjegohet?- pyeti Mira, që atë çast po fuste pjatat në lavastovilje.

Naimi ia kishte ngulur sytë një pikturë natyrë e qetë, me ca ftonj e qepë të pikturuara në mënyrë moderne.

- Njeriu e formon personalitetin e tij, duke persekutuar të vërtetën!- foli më në fund, gjithë duke kundruar pikturën, që qëndronte pak shtrembër në mur.- Mbase ndodh kështu, sepse shpresa, që organizon jetën tonë, shpesh vdes në një terren të vërtetash. Ja, unë shpresoj se do t'i kem një ditë fëmijët pranë. Bie dhe çohem me këtë ëndërr. Por, kur mendohem me gjakftohtësi, nuk kam më shpresë, sepse ajo tund këmbët dhe fëmijët nuk i lëshon. Dihet e vërteta tjetër, femrat rrojnë më shumë se meshkujt dhe nuk ka më asnjë shpresë për mua...Unë nuk dua ta pranoj këtë të vërtetë!...

Mira fshiu duart me një peshqir që i doli përpara dhe erdhi e iu ul Naimit përballë.

- Dëgjo! Pse nuk provon të jetosh përsëri me ndonjë femër? Unë shpresoj se ajo do të ndihmojë ta jetosh jetën në mënyrë më të gëzuar! Unë nuk jam shkrintare, si ty, por një gjë e di mirë, nga jeta ime, që, tek e fundit, është jetë, si e jotja: kur krijon, njeriu harron! Krijë një gëzim, për të harruar një mërztije! Ja, edhe ne i kishim para ca viteve marrëdhëniet në krizë, aq sa unë mendoja gjithmonë e më shpesh divorcin. Po e di se si e zgjidhëm krizën? Lindëm fëmijën e dytë!...

Naimi nuk ia ndante sytë.

- Edhe kjo është një e vërtetë, të cilën unë nuk dua ta besoj,- tha shkoqur më në fund. Pastaj recitoi duke buzëqeshur ëmbël fillimin e "Romeo e Xhuljetës", po mos ketë gënjyer: "Një grindje e vjetër lind një luftë të re, dhe gjaku i pafajshëm rrjedh rrëke!..."



Mira psherëtiu.

- Me fjalë bëhen librat, me vepra bëhet jeta!

- Po jeta çfarë është? Pronë private, apo pronë shoqërore, apo pronë shtetërore? Ne pretendojmë se ajo jetë e krijuar nga sperma dhe fëkondimi na takon vetëm neve, por më duket se kjo nuk zbatohet realisht në jetë. Janë pikërisht librat ato që organizojnë jetën tonë mizerabël, që dirigjohet nga opinionet dhe interferencat më banale...

Tani ai ia pati ngulur sërish sytë pikurës me ato qepë katrore e ftonj të zij në një degë plot gjethe të bardha me rremba blu.

- E di si ka thënë për afërsisht Lorka në një poezi të tijën?- tha papritur, gati me ngashërim: “Njerëzve u tha duke qarë/Se ç’bënë me atë të tjerët./Era në murin e errët/Tullat kafshonte egër...” Kështu ndodh gjithmonë: kur njeriut i dhunohet jeta, natyra e ha, njerëzit ose pijnë, ose qeshin!

Mira tundi kokën mohueshëm.

- Ti, nuk je mirë!

Ku e nuhati ajo se Naimi nuk ishte vërtet mirë? Një javë më vonë ai u nis për në Stokholm, ku do t’i festonin botimin e një libri. Një natë para nisjes, ne u mbledhëm në shtëpinë e tij, pimë verë e qeshëm me historitë e tij të çuditshme, që ai i tregonte aq rrallë. Mira grisi getat, duke kërcyer me mua dhe ai i premtoi se do t’i sillte dhjetë palë të reja, vetëm mos e bënte fytyrën si maskë karnavalesh për aq gjë. Një javë më vonë unë mora vesh lajmin tragjik, që Naimi kishte vlarë veten, duke prerë damarët në një hotel të atij qyteti, që ai e vizitonte për herë të parë. Lajmin e tmerrshëm ma dhanë në kafe, njerëz që e njihnin miqësinë tonë dhe unë ngela gojëhapur një kohë të gjatë si guak. Përsëri ky njeri më kishte kapur gafil, duke kryer veprimin më të pa parashikueshëm prej meje! Mua më thirrën urgjent në Stokholm, sepse ai kishte lënë një letër dhe një pako. Amaneti i tij ishte i varfër: “Dua të varrosem në Stokholm dhe varrimin të ma organizojë Tomi!”

Kisha shumë kohë pa qarë. Unë ia plotësova amanetin, duke e vendosur trupin e tij e mbyllur në një arkivol luksoz, që nuk arrita ta shoh më, në një varrezë private në mes të një pylli të vogël ku shpesh shëtisnin drerët madhështorë dhe bredhat fëshfërisnin rëndë-rëndë.

Në pako ndodheshin dy disketa, dhuratë për mua, dhjetë palë geta për Mirën dhe dy kompjutera për fëmijët e mi. “Shtëpinë time shite, më urdhëronte, dhe lekët futjau familjes sime në bangë...”

Në njërën diskutë ndodhej romani i tij i fundit, me një përkushtim prekës për mua, “Tomi, njeriut që ia kushtoj gjithë suksesin tim!” Në diskutën tjetër ishte një autobiografi tronditëse e Naimit. Duke lexuar ato rradhë, unë arrita të kuptoj plotësisht fatkeqësinë dhe vuajtjen e tij, torturat e vërteta shpirtërore dhe gëzimet e rralla të tij në botën tonë të mbushur me kaq keqkuptime, por këtë diskutë nuk ia

dhashë për botim askujt, pavarësisht nga shuma astronomike që më afruan, sepse jo vetëm të gjithë emrat e përmendur janë ende gjallë e as kanë ndërmend të vdesin, por edhe fëmijët e tij nuk do t'i kapërdinin dot as sot e as mot aventurat dashurore të babait të tyre. Romani i tij tani është bërë i njohur në botë dhe për Naimin, me të cilin më lidhi krejt rastësisht një tolerancë dhe një kare e çuditshme dhjetash, flitet shumë. Unë as do merrja mundimin të tregoja për njeriun e habitshëm, sikur mos lexoja një libër me kujtime për të, ku thujse të gjithë ia fusnin kot e ku një kamarier, i kafes sonë të preferuar atëherë, ligjëronte për kurnacllëkun naimjan. E kujt mund t'i shkonte mendja se ai njeri atë kohë nuk kishte as bukë të hante? Ngushëllimi i vetëm për mua nga ai libër-masakër qëndronte te fakti që nuk isha për vete i famshëm. Kush e di ç'gjepura do hidheshin në letër për mua e kush e di ç'mëri e mallkime do të zgjonin pas vdekjes sime!

Unë i telefonova gruas së tij dhe i tregova gjithçka, por ajo nuk donte asnjë kujtim nga ish-bashkëshorti i saj.

- Bëri mirë që vdiq!- artikuloi me një cinizëm të pashoq.

E kuptova se me atë femër hamshore ishte e pamundur të merreshe vesh dhe e mbylla telefonin me keqardhjen, që ai njeri aq tolerant ishte tortuar vite me rradhë nga një egërsirë egërsisht e egër, si ajo. Ndoshta kishte një lloj të drejte, që e vrau veten aq barbarisht!

Një pjesë të pikturave të tij magjike tani janë varur në muret e shtëpisë sime. Mes tyre dallon natyra e qetë me qepët dhe ftonjtë e çuditshëm, si vetë mendimet e Naimit, ndërsa shtëpinë e çuditshme e bleu shteti dhe tani ajo është muzeum. Unë shkoj ndonjëherë atje, pagoj biletën hyrëse, sillem në atë shtëpi që më shkakton aq kujtime, duke dëgjuar shpjegimet idiote të cicerones, që gënjen orë e minutë, kurse Mira nuk pranon të shkelë më në atë shtëpi aq të dashur dikur për të. Më duket sikur do më dalë përpara në derë Naimi, thotë ajo. Ai njeri tani i përket të kaluarës, por kjo nuk do të thotë që unë nuk e dëgjoj zërin e tij kumbues ndonjë mbrëmje të trishtuar, teksa reciton Lorkën:

Njerëzve u tha duke qarë  
Se ç'bënë me atë të tjerët.  
Era në murin e errët  
Tullat kafshonte egër...

Unë nuk pretendoj se kështu ndodh gjithmonë, por, kam përshtypjen, se ndodh edhe kështu...

**NËNTOR, 1996**



Si by the!

## DYZET E DY VJET MË PAS...

- Ne kemi jetuar dyzet e dy vjet me mendjen te ty!- tha më e reja nga gratë.

Ato po pini kafe te hollu i madh i Hotel "Tiranës", po pinin një kafe të çuditshme, po të merrje parasysh çmimet astronomike të këtij lokali dhe faktin, se ato duhet të ishin të dyja pensioniste.

Më e moshuara, një grua trupvogël, por e mbajtur mirë, fshinte lotët ngadalë, duke parë përmes xhameve të mëdhej nga rruga. Ajo duhej të ishte diçka mbi gjashtëdhjetë vjeç...

-...Dinim gjithçka për ty, kur kishe fëmijët sëmurë, kur t'u sëmur burri...Luteshim për ty, po nuk të ramë kurrë në sy...Edhe kur, ti, u shtrove në spital nga mushkëritë, unë u përpoqa të t'i siguroja të gjitha ilaçet që mungonin atëherë...

Më e reja, një ish-farmaciste, grua e mbajtur, fliste duke ndjellë hundët me një vështrim të ulur mbi filxhanin e kafesë, në kohën që tjetrës i shfaqej turbull mes lotëve figura e gjatë e Koços. Ja, ku ishte edhe ajo, imcake, e bukur në krah të tij, në atë përcjellje torturuese anash Lanës 42 vjet më parë...O Zot, iu kujtua menjëherë gjithçka. Edhe timbri i zërit të tjetrit:

-Unë të dua! Dua të martohemi bashkë!...

Dhe përreth ushtonin ujërat e turbulla të lumit, që rrihnin të merrnin degë shelgjesh me vete. Asgjë nuk kishte mbetur tani nga ai peizazh...

Asaj i pëlqente ky djalë simpatik, ia ndjente vështrimet që i ngjiteshin si pullë nga pas, por fjalët e tjetrit e patën tronditur keqas përbrenda...

....Si flet kështu? Po unë kam dy motra për të martuar, pastaj ne jemi shumë të varfër...Unë nuk mendoj tani për këto gjëra...As, ty, nuk të kam dhënë

asnjë të drejtë të gjykosh kështu!...

...Unë të pres, sa të duash të pres! Unë nuk martohem me tjetër njeri!...Nuk ka kuptim të martohem me ndonjë vajzë tjetër!...

...T'i pyes një herë prindërit...

Zot i madh! Zëri i saj ishte!...

Po, ti, mos shpreso kot!...

- O Zot, sa të deshte!- vazhdonte farmacistja.- Unë isha tetë vjeç atëherë, më e vogla e gjashtë motrave, dhe e mbaj mend kur ai na tha: O martohem me atë, ose vdes!...

...Tjetrës iu kujtua mëngjesi i së nesërmes...Unë e kam fajin, mallkoi veten. Asaj i treguan shoqet me vrap, në skutën e errët ku ambalazhonin bobinat, se Koçua kishte hapur namin që do martoheshin bashkë...

-Unë?- qe çuditur ajo- As më ka shkuar nëpër mend!...

-Po, ti, i ke dhënë edhe fjalën!...

Qe tmerruar ajo vajzë e vogël, që aso kohe të gjithë burrat i kallnin tmerrin...Kur nuk m'u thanë këmbët dhe goja bashkë, rimallkoi veten ajo...

Kishte takuar Koçon në oborrin e ofiçinës dhe, mes të qarave, ia kishte bërë hasha gjithçka, si qe e vërteta, drejt ta hante!...

E shihte Koçon të trishtuar, me sytë nga kodrat përbri, ia ndjente deri në eshtra faljen...Pastaj, në drekë, ai u nis pa i dhënë urdhër kush në Shkodër. Do merrnin një prozhektor atje dhe Koçua shkoi thjesht, për qejf...

Iku, se ishte i mërzhitur nga fjalët e mia, i tha vetes plaka. Iku dhe nuk u kthye më. Duke e ngarkuar prozhektorin në karroceri, aparati iu kishte shpëtuar nga duart dhe pati zënë Koçon përfund.

Askush nuk e dinte bisedën e saj me Koçon dhe plaka nuk kishte ndërmend t'ia tregonte kujt. C'kuje kishte qenë ajo! Një vëlla me gjashtë motra!...

-...Ti nuk erdhe në varrim!

- Unë nuk kam shkuar në asnjë varrim në jetën time, as në varrimin e burrit!...Po, edhe po të desha, nuk do të vija dot, sepse nuk kisha atëherë aq lekë, sa të paguaja udhëtimin deri në Korçë, ku e varrosët ju...

Nuk gënjente. Por nuk tha, se, nga vdekja e Koços, ajo pati marrë këtë vendim të habitshëm dhe nuk pati shkelur kurrë në asnjë funeral.

- E dimë,- i tha tjetra.- Ne gjithmonë kemi dashur të bisedojmë me ty, por mendonim se nuk duhej të shqetësoheshe...Tani...që burri i juaj...

- Të kuptoj,- tha plaka.

Qenë takuar përpara Hotelit, tjetra e pati lutur për t'i afruar një kafe, pastaj prezantimi dhe, ja, ku iu ringjall gjithçka nga ajo kohë e pluhrosur tashmë. Ndihej keq dhe kërkoi një kafe tjetër. I fshiu mirë e mirë lotët, ndolli hundët, pastaj tha ngadalë:

- Ai ka qenë një djalë i mrekullueshëm! Unë isha shumë e re atëherë, por e dija se të gjitha vajzat e pëlqenin...C't'i bësh? Fatin nuk e dimë, po i miri ikën i pari nga kjo botë!...

Farmacisten e ngrohën fjalët. Ajo kishte kohë që po mendohej si ta kërkonte atë që deshte.

- Unë do t'iu lutesha për diçka,- tha,- po hatri nuk më mbetet, po nuk pranove...

- Urdhëro!- tha tjetra.

Ra një heshtje e rëndë.

- Ne ia sollëm vëllait eshtrat në Tiranë, -ia nisi më në fund tjetra.- I kemi bërë edhe një varr të madh. Ia bëmë të gjitha motrat bashkë...Ne duam që ti të vish një ditë me ne në varreza, sa për t'i vënë një tufë lule te koka...Mbase i qetësohet shpirti...E di, na del të gjithave në ëndërr. Do ketë ndonjë siklet...

Plaka u mendua një hop. Ajo kujtoi fëmijët e rritur dhe hamendësoi se si do reagonin ata, po ta merrnin vesh ndodhinë. I tha tjetrës se do të këshillohej edhe një herë me djemtë dhe kështu u ndanë.

Djemtë e dëgjuan me durim nënën. I vogli i tha pastaj se kjo histori e trishtuar nuk ishte punë për ta. Ajo le të vendoste vetë, por, po të kishte qejf, mund ta shoqëronte edhe ai me nusen. Plaka qau përsëri dhe shkoi në dhomë. E dinte shumë mirë të vërtetën, e dinte se nuk kishte asnjë faj, që tjetri vajti e vdiq kot së koti, por prapë diç e gërryente përbrenda. I qe fiksuar në kokë, se, po t'i pranonte atëherë atij djali të mrekullueshëm, qoftë edhe po ta largonte më butësisht, ai nuk do të kishte atë fat të zi, që pati...

Një javë më pas, shtatë gra çanin përimes varreve ngarkuar me lule. Ato ndaluan para një varri madhështor. E mbuluan me lule dhe plaka, rrethuar nga një respekt solemn, bëri atë që nuk i kërkoi askush e, që, po të kishte guxuar ta bënte dyzet e dy vjet më parë, në këtë varrezë mund të mungonte sot një varr: puthi fotografinë e Koços dhe pastaj tha duke psherëtitur:

- Ta dija se do të ikje përgjithmonë për kaq gjë, do të kisha puthur vetë, pa ma kërkuar, ti!...

Asgjë nuk e kishte pasur këtë njeri, qe sjellë me të vërtet si zonjushë atëherë, por nga ajo ditë plaka ra e filloi të shkojë gjithmonë e më shpesh në kishë. Ndizte qirinj dhe nuk e dinte se kështu bënte një rrugë e dy punë: edhe qetësonte shpirtin e saj të trazuar tashmë, edhe të gjithë njerëzit e mbanin në gojë si grua që e respektoi burrin deri më një jo vetëm sa qe gjallë, por edhe pas vdekjes...

**PRILL, 1996**

## **BURGU**

Ne qëndronim në tarracën e vilës mbi det, duke parë atë hapësirë të kulluar blu, që shtrihej si e përgjumur para nesh. Bisedonim për shqiptarët. Kori, një hollandez i bëshëm, përsëriste gjithë mirësjellje se shqiptarët janë popull i etur për identitet e afirmim por, theksonte ai, ju dominoheni nga pragmatizmi. Kori punonte prej katër vitesh në Shqipëri. Ai merrej vesh me shqiptarët në gjuhë të huaj, sepse zotëronte të gjitha gjuhët e Evropës Perëndimore, por kuptonte mirë edhe shqipen, veçanërisht shkodranishten, meqë atje kishte punuar e jetuar më gjatë.

- Nuk është fare kështu,- e kundërshtova unë, por pa ndonjë këmbëngulje të madhe.- Shqiptarët janë në thelb tipa perspektivë. Në masën më të madhe, jetën e tyre e organizon e nesërmja e papritur...

Tani mua po më qëndronte mendja te djali dhjetëvjeçar i Francit, që nuk po kthehej nga deti. Ne e morëm të pushonte me ne djalin e Francit, sepse tani që Franci ndodhej i shtruar në spital, nëna nuk e linte dot vetëm në shtëpi.

-...nuk pretendoj se...,- po fliste holandezi, por unë nuk po e ndiqja më. Nuk më interesonte shumë filozofija e tij. Atë çast pashë Noelin, që kapërceu rrugën, duke ma bërë me dorë.

- Sa vjeç është?- më pyeti Kori.

- Dhjetë!- i thashë.

- E ke të afërt?

- Jo, asgjë! Por babain e tij e kam shumë mik...E mora me vete, sepse i ati është i shtruar në spital...

- Rëndë?- pyeti Kori.

Unë i shpjegova se i ka shumë të prekura mushkëritë.

- Ka qenë 15 vjet në burg, në kohën e diktaturës, sepse fliste në shkollë kundër pushtetit dhe grisi fotografitë e diktatorit. Ne ishim maturan të, në një bankë, kur e futën në burg. Doli në fillim të vitit 1991, kur u vendos demokracia në Shqipëri...Këtë fëmijë e ka lindur në burg...

Noeli po vinte dhe unë e ndërpreva bisedën. Kisha përshtypjen se ky fëmijë nuk donte ta kujtonte burgun e babait.

- Gjeta fiq!- briti ai me sytë që i ndrisnin nga lumturia, duke na zgjatur kapelen e tij të mbushur plot me fruta të errëta.

- Noel, mos hyp në fik,- e këshillova unë,- sepse, po re nga fiku, ngelesh sakat për gjithë jetën!

- Jo,- më tha ai,- ishte fik i ulët dhe unë i mblodha kokrrat nga toka...

Ishte djalë i pafjalë, me vështrim të zgjuar dhe një lëkurë të pastër-të pastër, si mëndafsh. Vinte hollak e i gjatë. Me siguri do t'i ngjante Francit, kur të rritej, atij Franci që, kur e morën në burg, mezi e lidhën tre policë.

Mua më duhej të përfundoja një letër urgjente. I lashë Noelin me Korin dhe vetë u ula në tryezën në cepin lindor të tarracës, nga shtrihej qyteti mes ullinjve. Me një vesh i dëgjova që filluan të bisedojnë anglisht. Noeli fliste një anglishte të pastër. Ai studionte në një kolegji amerikan, që trajtonte me përparësi fëmijët e njerëzve të dënuar politikisht gjatë regjimit të Hoxhës, por Franci më kishte shpjeguar se Noelit nuk i pëlqente ajo shkollë. Ndoshta atje i kujtohej shpesh burgun...

- Të ka treguar babi për burgun?- po e pyeste Kori.

Djali shihte këmbët.

- Babi nuk ka qejf të flasë për burgun,- u përgjigj më në fund me zë të mbytur.

- Pse hyri në burg?- këmbëngulte tjetri.

Ai ishte kurioz të dëgjonte histori të rralla, që në Shqipëri i hasje me kuintalë.

- Për politikë,- ia ktheu djali, gjithë duke e larguar vështrimin nga tjetri,- po burgu për burrat është!- shtoi çditërisht në fund.

Kori e pa i habitur.

- Të gjithë do hyjnë në burg,- shpjegoi Noeli.- Ja, tani që po flasim ne të dy, në burg është edhe ish-Presidenti Alia, edhe më i madhi i opozitës, Fatos Nano...

- Pse i kanë futur në burg?- bëri të paditurin Kori.

- Kot!- tha Noeli.- Ata as kanë vjedhur, as kanë vrarë...Edhe babi im nuk ka qenë as hajdut, as kriminel!...Domethënë, burgu këtu është ndryshe nga burgu në Holandë. Këtu gjen kë të duash brenda. Babi im thotë nganjëherë se burgu shqiptar është si një qytet i vogël, që i ka të gjitha: doktorët, mësuesit, nxënësit, policët, shoferët, deputetët, ministrat...

- Jo, te ne është ndryshe,- u pajtua me të Kori.

Ai deshte të shtonte diçka, por Noeli e ndërpreu, kur kërcëu gjithë pasion:

- E shikon! Prandaj as babit, as mua nuk na pëlqen të themi se babi ka qenë në burg!...Për njerëzit, kush hyn në burg, është rob i keq...

- Jo për të gjithë!- e ngushëlloi Kori.

Noeli e pa mosbesues.

- Ç'më thua, o xhaxhi holandezi,- tha ai gjithë përçmim,- babi im thotë se, kur më kujtohet që kam qenë në burg, më duket vetja njeri i keq, megjithëse e di shumë mirë se nuk kisha faj!...Tani, më fal, po duhet të mbaroj pikturën, që nisa në drekë,- tha Noeli, duke u drejtuar nga një tabak i madh letre, që po e mbushte me kama, kafka, gjak e abstraksione. Dukej se nuk po e merrte shumë malli të pikturonte, por nuk dinte si ta hiqte qafe atë bisedën aspak interesante për atë.

U shtri në tarracë, ia nisi pikturës dhe nuk u ndje më. Në darkë, kur ne po pinim nga një birrë, ai erdhi dhe na i tregoi kryeveprën e vet. E kishte prerë gjithë atë tabak, nja një metër me një metër e gjysmë në formë zemre dhe, kur na i shtriu te këmbët, gruaja ime tha:

- Na fute tmerrin, Noel, me gjithë këto kafka!

- Bota është plot me kafka!- deklamoi Noeli.- Kjo e prera në formë zemre tregon se bota ka shpirt...

- Po kafkat pse pikojnë gjak? Ato sikur nuk kanë gjak?- e pyeta unë, më shumë për ta ngacmuar, megjithëse po më tërhiqte mënyra se si ishte kompozuar gjithë ajo pikturë naive.

- Vërtet janë fosile.- shpjegoi ai, duke më treguar shkoqur, që nuk hynte në kategorinë e injorantëve.- por gjaku tregon se krimi vazhdon! Është, si punë, si i thonë?...

- Simboli!

- Tamam!- tha Noeli, pa ia ndarë sytë kryeveprës së vet.

Edhe Kori nuk po ia ndante sytë letrës të mbushur plot me naivitete e primitivizma në sfond, ku mund të gjeje plehra, varreza, xhami, kryqe, shtëpi të rrënuara...

- Po këto, pse i ke bërë?- pyeti ai, duke treguar me gisht nga ai sfond i stërmbushur me shkarravina të rrëmujshme.

- Bota është si rrëmujë, nga krimi...- tha Noeli.

- Mos do të thuash kaos?- pyeti holandezi.

- Bravo, kaos!- miratoi Noeli.- Që kur po pikturoja, nuk po e gjeja dot këtë fjalën! Faleminderit!- shtoi.

Ne e pamë edhe një kohë atë fantazi e mendim fëminor, pastaj Noeli na pyeti:

- Si iu duket?

- Mua më tremb,- tha gruaja ime.

- Mua më pëlqen,- thashë unë,- po duhet t'ia tregojmë ndonjë piktori, që kujton nga këto gjëra...



- Po ma shite, unë e ble!- tha Kori.

- Ta kam falur!- ia ktheu Noeli.- Merre!

- Mirë,- pranoi Kori,- por lekët e pikturës unë po t'i jap ilaçe për babin, nga më të rejat që ka sot në botë për mushkëritë!...

- Dakort!- kërceu Noeli.- Recetën ta jep xhaxhi Dori!...

E mbështolli pikturën me ngut, a thua kishte frikë mos Kori ndërronte mendje dhe e linte pa ilaçet e Francit, pastaj ngriti befaz sytë e kthjellët dhe pyeti me një zë gjithë ankth:

- A thua do shërohet? Ai është dobësuar shumë... Tani mezi e njohim unë me mamin...

- Do shërohet,- tha Kori,- vëllai im ka qenë më keq se babi jot, po tani punon dhe luan futboll!...

- Mos e eksagjero!- tha Noeli i mërzitur.

- Noel,- pëshpëriti gruaja ime.- Hajde, këtu, të të shpjegoj një të vërtetë të madhe!

Ajo e mori djalin në prehër, e puthi në flokë, pastaj i shpjegoi me një ton të butë, por të padiskutueshëm prej mësuesi me përvojë:

- Asgjë nuk quhet e eksagjeruar, po të ketë brenda saj të vërtetën e madhe! Franci vërtet mund të mos luajë më futboll, por e rëndësishme është se ai do të shërohet...

- Dhëntë Zoti!- uroi Noeli, në kohën që një yll u këput e ra nga pasqyra e kulluar e qiellit.

Ai e pa atë yll dhe iu duk se ylli i tha "jam edhe unë dëshmitar i së vërtetës!", sepse menjëherë na uroi i lumtur "natën e mirë" e ia mbathi në shtrat, ku do shihte kush e di ç'ëndërr të bukur me të atin.

- Ti, kishë të drejtë, kur këmbëngule se shqiptarët dominohen në thelb nga perspektiva,- e theu befaz atë heshtje të rëndë Kori.- Por gjendeni në kaos,- shtoi me një ton të ftohtë.

- Si të gjithë,- thashë unë,- vetëm se këtu është një kaos i pa kamufluar...

Gruaja ime shtoi se këtu nuk ka shtet dhe kështu shpjegohet gjithçka, pastaj u ngrit që të na servirte nga një birrë tjetër të ftohtë. Ajo hapi edhe një shishe për vete. Nga ai qiell i kulluar gushti këputeshin yje papushim, si kokrrat e gështenjave të egra, kur frynte erë. Mua më shtrëngonte diçka si punë trishtimi në fytyrë për Francin. Boll kishte vuajtur ai njeri në këtë jetë monotone, dreqi ta hante!...Kori pinte birrë dhe kundronte pa folur pikturën e rihapur të Noelit, kurse gruaja ime largonte herë pas here me një degë fieri mushkonjat nga pulpat e saj të xhveshura.

- I hëngërt kanceri këta njerëz që fusin dynjanë kot në burg!- e shfryu dufin më në fund ajo.- I kanë bërë fëmijët me hije...

- E keqja duhet parë, që të luftohet,- filozofova në tym unë.

- Në një natë të tillë, në Hollandë ka qindra vetëvrasje,- tregoi Kori. Dhe shtoi i lehtësuar:

- Unë ia hodha edhe këtë herë!...

Po a do t'ia hedhim gjithmonë këtij shpëtimi, pyeta me vete gjithësinë, që rreshte papushim një shi magjik yjesh të ndritur. Një gjë është e sigurt, shtova në mënyrën më absolute, si një idiot i lindur: Të keqes, o ia ha kokën, o ta ha kokën! Bashkëjetesë nuk ka! Dhe, për herë të parë, më shkoi mendja si turbull te zbulimi, që, njerëzimi njeh shumë mirë gjërat e stërkomplikuara, por thajse nuk i njeh fare gjërat e thjeshta, si, përshembull, nga të vjen ngordhja...

**NËNTOR, 1996**

## GJITHMONË, MË 29 TETOR

- Hajde, Xhavit, vëllaj!- do thërrasë Françesku, duke i bërë tjetrit edhe një ftesë plus me dorë. Kështu ndodh gjithmonë, sa shfaqet në derën e Bar "Evropës" figura mjerane, komike dhe e rraskapitur bashkë e Xhavitit.

Ky dialog zhvillohej një herë në vit, çdo 29 tetor, dhe ne të gjithë tashmë e dinim, se ata, pasi të pinin te tryeza pranë fasadës prej xhami nga dy kafë, do hanin një drekë luksoze te restoranti i peshkut, mbrapa Barit. Pastaj Xhavitit do harrohej dhe do të bëhej i gjallë fiks pas një viti, aty nga ora njëmbëdhjetë. Kishte dymbëdhjetë vjet që ndodhte kështu!

Françesku është një biznesmen i suksesshëm, që fiton gjithmonë, duke zbatuar moton e tij të preferuar "më mirë si miu, se sa si ariu!"; Xhavitit është bojaxhi me emër, por që tani mezi gjen punë, sepse vitet e gjata në këtë profesion e kanë këputur në kryqe. Po të marrësh parasysh se Françesku është tip me sqimë e aspak sentimental, ky çift miqësor të habit tej mase. Por ata lidhen diku bashkë: Kanë qenë të dënuar politikë të dy në një burg. Xhavitit pesëmbëdhjetë vjet, Françesku njëmbëdhjetë dhe janë liruar në një ditë. Nga ajo ditë e paharruar ata takohen vetëm një herë në vit, ditën e lirimit, më 29 tetor. Kjo hyn në psikopatinë e tyre respektive, të cilën Françesku e përcakton me zemërgjerësi: "Shyqyr që na la Zoti vetëm me kaq!"

- Si i ke fëmijët?- e pyet Françesku, me t'u ulur tjetrin.

- Ca brenda e ca jashtë,- ia kthen Xhavitit.- Po ata të tutë?- pyet ai duke ndezur cigaren e lirë e që të çpon hundët me atë kudërbimin e rëndë, në çastin që i sjellin kafënë.

- Edhe dy "Marboro"!- urdhëron Françesku kamarierin.- Rriten!- i kthen përgjigje pastaj Xhavitit.- I madhi në shtëpi, i vogli te vjehrra...

Nuk shkëmbejnë fjalë një kohë. Tani të dy janë duke menduar pak a shumë të njëjtat gjëra. Kujtojnë fundin e dënimit. Janë duke lyer një mur të gjatë-të gjatë në oborrin e burgut, një mur i ndërtuar për të mos i lejuar të burgosurit të shohin ç'bëhet përtej telave me gjemba. Xhaviti po lye qetësisht murin me furçë. Kështu ka urdhëruar komanda: dy duar me furçë, një me pompë në fund!...

"Kam parë një ëndërr mbrëmë,- ia nis si pa të keq Françesku.- sikur dolëm në një ditë nga burgu..."

Xhaviti i bie të lirohet një javë para tjetrit.

"Të hëngërt goja mut!", përgjigjet ai, duke vëzhguar si ka marrë boja në mur.

Nuk jeton dot më asnjë minutë në këtë ferr! Tani numuron edhe orët! I ka ardhur shpirti në majë të hundës dhe syrin e ka të prerë, nga që nuk ve prej ditësh gjumë në sy...

Françesku kukuris.

"Pse e prish gojën, o vlla?!- bën të habiturin ai.- Unë për të mirën tënde e kam! Sa t'i marrësh malet më këmbë e të të çajë ndonjë ujk, të çon vëllai si kont me taksi deri në Milot...Me veturë, po! Pa lek, po! Unë do t'i lutesha vetë komandës të ma shtynte lirimin edhe një javë!..."

"Të hëngërt goja mut!", përsërit Xhaviti pa ia ndarë sytë murit...

- Ama, mut e ke pasur atë gojë, o Çesk!- e thyen befas heshtjen Xhaviti, ndërkohë që tjetri po kundron me keqardhje rrënimin fizik të mikut të vjetër. Tani brenda skeletit të thatë nuk ka mbetur asgjë nga gjithë ai vetëmohim i atëhershëm.

Xhavitin vërtet e mbajtën një javë më shumë në burg atëherë. Ia bënë llogaritë gabim fakirit...

- Më fal!- i lyp ndjesë si gjithmonë Çesku.- Ku e dija unë se ata derra nuk dinin as të numuronin!

Xhaviti i bën një shenjë me dorë mos mërzhitet shumë, pastaj të dy pushtohen sërish nga kujtimet e asaj dite të parë në liri. Shohin vetveten, duke dalë nga ai ferr i rrethuar me tela gjëmboçë anash e sipër kokës, a thua kishin frikë mos hynte dielli a ndonjë zog në territorin e shenjtë të burgut. Nga hutimi, Xhaviti ka harruar në burg çantën e shpinës me ca rreca e kujtime brenda, po nuk ia mban të kthehet e as ka burrë t'ia mbushë mendjen. Ia flakin çantën gardianët te këmbët, duke e sharë e mallkuar dhe ai, si e rregullon çantën pa fjalë çapitet në rrugë para Çeskut.

- Shpirti ma di, si e kam bërë atë copë rrugë!- thotë ngadalë Xhaviti.

- Mua më habiti kampi, kur e pashë nga jashtë!- i thotë Çesku.

- Unë e ktheva kokën i pari! Ti nuk deshe ta ktheje kokën...

Xhaviti merr si përgjigje një "Po" të thellë.

- Nuk e kisha parë ndonjëherë nga jashtë atë vend...

- As unë.- ia kthen si gjithmonë Françesku.- mban mend si ishte? Si bunker! Xhaviti psherëtin. Tani ai do të thotë: "Mua m'u duk si arkivol!". Ashtu

përsërit vërtet.

Tani ai është duke kundruar, si atëherë, sy çapëlyer burgun. Në krah ka Françeskun, të ulur edhe ai në një pllakë të verdhëlleme. Përtej telave vijnë vërdallë gjithë zhurmë një tufë korbash. Atje janë varrezat kolektive të burgut. Natën toka lëshon një si dritë të argjendë.

Xhaviti dënes rëndë.

“Mbaroi tani!”, i thotë Çesku.

E mban në gjoksin e tij të gjerë Xhavitin e vogël dhe nuk e lëshon, derisa ai qetësohet. Më në fund Xhaviti e mbledh veten.

“Kush e di se ç’fat na pret tani?”, pyet përhumshëm, duke parë këpucët e shqyera.

“Do mendojë më në fund Zoti dhe për ne,- i jep zemër Çesku.- Ty,- shton ai,- Zoti ka me të dhënë për grua një kurvë të mirë me katër kalamaj!...”

“Të hëngërt goja mut!”, uron sërisht Xhaviti, duke u ngritur. I dhembin sytë nga pamja përballë dhe merr rrugën i pari drejt klubit...

- Gojë plehrë kishe, o Çesk!- rizgjohet sërisht Xhaviti.

Çesku porositi kafetë e dyta.

- Lere, mos e pyet!- thotë Çesku me një pamje fajtori, duke kujtuar martesën e Xhavitit, atë dasëm të çuditshme me katër njerëz: Xhavitin, Çeskun, Arjanën dhe vëllain e Nandit të shkretë, ish-burrit të Arjanës, që e vranë pa iu dridhur dora, si qen, në revoltën e Spaçit. Atë natë më shumë fshinë lotët, se sa u gëzuan...

- Çudi si u lidh ajo martesë!- thotë Çesku.- Edhe, hajde, mos iu beso profecive pastaj!

Xhaviti bën një gjest pohues, duke rrudhur buzët e vogla e duke mbledhur supet e ngushtë.

- Shkova për t’i çuar Arianës plaçkat e Nandit të shkretë dhe ngeca!- thotë ai.- Për shpirt të plakut, Çesk,- betohet ai,- m’u dhimbs, kur e pashë me tre kalamaj nëpër këmbë, duke i rënë kokës me grushta para plaçkave të Nandit!...Herën e dyta shkova për t’i lyer pa lek shtëpinë...Duhej bërë edhe ajo punë, ishte si biçim amaneti!

- Kush e bëri shkesinë?- pyet Çesku sa për t’u gjetur në muhabet.

- Naimi! Ai ia nisi si me shaka: pse nuk e bën edhe ti, si Profeti Muhamet, o Xhaviti! Merre për grua vejushën e shokut tënd të ngushtë, që mos vuajë akoma...Aq duhej! E kush më merrte mua? Biografia-sterrë! Xhepi-bosh! Basareti-si i bukuri shejtan!...

- Mos e ki pishman!- i jep zemër Çesku.- Zoti mbarë ka për ta bërë! Këtu do jemi!

Ai vetë është nun i djalit që lindi nga bashkimi me Arianën. Ia vuri emrin LEK, që ta bëjë Xhavitin me lekë, shpjegoi atëherë, kur tjetri po shfrynte se nga

katoliku veç emra katolikësh prit!...

Tani djali është dhjetë vjeç. Një djalë vërtet i bukur, por i trishtuar.

- Fëmijë!- e ngushëllon Çesku.

Kjo fjalë iu kujton të dyve çudinë më të madhe që ndjenë, sapo dolën nga burgu: kur panë dy fëmijë të rreckosur në klubin e minierës. Ishin fëmijët e shitësit. Ata shqyen sytë, duke i rënë me bërryl njëri-tjetrit. I patën harruar fare këto krijesa të njoma. Iu dukej vetja sikur ndodheshin rastësisht në një planet të huaj.

- Banakieri e mori vesh si qe puna,- i thotë Françesku, duke kujtuar qerasjen e tjetrit me dy dopio konjakë e dy kafë të forta dhe atë urimin domethënës: "Mos ua pafsha më sytë këtej!"

- Sa kishte parë si puna jonë ai!- thotë Xhaviti.- Atij i qe bërë syri gëlqere me ne!

Të zhytur në ato histori drithëruese, ata kujtohen më në fund të shohin orën. Është ora tamam për të filluar drekën e gjatë. Çesku ka porositur që një ditë më parë makarona me fruta deti, levrekë kiloshë të pjekur me kripë dhe dy aragosta të mëdha. Ngrihen duke shpirë trupin dhe nisen për në restorantin pranë. Rrugës Çesku i fut ca lek në xhep Xhavitit. E di mirë që tjetri do të protestojë, por ai ia mbyll gojën shpejt me të folurën e tij mospërfillëse:

- Bliji diçka Lekës nga unë! Po mos harro!...

Ne restorant është qetësi. Ata janë klientët e parë. Të duken si dy personazhe filmi: njëri i veshur kokë e këmbë me "Valentino", tjetri me firmën GABI dhe me copë gëlqere nëpër flokë e duar.

- Ik, laj duart, se ma shpife!- i thotë Çesku nën zë.- Dhe mos e vidh sapunin!- e paralajmëron.

Pastaj ngre zërin gjithë qejf drejt kryekamariert elegant:

- Me vrap, djema, si të marrë, se ka ardh' Xhaviti i parë!

Kamariert vërsulen drejt tryezës së Françeskut. Do ketë punë dhe bakshish të majmë sot!

- Çesk, kush është ky Xhaviti?- pyet një kamarier i ri, që nuk ka shumë muaj në këtë lokal.

- Ky është gjak mbreti!- deklamon gjithë qejf Çesku.

Ai e përqafton edhe një herë Xhavitin, që tani mban erë sapun tualeti, ia puth sytë e butë, pastaj iu kthehet gjithë qejf pjatave. Çesku ruan respekt për mbretërit. I duken njerëzit me ADN-në më të përsosur në botë. Dhe është fare i bindur që edhe Xhaviti duhet ta ketë origjinën nga ndonjë rrjedhje moskokëçarëse sperme mbretërore, në ato orgjitë e pëlqyeshme e të praktikueshme thujse nga të gjithë. Nuk ka njohur njeri më fisnik se ai në burg, atje ku krijesa më humane egërsohej e transformohej pa kuptuar as vetë në përbindësh.

- Ha!- i lutet ai Xhavitit gjithë mirësjellje.

Xhaviti po fshin një pikë lyre, që i ka rënë nga makaronat në pantallonat e tij qelbësirë.

- Pa fat ngela gjithë jetën,- psherëtin ai,- po unë pikohem gjithmonë!

- Gjynah,- nis e tallet e Çesku.- Bëre pis pantallonat e reja...

Pastaj ndërron ton:

- Sa të kesh Çeskun tënd, mos çaj kokë!

Xhaviti nuk ia ndan sytë vendit të lyrosur, që nuk ka shtuar asgjë në sasinë e pisllekut të pantallonave të tij.

- Çfarë dite është sot?- pyet befas.

- E martë!

- Ah, kur nuk është e shtunë!- psherëtin.

- E ç'punë të prish e marta apo e shtuna, ty?- e pyet Françesku.

- Kisha qejf të bëja një dush!- ia kthen tjetri.

Çeskut i dalin makaronat nga vrimat e hundës prej të qeshurës.

- Ah, po, ti, je flori, o Xhavit, vëllai!- i burojnë nga shpirti fjalët Çeskut.- U bëfsha mut, që nuk më ka shkuar mendja të të ble një dush të mirë!

Xhaviti i bën një shenjë me dorë, që përktthehet mes tyre "lere atë muhabet!"

- Për mua rroftë kanoçja,- shton me gojë ai.- Të rri e të paguaj edhe korentin e dushit! Apo nuk ta masin kokën me pe këta sahatët e rinj, që s'ka burrë nëne t'i ngeci!

Çesku bie përmbys nga e qeshura mbi tryezë. Ai ngre duar e sy lart. Tani do betohet!

- Për atë Krisht, që po më ndih, dushin do ta ble që nesër, do dërgoj njerëz ta montojnë, do ta paguaj unë korentin, derisa të dalë Leka në punë, se është krim, që një qelibar si ty, të jetë i palarë nga jashtë!

Zëri nuk i duket si i veti. Është një zë thellësisht i sinqertë. Nga ky zë Françeskut cinik me botën i vjen për të qarë. Vdekja i duket lule përpara harresës...

## PA EMËR

- Mua nuk më besohet që jam në shtrat me ty!

- As mua!- tha Martini.

Ai kishte ndezur cigaren dhe po kundronte format e lakuara të trupit të tjetrës. I bënin përshtypje gjinjtë. Qenë të plotë e të fryrë mbi një kraharor elegant si prej balerine. Ishte njohur me Megin dy ditë më parë në rrugë. Ajo e kishte thirrur gjithë emocion nga pas, ai qe kthyer duke e kundruar plot kërshtëri bukurinë e panjohur, patën pirë një kafe bashkë dhe tani gjendeshin gollomesh në shtrat.

- Ëndërr e kam pasur të të takoja, pale më të bëja dashuri me ty!

Martini artikuloi pa asnjë redaktim atë që po mendonte:

- I paske ëndrrat idiote!

Tjetra qeshi mbytur dhe i ra lehtë me grushtin e saj të brishtë në sup:

- Duhet të kesh më shumë respekt për veten tënde! Ti, hyn në racën e të talentuarve!- e këshilloi, duke iu rrasur si mace në trup.

Martini nuk denjoi t'i përgjigjej. Ky muhabet i dukej koti, jo ke talent, jo s'ke talent! Ç'rëndësi ka, kur po mbushet viti pa shkruar as edhe një rresht, mendoi ai. Ke një diamant, por të mungon floriri. E bën dot unazë? Jo! Hidhe në plehra!...

E ktheu Megin përmbys dhe filloi t'i kundrojë shpinën e lëmuar e të plotë prej vajze, që përmbledhej nga një pëllëmbë e vetme në mes e që rihapej me një kërcim rrethor te vithet. Ai ia fërkoi lehtë lëkurën, si të deshte t'i fshinte pluhurin, pastaj u zgjat drejt xhaketës të flakur te këmbët e shtratit dhe, si mori stilolapsin, ashtu përhumbar papritur nisi të shkruajë me një kaligrafi të rregullt në shpinën e vajzës:



*Një sy,  
Një klithëm,  
Një ikje,  
Një dimër.  
Dita  
Kot.  
Kujtesa  
Plot...*

Tre pikat e vendosura me kujdes, a thua aty qëndronte thelbi i krijimit, e rrënqethën Megin. Kur ai e hodhi mbi tryezë stilolapsin, ajo u ngrit ngadalë, a thua druhej mos i binte ndonjë gjë nga trupi. Qëndroi para pasqyrës dhe u përpoq të lexonte ç'shkruajti Martini. Mirëpo nuk mundi. Atëherë ia lexoi ai ngadalë. Pastaj u ngrit të korigjonte një varg dhe, meqë nuk gjeti vend në shpinë, doli me një shigjetë në mollaqe. Megi e la të mbaronte, duke qëndruar si statujë në këmbë. Kur ai mbaroi, ajo ishte e përlotur.

- Tani duhet të iki!- tha.- Nuk besoj se të mbetet hatri!

Ajo studionte në Peruxhia të Italisë për manaxhim arti dhe një Zot e dinte nëse do të kthehej më në Shqipëri apo jo. Do nisej mbasdite me traget.

- Kur të kthehesh, më bëj një telefon,- i tha Martini formalisht, duke e përcjellë te dera.

- Edhe, ti, po erdhe në Itali, më kërk,- ia ktheu ajo e lumtur nga paraditja magjike e përkujdesja e yllit të saj dhe kështu u ndanë, me kujtime të mira për njëri-tjetrin e me ca shenja respektive kafshimesh në trupat e tyre.

Për Martinin rifilloi rutina e parë, klub-shtëpi, birra-verë, ajo rutinë që ishte si një gomë magjike gjithçkafshirëse.

\*

Megi i shkruante hera-herës Martinin ndonjë letër, ku vështirë se merrje vesh gjë në gjithë atë rrëmujë fjalish, përveçse "jam mirë" dhe "ke shkruajtur ndonjë libër?" Martini përtonte t'i përgjigjej. Ai letrat i shkruante, mirëpo e kishte bezdi të kalonte andej nga posta. Kush blinte pulla, zarfa e dreqi me të birin? Dhe e linte fare atë punë, duke u kufizuar me dërgimin e ca të falave spontane, apo ndonjë pusulle, me anë të të njohurve të tij, të cilëve u binte rruga në Peruxhia. Mirëpo mbas nja një viti nga takimi i parë e i fundit i tyre, ai u nis për në Bari, ku zhvillohej një konferencë e shkrimtarëve të vendeve që lagte deti Adriatik. Bëri gati një copë letër që në Tiranë dhe, me të arritur në aeroportin e Barit, ia dha shoqëruesit

italian, duke iu lutur t'ia postonte Megit. Atje ai i dërgoi tjetrës adresën e hotelit, ku do të flinte, dhe në fund kishte shkruajtur shkurt: "Në këtë hotel do qëndroj një javë. Po deshe, më bëj ndonjë telefon. Martini"

Megi e mori të nesërmen. Sa nuk po çmendej, që nuk vinte dot në Bari. Nuk e braktiste dot shkollën.

- Hajde, ti, nja dy ditë në Peruxhia,- iu lut ajo,- pastaj, të shtunën, zbresim të dy në Bari...

- Po munda të shkëputem, do vij!- i tha Martini.

- Hajde!- iu lut ajo.- Biletën e trenit ta paguaj unë. Hajde, shiko edhe Peruxhian, është qytet vërtet i bukur...

- Do bëj çmos,- e qetësoi Martini më shumë për të larë gojën, mirëpo të nesërmen ai u mërzit me ato dokrrat e konferencës dhe pa e menduar gjatë bleu një biletë treni për në Peruxhia. Kur i tha Megit në telefon se ndodhej në qytetin e saj të mrekullueshëm plot vjetërsira, ndryshk dhe myshk, ajo uluriti si e marrë nga gëzimi. Ai qe shtruar e po darkonte për shtatë palë qejfe në një restorant të mirë i mirë ndoshta sepse ndodhej m'u në qendër të qytetit, se veç ca ullinjve verdhoshë gjë tjetër të veçantë nuk kishte, dhe Megi iu lut mos lëvizte prej andej.

- Qameti, për njëzetë minuta jam atje!- tha ajo.

Dhe nuk u vonua vërtet.

Martinin e habitën lotët e tjetrës. Ata nuk kishin asnjë lidhje, qoftë edhe të largët me njëri-tjetrin, përveçse një të shkuare formale, thjesht për hobi, nga ana e saj, dhe për ndërrim gjelle e mosprishje qejfi, nga ana e tij. Kurse Megi tani i qe varur në qafë dhe vetëm qante si idiote!

- Po qave, u ktheva në Bari!- kërcënoi Martini, që kurrë nuk i kishte duruar lotët e femrave. I dukeshin si ujë çezme, aq lehtësisht ia merrnin të qarit!

- Mirë, mirë, nuk qaj më!- i tha ajo, duke iu ulur përballë pa ia ndarë sytë.

Megi e kishte dashuruar Martinin gati dy vjet më parë, kur lexoi romanin e tij të njohur "Një mëngjes i errët" dhe nga ajo ditë ajo nuk pranoi të verë shkrimtar tjetër para Martinit. Edhe pyetja e parë, që i drejtoi idhullit të saj, ishte nëse kishte shkruajtur ndonjë gjë?

- Shterpësi!- ia ktheu Martini. Dhe shtoi duke kundruar një peizazh të shpëlarë në mur: E kush e ka mendjen tani në Shqipëri të letërsia? Atje tundin këmbët për pak politikë...

- Injorantët!- shfryu Megi.

Pastaj iu lut tjetrit të ngrihet.

Apartamenti i Megit iu duk i ngrohtë, por ai u befusua veçmas nga një fotografi e stër-madhe e varur në dhomën e Megit, sipër kokës së shtratit të saj. Ai nisi të qeshë me të madhe. Dikush e kishte fotografuar Megin lakuriq nga mbrapa dhe fjalët e poezisë të shkruajtur dikur prej tij në trupin e lakuriqtë lexoheshin fare

qartë. Më shumë ai u shkri me atë korigjimin, i cili dilte me shigjetë te mollaqja e djathtë e Megit.

- Ti je idiote!- i tha ai, megjithëse tani fotografija i dukej tamam një vepër arti.

- Unë e di se si e kam bërë atë udhëtim me traget, që mos më prisheshin fjalët, sa të dilja në fotografi, se në Tiranë nuk e bëja dot...Edhe ajo më duhej!...Vesha një fustan pa asgjë poshtë, vetëm me mbathje të vogla e rexhipeta isha, dhe nuk u ula asnjë çast gjatë gjithë udhëtimit!...

Fotografija ishte vërtet e bukur, gjithë dritë e nga muri shpalosej një trup i mrekullueshëm vajzëror. Martini u ngacmua nga lëkura vetëtitëse dhe e tërhoqi Megin pranë. Filluan të puthen mirë e mirë, gjithmonë e me më tepër pasion. deri sa ngelen të dy lakuriq. Megit i ndjehej lumturiya, një lumturi e thellë, që ia mbylli sytë dhe ia shpërtheu rënkimet nga kraharori. Kështu kaloi kjo natë, plot fjalë të ëmbla, gjithë qeshje të gëzuara, deri sa i pushtoi pa kuptuar gjumi në krahët e njëri-tjetrit.

\*

Martini u zgjua vonë. Në apartament mbretëronte heshtja dhe sytë e tij, si ia nisën bredhjes nëpër sendet e dhomës, më në fund ndaluan në tryezë. Atje qenë vendosur me kujdes ushqime, cigare dhe një letër për të. Në letër Megi i lutej mos mërzhitej. Ajo do të kthehej në orën një e gjysmë nga fakulteti dhe do shkonin të hanin drekë në një vend të mirë. "Po nuk pate me ç'të merresh, shkruaj ndonjë gjë për mua!" mbyllej ajo letër, pa harruar një puthje idiote në fund, ku kishin ngelur gjurmët e buzëve të plota të saj të lyer me një të kuq si në rozë.

Ora ishte njëmbëdhjetë dhe në dush Martini filloi të vrasë mendjen si t'i shtynte këto dy orë e gjysmë, por, pasi hëngri diçka, ajo qetësi e ëndërruar për çdo shkrimtar, sikur ia mbushi mendjen të ulej një herë e të shkarraviste diçka. Kur u kthye Megi, ai sapo kishte përfunduar një tregim të çuditshëm: atje bëhej fjalë për një njeri, i cili i ka respektuar tradicionalisht vizat e bardha dhe semaforët në rrugë, por pikërisht atje një herë i ndodh një aksident, jo për faj të tij, natyrisht, që e le të gozhduar në një karrocë paralitikësh përjetësisht. Nga ajo ditë ai vendos të vrasë veten dhe tani nuk i respekton më semaforët e vijat e bardha, por aksidenti nuk ndodh, sepse të gjithë frenojnë, duke e sharë, te rrotat e karrocës së tij...

Megi e lexoi dy herë e heshtur tregimin dhe ngeli një çast e menduar.

- I fortë!- tha pastaj.

- Kam nja dy vjet pa shkruajtur prozë,- i shpjegoi Martini, më shumë për të justifikuar gabimet teknike që mund të kishte tregimi, por Megi tundi kokën mohueshëm:

- Për mua, është tregim fantastik! Ti je tregimtar i lindur!

- Ta kam falur!- i tha shpërfillshëm Martini.

Dhe e harroi tregimin. Ata ia mbathën për në restorant dhe ia nisën nga e para orgjive të tyre pa prishur qejf. Deri në fund të atij udhëtimit, Martini shkruajti edhe dy tregime të tjera për Megin.

- Bëj ç'të duash me ato,- i tha tjetrës, teksa përqafoheshin në stacionin e trenit të Barit, dhe vërtet që tani nuk i interesonte shumë letërsija. Merrej me gazetari dhe fitimet nuk qenë të vogla. Nga letërsija vetëm pak bukë me djathë haje në Shqipëri, me djathë të bardhë nga ai i liri!

- Faleminderit!- dënosi Megi.- Më ke bërë një dhuratë të mrekullueshme!...Mbase ta shpërblej ndonjë herë...

U ndanë. Megi ia nisi sërish letrave të saj përmalluese e çaprazçe. Tani Martini i kthente hera-herës ndonjë përgjigje plot satirë e humor, që tjetrën e bënin sakaq të lumtur, por këto raste nuk qenë të shpeshta.

Një ditë Martinin e thirrën në Ambasadën italiane. E priti me respekt një fytyrë-kuq nga konsumizmi i verës dhe i komunikoi se Martinin e kishin ftuar në Milano, pasi ai qe shpallur fitues i një çmimi të rëndësishëm vjetor për prozën e shkurtër.

Martini u habit. Ai nuk dinte të ishte përkthyer ndonjë tregim i tiji në italisht, por u kthjellua, kur iu kujtua Megi.

- Shpenzimet janë të palës italiane...Keni edhe një shpërblim të fortë për të marrë,- i shpjegoi italiani.

Martinit nuk i ndahej nga mendja Megi.

- Më duhet edhe një përkthyes,- tha ai më në fund, megjithëse fliste një italisht të pastër. Dhe afroi emrin e Megit.

Tjetri pranoi me kënaqësi.

- Nuk paguaj unë!- shtoi.

Pastaj, duke nxjerrë nga një sirtar romanin e Martinit, iu lut t'i linte një autograf.

Jashtë kishte filluar shiu. Martini nuk pranoi ta shoqëronin me makinë. Hyri në një bar pranë godinës së Radio-Televizionit dhe porositi vodka. Ca sy kuriozë e vëzhgonin, ca sy si të Megit, por ai u bë i pandjeshëm. Nuk ia kishte qejfi të fillonte ngatërresat nga e para me ca femra, të cilat të shihnin të habitura në gojë, a thua goja jote ishte një bythë pule, nga ku dilte veza e kuqe. Mendonte tani se si ishte ndërtuar ky drejqi fati njerëzor, duke kujtuar atë vargun e hershëm të nënullës klasike, ku nëna tund fëmijën, duke i kënduar: "...kush të do e kush të ka!"

Nuk i pihej, por porositi edhe një vodka tjetër. Vërtet, po filozofonte me atë mendjen e tij të çuditshme: kush na ka e kush na do!



## VETËM PËR DASHURINË!

1.

Farmacisti ishte një mesoburrë, që duhej të rrotullohej aty te të dyzetat. Fytyra e tij ruante një vështirim të butë. Kur nuk kishte punë, do ta shihje në prag të farmacisë së vogël, duke kundruar fushën rrangallë, gjithë makina të prishura, e cila shtrihej tamam para fasadës së farmacisë së tij dhe në perëndim bënte një kryqëzim të çuditshëm të diellit në shtyllën e tensionit të lartë dhe telat elektrikë. Nuk fliste shumë, por njerëzit e asaj zone periferike e respektonin, sepse ai merrte vesh edhe nga profesioni i mjekut dhe jo rrallë ata varfanjakë periferije, të papërfillur nga askush, i binin shkurt, duke u vizituar tek ai e duke shpëtuar kështu nga sorrollatjet pafund dyerve të ambulancave. Ai trishtohej nga mjerimi i këtyre njerëzve, që shpesh nuk bënin dot lekë as për të paguar ilaçet, por nuk fliste. I shihte kur kalonin para derës së farmacisë, ua bënte me dorë, atyre që e përshëndesnin, dhe gjithmonë mendonte vetëm kaq: njeriu, nëqoftëse vjen në jetë, duhet të ketë një fat më të mirë! Në thelb, ai nuk ishte as kundër divorcit, as kundër jetës.

Duke lexuar gazetën, atij i shkoi mendja sërisht te fati. Tani fati sikur po dilte në një or të dorës së dytë. Qenë shtuar vetëvrasjet, krimi po shkonte lart e më lart, kurse shteti heshte! Çudi, mendon turbull farmacisti dhe kush e di sa herë do ta përsëriste këtë fjalë çpuese, sikur mos kërciste dera dhe në pragun e saj të dukej klientja e parë. Ishte një grua-vajzë fare e re, me bukuri tunduese, që kalonte gjithmonë kryeulur para farmacisë. Farmacisti e dinte se ajo sapo ishte martuar në një dasmë të rrëmujshme plot të shtëna me një prej kriminalëve më me emër në këtë zonë periferike, që terrorizonte me bandën e tij gjithë prefekturën e Tiranës,

dhe e priti me bezdi tjetrën. Nuk dëshironte as t'iu fliste këtyre njerëzve me pamje komitësh e huqe kaçakësh pylli.

Gruaja e re hezitonte të fliste. Shihte e trembur përreth, po, dikur u trimërua.

- Ndjej dhembje,- tha më në fund, duke kullotur sytë nëpër raftet plot barna.

- Je vizituar?- ia ktheu ai me idenë për ta hequr qafe shpejt e shpejt, mirëpo u pendua.- Ku?- e pyeti pastaj.

Ajo vuri dorën në brinjë, nga ana e majtë e toraksit të saj.

- Këtu!

- Je vizituar?- përsëriti pyetjen krejt mekanikisht ai.

- Jo! Sot më filluan dhimbjet...Po të kesh mundësi...

- Hajde!- e ftoi me bezdi farmacisti, duke hapur një derë, që të fuste në një dhomë, të cilën ai e përdorte edhe si magazinë barnash, edhe si vend vizitash mjekësore.- Po unë nuk jam për këtë punë, moj zonjë,- shtoi ai.

Tjetra hyri e drojtur dhe u ul në një shtrat më çarçafë të pastër.

- Shtrihu!- e urdhëroi farmacisti, që atë çast po vishte dorezat e vizitës. Kohët e fundit edhe sikur i vinte ndoht t'i prekte me dorë këta njerëz.

Kur ai u kthye, ajo qëndronte e shtrirë. Farmacisti i ngriti këmbësh bashkë më kanotieren dhe u befasua, kur dalloj një hematomë të madhe në brinjë, paksa nën gjinj.

- Ku je masakruar kështu?- pyeti ai.

- U rrëzova mbrëmë nga shkallët,- belbëzoi ajo, mirëpo atij i zunë sytë edhe ca shenja në qafën e bukur të tjetrës.

- Nuk je rrëzuar,- tha me ton pajtues ai,- ty të kanë rrahur, se shkalla nuk ka mbërthyer njeri për fyti deri më sot,- shtoi.- Apo jo?...Priftit, avokatit dhe mjekut i tregohet vetëm e vërteta!...

- Ç'rëndësi ka, jam rrëzuar, apo kam ngrënë dru,- belbëzoi ajo.- Puna është se kam shumë dhembje, mezi marr frymë...

- Rëndësi ka, që mos vdesësh fare nga druri nesër,- ia ktheu farmacisti,- por, vërtet, kjo nuk është puna ime!...Secili e zgjedh vetë mënyrën e vetëvrasjes. Unë vetëm desha të të them, se egzistojnë edhe mënyra të tjera më të mira për të vlarë veten!

Ai ia nisi pastaj mjekimit të tjetrës, e urdhëroi mos ngrihej tre ditë nga shtrati, i kujtoi se pas tre ditësh ajo duhej të vinte përsëri dhe e përcollti deri te dera. Atje u kujtua se duhej ta regjistronte dhe e pyeti si quhej.

- Rajmonda Bisha,- tha tjetra,- jam 22 vjeç!

Në duar bishash ke rënë, mërmëriti me vete ai, duke vështruar ecjen e ngadaltë pak si pjerrtas të tjetrës. I erdhi vërtet keq për këtë njeri të masakruar, por nuk pati kohë të merrej gjatë me problemet e saj.

Dy ditë më pas te dera e farmacisë ndaloi me zhurmë një veturë luksoze. Dikush ia pati ngulur sytë nga vendi i shoferit farmacistit dhe priste pa ngut tjetrin të ngrinte kokën e ta shihte. Kur farmacisti hodhi sytë nga rruga, ndeshi me vështrimin e njeriut në timon. Ishte burri i Rajmondës, një fytyrë e keqe, gjithë vraga plagësh, si një shesh beteje pas luftës vendimtare.

- Ke ndonjë hall?- e pyeti farmacisti me një ton pa ngjyra, por nga brenda u drodh.

- Jo, thashë mos kishe, ti, ndonjë hall,- ia ktheu tjetri me tonin e tij të vrazhdë.

- Faleminderit!- tha farmacisti.- Si është gruaja?- e pyeti pastaj.- Duhet ta vizitosh te ndonjë ortoped, se unë nuk jam specialist për atë punë. Mund të ketë frakturë...

Tjetri tundi kokën pohueshëm, kush e di ç'mendoi me atë kafkë të shtrembër, pastaj i dha gaz veturës e u zhduk si i marrë në rrugën gjithë gropa.

Farmacisti iu kthye sërisht sistemimit të barnave të reja pa marrë vesh se ku i flinte mendja tjetrit. As e vriste mendjen për atë kërmë, që nuk merrej vesh pse e linin rrugëve të lirë ata prokurorët e tmerrshëm të Republikës. Por, të nesërmen, kur në derë u shfaq Rajmonda, ai vuri re se atë e survejonte një vështrim i vëmendshëm nga ana tjetër e rrugës. Rajmonda e thithi gjithçka, duke ndjekur vështrimin e farmacistit.

- Është xheloz,- mermëriti,- dhe ka caktuar një njeri mbas meje. Ka frikë mos bëj dashuri me ty!

- Me këtë plagë që ke që brinjë, ti?! Ruajna, Zot!- qeshi farmacisti, pastaj e pyeti tjetrën si ndihej. Ajo merre frymë më lirisht. Farmacisti nuk luajti me nervat e përgjuesit. Nuk e futi Rajmondën në dhomën e vizitës, vetëm sa ia tatoi masën e dhembjeve me ca prekje të shkathëta të gishtrinjve mbi triko dhe e këshilloi tjetrën mos sforcohej edhe disa ditë.

- Duhet të vi prapë?- e pyeti ajo.

- Si ta gjykosh!- ia ktheu tjetri.- Por, që ta shoh gjendjen e plagës, nuk duhet të kesh roje nga mbrapa!...Me thënë të drejtën, nuk kam ndonjë kënaqësi t'i kem edhe unë plagët e tua në trup!...

- Ditën e mirë!- tha tjetra me një nënqeshje në buzë e u zhduk andej nga qe shfaqur, gjithë me njeriu-hije pas.

Farmacistin e habiti xhelozija e katilit. Dakort, xheloz kishte qenë edhe Kuazimodo, por ai nuk ishte xhelat! Kurse bisha i kësaj krijese të pambrojtur nuk ruante asnjë lidhje me veset njerëzore! Ku dreqin e kishte gjetur xhelozinë?!

Farmacisti thajse e harroi Rajmondën, por, pas nja dy javësh ajo u shfaq sërisht në derë. Këtë herë fytyra e saj ruante një pamje të qetë e të freskët, ç'ka ia

shtonte hirin.

- Ndoshta keni kohë të ma shihni plagën,- tha ajo, me një vështrim kurioz, që i bridhte si herën e parë po nëpër raftet e barnave.

- Ke marrë leje-vizite?- u tall farmacisti.- Sepse unë nuk vizitoj njeri, pa rekomandim nga prindi, ose bashkëshorti!...

- Ai ka një javë që është zhdukur,- belbëzoi Rajmonda,- se ç'ka bërë andej nga Durrësi dhe tani po e kërkon policija...

- Prandaj paska rënë lagjia në qetësi,- vërejti farmacisti, duke udhëhequr rrugën për në dhomën e vizitës.

Në dhomë binte një diell i ngrohtë. Rajmonda u shtri në shtratin vezullues dhe, duke pritur tjetrin sa të vishte dorezat, sesi iu rrotullua një gjumë.

- Mos i vishni kot dorezat,- e këshilloi butë farmacistin,- sapo jam larë dhe nuk kam vuajtur kurrë nga asnjë lloj sëmundjeje!

- Ngriji plaçkat!- i tha farmacisti, pastaj nisi të kundrojë njollën e plagës, tashmë të nxirë e të zvogëluar. Ishte një plagë në shërim. Ai vështroi gjithë kërkshëri barkun e sheshtë të tjetrës dhe zbriti dorën pa e kuptuar as vetë më poshtë, atje ku ndodhej mëlçija.

- Ke dhembje këtu?

- Pak,- iu përgjigj ajo.

- Po këtu?

Dora kishte zbritur edhe më poshtë. Tani mbi një pjesë të gishtrinjve qëndronte llastiku i të mbathurave të Rajmondës.

- Jo!

Farmacistit sikur po i ngrohej gjaku nga ai zë, i cili i përgjigjej përmes drithërimave. Ai ngriti dorën lart, gjithë duke i prekur lehtë, si tastierat e pianos, brinjët e tjetrës, pastaj ndaloi nën gjirin e majtë. E futi ngadalë mes gishtit të madh dhe treguesit atë masë të butë e të ngrohtë dhe ripyeti tjetrën:

- Po këtu?

Rajmondës po i merreshin mendtë. Edhe turp, edhe mirë i vinte.

- Atje më vjen mirë,- belbëzoi papritur mbytur ajo.

Dy çaste më pas, farmacisti ndodhej sipër saj. Rajmonda nuk ia refuzoi ledhet. Ajo e shtrëngoi në krahë këtë njeri të qetë e të sjellshëm dhe iu dorëzua pa as më të voglin veprim kundërshtues.

Gjithçka ndodhi shpejt, si në ëndërr, dhe Rajmonda, si u pastrua e rregullua me ngut doli nga dhoma pa folur asnjë fjalë. Farmacisti mbeti i habitur, duke kundruar rrugën nën një ditë pranvere gjithë diell. Ndjente akoma aromën e butë të Rajmondës dhe nuhati pa vetëdije rrobat e trupit. Që andej vinte një erë parfumi, një erë tunduese. Farmacisti po habitej me veten e tij. Po mbushte një dekadë e gjysmë në këtë zanat dhe kjo situatë nuk i kishte ndodhur kurrë! Nuk e kuptonte



se si qe tunduar e iu pat dhënë aq liri duarve të tij të bridhnin nëpër trupin e bukur femëror. Nuk ia ndante sytë rrugës së shkretë, të mbushur me gropa, ku njerëzit hidheshin si majmunë e ecnin si akrobatë. Ndoshta ka ardhur çasti që edhe unë të dorëzohem, mendoj turbull ai. Duhej gjetur një nuse...Dhe duhej gjetur sa më shpejt, sepse, po të vazhdonte kjo punë, ndonjë ditë do t'i gjente atij fati ndonjë burrë!...

3.

Farmacisti nuk e pa më për një kohë të gjatë Rajmondën. aq sa tani i dukej sikur mes tyre nuk kishte ndodhur asgjë dhe gjithçka ishte një sajese mendjesh të çoroditura. I shoqi i saj kishte dalë sërish në skenë dhe nëpër gazeta kronika e zezë ishte pasuruar dukshëm me gjak të freskët. Ai po lexonte një të dielë paradite në shtëpinë e tij pikërisht kronikën e një prej këtyre vrasjeve makabre, ku, me siguri, gjendej edhe dora e Bishës së Rajmondës, kur dëgjoi trokitje të lehta në derë. Mendoj se do të qe ndonjë nga fqinjët, apo dikush që kishte ngatërruar adresë, dhe u ngrit gjithë bezdi. Por u befasua, kur pa në derë Rajmondën.

Ajo i kishte lidhur flokët bishtalec dhe fytyra e saj shpaloste një pamje prej fëmije të trembur.

- Po, ti?- pyeti gojëhapur farmacisti, duke harruar t'i hapte rrugën.

Ajo e shtyu lehtë, hyri në koridorin e mobiluar varfërisht dhe tha me një zë të mbytur:

- E dija që, ti, banon këtu, sepse nëna ime banon dy pallate më tej. Ti nuk më mban mend, unë kam qenë e vogël atëherë, por mua më kishe ngelur në mendje...Sot erdha te nëna dhe thashë po trokas një herë...

- Po ku u zhduke kaq kohë?

- Ai do na vriste ne, po ta merrte vesh ç'ka ndodhur,- shpjegoi qetësisht Rajmonda,- ai është kriminel!

- Po, atëherë, pse erdhe?!

- Nuk e di...Erdha!...

Qëndronin të dy përballë në koridor, njëri i hutuar e tjetra konfuzë, pa ditur ç'të bënin.

- Nuk duroja dot pa të takuar,- shtoi ajo syllur.- Për natë të kam parë në ëndërr!...

Dy çaste më pas ndodhej në gjoksin e farmacistit. Puthte me një uri të pashpjegueshme tjetrin, duke ia zbërthyer me vull këmishën dhe rënkimet e saj mbushën hapësirën e ngushtë. Farmacistin e mahniti ai trup i përsosur femëror, të cilin nuk e kishte parë kurrë të xhveshur dhe humbi i gjithë nën magjinë e ledheve të tjetrës. Këtë herë ajo qëndroi gjatë në shtrati e madh. Nuk ngutej dhe nuk

dëshironte të largohej, pa marrë gjithë ç'përbante seksi i tjetrit dhe, sa herë ndjente rirforcimin e farmacistit, rënkonte e lumtur, duke lëpirë buzët e saj të plota. Pastaj, aty nga dreka, i shpërtheu një dënesë e rëndë. I foli tjetrit për fatin e saj tragjik, për mënyrën e dhunëshme se si ishte bërë gruaja e Agim Bishës, për kërcënimet e pafundme, deri sa nëna e saj ishte dorëzuar, më shumë për të mbrojtur dy vajzat e tjera më të vogla.

- Tani nuk kam më shpëtim nga ai kriminel,- rënkoj ajo, duke ndjellë hundët,- dhe askush nuk më beson!...

Farmacisti i ledhatonte flokët e gjatë të shpërndarë mbi cohen e bardhë dhe nuk fliste. Nuk dinte çfarë t'i këshillonte kësaj krijese hyjnore me lëkurë vetëtitëse e gjinj marramendës me thitha të vogla kryeneçe. I vinte keq për Rajmondën. I vinte dy herë keq, se ishte njeri dhe se ishte një hyjni e lakmueshme nga kushdo. Tani ajo duhej të përmirësonte gjenetikisht një racë bishash, te të cilët bukurija e mirësija nuk duheshin të qenë afuar prej dhjetë shekujsh. Ishte i bindur se as Herkuli me lumenjtë e tij e as Stalla e Avgjisë nuk jepnin garanci se diçka mund të pastrohej e ndreqej në gjithë atë pisllek të pashembullt. Por me gojë foli ndryshe. Nuk kishte kuptim ta luante mendsh këtë krijesë të pafajshme, të braktisur edhe nga Zoti vetë.

- Mbase diçka rregullohet,- shqiptoi ai, duke përkëdhelur gjinjtë gjysmë të fshehur nën flokët e gjatë.

- Asgjë nuk rregullohet tek ai njeri!- ia ktheu përhumbshëm ajo.- Kafka e tij bën çika-çika edhe daltën e skulptorit më të mirë! Veç në hëngërt ndonjë plumb! Po kush ta vrasë?! Kujt ia mban t'i dalë përballë atij? Policia, po, nuk i bën gjë, se e ka blerë me lekë!...Fati im i keq!- rënkoj.

Farmacisti u përpoq ta qetësonte dhe iu lut që mos zhdukej sërisht.

- Në farmaci nuk ka kuptim të vi,- tha ajo,- por, ti, më prit të dielave paradite. Po erdha te nëna, do kthehem patjetër këtej. Ti, vetëm më ler këtë këmishën si shenjë në dritare, që unë ta di, je brenda apo jo!

Nga ajo ditë këmisha e farmacistit ngeli si një zog i harruar në dritare, në diell e në shi. Ai nuk doli më asnjë të dielë paradite, braktisi gjithçka, megjithëse e dinte se Rajmonda nuk vinte dot më shumë se një herë në muaj, por ai priste dhe ndjente se po lidhej gjithmonë e më shumë me këtë krijesë magjike, aq sa kishte mbushur muret e dhomës me reliket e saj, me ato veshje intime e copa flokësh, që shpërndanin aromën e veçantë në atë dhomë të mbushur plot me pritje torturuese. Një diell sikur lindte mes tyre, kur i shoqi i saj derdhte një lumë gjaku e zhdukej ca kohë për të humbur gjurmët, por bisha kthehej përsëri, më i egër, më kriminel se më parë dhe kështu shpaloj sërisht pritja e pafund, ankthi se mos ai kuptonte diçka, pasigurija torturuese për Rajmondën.

- Kështu nuk shtyhet më!- tha një ditë i trishtuar farmacisti me Rajmondën të

strukur në kraharonin e tij.

Jashtë binte një shi i shtruar, që sikur përkundte në djep gjithësinë.

- Si t'ia bëjmë?- pyeti e trembur tjetra.

Ajo druhej mos farmacisti hiqte dorë. Atëherë nuk do të kishte më asnjë gëzim për të!

- Ta shes farmacinë dhe ikim fare nga Shqipëria!- tha befasi ai.- Unë mund të punoj kollaj fare andej...

- Do na gjejë!- e ndërpreu ajo.

- Si do na gjejë?

- Do na gjejë! Është e kotë!- tha ajo.

- Por kështu nuk shtyhet më!- përsëriti farmacisti.- Unë nuk jetoj dot më larg teje!

- As unë,- dënosi ajo dhe ai vajtim i dhimbshëm u ende gjatë në muret e dhomës. Përballë tyre, një Krisht i kryqëzuar i pikturuar keq, sikur i ngushëllonte me atë gjakun që i kullonte përjetësisht. Kur s'kisha fat as unë, ju nuk do të keni e s'do keni!...Në gjithë trishtimin e vajtimin njerëzor e të motit bashkë vetëm një dritë shprese hynte nga dritarja: ishte zëri i një fëmije, i cili i hakërruhej dikujt me moskokëçarje e inat fëmënor, pa marrë parasysh asgjë!

#### 4.

Aty nga fillimi i dimrit Bishës papritur e pakujtuar i vranë një nga njerëzit e tij më të afërt. I vranë krahun e djathtë në rrethana krejt të çuditshme. Më saktë, besniku i tij u gjet i vdekur mbi timonin e makinës së tij në rrugën që të çonte në Malin e Dajtit. Në fyt kishte një plagë të hollë e të thellë thike të mprehtë. Ç'ishte më e keqja, vrasësi ia kishte grabitur të gjitha sendet e floririt viktimës dhe në një copë letër të shkruajtur keq paralajmëronte Bishën se tani po i vinte radha atij vetë. Bisha uluriu nga tërbimi. Askush nuk do të guxonte ta bënte këtë punë, as policia kriminale vetë, veç një bande rivale, që nuk ia harronin një përleshje të vjetër në një bilardo të periferisë, ku vetëm ndërhyrja e Zotit i shpëtoi njerëzit nga masakra. Atëherë Bisha kishte qëlluar me breshëri automatiku kundër rivalëve, por nga plumbat pasojat u reduktuan vetëm me lënien sakatë të përjetshëm të tre rivalëve. Mbi varrin e besnikut të tij Bisha u betua për hakmarrje. Dhe, pa u mbushur muaji, policia çoi në morg trupat e dy kundërshtarëve të Bishës. Ata ishin sharruar nga plumbat pa fund në një kryqëzim, në pritje të hapjes së semaforit. Kishte filluar një luftë e tmerrshme, që iu krijoi sërisht një kohë qetësie farmacistit me Rajmondën. Bisha, që e dinte mirë se në ç'luftë me fund të largët qe futur, nuk donte më njeri nëpër këmbët e tij. Ai vetë flinte diku në mal të Dajtit dhe, puna e parë që bëri,urdhëroi Mondën të nisej te nëna e saj.

“Ti, nuk do dalësh më rrugëve!- e urdhëroi ai.- Edhe kur të të dërgoj lajm unë, do ta zbatosh vetëm po të dërgova unazën time!...”

Tani ajo i kalonte mbasditeve shpesh te farmacisti. Nuk druhej nga Bisha. E dinte se ai nuk mund të qarkullonte nëpër Tiranë, por, edhe sikur të ndodhte kjo gjë, Monda ruante një rrugëdalje. Do t’i thoshte Bishës se kishte qenë për vizitë te një shoqja e saj e feminisë, e cila banonte në shkallën e farmacistit dhe Monda kthehej vërtet shpesh te mikja e saj e vjetër për të pirë një kafe. Tani Monda nuk vinte më vetëm për të bërë seks te farmacisti. Jo rrallë ajo i hynte pastrimit të asaj shtëpije beqari dhe, pa kaluar shumë kohë, apartamenti i vogël mori një pamje të re. Mondës i qe bërë fiksion se Zoti po e shikonte më në fund.

- Më duket sikur ai nuk do të kthehet më!- i tha një ditë Rajmonda farmacistit, teksa po dilnin të dy nga dushi i ngrohtë.- Këtë herë i ka hyrë një sherri të madh...E di si më tha një ditë nëna e tij? As dy jetë nuk i dalin Gimit tim, për t’i mbyllur këto hesape tamam!...Ajo është vërtet plakë e zgjuar, tip fallxhore, çdo gjë e parashikon!...

- Dhëntë Zoti!- uroi ai.

Dhe Bisha vërtet s’mund të kthehej. Vrasjet vazhdonin dhe tani atij i qenë vrarë edhe dy miq të tjerë, ndërkohë që edhe Bisha nuk kishte qëndruar spektator në mal. Kasaphana duhej të qe shtrirë shumë, derisa një ditë e thirrën edhe Mondën në polici. Hetuesi kërkonte Bishën. Ai mendonte se ajo duhej ta dinte ku strehohej.

- Që kur u vra shoku i tij i ngushtë, mua ai më largoi nga shtëpia,- tha Monda.- Nga ajo ditë, unë vetëm një herë kam shkelur atje...

- Ti, nuk e di ku strehohet?

- Jo! Dhe u bënë katër muaj që nuk më ka kërkuar e dërguar asnjë lajm. Herën e vetme që shkova në shtëpi, për të marrë ca plaçka, më thanë sikur ka ikur jashtë shtetit...

- Këtu është!- tha hetuesi.- Një ditë ai do të bëhet i gjallë dhe, kur të ndodhë kjo gjë, mos harro t’i thuash, se, po deshi ta shpëtojë kokën, të dorëzohet menjëherë...Unë i dola borxhit!

Mondën e trembi policia. Nuk kishte hyrë kurrë nëpër ato labirinte, por burri i shoqes së saj, që punonte në Shërbimin Informativ, e qetësoi:

- Ata e dinë se ti nuk ke gisht në këtë mes, por, sidoqoftë, kanë dashur t’i dërgojnë një lajm Bishës. Kjo luftë e tij tani është bërë vërtet problem. Mund të ketë edhe të vrarë të tjerë...

Dhe, vërtet, atë kohë Bisha qërroi një rival tjetër, këtë herë me dorën e tij m’u në mes të Tiranës. Ishte hera e parë që ai ekspozohej kështu. Policia iu vu nga mbropa, kreu gjithë vendet ku ai mund të fshihej, kontrolloi dy herë edhe në shtëpinë e nënës së Mondës, po nuk i ra dot Bishës në gjurmë.

- Po më dëgjove mua,- e këshilloi hetuesi Mondën gjatë njerit prej kontrollove

në mesnatë,- mos bëj fëmijë me Bishën! Të garantoj se nuk do ta shohë kurrë të atin me sy!...

Monda u mendua. Ajo vendosi t'i dërgonte një lajm Bishës për gjithë ç'po ndodhte e po dëgjonte. Më shumë kishte hallin për t'ia bërë të qartë tjetrit mos dukej nga shtëpia e nënës së saj, sepse e ruante policia. Kështu do të ndihej fare e qetë me farmacistin...

“ Do më hanë mutin!”, ishte përgjigjia e Bishës.

Dy herë policia arriti t'i binte në gjurmë, po të dyja herët kapi vetëm armët e tij. Ai arriti t'iu shpëtonte dhe, si për të përgënjeshtuar zërat e hapur, se Bisha që larguar nga Shqipëria, ekzekutoi edhe një rival tjetër në një bilardo të Tiranës. Tani emri i tij mori famë. Legjendat e thurrura rreth tij thoshin se ai e kishte ndryshuar portretin përmes një operacioni plastik, gjë që e bënte të pamundur identifikimin e Bishës, por Monda nuk i besonte këto përralla.

- E ku ndryshon dot fytyra e tij!- i tha një ditë farmacistit.

Megjithëse e dinte që ai tani nuk merrej dot me të, Monda i trembej për vdekje Bishës. Druhej se tjetri do kishte ngarkuar dikë, që mos ia ndante sytë Mondës dhe ishte e sigurt, se po të mernte vesh ç'po ndodhte, ai do linte çdo hakmarrje në mes për t'u marrë me atë e me farmacistin. Ky mendim Mondën e terrorizonte, por farmacisti ndihej i qetë.

- Kurrë nuk do ta marrë vesh!- përsëriste ai, me kokën të futur brenda gjinjve të saj. Atij nuk i pëlqente të mendonte të tilla gjëra me Mondën në shtrat. Farmacisti ia hapte flokët e gjatë mbi gjinj e mbi bark, kundronte atë figurë magjike të veshur si me mëndafsh të zi dhe humbiste në zjarrin që ndizej brenda atij trupi, duke mbushur me lumturi gjithçka.

“ Të dua!”, përsëriste gjithmonë e më shpesh në ekstazë ai.

“ Ma thuaj prapë!”, lutej në prag të orgazmës ajo.

Kështu shtyheshin ditët e tyre, të mbushura me seks e dashuri, me rrëqe ujërash të ngrohta në dush, me puthje gjymtyrësh e betime dhe me një ankth, që qëndronte si hije e zezë kudo.

5.

Atëherë kur dara rreth Bishës ishte shtrënguar më shumë se kurrë, ai doli edhe një herë në skenë. Ishte po ai portret, veçse tani më i egër. Kishte qëndruar në prag të farmacisë dhe nuk ia ndante sytë farmacistit. Farmacisti u drodh, kur e pa.

“ Mbaroi gjithçka!”, mendoi dhe, nëpër atë panik, u mat një herë t'ia mbathte nga dera e pasme. Por s'kishte pikë fuqije dhe, ç'ishte më e keqja, ndjente një nevojë të tmerrshme për të urinuar.

“ Për ty kam ardhur, i tha Bisha. Mbylle farmacinë dhe hajde me mua!”

Ishte e kotë ta pyeste tjetrin. E dëgjoi si i hipnotizuar, mbylli farmacinë, hypi

në makinën që e priste tjetrin te dera dhe u bë grusht në sediljen e pasme. Farmacistit i vunë një kapuç në kokë dhe ai nuk pa më asgjë, deri sa e futën në një shtëpi, që nuk merrej vesh ku ndodhej, pasi edhe dritaret qenë të gjitha të mbuluara.

“Gjyqi i fundit!”, mendoi farmacisti, teksa po i hiqnin kapuçin. Rrezik askush nuk do ta gjente më trupin e copëtuar të tij dhe luti Zotin që gjithçka të përfundonte sa më shpejt me një plumb.

- Ç’pate me mua?- belbëzoi ai, duke u dridhur para Bishës.

- Kemi një të sëmurë,- ia ktheu vrazhdë Bisha.

Farmacisti u këput si i sharruar mbi një minder të vjetër dhe një curril urine i ra nga pantalloni i majtë. Dridhej i tëri, por një flakurimë e rëndë e Bishës e solli në vete.

- Mblidh veten, se nuk kemi kohë të merremi me ty, shurranjos!- briti tjetri.

I sëmuri dridhej i gjithi. I kërcisnin dhëmbët në mënyrë të frikshme dhe farmacisti u tmerrua, kur i dalloj një plagë të thellë në këmbë, që po qelbëzohej e tëra. U ul, shkruajti një letër dhe ia zgjati Bishës.

- Dikush duhet të shkojë tani te një miku im dhe t’i marrë këto ilaçet. Ky është keq!

Pa ia kërkuar askush, farmacisti i qëndroi tjetrit tre ditë pa lëvizur te koka. Ai ishte një djalë i ri, jo më shumë se 20 vjeç, që kërkonte mes përçatjeve nënën, por, kur erdhi në vete, fytyra iu egërsua sërish dhe, puna e parë që bëri, ishte dora që kërkoi automatikun e vogël. Farmacisti nuk ia ndante sytë.

- Shërohu një herë, pastaj kape automatikun!- i tha.

- Ti, shiko plagën dhe mos llap shumë!- ia ktheu tjetri.

- Më fal!- u tërhoq farmacisti, pa e parë Bishën, që po dëgjonte nga dera e hapur e dhomës.

Bisha i bëri një shenjë farmacistit ta ndiqte në dhomën tjetër.

- Si është?- e pyeti.

- Tani ia hodhi,- tha farmacisti,- vetëm i duhet ndërruar plaga çdo ditë.

- Sa të bën pazari?

- Asnjë lek!- ia ktheu ftohtë farmacisti, por Bisha i rراسi një shuk me dollarë në dorë dhe, pa i folur as edhe një fjalë, i vuri ngadalë kapuçin e zi në kokë. I ra lehtë shpatullave dhe e këshilloi me atë tonin e tij që nuk paralajmëronte asgjë të mirë:

- Bashkë nuk jemi parë! Këtë mos e harro!...

E la dikush para derës së farmacisë dhe, kur u pa në pasqyrë, farmacisti u tremb nga fytyra e tij. Ishte i parruar dhe sytë gri sikur i qenë zbardhur. Gjëja e parë që i erdhi në mend ishte Monda. As vetë nuk e mori vesh si arriti në shtëpi, si qëndroi në dritare, deri sa tjetra e pa, si e priti ardhjen e tjetrës, si i shpjegoi shkurt Mondës ç’kishte ndodhur. Ra menjëherë në një gjumë të rëndë, pa ëndrra, dhe u

zgjua të nesërmen. Nën dush ai i shpjegoi edhe një herë gjithçka Mondës.

- Unë u tmerrova,- dënesi tjetra.- Mendova se të kishin vrarë...

- Më mirë të më kishin vrarë!- trishtoi ai, duke kujtuar atë curril të hollë urine, që varej nga këmbët e tij.

- Larg qoftë!- briti Monda, e lidhur pas trupit të tij nën mjegullën e avujve të ngrohtë.

Gjinjtë e saj tani ishin tepër tundues, ijet joshëse kërkonin pëllëmbët e mëdha, vithet e ngritura lart sikur i tërhiqnin drejt vetes ledhet dhe rënkimet mbushën sakaq banjën.

“ Të dua!”, belbëzoi ai.

Monda rënkoi.

“ Ma thuaj prapë!...Prapë!...”

Ai rënkim i ethshëm sikur i ngjante një vajtimi. Frika, ankthi, tmerri, kënaqësija, prehja, paqja përziheshin keqas bashkë me trupat e xhveshur, kurse nga dritarja e banjës sikur zgjasnin kokat e tyre përjetësija me vdekjen. Kush po më shikon, mendonte me vete farmacisti. Pyetja ishte fare e thjeshtë, mirëpo ai nuk dinte si t’i përgjigjej. Vetëm një gjë dinte mirë: jeta e tij kishte ndryshuar rrënjësisht. Thellë, turbull, ai gjykonte se ndihej i lumtur vetëm sepse për këtë lumturi kishte rrezikuar shumë,- pat lënë me një kokëkrisje të habitshme jetën e tij për kapar! Kishte luajtur me gjithçka për gjithçka!

6.

Frika ishte bërë torturoese edhe për Mondën. Tani ajo shihte vazhdimisht ëndrra gjumëprishëse, ku torturohej e vritej në lloj-lloj mënyrash kanibaleske. Kjo frikë, që po e gryente pak nga pak edhe farmacistin, i shtyu ata një pasdite të merrnin më në fund një vendim.

- Kështu nuk shtyhet vërtet,- tha ai, duke menduar si ta vazhdonte bisedën e vëshirë.- Unë kam fituar një bursë gjashtëmujore për kualifikim në Amerikë,- tha më në fund,- mbase është mirë të shkoj...Kështu zhduket edhe çdo dyshim, që mund të ketë lindur...

Ajo nuk fliste.

- Po unë, ç’të bëj?- trishtoi pastaj.

Nuk folën më. Shihnin secili për hesap të vet andej nga dritarja e dhomës, duke menduar të dy të njëjtën gjë, humbjen e njeri-tjetrit. Në këtë dhomë ishin ndërë të dy të lumtur në sfidën e madhe që i kishin bërë realitetit, në këtë dhomë ajo që ndërë një femër e lirë dhe e lumtur, ai-njeri! Ndarja do ta bënte sërish pa kuptim jetën e tyre, një jetë të zymtë, plot dhunë e vetmi.

- Ti, duhet të ikësh!- foli më në fund ajo.- Ik një herë, pastaj mbase gjehet

ndonjë zgjidhje. Vetëm më premo se do më shkruash!

- Të premtotj!- tha farmacisti, duke e përqaftuar.

Monda nuk u bë më e gjallë nga ajo ditë. Një zë i pëshpëriti në vesh të duronte e mos luante më me zjarrin. Ajo e diti si duroi një muaj, pa e takuar tjetrin, derisa ai u largua. E shihnte në ëndërr, bëhej gati mijëra herë të nisëj me vrap tek ai, por gjithmonë arriti të përmbahej. Vetëm se tani përlopte shpejt e nuk kishte më dëshirë të hante. Ajo fytyrë e bukur u hoq e kjo ia shtoi hirin. Çuditërisht, atë po e hante dashurija dhe ajo po ushqehet me dashuri! Qe krijuar një lidhje e habitshme mes njeriut e ndjenjës, një lidhje që i mbante të dy të gjallë, të bukur.

Tre muaj pas ikjes së farmacistit, Bishën e vranë. Atë e gjetën në një lokal të vogël në Malin e Dajtit të sharruar nga plumbat bashkë me të dashurën e tij në një pellg gjaku, që nuk dihej i kujt ishte. E vranë, duke ngrënë bukë, me një breshëri nga jashtë dritares të thërrmuar.

Monda nuk mori pjesë në varrimin madhështor aq të përfolur në gjithë vendin, ku qindra kriminelë betoheshin për hakmarrje e shtinin me breshëri automatiku në ajër, duke tmerruar gjithë të vdekurit, që preheshin në varrezën paqësore. Ajo i tregoi gjithçka në telefon farmacistit dhe ky iu lut të vinte pranë tij në Amerikë.

- Nuk jetoj dot pa ty!- tha ngadalë tjetri.

- Do vij!- i premtoi Monda.

Një muaj më pas ata përqafoheshin duke qarë në aeroportin e Nju Jorkut. Vetëm qanin dhe nuk flisnin asnjë fjalë, duke habitur edhe fytyrat indiferente të punonjësve të aeroportit.

Sot ata ndodhen ende në Amerikë. Monda është shtatzanë në muajin e tetë. Asaj ende nuk i besohet që shpëtoi gjallë nga Bisha, nga ai përbindësh, rreth të cilit vazhdojnë të thuren legjenda në Shqipëri.

- Vetëm Zoti mund ta bënte këtë gjë!- i thotë ajo herë pas here farmacistit.

- Po,- ia kthen ai,- vetëm Zoti!

- Gjynah, që është një i vetëm dhe nuk i ndihmon dot të gjithë!- shton ajo me atë mirësinë që nuk i plaket e mpaket kurrë.

- Vërtet gjynah!- ia kthen tjetri.

Pastaj të dy mendojnë për Zotin. Zoti është vërtet një krijesë e madhe, një çelës që zgjidh gjithçka. Pse nuk është edhe njeriu më pranë Zotit, më Zot, pyet rëndom ajo. Farmacisti mendoi një herë t'i tregonte Mondës, se nga Bisha e ka shpëtuar vetëm ai, por është betuar të mos flasë. Iu kujtohet pse hyri në gjithë atë luftë të përgjakshme me rivalët e tij Bisha? E, pra, krahun e tij të djathtë e vrau farmacisti! E therri si keç me bistrinë e tij, që e flaku pastaj të përgjakur në ferra. E bëri vetëm nga dashurija për Mondën! Këtë gjë e di mirë edhe një njeri tjetër në Tiranë, hetuesi, që e mban provën e krimit në kasafortën e tij personale. Por as ai nuk flet. Deri sa shteti ishte i pazoti ta bënte Bishën zap, do dilte një i zoti t'ia



tregonte vendin! Kjo është logjike për hetuesin e mësuar me krime e gjak. Vërtet atij nuk i është rritur rroga, por puna i është pakësuar. Indirekt, për të njëjtën pagë ai ka më pak punë, pra, i bije t'i jetë rritur rroga. Këtë ai e konsideron fitore, pozitivitet!

**NËNTOR, 1996**